

NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË PRODUKTIN E BRENDSHËM BRUTO NË KOSOVË

Nakije Kida

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në

Shkenca Ekonomike, profili Financë, për marrjen e gradës shkencore

“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Engjëll PERE

Numri i fjalëve: 64182

Tiranë, maj 2016

© DEKLARATA E AUTORËSIS :

Unë, e nënshkruara, deklaroj se kjo tezë është vepra ime origjinale dhe nuk është paraqitur për një diplomë në ndonjë universitet tjetër, dhe se të gjitha burimet e materialeve të përdorura për këtë tezë janë pranuar në mënyrë të rregullt.

ABSTRAKTI

Në përpjekje për të zënë hapin e vendeve të zhvilluara, gjë e cila ka ndodhur, ky punim analizon efektin e Investimeve të Huaja Direkte në rritjen ekonomike të vendeve të EQ, EJT dhe Kosova. I ndarë në dy pjesë, së pari një analizë makro një panel me të dhëna dytësore, studion efektin e IHD në rritjen ekonomike, hendekun e teknologjisë, rolin e kapaciteteve absorbuese lokale në kapjen e një përhapjeje, ndikimin e përhapjes së teknologjisë në produktivitetin e firmave lokale në vitet 2004-2014. Pjesa e dytë përmban një analizë përmes 306 pyetsorëve të strukturuar drejtuar investitorëve të huaj në Kosovë, e orientuar në dy drejtime: gjetjen e pengesave që hasën investitorët e huaj gjatë investimit në Kosovë dhe mundësi të shumta që ju ofron atyre Kosova.

Objekti ynë është marrëdhënia IHD-rritje dhe gjetja e faktorëve që kushtëzojnë praninë e investitorëve të huaj. Rrjedh natyrshëm pyetja kërkimore bazë: çfarë kushtesh në vendin pritës janë të rëndësishme për të shpjeguar ndryshimet në ndikimin e IHD-ve mbi rritjen ekonomike?

Përmes modelit të Boreinsztein, et al. (1989), teknikes GLS, metodave (FE) dhe (RE), rezultatet tregojnë se përhapja e teknologjisë dhe efektet grumbulluese jashtë (crowding-out) kanë ndodhur; gjetjet janë bërë përmes mekanizmave ndërvepues. Ndërsa Investimet e brendshme si të vetme, kanë një efekt pozitiv në rritje, ndërsa përfitimet vetëm nga kapitali human nuk janë arritur, vetëm nëse në nivel vendi 14% popullsisë arrin të ketë nga një diplomë të shkollimit të mesëm, kjo do të ndodhë. Së fundi, përmes dy ekuacioneve vijmë në përfundim se kemi lidhje të njëanshme pozitive në mes IHD dhe rritjes, rritja ekonomike tërheq fluksin e IHD ndërsa IHD nuk ka efekt në rritje. Rezultatet na kofirmojnë se investitorët e huaj hasën në pengesa të shumta por edhe në mundësi të shumta përfitimi në Kosovë. Rezultatet e studimit ndihmojnë në identifikimin e pengesave në përmirësimin e infrastrukturës fizike, institucionale dhe njerëzore për përfitime të mundshme nga prania e huaj.

Fjalë kyçe : *Rritja ekonomike, IHD, faktorët kushtëzues në vendin pritës, makro-panel, FE dhe RE, pyetsorët.*

ABSTRACT

In an effort to catch-up the pace of the developed countries which happened, this paper analyzes the effect of Foreign Direct Investment on economic growth of CE, SEE countries and Kosovo.

Divided into two parts, first a macro analysis a panel with secondary data, it studies the effect of FDI on the economic growth, the gap of technology, the role of the local absorptive capacities in the capture of an extension, the impact of the spread of technology in the productivity of the local firms in the years 2004-2014. The second part contains an analysis through 306 structured questionnaires to foreign investors in Kosovo, oriented into two directions: finding the obstacles encountered by the foreign investors while investing in Kosovo and numerous possibilities that Kosovo offers to them. Our objective is, FDI-growth relationship and finding the factors that influence the presence of foreign investors. The base research question naturally arises: what conditions are important in the host country to explain the changes on the impact of FDI on economic growth?

Model of Boreinsztein, et al. (1989), the GLS technique, (FE) and (RE) methods, the results show that the spread of technology and the crowding-out effects have occurred, the findings were made through interactive mechanisms. And, the domestic investments as single have a positive effect on growth, whereas the benefits only from human capital have not been achieved, only if 14% of population at the national level manage to have a secondary school diploma, it will happen. Finally, through two equations we conclude that there is a unilateral positive link between FDI and growth, economic growth attracts FDI inflow while FDI has no effects on growth. The results confirm that foreign investors have faced numerous obstacles as well as numerous beneficial opportunities in Kosovo. Study results help the identification of barriers in improving of the physical, institutional and human infrastructure for potential benefits from the foreign presence.

Keywords: *Economic growth, FDI, absorptive capacity, macro-panel, questionnaires.*

Dedikimi :

Gulinda dhe Oesa Morina,

vajzave të mia

FALENDERIME

Falënderoj profesorin tim të nderuar Dr. Engjëll PERE për përkrahjen e tij, këshillat, sugjerimet dhe komentet konstruktive që nga fillimi deri në përfundimin e këtij punimi.

Falënderoj Universitetin European të Tiranës në Tiranë, për sigurimin e një mjedisi të favorshëm për të ndërmarrë këtë studim.

Unë jam gjithashtu mirënjohës për miqtë e mi që kanë dhënë kontribut të konsiderueshëm për këtë studim. Së fundi, falënderimimi i veçantë është për familjen time, bashkëshortin tim Mentorin, që më mbështeti moralisht.

PËRMBAJTJE.....	vi
LISTA E SHKURTESAVE.....	xi
LISTA E TABELAVE	xii
LISTA E FIGURAVE.....	xiii
LISTA E GRAFIKËVE.....	xv
KAPITULLI I : Hyrje.....	1
1.1 Parathënje.....	1
1.2 Shtrimi i problemit.....	8
1.3 Qëllimi / Objektivat e studimit.....	12
1.4 Burimet e referimit.....	17
1.5 Pyetjet kërkimore dhe Hipotezat.....	18
1.6 Përshkrimi metodologjisë dhe metodave kërkimore.....	21
1.7 Mundësitë dhe kufizimet e studimit.....	23
1.8 Rëndësia e Studimit.....	25
1.9 Struktura e disertacionit.....	28
KAPITULLI II: Aspekti teorik i modeleve të rritjes ekonomike dhe	
Investimeve të Huaja Direkte.....	31
2.1 Modelet e rritjes ekonomike.....	31
2.1.1 Modeli egzogjen i rritjes.....	33

2.1.2 Modeli endogjen i rritjes.....	37
2.2 Shqyrtim i literatures teorike të Investimeve te Huaja Direkte.....	41
2.2.1 Klasifikimi i Investimeve të Huaja Direkte sipas vendit të origjines.....	42
2.2.2.Klasifikimi i IHD sipas motivit të investitorit.....	45
2.2.3 Investimet e Huaja Direkte sipas formës së organizimit.....	47
2.2.3.1 Modelet teorike të Investimeve të Huaja Direkte (IHD).....	48
2.3 Teoritë e Investimeve te Huaja Direkte.....	49
2.3.1 Klasifikimi i Teorive Ekonomike të Tregtisë dhe IHD-ve.....	51
2.3.2 Teoritë klasike të ndërkombëtarizimit të IHD në nivel mikro.....	53
2.3.2.1 Teoria e avantazheve specifike të ndërmarrjes.....	55
2.3.2.2 Teoria e ciklit jetësor të produktit.....	57
2.3.2.3 Teoria e ndërkombëtarizimit (brendësimit).....	59
2.3.2.4 Teoria (OLI) e prodhimit ndërkombëtar dhe evolucioni i saj.....	60
2.3.2.5 Avantazhet e teorisë ekektike Dunning.....	64
2.3.2.6 Infrastruktura institucionale-zgjerimi i kornizes Dunning's.....	66
2.4 Diskutime dhe debate empirike- IHD dhe rritja ekonomike.....	70
2.4.1 IHD burim i kapitalit fizik.....	71
2.4.2 IHD kanal i përhapjes së teknologjisë.....	74
2.4.3 Kapaciteti absorbues (niveli i pragut) dhe IHD në vendin pritës.....	77
2.4.4 Roli i IHD në rritjen ekonomike (diskutime dhe debate empirike).....	81
2.4.4.1 Marrëdhënia mes rritjes ekonomike, IHD-ve dhe investimeve të brendshme.....	84

KAPITULLI III: Stabiliteti Makroekonomik dhe Institucional përcaktues i IHD dhe rritjes ekonomike në Kosovë.....88

3.1 Vështrim i përgjithshëm imazhit të Kosovës.....88

3.1.1 Zhvillimi institucional dhe mbështetja ligjor për investimet e huaja në Kosovë92

3.1.2 Indikatoret e të bërit biznes në Kosovë.....99

3.2 Stabiliteti makroekonomik përcaktues i rritjes ekonomike dhe i IHD.....104

3.2.1 Investimet e Huaja Direkte në Kosovë.....113

3.2.2 Dinamika e IHD në Kosovë.....117

3.2.3 Investimet private, IHD dhe kapitali human në Kosovë.....122

3.2.4 Kompanitë e huaja që veprojnë në Kosovë.....125

3.2.5 Shpërndarja e IHD sipas aktivitetit ekonomik dhe origjinës në Kosovë.....132

3.2.5.1 IHD sipas origjinës në Kosovë.....134

3.3 Rrjedha globale e IHD sipas grupimit të ekonomive dhe efektet në vendet pritëse
analizë krahasuese me Kosoven.....135

3.3.1 Një pasqyrë IHD-ve dhe faktorëve kushtëzues në EQ dhe EJT dhe Kosovë.....139

3.3.2 Analizë krahasuese IHD në vendet EQ, EJT dhe Kosovës.....150

KAPITULLI IV: Metodologjia e Studimit.....162

4.1 Metodologjia e të dhënave parësore.....162

4.2 Metodologjia e të dhënave dytësore.....	166
4.3 Përshkrimi i modelit teorik.....	169
4.3.1 Modeli Empirik.....	184
4.3.2 Përshkrimi i metodave të studimit në analizen e të dhënave panel.....	188
4.3.2.1 Metoda e Efekteve Fikse.....	190
4.3.2.2 Metoda e Efekteve të Rastit.....	193
4.3.2.3 Testi Hausman.....	195
KAPITULLI V: Rezultatet e Studimit.....	197
5.1 Rezultatet empirike ekonometrike të studimit.....	197
5.1.1 Paraqitja e statistikave përshkruese të dhënave panel.....	199
5.1.2 Testi i përcaktimit të modelit Efekt Fikse kundrejt Efekteve të Rastit.....	201
5.1.2.1 Zgjidhja e Hipotezes së parë dhe rezultatet e tabelave.....	204
5.1.2.2 Rezultateve përfundimtare pas diagnozifikimit të testeve GDP _{gpc} -e varur.....	213
5.1.3 Zgjidhja e Hipotezës dytë -IHD e varur.....	232
5.1.3.1 Rezultatet përfundimtare modeli Efektet e Rastit (RE).....	236
5.1.4 Efekti i njëanshëm IHD dhe rritje ekonomike.....	242
5.2 Analizë përshkruese pyetsorëve.....	245
5.2.1 Pengesat që hasën investitorët e huaj në Kosovë.....	245
5.2.2 Mundësitë dhe planet e Investitorëve të Huaj për të investuar në Kosovë.....	270

KAPITULLI VI: Përfundimi dhe Rekomandimet	279
6.1 Përfundimet për analizen ekonometrike dhe analizen e pyetsorëve	279
6.2 Rekomandimet e studimit	292
SHËNIME: Këtu përfshihet i gjithë materiali shtesë nga kapitulli II	300
SHTOJCA A: Këtu përfshihet i gjithë materiali shtesë nga kapitulli I, IV,V	305
SHTOJCA B: Këtu përfshihet i gjithë materiali shtesë nga kapitulli V	324
Pyetsori 1	325
Pyetsori 2	329
REFERENCAT	333

LISTA E SHKURTESAVE

PBB - Produkti i Brendshëm Bruto

IHD- Investimet e Huaja Direkte

INV.BR-Investimet e brendshme

HC- Kapitali Human

IHD*HC-IHD në ndërveprim me HC

IHD*INV.BR.-IHD në ndërveprim me INV

GDPgpc- Norma e rritja e GDP-së për frymë

REM-Remitancat

SHP.P.K.F.Q- Shpenzimet e Përgjithshme të Konsumit Final të Qeverisë

APIK- Agjensioni për Promovimin e Investimeve

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

ASK - Agjensioni i Statistikave të Kosovës

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

NMV - Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme

BB - Banka Botërore

CEFTA - Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Europës Qendrore

MIGA - Agjensia për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe

KIESA - Agjensia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

WDI - Indikatorët e Zhvillimit Botëror

WIR - Raporti Botëror i Investimeve

UNCTAD - United Nations Conference on Trade and Development

MNC - Korporata Multinacionale

GLS –Katrorë të Vegjël të Përgjithësuar

LS – Katrorët e Vegjël

FE - Efektet Fikse

RE – Efektet e Rastit

LISTA E TABELAVE

Tabela nr.1. Variablat e regresionit.....	305
Tabela nr.2. Mostra e vendeve të përfshira në studim.....	309
Tabela nr.3 IHD vertikale dhe horizontale.....	43
Tabela nr.4 Modelet ekonometrike (faqja e shenimeve).....	300
Tabela nr.5 Klasifikimi në tri klasa i teorive ekonomike.....	50
Tabela nr.6 Teoritë dhe përcaktuesit e IHD-ve (faqja e shenimeve).....	302
Tabela nr.7 Konfigurimi i tre grupeve të avantazheve të Duning's	67
Tabela nr.8 IHD dhe rritja ekonomike (faqja e shenimeve).....	303
Tabela nr.9 Efektet negative dhe të dobëta në mes të IHD-ve dhe rritjes ekonomike.....	304
Tabela nr.10. Të bërit biznes, indikatorët për Kosovë.....	99
Tabela nr.11. Krahuesshmëria e disa treguesve me disa vende të EJT8.....	102
Tabela nr.12. Treguesit makroekonomikë në Kosovë në vitet 2008-2013, në milion €.....	108
Tabela nr.13. Komponentet e IHD para korrigjimit të statistikave 2014.....	114
Tabela nr.14. Elasticiteti i IHD, korrigjimet e statistikave të fundit, 6/2015.....	115
Tabela nr.15. Numri i ndërmarrjeve sipas origjinës (2000/2014).....	129
Tabela nr.16. Statistika përshkuese e të dhënave panel për vitet 2004-2014.....	200
Tabela nr.17. Zgjedhja FE kundrejt RE.....	205
Tabela nr.18. Vlersimi i testit Hausman.....	207
Tabela nr.19. Rezultatet e vlersimit në bazë të FE shkalla e rritjes së GDP _{gpc}	214

Tabela nr.20.Vlersimi i testit Hausman	233
Tabela nr.21.Zgjedhja RE kundëjt FE.....	234
Tabela nr.22.IHD dhe rritja ekonomike - Rezultatit përmes metodës RE.....	238
Tabela nr.23.Vlersimi i testit Hausman për FE dhe RE.....	242
Tabela nr.24. Testi parwise i shkaktësis Granger	243
Tabela nr.25. Vertetimi i Hipotezave-Rezultatet.....	242
Tablela nr 26. Numri i të punësuarve sipas viteve.....	249
Tabela nr.27.Gjetja e madhësis së mostrës së pyetsoreve (shtojca B).....	324
Tabela_a. Testi i percaktimit të modelit FE kundëjt RE (shtojca A).....	312
Tabela_b. Testi i percaktimit të modelit RE kundëjt FE(shtojca A).....	313
Tabela_c. Hausman FE/RE (shtojca A).....	314
Tabela_d. Testimi me Efektet Kohore Fikse(shtojca A).....	315
Tabela _e. Testimi për Heteroskedasticitet (shtojca A).....	316
Tabela _f. Matricat e Korrelacionit - Korelacioni i shumëfishtë (shtojca A).....	317
Tabela_g . Matricat e Korrelacionit –rëndësia (shtojca A).....	317

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Statistika e treguesve vital të ekonomisë së Kosovës.....	90
Figure 2: Tregu i punës.....	111
Figura 3: Vitet e themelimit të biznesit.....	248
Figura 4: Vitet e të bërit biznes në Kosovë.....	249
Figura 5: Renditja e ambientit të biznesit.....	251
Figura 6: Mundësi të mira për investime.....	252
Figura 7: Kosova vend qendror në rajon.....	253
Figura 8: Forca e punës e kualifikuar mirë me kosto të ulët dhe konkurruese.....	254
Figura 9: Legjislacioni modern dhe i ngjashëm me BE-në.....	256
Figura 10: Sistem bankarë i përgjegjshëm.....	256
Figura 11: Qasje të lirë në tregun e BE-së.....	257
Figura 12: Qasje të lirë në tregun e CEFTA-s.....	258
Figura 13: Dogana.....	258
Figura 14: Stimujt e taksave.....	259
Figura 15: Nxitje e investimeve.....	260
Figura 16: Valuta: Euro.....	260
Figura 17: Bizneset moderne mbështeten nga institucionet.....	261
Figura 18: Pengesat që hasën Investitorët e Huaj –Kufizimet Tregtare.....	261

Figura19: Pengesat që hasin Investitorët e Huaj– Procedrat burokratike.....	263
Figura 20: Reformat e administrates qeveritare.....	264
Figura 21: Reforma në thjeshtimin e rregullave dhe procedurave tatimore	266
Figura 22: Veprimet tjera të qeverisë që do të kontribonin në përmirësimin e biznesit.....	268
Figura 23: Herë e parë që është investuar në Kosovë.....	269
Figura 24: Si jeni informuar për Kosovën.....	270
Figura 25: Planet në të ardhmen për të investuar në Kosovë.....	271
Figura 26: Sa tërheqës është situata e investimeve në Kosovë.....	271
Figura 27: Cilësinë e informacionit në lidhje me Mjedisin e biznesit në Kosovë	273
Figura 28: Zona juaj më me interes për të investuar.....	274
Figura 29: Madhësia e investimit që Investitorët e Huaj do ta bëjnë në vitin 2015.....	277
Figura 30: Arsyet që Investitorët e Huaj hezitojnë të investojnë në Kosovë.....	277
Figura 31: Simujt e veçantë që duhet të bëjë qeveria.....	278

LISTA E GRAFIKËVE

Grafik nr.1.Vlerat e GDP-së , GDP për frymë dhe popullsa sipas viteve.....	105
Grafiku nr.2. Niveli i pagës minimale në Ballkan.....	110
Grafiku nr.3. Pasqyra e rritjes ekonomike në përqindje sipas viteve.....	112
Grafik nr.4. Prurjet e IHD (në milionë US\$) dhe GDP reale në Shqipëri.....	118
Grafik nr.5. Prurjet e IHD (në milionë Euro) dhe GDP real në Kosovë.....	119
Grafiku nr.6. Përqindja e IHD në GDP për periudhën 2000-2013.....	121
Grafik nr.7.Investimet e.Brend., IHD dhe IHD*HC në Kosovë, 2004-2014, në US\$.....	123
Grafiku nr.8. Performanca e IHD *HC dhe INV.BR*HC.....	124
Grafiku nr.9. Kompanitë huaja sipas sektorëve të ekonomisë.....	125
Grafiku nr.10. Kompanitë e huaja me 100% kapital të huaj 2000-14.....	126
Grafiku nr.11.IHD në Kosovë sipas aktivitetit ekonomikë në %	132
Grafiku nr.12. Fluksi hyrës i IHD në botë në çdo pesë vite (1970-2013).....	136
Grafik nr.13.Trendi global i IHD-ve sipas grupimit të ekonomive, çdo pesë vite.....	138
Grafiku nr.14.IHD neto në Ballkan, vitet 2005-2012.....	138
Grafiku nr.15.Mesatarja e IHD ne 24 vende europiane për vitet 2004-2014.....	140
Grafiku nr.16. Vlersimi i performances së PBB-së, 2003-2014 në 24 vende europiane...	143
Grafiku nr.17. Mesatarja e rritjes së GDP për frymë për 11 vite, në 24 vende europiane..	145
Grafik nr.18. INV.Brendshme (GCFC) si përqindje e GDP-së për 24 vende europiane...	146

Grafiku nr.19.Remitancat, mesatarja vjetore për vitet 2004 -2014.....	148
Grafiku nr.20.Mesatarja e Shpenzimeve të Përgjithshme të Konsumit Final të Qeverisë..	148
Grafik nr.21.Performanca e IHD ne vendet e ballkanit (IHD në vitin 2004 dhe 2014).....	151
Grafik nr.22. Hyrjet neto të IHD në Kosovë dhe Shqipëri, 2004-2014.....	152
Grafik nr.23.Hyrjet neto të IHD në Maqedoni dhe Mal i Zi 2004-2014.....	153
Grafik nr.24.Hyrjet neto të IHD në Kroaci dhe Bosnjë Hercegovina, 2004-2014.....	154
Grafik nr.25.Hyrjet neto të IHD në Serbi dhe Slloveni, 2004-2014.....	155
Grafik nr.26. Hyrjet neto të IHD në Bullgari dhe Rumani, 2004-2014.....	156
Grafik nr.27. Hyrjet neto të IHD në Hungari dhe Poloni, 2004-2014.....	157
Grafik nr.28. Hyrjet neto të IHD në Portugali dhe Republika Çeke.....	158
Grafik nr.29: Hyrjet neto të IHD në Republiken Sllovake dhe Estoni 2004-2014.....	158
Grafik nr.30. Hyrjet neto të IHD në Lituani dhe Suedi, 2004-2014.....	159
Grafik nr.31. Hyrjet neto të IHD në Holandë dhe Austri, 2004-2014.....	160
Grafik nr.32. Hyrjet neto të IHD në Gjermani dhe Zvicërr, 2004-2014.....	161
Grafik nr.33. Hyrjet neto të IHD në Norvegji dhe Itali, 2004-2014.....	161
Grafiku nr.34. Vendndodhja e biznesit.....	246
Grafiku nr.35. Shpërndarja sipas llojit të biznesit.....	247
Grafiku nr.36. Të rinj të arsimuar, popullsi dinamike dhe njohja e gjuhëve.....	254
Grafiku nr.37. Telekomunikacioni modern në Kosovë.....	255

Grafik nr.38. Pengesat që hasen Investitorët e Huaj – Korrupsioni dhe nepotizmi.....	262
Grafik nr.39. Pengesat që hasen Investitorët e Huaj-Infrastruktura dhe mjedisi fizikë.....	264
Grafik nr.40. Heqjen e procedurave të panevojshme të dhënies së lejeve për ndërtim....	265
Grafik nr.41. Futja e një mase të rreptë për të parandaluar korrupsionin.....	267
Grafik nr.42.Reforma në sistemin e arsimit.....	267
Grafik nr.43. Agjencia për Promovimin e Investimeve (APIK).....	275
Grafik nr.44.A do të investonit përsëri në Kosovë.....	276
Grafik nr.45. Shkalla e rritjes së GDPpër frymë në 24 vende europiane në 2004-2014....	318
Grafik nr.46.LoG_GDPGPC / Investimet e Brendshme/GDP.....	319
Grafik nr.47. IHD/GDP në US\$ (2004-2014).....	319
Grafik nr.48.Investimet e Brendshme/GDP.....	319
Grafik nr.49. Kapitali Human/ Popullsia.....	320
Grafik nr.50. Remitancat/GDP.....	320
Grafik nr.51. Shpenzimet e Përgjithshme të Konsumit Final Qeveritarë / GDP.....	321
Grafik nr.52.Shkalla e rritjes së GDP për frymë dhe kapitalit human.....	321
Grafik nr.53.Log_IHD/GDP (e varur) dhe Log_GDPgpc(e pavarur).....	322
Grafik nr.54. Log_GDP gpc dhe IHD në bashkëveprim me HC.....	322
Grafik nr.55.Log_rritja e GDPgpc për frymë dhe log_GDPfillestare)(lfitlog_GDPgpc logGDPfill).....	323

KAPITULLI I : Hyrje

1.1 Parathënje

Ndikimi i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në rritjen ekonomike në tre dekadat e fundit është debatuar nga studiues të shumtë. IHD janë parë si faktor i rritjes ekonomike sidomos në vendet në zhvillim. Efekti i drejtëpërdrejtë pozitivë i IHD në formë të burimit të financimit si kapital shtese në investime të brendshme dhe e efektit i tyre i tërthortë përmes përhapjes së teknologjis dhe njohurive, janë objekt studimi që materializohet përmes të dhënave dytësore. Për njohjen më gjithëpërfshirëse të këtyre marrëdhënjeve, efekteve, shkaqeve dhe pasojave në mes segmenteve të ndryshëm institucional dhe Investitorëve të huaj përdoren të dhënat parësore të mbledhura nga investitorë të huaj në Kosovë.

Në përgjithësi literatura ekonomike pas viteve të 90ta është fokusuar përveq IHD-ve edhe në cilësinë e institucioneve vendore si një faktor i rëndësishëm në tërheqjen e kompanive të huaja. Infrastruktura e mirë institucionale sidomos në vende në zhvillim konsiderohet si një thesar tërheqës për investitorë të huaj. Një formë sigurie në pritshmëritë e tyre krijojnë sidomos mbrojtja e të drejtave të pronës, të drejtave civile, niveli i ulët i korrupsionit, etj. Dobia nga institucionet e mira krijon më shumë siguri te investitorët dhe normat e fitimit të tyre, ndërsa zhytja në pasiguri buron nga efikasiteti i dobët i qeverisë.

Pra, ndërthurja e të dhënave mikse, parësore dhe dytësore dhe një analizë krahasuese të IHD dhe rritjes ekonomike në mes 24 vendeve europiane bënë këtë studim më të veçantë. Edhe qëllimi i të dhënave parësore, pra është vlerësimi empirik i infrastrukturës institucionale dhe të avantazheve tjera të vendndodhjes (Dunning's, 2006), që

materializohet përmes opinionit të investitorëve të huaj prezentë në Kosovë, duke mos përfshirë në pyetorë qëndrimet e qeverisë apo agjensioneve që promovojnë IHD në vend.

Megjithatë, arsye e fortë e ardhjes së investitorëve të huaj në Kosovë supozohet të jenë, politikat e hapura për investime, privatizimi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, liberalizimi i ekonomisë së tregut dhe integrimi në institucione ndërkombëtare, burimet natyrore dhe një forcë punëtore e lirë, e re në moshë, janë faktorë që nxitën ardhjen e investitorëve të huaj aktualë. Megjithë angazhimin e institucioneve në krijimin e një baze ligjore të përshtatshme për investitorë të huaj, mekanizmat institucionalë janë të pafuqishëm në zbatimin e drejtë të ligjit, kanë krijuar pengesa të ndryshme në punën e kompanive të huaja në Kosovë.

Për të pasur një pasqyrë sa më reale është krijuar një kombinim i shqyrtimit të literaturës nga motivi i investitorëve, klimës institucionale, kushteve makroekonomike, tregut të punës si faktorë të vendndodhjes, Dunning dhe Narula (1996). Sipas Lipsey (1999), investitorët e huaj shkojnë drejt vendeve me stabilitet politik dhe korrupsion të ulët, ndërsa sipas Lankes dhe Venables (1996), Bruno et al. (2008) janë reformat në tregun e kapitalit që tërheqin më shumë investitorë të huaj. Edhe të drejtat pronësore dhe tregu i punës janë theksuar nga Bevan, et al. (2004), si tërheqëse për investitorë.

Kombinime të tilla shumëdimensionale kanë shërbyer për të kuptuar faktorët që penguan apo ndihmuan investitorët e huaj, dhënien e një vlersimi sa më real të efikasitetit të administratës publike, shtrirjes së konkurrencës në të gjithë sektorët, rolin e informacionit dhe cilësinë e kapitalit njerëzor.

Analizimi i faktorëve që nxisin apo pengojnë ardhjen e investitorëve të huaj do të realizohet përmes pyetsorëve të strukturuar me bizneset e huaja në Kosovë. Informacioni dhe konkluzionet janë pjesë e opinionit të 306 investitoreve me 100% kapital të huaj në Kosovë, që do të shërbejnë për institucionet vendore të hartojnë politikat për tërheqjen e IHD-ve. Mbledhja e të dhënave parësore në teren dhe paraqitja e rezultateve në mënyrë përshkruese ka për qëllim gjetjen e pengesave dhe mundësive të shumta që kanë hasur investitorët e huaj në Kosovë. Interpretimi i rezultateve nga anketat ka për qëllim të përqoj një mesazh investitorëve të huaj se mund të gjejnë mundësi të mira për të investuar në Kosovë.

Konkurrenca globale ju ka dhënë rëndësi edhe më shumë institucioneve, dhe vetë investitorët janë të vetëdijshëm kur vendosin të investojnë duke zgjedhur vende me institucione më cilësore (Bevan dhe Estrin, (2004), Jakobsen (2011), Jakliq, et al (2011). Studimet empirike të kohëve të fundit kanë filluar të përdorin variabla institucionale si përcaktues të IHD. Magnus, J.R., Powell, O.R., Prüfer, P., (2008) diskutojnë efektet pozitive të mjedisit të mirë institucional në formën e një kuadri ligjor funksional që do të jetë i rëndësishëm për IHD.

Prandaj, fokus i punimit është edhe cilësia e institucioneve, roli i institucioneve formale dhe informale në dinamikën e IHD, efekti i distancës në hyrjet bilaterale të IHD duke specifikuar aftësinë e gravitetit. Njëkohësisht nuk lihet pa u përmendur se Kosovën e bëjnë atraktive kosto e punës dhe lëndëve të para dhe asetet me rëndësi strategjike rajonale.

Ndërsa përmes të dhënave dytësore analizon marrëdhënjen në mes IHD dhe rritjes ekonomike duke përfshirë një dimension hapsinor më të gjërë përveq Kosovës, me qëllim të krahasimit të Kosovës me vende tjera Europiane. Studimi i endogjenitetit të lidhjes në

mes IHD dhe rritjes ekonomike dhe rolit të përcaktuesve të tjerë (kapitalit human, investimeve të brendshme, remitancave dhe madhësis së qeverisë), përveç IHD në normën e rritjes së GDP për frymënë rritjen ekonomike në 24 vende pritëse. Në këtë pjesë të punimit kemi ndjekur qasjen e Boreinsztein (1998), një model endogjen që në vete përfshin kapitalin fizik, kapitalin human dhe përcaktues të tjerë, duke formuar një regresion më të gjerë. Borensztein et al. (1998) tregon se përhapjen e teknologjisë nga vende të zhvilluara në vende në zhvillim i bëjnë IHD përmes futjes së llojit të ri të kapitalit i cili kërkon njohuri të mjaftueshem në vendin pritës për të vënë në veprim teknologjinë dhe njohurit, duke përfituar nga përhapja e tyre.

Gjithashtu, rol të veçantë kanë zënë variablat bashkëvepruese siç janë IHD me kapitalin human (niveli sekondar i shkollimit) dhe investimet e brendshme në komplementaritet me IHD. Efektet e fluksit hyrës të IHD (kapitali fizik), efektet spillovers përmes transferit të teknologjisë dhe matja e aftësisë së kapaciteteve absorbuese (kapitali human) të vendit pritës është fokusi i kësaj pjese të studimit. IHD si kanali kryesor i tërheqjes së teknologjisë dhe njohurive përbën objektin e këtij hulumtimi dhe konsiderohet ndër temat më aktuale në Kosovë dhe rajon. Prandaj IHD, përveç se konsiderohet variabël e pavarur në ekuacionin e rritjes, ato konsiderohen edhe si variabël e varur në ekuacionin IHD funksion i variablave të pavarura (GDPg.p.c, kapitali human, investimet e brendshme, investimet e brendshme në bashkëveprim me IHD, remitancat dhe shpenzimet e përgjithshme qeveritare). Duke përdorur një kornizë teorike endogjene, modeli i Boreinsztein (1998) dhe teknikat ekonometrike, efektet fikse (FE) dhe efektet rastësore (RE) është ardhur deri te konkluzionet mjaft domethënëse.

Mungesa e një strukture ekonomike adekuate në Kosovë pamundësoi që të rriten të hyrat vetëm nga tregtia me importe dhe remitanca, përkundër ndihmës së vazhdueshme nga bashkësia ndërkombëtare, Misioni Ndërkombtar i Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Vitet e para karakterizojnë ardhjen e IHD nga vala e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë, rreth 500 sosh u privatizuan për 6 vitet e para. Viti 2006 vuri kornizat e para ligjore për sigurinë e investitorëve të huaj në Kosovë, i përmirësuar me Ligjin e ri Nr. 04/L-220 në dhjetor 2013 (www.mti-ks.org). Ndërsa Agjensioni për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK) bën promovimin e vazhdueshëm të vendit, Agjencia Shumëkombëshe për Sigurinë e Investimeve (MIGA), garanton investimet në Kosovë deri në shumën 20 milion euro. Në vazhdimësi bëhet privatizimi i sektorëve strategjikë siç janë (KEK-distribucioni nga KEDS, Aeroporti Adem Jashari nga Limak-Calik, Shar-cem, etj.),

Disponueshmëria e aseteve të tilla me rëndësi rajonale dhe pasuritë natyrore (energji, miniera, etj.) të pashfrytëzuara, kosto e ulët për lëndë të para dhe fuqi punëtore (paga mesatare 360 euro në muaj) nën mesataren rajonale e bëjnë Kosovën joshëse për investitorë të huaj. Procesi i lehtë, i thjeshtë dhe falas i regjistrimit të një kompanie në 22 qendra të njohura si “one-stop-shop” (www.arbk.org), pa kufizim lidhur me pjesën e kapitalit që subjektet e huaja janë të lejuara ta mbajnë, ligje liberale të punës, tregtia e lirë, regjim Autonom të Preferencave Tregtare të BE-së (ATP), trajtimi i privilegjuar i mallrave tëeksportuara në tregun e SHBA-së, Japonisë dhe Norvegjisë dhe inkuadrimi në CEFTA me rreth 28 milionë konsumatorë potencialë (distanca e ulët nga qendra të mëdha) është një udhërrëfyes për njohje më të mirë të Kosovës.

Këtë e plotëson edhe më shumë administrimi i ligjeve tatimore (www.atk-ks.org) të ngjashme me BE-në me normat tatimore më të ulëta në rajon (TAK -Tatimin në të Ardhura në Korparata 10 përqind, TAP -Tatimin në të Ardhura Personale me shkallët 4, 8, 10 përqind, TVSH-Tatimi mbi Vlerën e Shtuar me shkallë standarde 18 përqind dhe shkallëzim 8 përqind për disa mallra dhe shërbime, tatimi mbi Dividente me 0 përqind).

Stimulimi i prodhuesve dhe eksportuesve të huaj përmes lehtësive doganore (www.dogana-ks.org) të taksave në kufi, dhënia me qira e tokës prej 10 deri 99 vite (Ligji për Qeverisjen Lokale Nr. 03/L-040) dhe trajtimi në mënyrë të barabartë me bizneset vendore rrit motivin për një qëndrim më të gjatë në Kosovë. Ndërsa institucionet dhe politikbërësit vazhdojnë negociatat për integrimin më të shpejtë të Kosovës në BE, mbetet sfida mosefikasiteti në luftimin e korrupsionit dhe sundimit të ligjit. Kjo dobëson praktikimin e lehtësive ligjore dhe incentivave (<http://invest-ks.org>), me një rritje në koston e të bërit biznes (www.wbginvestmentclimate.org) dhe klimë e dobët të investimeve.

Vlersim empirik i lidhjen dhe ndikimit të IHD në rritjen ekonomike në Kosovë dhe disa vende Evropiane nga viti 2004 deri në vitin 2014, bëhet duke përdorur një panel të dhënash nga burime, treguesit e zhvillimit botëror të shprehur në US\$ dhe Agjensinet e Statistikave të vendeve përkatëse. Testimi i variablave, kapitali human dhe investimet e brendshme nëse bashkëveprojnë në mes tyre a stimulojnë IHD dhe rritjen ekonomike. Kjo do të thotë të matet niveli i njohurive për të përdorur teknologjinë e huaj që sjellin kompanitë e huaja në Kosovë dhe vende të tjera në mostër.

Pas shqyrtimit të literaturës teorike dhe empirike të teorisë së rritjes ekonomike dhe IHD në aspektin e teorisë egzogjene (modeli Sollow-Swan) ne zgjerohemi në studimin e marrëdhënieve në mes IHD dhe rritjes ekonomike në aspektin endogjene Lucas (1969), Romer (1986; 87; 83; 93; 94; 98). Çështjet që studiojmë janë, niveli i akumulimit të kapitalit, niveli i përhapjes së teknologjisë, niveli i kapitalit human edhe nga aspekti i teorive të IHD-ve të Vernon, (1960) teoria e ciklit jetësor të produktit, Hymers (1960), teoria e organizimit industrial dhe Dunning (1980), teoria e ndërkombëtarizimit. Vlerësimi ekonometrik bëhet përmes sistemit të ekuacioneve të shumëfishtë dhe lineare të cilin e përdori edhe Boreinsztein et al. (1998:121), Johnson A. (2005:8), Barro dhe Sala-i-Martin (2005) ku njëri ekuacion e konsideron rritjen ekonomike të varur, ndërsa ekuacioni i dytë i konsideron IHD të varuara. Përdoret metoda e efekteve fikse (FE) përmes modelit OLS dhe efekteve rastësore (RE) përmes modelit GLS, përdoret edhe testi e shkakësisë Granger në mes dy variablave të varura IHD dhe rritja e GDP për frymë.

Mundohemi të gjejmë se IHD dhe rritja a janë përcaktues të rëndësishëm për njëri tjetrin, apo variablat, kapitali human dhe investimet e brendshme të vëna në komplementaritet me IHD a kanë dhënë efekte në tërheqjen e IHD në njërën anë dhe në anën tjetër çfarë efekti kanë dhënë në rritjen e GDP për frymë. Statistikat tregojnë se në vendet europiane në mesin e tyre edhe në Kosovë, në dekadën e fundit janë ulur flukset e IHD dhe rritja ekonomike si pasojë e krizës globale, megjithatë të dhënat e fundit (2015), tregojnë se ka një rritje të IHD dhe rritjes ekonomike.

1.2 Shtrimi i problemit

Meqenëse IHD konsiderohen burim i rëndësishëm i të hyrave, edhe në Kosovë IHD trajtohen me prioritet në aspektin e zhvillimit të shpejtë ekonomik të vendit, punësimit, përmirësimit të bilancit të pagesave, rritjes së eksporteve, zhvillimit të ndërmarrjeve prodhuese, integritet në rrjetin global, transferit të teknologjisë dhe njohurive në vend dhe përmirësimit të kualitetit të investimeve të brendshme.

Dobësitë e vazhdueshme institucionale dhe zhvillimi ekonomik i ulët në Kosovë kanë zvogëluar ardhjen e kompanive të huaja në Kosovë. Një pjesë e kompanive të huaja kanë shuar veprimtarinë e tyre ose kanë shkuar dikund tjetër për të investuar. Këtë e vërtetojnë statistikatat e ulëta të IHD, dhe anketat e zhvilluara në 306 kompani të huaja që veprojnë në Kosovë nga viti 2000 deri në 2014. Ky nivel i ulët i fluksit të IHD nuk justifikon stimujt fiskalë dhe incentivat e vazhdueshme. A veprojnë mjaftueshëm palët e interesit, institucionet me mekanizmat e tyre, sa janë praktik dhe të mjaftueshëm ?

Incentivat, normat ligjore, mjedisi dhe klima e investimeve sa janë të shëndetshme, ndërsa institucionet përgjegjëse, APIK dhe MTI a janë duke promovuar mjaftueshëm vendin?

Për këto dhe probleme tjera, gjejmë përgjigje nga vetë investitorët që veprojnë në Kosovë. Ndërsa, përmes të dhënave primare të mbledhura përmes pyetsorëve të strukturuar të mbledhur në 306 kompani të huaja që veprojnë në Kosovë, konkretizohen problemet që ndeshën bizneset e huaja gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe mundësitë që ofron Kosova, si në aspektin e burimeve ashtu edhe në atë të kostos.

Gjithashtu, marrëdhënia në mes IHD dhe rritjes vjetore të GDP për frymë në 23 vende dhe në Kosovë është objekt hulumtimi në këtë disertacion me qëllim të arritjes së objektivave të zhvillimit ekonomik të mijëvjeçarit që mund ta sfidojnë veçanërisht Kosovën. Nevojiten

impenjime në drejtim të reformave ekonomike dhe politike që nxisin prurjet e IHD, meqenëse konsiderohen si katalizator i rritjes ekonomike si faktore i cili mund të reduktojë fektet e krizes globale (Pere, E. & Harshova, A. 2011). Interesi për t'u marrë me një temë të tillë sa aktuale aq edhe sfidues është: në njërën anë përmes të dhënave dytësore për të gjetur faktorët që kontribuojnë në rritjen ekonomike në 24 vende europiane, në mesin e tyre është edhe Kosova, që më pastaj të jepen rekomandime që faktorë të tillë të stimulohen.

Synim i qeverisë së Kosovës është tërheqja e investimeve të huaja për të plotësuar hendekun teknologjik dhe njohurive, trajnimit të punëtorëve, ngritjes së kapaciteteve të reja prodhuese dhe rritjen e eksporteve. Me rritjen e normës së GDP për frymë në Kosovë do adresoheshin shumë probleme që synon edhe qeveria e vendit, një ndër sfidat është papunësia më e lartë në Europë, nga burime zyrtare (ASK, 2014) arrijnë në 30.9 përqind, ndërsa sipas burimeve joformale ajo arrijnë edhe në 45 përqind. Kosova me valutën Euro të qëndrueshme dhe inflacion një shifror nuk rrezikon investitorët që sjellin kapitalin e tyre për të filluar biznes, problem paraqesin treguesit institucionalë (zbatimi i dobët i ligjit, korrupsioni, jostabiliteti politik, mosintegrimi në BE dhe mungesa e lëvizjes së lirë, etj.). Edhe pse ka përmirësime të vazhdueshme, klima dhe konkurrenca e biznesit dhe investimeve mbetet e dobët.

Importet e larta në raport me eksportet krijuan një deficit të lartë tregtar edhe përkundër rritjes ekonomike pozitive në mesatare prej 4 përqind për një dekadë e gjysmë. Ndërsa sistemi bankar është likuid, ndërmarrjet kosovare kanë vështirësi qasjeje në financa dhe subvencione, bankat komerciale disponojnë norma të larta reale të interesit (nga 13.3% në 2004 në 7.6 përqind normë efektive interesi në 2015).

Edhe kontributi i IHD-ve në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe industrial në Kosovë ka qenë ndryshueshëm, duke u luhatur midis 2.6 % (2005) dhe 12.6 % (2007) të GDP-së¹.

Tërheqja e ulët e IHD në Kosovë është pasojë e jostabilitetit politik në vend që shoqërohet me qeverisje jo funksionale të institucioneve publike. Kosova ende ka një imazh negativ, edhe pse APIK, Ministria e Diasporës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), mundohet të promovojë vendin. Pavarësisht nga liberalizimi i tregtisë, Kosova nuk arriti të integrohet në BE. Edhe pse vazhdon të jetë një vend me kosto konkurruese për IH (pagave të ulta), nuk ka arritur të tërheqë investitorë seriozë që vendi të përfitonte në sektorin e prodhimit, minierave dhe energjisë elektrike.

Hyrjet e vogla të IHD-ve në masë absolute, e renditin Kosovën në vendin e fundit në rajon. Sektori i shërbimeve në Kosovë ka përfituar më së shumti (sektori bankar, i sigurimeve, patundshmërive, hotelierisë dhe tregtisë).

Të suksesshme janë bankat komerciale, Pro Credit Bank (PCB) nga bashkimi i kompanive ndërkombëtare, Raiffeissen Bank (RBKO) nga Austria, Banka e Lubjanës (NLB) nga Sllovenia, Banka Kombëtare Tregtare (BKT) me parteneritet Shqiptaro-Turk, etj. Kontributi në rritjen ekonomike i atribuohet këtyre sektorëve, e ndihmuar nga konsumi, remitancat dhe fare pak nga eksportet. Meqenëse IHD sjellin jo vetëm kapital por edhe përfitime tjera direkte dhe indirekte (punësim, trajnim të punëtorëve, tregje të eksporteve, tërheqje të teknologjisë, përmirësim të cilësisë së investimeve të brendshme, etj.), agjenda qeveritare kërkon mekanizma më fleksibilë që nxisin rritjen e tyre. Investitorët potencialë përballen me nxitje të qeverive të shumta, prandaj planet zhvillimore, zhvillimet politike

¹Pere, A, Hashorva – “WesternBalkans’ Countries In Focus Of Global Economic Crisis” pg. 11. Economy Transdisciplinarity Cognition; www.ugb.ro/etc

dhe perspektiva ekonomike e sociale e Kosovës është e lidhur ngushtë nga aftësia e saj për të tërhequr sa më shumë IHD.

Kosova ka thyer barrierat tregtare dhe aplikon stimuj të taksave dhe tarifave doganore, por mbetet prapa vendeve në rajon me pushime tatimore dhe praktikimi i incentivave qeveritare dhe lokale. Ndërsa hapja e ekonomisë solli rritje të IHD-ve, sidomos në vitin 2007 (603 milionë US\$), por kjo tendencë e rritjes është ndikuar nga trendi i krizës globale 2008 - 2010, duke ulur ndjeshëm IHD në 343 milionë US\$ në vitin 2013. Kjo tregon se Kosova nuk është destinacion tërheqës për investitorë të huaj sidomos pas krizës globale dhe qëndron më keq se vendet fqinje. Është një sfidë për institucionet vendore që të promovojnë vendin duke filluar nga rezultatet e efikasitetit të qeverisë e cila mund të nxisë transparencën dhe llogaridhënien e punonjësve institucionalë, luftimin e korrupsionit, zbatimin e drejtë të ligjit me qëllim të fitimit të besimit për të investuar në Kosovë. Heqja e pengesave për IHD është faktori kryesor që rrit prurjet e IHD-ve. Politikat e investimeve të janë të qarta, lehtë të kuptueshme dhe të arritshme nga investitorët e huaj.

Trekendeshi, reformat makroekonomike, institucionale dhe sociale të bëhen me kohë dhe të jenë të sukseshme, të jenë në favor të mbrojtjes së investitorëve të huaj dhe atraktivë për ta. Pikërisht përmes këtij studimi do të analizohen flukset hyrëse të IHD marrëdhënia me rritjen ekonomike, faktorët përcaktues të IHD-ve, ndikimi i këtyre përcaktuesve në rritjen ekonomike në Kosovë duke shtuar dhe 23 vende të Europës Qendrore dhe Juglindore (që rezultatet ekonometrike të jenë më bindëse dhe të sakta). Ndërsa plotësohet me analizen përshkruese për njohjen e pengesave që kanë hasur investitorët por edhe mundësi të për të investuar në Kosovë. Kjo mundëson nxjerrjen e konkluzioneve duke synuar në dhënjen e

ndihmes për hartuesit e politikave për promovimin e investimeve përmes incentivave që tërheqjen e investitorët e huaj.

1.3 Qëllimi / Objektivat e studimit

Objektiv i studimit së pari është paraqitja e pengesave që kanë hasur investitorët e huaj në Kosovë. Së dyti, paraqitja e anëve të mira të Kosovës me qëllim të sensibilizimit të investitorëve të huaj se, në Kosovë ka lëndë të para dhe forcë pune të lirë, sektorë strategjikë (telekomunikacion, aeroport, energjitikë, industri nxjerrëse, ndërtimtari, etj.), treg i vogël por një distancë e afërt me vende të mëdha, treg i ri dhe legjislacion i ngjashëm me BE-në. Praqitja e anëve të dobëta të ekonomisë dhe institucioneve të Kosovës ka për qëllim të sensibilizoj mekanizmat qeveritarë për krijimin e kushteve dhe politikave të volitshme për investitorë.

IHD kërkojnë një mjedis institucional të volitshëm, atëherë janë hulumtuar pengesat e shumta që hasën investitorët e huaj dhe gjasat që ata përsëri të investojnë në Kosovë.

Këndvështrimi i objektivit është përshkruar, sepse sistematikisht bëhet përpjekje për të përshkruar pengesat por edhe stimujt që fenomeni IHD të kontribuojë në rritjen ekonomike.

Gjetja e shkakut të pengesave, apo motivit për të investuar në Kosovë është një ndër pyetjet kryesore. Qasja, si të gjejmë faktorët që pengojnë ardhjen e investitorëve në Kosovë dhe si të përmirësojmë faktorët që tërheqin investitorët bëhet me pyetsorë të strukturuar duke marrë parasysh opinionin e investitorëve të huaj.

Pyetjet që kërkojnë përgjigjeje na mundësojnë nxjerrjen në pah të pranis së pengesave që ulën motivin e investitoreve aktualë për të vazhduar investimin në Kosovë, dhe në anën tjetër atraktivitetin që ka Kosova për investitorë potencialë.

Arritja e objektivit bëhet me qëllim të rekomandimit të institucioneve për formulimin e një strategjie që do të përmirësonte pengesat institucionale dhe ekonomike dhe orientimin e politikave të IHD-ve që nxisin ardhjen e investitorëve të huaj në Kosovë.

Ndërsa, përmes një studimi të thelluar, janë gjedhur variabla të rëndësishme ekonomike dhe joekonomike duke analizuar marrëdhënjen dhe ndikimin e IHD në rritjen ekonomike përveq Kosovës edhe 23 vende europiane. Gjithashtu testohen edhe varablat shpjeguese po aq të rëndësishme, kapitali human, investimet e brendshme, madhësia e qeverisë dhe remitancat. Sistemi i vlerësimit bëhet përmes modelit të GLS dhe OLS, duke u praktikuar metodat e Efekteve Fikse (FE), Efekteve të Rastit (RE) dhe testeve të ndryshme. E gjithë kjo është realizuar përmes të bazës balancuar të dhënave panel, janë përfshirë 24 vende (N=24) dhe periudha e studimit përfshinë vitet 2004 deri 2014 (T=11).

Edhe pse vendet e EJT-së konsiderohen me flukse të ulëta hyrëse të IHD ato nuk janë lënë anash sepse Kosova ka bashkëpunim bilateral me shumicën e këtyre vendeve ndërsa në vendet e EQ ka një diasporë të gjërë, pra janë përfshirë vende të zhvilluara dhe në zhvillim.²

Është bërë një kombinim i vendeve nga vendet e Europës Juglindore që kanë karakteristika të përbashkëta: vende të dala nga lufta apo nga sundimi komunist, vende në tranzicion apo

²Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Maqedonia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Hungaria, Portugalia, Republika Çeke, Republika Sllovake, Suedia, Holanda, Austria, Gjermania, Zvicra, Norvegjia, Italia, Estonia dhe Lituania.

të përfshira në privatizim, vende fqinje, vende me gjuhë dhe kulturë të përbashkët, histori të gjatë bashkëpunimi. Ndërsa vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore karakterizohen me diasporë të gjere nga vendet e EJT-së, këmbime të ekspertëve të fushave të ndryshme sepse kanë kapital njerëzor në nivel të lartë, tregti të zhvilluar. Vende që janë pjesë e BE-së, vende që janë kandidatë potencialë për në BE dhe vende që presin për të qenë pjesë e saj. Kombinimi i tillë i vendeve ka për qëllim njohjen më të thellë me përcaktuesit e IHD dhe rritjes ekonomike me qëllim të gjetjes së karakteristikave më atraktive të këtyre vendeve pa marrë parasysh shkallën e zhvillimit.

Kuptimi e transferit të teknologjisë ka të bëjë me: teknologjinë prodhuese, procesin e shpërndarjes dhe aftësitë e menaxhimit dhe të marketingut që është vështirë të ndahen se a janë efekte direkte apo indirekte (eksternalitete) të IHD-ve. Rritja ekonomike bëhet realitet atëherë kur përmirësohet produktiviteti në nivel mikro duke përdorur teknologjinë, prandaj duhet të dihen: IHD a ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vendeve të EQ dhe EJT ? ; A ekziston ndonjë lidhje shkakësore midis IHD-ve, investimeve të brendshme dhe rritjes ekonomike? Cilat janë burimet e transferimit të teknologjisë dhe çfarë është rëndësia e këtyre kanaleve? A janë në gjendje të absorbojnë teknologjinë dhe njohuritë vendet që konsiderohen në tranzicion apo në zhvillim dhe disa vende të Evropës Qendrore? A kanë një prag të mjaftueshëm të njohurive që mundëson përdorimin e teknologjisë që sjellin IHD? Sa janë tërheqëse këto vende në krahasim me vende të zhvilluara që janë pjesë e këtij studim?

Terma të ndërveprimit janë përdorur në ekuacionet e IHD-ve me investime të brendshme, IHD me kapitalin njerëzor. Ndërsa për të ditur efektin e komplementaritetit të IHD me

investime të brendshme duhet të dihet: Investimet e brendshme kapin eksternalitet e teknologjise si konsumatorë, konkurent apo furnizues?; IHD ka efekt plotësues apo zëvendësues në investimet e brendshme në EQ dhe EJL dhe Kosovë ?; IHD a kontribuon në rritjen ekonomike më shumë se investimet e brendshme ?; Cilët janë faktorët kushtëzues që varen IHD ? A kanë një prag të mjaftueshëm të njohurive vendet e EQ dhe EJL-se dhe Kosova dhe sa është është ai prag ?

Nisur nga modeli endogjene i rritjes,³ i formuluar nga Boreinsztein (1995:9; 1998:121), duke e plotësuar paraprakisht me teorinë e organizimit industrial dhe e ndërkombëtarizimit të IHD⁴, bëjmë përpjekje të bëjmë një vlersim të drejtë të rolit të IHD në rritje.

Themelet e rritjes ekonomike janë gjetur të jenë në përmirësimin e produktivitetit në nivel mikroekonomik përmes tranferimit të teknologjisë dhe njohurive të cilat rrisin kualitetin e investimeve të përgjithshme, megjithatë janë marrë parasysh edhe mekanizmat makroekonomik (masat e politikës ekonomike) duke i agreguar njëri me tjetrin. Objektivi kryesor i hulumtimit tonë është të vlersojmë marrëdhëniet IHD dhe rritje ekonomike në 24 vende europiane dhe Kosovë. Analizojmë pra efektin dhe shkakësinë midis IHD dhe rritjes ekonomike.

Edhe pse IHD ndikon në fusha të dryshme (bilanc të pagesave, punësim, kurs këmbimi, etj.) në këtë pjesë të punimit ne jemi kuafizuar vetëm në akumulimin e kapitalit

³ Anghion (2012:1-9), Romer dhe Lukas (1990:71), etj.

⁴Kindleberger (1969) dhe Hymers (1960) dhe Vernon (1971); (Dunning (1990:7), Johanson (2005:8-10), etj.

dhe transferimin e teknologjise permes IHD-ve.⁵ Edhe termin përhapje e analizojmë në mënyrë të përgjithshme.

Gjithashtu është analizuar GDP fillestare për të shprehur efektin “catch-up” procesin e konvergjencës së vendeve në zhvillim drejt niveleve të ekonomive më të përparuara, tendencat e tyre drejt rritjes, ashtu siç e parasheh literatura⁶.

Gjetjen e kanaleve të transferimit të teknologjise dhe njohurive në vendet pritëse dhe rëndësinë relative të tyre. A është më madhë kontributi i IHD në mënyrë direkte apo indirekte në rritjen ekonomike, prandaj analizojme çdo komponentë veq e veq dhe pastaj studjojmë efektin e tyre të kombinuar (termin bashkëveprim dhe përhapje).

Meqenese masim efektin direkte të IHD si rrjedhë e kapitalit dhe njohurive atëherë kërkojmë përgjigjeje se si ka hyrë rrjedha e kapitalit në formë bashkimi dhe blerjeve apo greenfield, si kanë reaguar firmat vendore, IHD a janë plotësues apo zëvendësuese të investimeve të brendshme. Analizojmë nëse IHD është përcaktues i progresit teknologjik të cilin e shohim përmes përhapjes se efektit grumbullues. Analizojmë ndikimin e rritjes ekonomike dhe përcaktuesve të tjerë (kapitali human, investimet e brendshme, remitancat dhe madhësin e qeverisë) në rritjen e IHDve. Studjojmë tendencat rrjedhjës së IHD-ve sipas grupimit të ekonomive, gjithashtu kemi diskutime dhe debate empirike për IHD dhe rritje ekonomike dhe një krahasim të studimit tonë me studime tjera. Së fundi është bërë një analizë krahasuese në mes Kosovës dhe 23 vendeve europiane.

⁵Është përdorur në këtë tezë termi teknologji në kuptimin e gjërë, duke përfshirë teknologjine prodhuese dhe procesin e përhapjes së teknologjisë, aftësive të menaxhimit dhe marketingut të cilat si të ndara janë vështirë për tu matur .

⁶Vendet e zhvilluara shkojnë drejt uljes së rritjes ekonomike ndërsa vendet në zhvillim drejt rritjes së saj (efekti catch-up), pra zënia e hapit drejt vendeve të zhvilluara.

1.4 Burimet e referimit

Sfida e të dhënave - mbledhja e të dhënave parësore dhe dytësore është realizuar përmes instrumenteve të ndryshme. Të dhënat primare janë mbledhur përmes pyetsorëve të strukturuar që mbulon 306 kompani të huaja që veprojnë në Kosovë me kapital 100% të huaj). Deri te kompanit e huaja është ardhë përmesh sigurimit të informacionit bazë nga zyra për regjistrim ARBKO (<http://www.arbk.org/>) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (<http://www.atk-ks.org/>) dhe më pastaj është realizuar kontakti i drejtëpërdrejtë me investitorë të huaj të cilët kanë zgjedhur që të përgjigjen aty për aty apo me e-majl përmes pyetsorëve të strukturuar.

Ndërsa, mbledhja e të dhënave dytësore është bërë nga baza e të dhënave të Treguesve të Zhvillimit Botrore (WDI) në US \$, për 24 vende të Europës, të zhvilluara (7 vende) në zhvillim (17 vende), në mesin e të cilave është edhe Kosova, për periudhën prej 11 vite (2004-2014). Të dhënat parësore dhe dytësore janë të besueshme, duke lehtësuar zbatimin e një metodologjie të njëjtë, e çmueshme për aplikim në programe Stata sidomos për kërkime makro-ekonomike.

Burimi i të dhënave tjera ka shërbyer më tepër për përshkrimin e fenomenit IHD dhe rritje ekonomike në kapitujt tjerë në vazhdim.⁷ Ndërsa të dhënat dhe burimi i tyre (Tabela 1,

⁷(<http://www.data.worldbank.org>); transparent international (<http://www.transparency.org>); dhe Freedomhouse (<http://www.freedomhouse.org>); <http://BQK> (bqk-kos.org). <http://webrzs.stat.gov.rs>; <http://cbs.nl/en-GB>; <http://data.un.org>; <http://info.worldbank.org>.

dhe Tabela 2, në shtojca A), për kapitalin human për Kosovë dhe Shqipëri merren nga: INSTAT (<http://instat.gov.al>); ASK (<http://ask.rks-gov.net>) dhe <http://masht.rks-gov.net>.

Të dhënat për kapitalin human të vendeve tjera dhe të dhëna tjera që janë përdorur gjatë gjithë punimit janë mbledhë edhe nga raportet e investimeve botërore (WIIR) të publikuara nga Banka Botërore (WB) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF), raportet shtetërore mbi Politikat Ekonomike dhe Tregtisë në Kosovë, Agjensioni për Promovimin e Investimeve (APIK) faqet e internetit, etj.

Flukset vjetore të IHD si përqindje e GDP-së përdoren për të matur IHD dhe përmes tyre ndikimin në PBB. Rritja vjetore e GDP për frymë (GDP_{gpc}) është tregues që përdoret për të matur lidhjen me IHD. Poashtu maten tregues të tjerë që ndikojnë në rritje, e rëndësishme është matja e kapitalit human (niveli i shkollimit të mesëm të lartë apo shkollimi sekondar, një masë (si ekuivalent) për kapitalin njerëzor. Përdoret softveri statistikor (STATA, version 12) përmes të cilit përpunohen të dhënat dytësore (analizë ekonometrike), ndërsa SPSS për vlersimin e të dhënave parësore (pyetorët e strukturuar).

1.5 Pyetjet kërkimore dhe Hipotezat

Në këtë disertacion për të testuar hipotezat janë ngritur pyetje kërkimore që si objektiv kanë vlersimin e variablave IHD si përqindje e GDP (si standard në literaturë) dhe shkallen e rritjes vjetore të GDP për frymë si variabla të varura në dy regresione të ndryshme në nivel të 23 vendeve evropiane dhe Kosovë.

Gjithashtu, testohet edhe hipoteza e tretë përmes pyetjes kërkimore për të gjetur cilat janë arsytet e pranisë apo mospranisë së investitorëve të huaj në Kosovë, duke analizuar segmente të caktuara institucionale dhe instrumentetë politikave të IHDve, burimeve natyrore dhe kostos së punës duke vlerësuar dhe pritshmëritë e investitorëve potencialë në të ardhmen.

Pra së pari, teston lidhjen IHD me rritjen ekonomike në disa vende europiane. Së dyti, duke ndjekur modelin e Boreinsztein et al. (1998), heton nivelin kapitalit human përmes matjes së nivelit të aftësive absorbuese të vendeve pritëse. Së treti, teston efektin e bashkëveprimit të variablave IHD dhe kapitali human dhe IHD me Investimet e brendshme në rritjen ekonomike. Edhe variablat remitancat dhe shpenzimet qeveritare janë marrë si variabla që mund të ndikojnë në rritje ekonomike apo të ndikojnë në fuksin e IHD-ve,

Pas rishikimit të literaturës dhe testimit të hipotezave presim që lidhja në mes IHDve dhe rritjes ekonomike të jetë pozitive në të dy drejtimet, ndërsa mbetet për të provuar nëse transferi i teknologjisë varet nga IHD, kapitali human apo nga ndërveprimi i këtyre variablave. Poashtu testohen edhe përcaktues të tjerë që mund të jenë faktorë që nxisin ose pengojnë rrjedhën e IHD dhe rritjen ekonomike. Gjithashtu matet efekti i konvergjencës në 24 vende. IHD janë trajtuar kryesisht nga qasja tradicionale, më pak përdoret qasja sipas faktorëve të diversitetit, ndërsa janë lënë pasdore variabla të tregtisë. Bazuar në sfondin teorik, rezulton se hipotezat për secilën variabël është shënuar si më poshtë.

Tezat që trajtohen kanë si fokush këto pyetje kërkimore :

1. Si ndikojn investimet e Huaja Direkte në rritjen ekonomike në vendin pritës, përmes efekteve direkte dhe efekteve indirekte, çfarë efekti ka në rritjen ekonomike termi bashkëveprim në mes IHD dhe kapitali human apo IHD dhe investime të brendshme?
2. A është i kushtëzuar nga faktorë të caktuar efekti i IHD në rritjen ekonomike, dhe cilët janë ata ?
3. Çfarë efekti ka rritja ekonomike në rritjen e IHDve në vendin pritës, dhe çfarë efekti kanë kapitali human, investimet e brendshme, remitancat dhe shpenzimet e qeverisë?
4. Cilat janë arsyet e pranisë apo mospranisë së investitorëve të huaj në Kosovë, segmente të caktuar institucionale apo instrumentetë politikës së IHD, burime natyrore apo kosto e ulët e punës, si vlerësohen pritshmëritë e investitorëve potencialë në të ardhmen ?

Me ndihmën e analizës ekonometrike testohen dy hipotezat e para, ndërsa përmes interpretimit të rezultateve të pyetsorëve testohet hipoteza e tretë:

Hipoteza H_1 : IHD ka një efekt të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendeve pritëse, IHD ka një efektë të tërthortë në rritjen ekonomike përmes ndërveprimit midis IHD dhe nivelit të kapitalit njerëzor dhe IHD me investimet e brendshme.

Hipoteza H₂: Përveq rritjes ekonomike edhe përcaktues tjerë, kapitali human, investimet e brendshme, shpenzimet e përgjithshme qeveritare dhe remitancat kanë efekt pozitivë në prurjet e IHDve.

Hipoteza H₃: Prania apo mos prania e investorëve të huaj në Kosovë është rezultat i intrumenteve të politikës së saj, dhuntisë së burimeve natyrore dhe kostos së ulët të punës.

1.6 Përshkrimi metodologjisë dhe metodave kërkimore

Pjesë e studimit janë të dhënat parësore (qasja sasiore), të mbedhura përmes intrumenteve – pyetsorët e strukturuar.⁸ Nga popullata prej 1369, investorëve⁹ me 100% kapital të huaj sa janë në Kosovë deri në qershor 2014, është zgjedhur kampioni prej 500 kompanive të huaja (duke lënë anash investorët me kapital të përzier që sipas ASK deri në qershor 2014 janë afërsisht 3721). Përmes kësaj analize merret opinionin e Kompanive të Huaja që veprojnë në Kosovë rreth pengesave, mundësive dhe planeve të tyre në të ardhmen. Fokusi është në identifikimin e sjelljes së firmave të huaja në Kosovë, kostos së transaksionit që rrjedhë nga korniza institucionale e paqëndrueshme.

Të dhënat e përdorura për modelimin ekonometrik janë të dhëna dytësore dhe janë marrë nga baza e të dhënave të Bankes Botrore, Teguesit e Zhvillimit Botror(WDI).Të gjitha

⁸ Në pyetsorin e parë janë bërë disa ndryshime të vogla në pyetjet e para me qëllim të marrjes së opinionit për kontributin e investorëve në të hyrat e buxhetit të Kosoves, borxhet e mbetura, punësimin dhe shurjen e bizneseve të huaja.

⁹ Agjensioni i Statistikave të Kosovës për kategorinë e investorëve me 100% kapital të huaj disponon të dhëna të sakta në krahasim me investorët me kapital të përzier, prandaj edhe janë zgjedhur kjo kategori e investitoreve).

ndryshoret e përdorura janë të bazuara në të dhënat vjetore nga viti 2004 deri në vitin 2014, nga 24 vendet e rajonit përfshirë edhe Kosova.

Analiza empirike e pjesës së dytë fokusohet në dimensionin makroekonomik për të gjetur se çfarë efekti kanë IHD në rritjen ekonomike, investimet e brendshme, transferin e teknologjise dhe faktorin më të rëndësishëm kapitali human (matja e nivelit të aftësive dhe njohurive të tyre).

Përdorim metoden e Efekteve fikse dhe Efekteve Rastësore¹⁰ (Lee, Y., J.A. Nelder, Y. Pawitan (2006), sepse kjo metodë përdoret shumë në studime empirike me panel të dhënash dinamike dhe është efektive edhe kur në ekuacion ndërthuren variabla egzogjene dhe endogjene njëkohësisht. Gjithashtu bënë të mundur përdorimin e variablave ndërvepruese siq i kemi zgjedhur IHD me investimet e brendshme dhe IHD me kapitali human. Pra këto metoda nuk injorojnë faktorët endogjen që tërheqin investitorë të huaj, si në ekuacionet ku variablat bashkëveprojnë (IHD*HC dhe IHD *Investimet Brendshme.).

Për shpjegimin empirik të problematikës janë përdorur instrumente hulamtuese.

Studimi përdor një panel të dhënash në të cilat vendet janë njësi të vëzhgimit. Mjetet e regresionit dhe te korelacionit të përdorura në procesin e vlerësimit janë ato të dizajnuara në mënyrë specifike për panelin e të dhënave, të tilla si metoda e katrorëve të vegjël (LS) metoden e Katrorëve të Vegjël të Përgjithësuar (GLS) kombimuar me testet e Efekteve Fikse (FE) dhe Efekteve të Rastit (RE), testin e Hausman, testin Wald, testin pairwise Granger causality, etj.

¹⁰ Lee, Y., J.A. Nelder, and Y. Pawitan (2006). *Generalized Linear Models with Random Effects: Unified Analysis via H-likelihood*. Chapman & Hall/CRC, Boca Raton, Florida. [ISBN 1-58488-631-5](https://doi.org/10.1201/9781484863155)

Të dhënat përbëjnë 24 vende për 11 vite në gjithsej 264 vëzhgime (observime). Shumica e variablave janë gjetur në raport me GDP si standard në literaturë përveq kapitalit human që është në raport me popullsin.

1.7 Mundësitë dhe kufizimet e studimit

Fokusi i studimit është për të verifikuar se Investimet e Huaja Direkte dhe përcaktuesit e tjerë a kanë kontribuar në drejtim të rritjes ekonomike në vendet pritëse, cilët nga këta përcaktues tërhoqën më shumë IHD në periudhën që mbulon vitet 2004-2014. Kjo tezë dallon nga studimet e fundit të kësaj natyre.

Së pari, qasja në nivelin makro dhe mikro të IHD në Kosovë, ndihmon aspiratat e ardhshëm të studiuesve kërkimorë për të identifikuar përcaktuesit tjerë të rritjes ekonomike në nivel institucional dhe përcaktuesit e IHD-ve edhe në nivel sektorial. Metoda e katroreve të vegjël (LS) trajton marrëdhënien mes variablit të varur shkalla e rritjes së GDP për frymë dhe atyre të pavarur si deterministë të modeli FE, dhe si përcaktues i rëndësishëm është marrë fluksi hyrës neto i IHD-ve. Ndërsa në një ekuacion të veçantë është trajtuar fluksi neto i IHD si i varur ndërsa si përcaktues kryesore është shkalla e rritjes së GDP për frymë, nuk janë përfshirë në të njëjtin ekuacion edhe stoqet e IHD, prandaj nuk paraqitet problemi me kolinearitete edhe pse është përdorur logaritmi natyral i IHD në rastin kur është përdorur kjo variabël si e varur.

Së dyti, përveç kontributit që ofron ky punim, ka edhe kufizime:

- Numri i viteve (11) bënë që përfundimi që ne nxorrëm nga analiza jonë, mund të mos ketë një fuqi të lartë statistikore. Një seri me një numër më të madh vëzhgimesh bën që fuqia statistikore e rezultateve të testeve të jetë më e lartë.
- Përfshirja heterogjene e vendeve (të zhvilluara dhe në zhvillim), mund të ndikojë që rezultatet përfundimtare të mos jenë shumë të qarta.
- Madhësia e mostrës në të dhënat dytësore nuk ka përfshirë një gamë të gjerë variablash dhe sidomos kursi i këmbimit, zhvillimi financiar dhe cilësia e institucioneve.
- Do të ishte shumë me interes që gjatë studimeve në të ardhmen të analizohen edhe efektet negative të IHD të referuara si kosto, që përfshijnë një përkeqësim të bilancit të pagesave, mungesa e lidhjeve pozitive me komunitetet lokale, efektet e dëmshme në mjedis, veçanërisht në industrinë nxjerrëse.
- metodologjia e katrorëve të vegjël (LS) është mjaft e ndjeshme në seri që kanë një trend të kufizuar.
- Përveç modelit GLS që është përdorur të metoda e efekteve të Rastit që është mjaft e qëlluar, do të sugjerohej të përdorej edhe metoda GMM, e cila do të analizonte mirë marrëdhënien e ndërsjelltë mes IHD dhe variablave tjera shpjeguese e kombinuar me vertetësin e testit Granger i shkakësisë (Granger Causality).
- Gjithashtu, mjaft interesante do të ishte të vazhdohej analiza e mësipërme, por të studiohej roli i tregtisë ndërkombëtare (importi dhe eksporti) në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, shumë studiues mund të jenë të interesuar të vazhdojnë analizen e mësipërme, duke përdorur metodologji të reja ekonometrike, modele të ndryshme teorike dhe të analizohen në mënyrë empirike.

- Të vlerësohet rritja ekonomike në aspektin mikro duke matur produktivitetin në sektor ekonomik të caktuar (sektorin e prodhimit, sektorin e shërbimeve dhe sektorin primar) në një panel që përfshin të dhëna për vendet në zhvillim, duke bërë një analizë krahasimore të sektorëve në Kosovës me vende tjera te EJsë.
- Poashtu është mjaft me interes që të analizohen IHD sipas origjinës sepse nga origjina e IHD varet edhe kualiteti i investimeve.
- Gjithashtu njohja me barrierat që hasin IHD në vendet në tranzicion pjesë e së cilave është edhe Kosova (gjeografike, fiskale, të sigurisë, stabiliteti politik dhe efikasiteti i institucioneve).
- Do të ishte e rëndësishme që për vendet në mostër të maten kapacitete absorbuese me shpenzimet e R & D, apo indeksi i shkollimit universitar, meqenëse tudimi ynë gjeti se kapaciteti absorbues (niveli i shkollimit të mesëm) nuk dha koeficient pozitiv, edhe pse shumica e vendeve kanë një prag të njohurive të mjaftueshëm.

1.8 Rëndësia e Studimit

Punimi filloj me dhënjen e një pasqyre të debatit mbi rritjen ekonomike dhe Investimet e Huaja Direkte. Diskutohen trendet globale të IHDve dhe rritjes ekonomike duke u fokusuar më shumë në Europë, sfida dhe mundësitë me të cilat përballen vende europiane të përfshira në studim, përballja me nxitjen e rritjes afatgjatë. Si shumica e vendeve europiane edhe Kosova përballen me mungesë të kapitalit, të njohurive, menaxhimit dhe me një sfidë punësimi. Duke e konsideruar IHD si kanalin më kryesor dhe të rëndësishëm përmes të cilit bëhen përpjekje në plotësimin e hendekut të kapitalit, transferit të teknologjisë, njohurive,

një mundësi e mirë e integritit të kapitalit human, integritit në tregje të huaja dhe rritjes së punësimit, fokusi i studimit është efekti i tyre në rritje ekonomike. Megjithatë, siç vuri në dukje de Mello (1997), roli i IHD si një katalizator i rritjes së prodhimit bruto është një hipotezë më pak e diskutueshme në teori dhe praktikë. Qëllimi i studimit është supozimi se IHD do të ndikojë në rritjen ekonomike në afatgjatë në dy mënyra, direkte përmes akumulimit të stokut të kapitalit që personifikon teknologjinë e re dhe indirekte të transferit të njohurive (nivele të aftësive të kapitalit human në vendin pritës), përfaqësuar nga shkollimi sekondar në raport me popullsinë.

A ka mundësi që akumulimi i kapitalit (transferi i teknologjise) dhe kapitalit human (transferi i njohurive), të kenë rëndësi të ndryshme varësisht se në cilat vendet transferohet (në vende në zhvillim apo në vende të zhvilluara) ?

Shumica e studimeve mbështeten në aspektin teorik, i vertetuar edhe në mënyrë empirike se rëndësia e transferimit të njohurive në kërkim dhe zhvillim (kapitali human) është më e madhe në vendet e zhvilluara se transferi i kapitalit në vendet në zhvillim. Prandaj në këtë studim meqenëse shumica e vendeve janë në zhvillim, është zhgjedhur kapitali human i personifikuar nga kapitali human teknik (niveli sekondar i shkollimit) në vend se kapitali human i personifikuar nga njohuritë e avancuara (R&D). Arsyeja e zgjedhjes së një variable të tillë është për dy arsye: Së pari, janë përfshirë në mostër 17 vende në zhvillim, ndërsa vetëm 7 vende të zhvilluara, Së dyti, mungesa e të dhënave në vende në zhvillim, pamjaftueshmëria e tyre, të dhëna nga burime të ndryshme për R&D (kërkim dhe zhvillim), do të krijojnë rezultate jo të sakta. Gjithashtu, hetohet nëse GDP_fillestare (Y_0), lidhet pozitivisht me rritjen ekonomike në grupe të vendeve me të

ardhura të mesme, se në vende me të ardhura të larta, ndërsa variablat e vëna në bashkëveprim (sinergji), krijojnë efekte pozitive në rritje. Për të testuar hipotezat janë vënë në bashkëveprim edhe investimet e brendshme për të ditur efektin e tyre plotësues apo zëvendësues, në disa variabla është përdorur vonesa në kohë (lag_lag për variabla, IHD ekacioni dytë, rritja ekonomike ekuacioni i parë dhe i dytë, ndërsa variablat tjera, kapitalin human dhe GDP fillestare me 1 ose 2 vite vonesë), për të ditur efektin afatgjatë të tyre.

Rëndësia e punimit qëndron edhe në faktin së paraqitet përvoja e njëmbëdhjetë viteve të fundit të përcaktuesve të ndryshëm të IHD, që njëkohësisht janë edhe faktorë të rritjes ekonomike. Kjo ndihmon në dhënien e përgjigjes së hipotezës së dytë, gjithashtu ndihmon për të nxjerrë në pah rëndësinë e IHD edhe si variabël e varur, përveç si variabël e pavarur në këtë studim. Nëse variablat e zgjedhura në studim si përcaktues të IHD dhe rritjes ekonomike janë pozitivë ose negativë por jo zero, atëherë është një prognozë e rëndësishme për të drejtuar politikat qeveritare për stimulimin e variablave makro-ekonomike, apo vënien e kriterëve për ndryshimin e destinacionit apo zvogëlimit të projekteve qeveritare. Kontributi në literaturë shprehet te efekti i kombinuar i rritjes ekonomike dhe Investimeve të Huaja Direkte, me qasje metodologjike dhe mostër të përdorur më ndryshe¹¹. Për këtë qëllim, kjo tezë kontribuon në literaturë në dy mënyra:

Së pari, ajo kontribuon në literaturën IHD-rritje, duke u përqendruar në efektin e transferit teknologjik dhe kapitalit human në rritjen ekonomike. Kontributi këtu shtrihet në aspekt të plotësimit të nivelit të aftësive të kapitalit human që kontribuon në tërheqjen e

¹¹Në përgjigje të një thirrjeje nga Eller et al. (2005) për një mostër të ndryshme në studimin e ndikimit të IHD-ve në zhvillimin financiar dhe rritjen në vend.

teknologjisë përmes IHD në vendet në zhvillim dhe të zhvilluara. Studimi shtrihet në literaturën ekzistuese mbi lidhjen e IHD me rritjen dhe njëkohësisht përcaktuesit e tjerë të rritjes, përcaktuesit kapitali human, investimet e brendshme në komplementaritet me IHD.

Së dyti, përdorë të dhëna panel dhe kryqezim i seri kohore me teknika të vlerësimit për vende specifike që janë mjaftë të ndryshme sa i përket investimeve, të rëndësishme nga pikpamja e konkurrencës në mes tyre, duke i dhënë këtij studimi rëndësi të veçantë.

1.9 Struktura e disertacionit

Në kapitullin e parë, është parqitur hyrja e ndjekur nga shtrimi i problemit, qëllimi dhe objektivat, pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura, është bërë një përshkrim i metodologjisë, burimet e të dhënave, modeli dhe metodat e përdorura në përpunimin e të dhënave. Pastaj është paraqitur rëndësia e studimit e percjellur nga mundësitë dhe kufizimet e studimit dhe në fund përshkrimi i strukturës së disertacionit.

Në kapitullin e dytë, është paraqitur literaturë për rritjen ekonomike dhe IHD, modelet e rritjes ekonomike, qasja egzogjene dhe endogjene e rritjes ekonomike që ka shërbyer si bazë në këtë studim zë një vend të merituar. Teoritë e IHD-ve, shqyrtohen motivet e zgjerimit të firmave të huaja, arsyet pse IHD është preferuar më shumë se format tjera të investimeve, faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimin për të investuar në një vend tjetër. Literaturën për IHD me fokus katër çështje kryesore në nivel mikro dhe makro-ekonomik: përparësitë e pronësisë, vendndodhjes, arsyet e ndërkombëtarizimit të IHD dhe

pikpamja institucionale duke konsideruar si të rëndësishëm faktorin kosto e punës dhe burimeve, si dhe rrezikshmërinë e mjedisit të investimeve.

Një trajtim i veçantë i bëhet drejtimit të shkakësisë në mes të dy variablave IHD dhe rritje ekonomike, kanaleve përmes të cilave përhapen efektet e IHD në ekonominë pritëse (IHD në bashkëveprim me investimet e brendshme), rolit të kapitalit human në transferimin e teknologjisë (IHD në bashkëveprim me kapitalin human) duke rritur produktivitetin i shprehur si efekt në rritjen ekonomike në vend. Janë paraqitur burimet prej nga rrjedhin IHD në vendin pritës, IHD si burim i kapitalit fizik, IHD si burim i transferit teknologjik, kapacitetet absorbuese në vendin pritës, diskutime dhe debate për marrëdhënien IHD dhe rritje ekonomike, marrëdhëniet në mes IHD rritjes ekonomike dhe investimeve të brendshme, kapacitetet absorbuese si përcaktues të IHD dhe rritjes ekonomike.

Kapitulli tretë, paraqet një vështrim ekonomis së Kosovës nën paraqigmën se stabiliteti ekonomik dhe institucional janë përcaktues të IHD dhe rritjes ekonomike në Kosovë duke përfshirë performancën e segmenteve të caktuar institucional. Performanca e politikave për investimet në Kosovë, mjedisin ligjor, garancia e investimeve dhe shteti ligjor në krijimin e ambientit të përshtatshëm të biznesit dhe investimeve.

Vend të veçantë zënë stabiliteti makroekonomik si përcaktues i IHD dhe rritjes ekonomike në Kosovë, performanca e PBB-së, tregu i punës, dinamika e IHD, kompanitë e huaja në Kosovë dhe kontributi i tyre në punësim, kontributin e investimeve të brendshme dhe kapitalit human në performancën e rritjes ekonomike në Kosovë, IHD sipas aktivitetit ekonomik dhe sipas origjinës. Në vazhdim janë paraqitur tendencat e IHDve sipas grupimit të ekonomive, një pasqyrë e përcaktuesve të IHD dhe rritjes ekonomike në 24 vende

europiane dhe Kosovë në periudhën 2004-2014. Dhe fund një analizë krahasuese e IHD në vende të EQ, EJT-se me fokus Kosovën.

Në kapitullin e katër, metodologjia, modeli teorik dhe empirik, metodat e studimit të dhënave panel, zgjedhja e metodave të studimit duke përdorur testin Hausman dhe teste tjera të rëndësishme për një vlerësim të drejtë të rezultateve.

Kapitulli pestë, meqenëse janë përdorur të dhëna parësore dhe dytësore, edhe rezultatet e studimit janë mikse dhe gjithëpërfshirëse. Së pari, paraqiten rezultatet e studimit të dhënave parësore të bladhura përmes pyetsorëve të strukturuar të shtrirë në 306 kompani të huaja në Kosovë. Analizë, pengesave dhe mundësive që hasën investitorët e huaj gjatë investimit në Kosovë. Së dyti rezultatet e të dhënave dytësore me qëllim të gjetjes se çfarë është efekti i IHD i kapitalit human, efekti i konvergjences – përmes GDP_fillestare, investimeve të brendshme, remitancave dhe shpenzimeve të konsumit final të qeverisë në rritjen ekonomike si variabël e varur në nivel të 23 vendeve Europiane¹² dhe Kosovë. Vlerësimi përmes modelit Least Squares (LS) metoda e Efektet Fikse (FE) dhe GLS me metoda Efektet e Rastit (RE).¹³

Kapitulli gjashtë, përfundimet, rekomandimet dhe implikimet në politika në të ardhmen. Gjithashtu, paraqiten referencat, shënime të rëndësishme të cilat nuk përfshihen brenda temës për shkak të kufizimit të fjalëve, Shtojca A dhe B, me udhëzime të detajuara për modelin ekonometrik të përdorur dhe pyetësorët jepen në fund të punimit.

¹² Është parë e domosdosme të rritet baza e të dhënave panel edhe për 23 vende europiane, 11 vite në Kosovë janë të pamjaftueshme për të dhënë rezultatet ekonometrike të sakta (prandaj është formuar paneli prej $n=24$; $T=11$ duke formuar $\Sigma=264$ vëzhgime.

¹³ Peter C.B. Phillips në vitin 2010:2, ka shkruar për, Alec Aitken, një nga më të famshme arithmeticienit i të gjitha kohërave, i cili ka kontribuar në formulimin e matricës dhe projektimin gjeometrik të regresionit linear, vlerësimi i katrorët e vegjël të përgjithësuar (GLS) u përshkrua për herë të parë nga Aitken në vitin 1934. <http://korora.econ.yale.edu/phillips/pubs/art/p1308.pdf>

KAPITULLI II: Aspekti teorik i modeleve të rritjes ekonomike dhe Investimeve të Huaja Direkte

2.1 Modelet e rritjes ekonomike

Duke u nisur nga ekonomia klasike, ku sipas Smith, rritja e produktivitetit dhe efikasiteti arrihet përmes ndarjes së punës dhe specializimit. Ai konsideron se fitimet nga bujqësia dhe industria kontribuojnë në rritjen e kursimeve e cila çon në rritjen e investimeve dhe në këtë mënyrë rritë rritjen. Ndërsa ndarja e punës rritë produktivitetin më shumë në industri se në bujqësi thekson (Thirlwall, 1999)¹⁴.

Ishte Rostov, që konsideroi shkallën e investimit si kyç i procesit të rritjes, duke e pranuar anën e ofertës dhe prirjen për të kursyer. Sipas studiuesve rritja afatgjatë është fryt i një rezultati pozitiv që vjen nga oferta e stimuluar nga faktorët e prodhimit. Kërkesa në ekuilibrin afatgjatë është parë më tepër si instrument që përdoret për të stimuluar rritjen në afatshkurtë.

Rostow, konsideron rritjen e popullsisë dhe risitë teknike si faktorët më të rëndësishëm në çdo teori të rritjes. Në një farë mase mendimi i Rostow mori mbështetje formale teorike nga Sollow dhe Swan (1956). Rostow nisur nga “*Pasuria e Kombeve*” e Smith¹⁵, shpjegon çfarë duhet bërë me tepicën që rrjedhë nga pronësia e tokës “....*Bujqësia duhet të japë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të saj të tepërta në sektorin*

¹⁴<http://kastoria.teikoz.gr/icoae2/wordpress/wp-content/uploads/articles/2011/10/087.pdf>

¹⁵ Smith në librin e tij “*Pasuria e Kombeve*” sugjeronqë tepicën e të ardhurave që rrjedhë nga pronësia e tokës duhet disi të tranferohet nga duart e atyre që nuk krijojnë, në duar e njerezve të frytshëm që do të investojnë, në sektorë modern dhe më pas duke ua kthyer prapa fitimet e tyre dhe njëkohësisht duke rritur produktivitetin e prodhimit (161:24).

modern”, kjo shkallë e investimeve sipas tij nxitë shkallën e rritjes së të ardhurave për frymë.

Rostov(1970:330-40) përsëri i referohet argumentit të Adam Smith-it, “...se akumulimi i kapitalit më shumë është nxitur nga të ardhurat e të punësuarve në riprodhim se të konsumit joproduktiv të plang-prishësve”, duke i konsideruar investimet si motor i rritjes së çdo ekonomie.

Në kontekstin e rritjes dhe zhvillimit është edhe modeli i Keynes i cili bazën e ka nga Harrod (1939) dhe Domar (1946) me fokus përcaktimin e normës së rritjes nga një periudhë në tjetrën, e mjaftueshme për të ruajtur punësimin e plotë. Shkallën e rritjes e konsiderojnë më të rëndësishëm se produktiviteti dhe punësimi (të ardhurat do të përdoren më pak se kapaciteti i saj). Pra shkalla e rritjes, e mban punësimin e plotë dhe produktivitetin më të lartë, Stern, (2007); Ghatak, (2003); Dixit, (1976), sipas, Tawiri N. (2010:760).

$$g = \frac{S}{Y} \cdot \frac{1}{K}$$

g = shkalla e rritjes

S=kursimi në periudhë (pra norma e kursimit është variabël ekzogjen sepse merret si e dhënë)

Y = të ardhurat nacionale

$\frac{1}{K}$ =koeficienti i kapitalit

Pra shkallen e rritjes e përcakton koeficienti i kapitalit të ardhurave kombëtare (Y)dhe shkalla e kursimit të tyre:

$$\left(\frac{S}{Y}\right), \frac{1}{K}, \frac{1}{Y}, \dots \text{eq.1)}$$

Ekuacioni paraqet, marrëdhënien në mes të asaj që është investuar dhe të ardhurave të krijuara. Modeli Harro-Domar, thekson rëndësinë e shkallës së kursimit (S/Y), e cila është e nevojshme për të arritur një shkallë të caktuar të rritjes ekonomike. Sipas këtij modeli mundësia e rritjes ekonomike vjen në dy mënyra, kur zvoglojmë K/Y ose, kur rrisin S/Y . Në këtë kontekst, modelet ekonomike kanë evoluar me kohë duke nxjerrë në pah përveç punës dhe kapitalit edhe faktorë të tjerë¹⁶ po aq të rëndësishëm, që nxisin rritjen e mirëqenies së shoqërisë.

2.1.1 Modeli egzogjen i rritjes

Teoria e ekzogjene e rritjes që u zhvillua në vitet e 50^{ta} dhe 60^{ta}, me fokus akumulimin e kapitalit si burim i rritjes. Forma kanonike e këtyre modeleve të rritjes u bazuar në një funksion prodhimi që kishte kapitalin dhe punën si inpute në prodhim, duke lënë jashtë teoris burimin e progresit teknik, Myle's, (2009:7-10) sipas qasjes së Sollow në vazhdim shpjegon gjetjet e modelit egzogjen të rritjes.

Teoria ekzogjene e rritjes është e bazuar në funksionin agregat të prodhimit të ekonomisë i cili është i vazhdueshëm i derivueshëm, një funksion prodhimi që përfshin kapitalin dhe punën¹⁷ e matur për orë si inpute në prodhim, ka produkte marxhinale pozitive rënëse dhe kthime konstante ndaj shkallës.

¹⁶ Kapitali human teknik (niveli i mesëm) dhe superior, inovacioni, teknologjia moderne, institucionet e mira, politikat qeveritare, etj.

¹⁷ Produktiviteti i të dy këtyre inputeve do të bjerë, pra do të ketë normë rënëse marginale të produktivitetit, poqëse nuk do të ketë ndryshime (ekzogjene) në akumulim të kapitalit.

Supozimi i një normë konstante zbulon mësim të rëndësishme rreth kufijve të rritjes dhe në qoftë se rritja ndodhë vetëm nëpërmjet akumulimit të kapitalit, duhet të ketë një kufi të procesi i rritjes, nëse nuk ka progres teknik.

Modelin Solow, e prezenton Acemogly D, (2009:28-35) dhe Myle's (2008:8-10). Sipas Acemogly, ka një numër supozimesh dhe akterësh¹⁸: familja,¹⁹ firmat dhe tregjet.

Familjet - për të parë këtë, modeli konsideron një ekonomi të mbyllur me një normë konstante të rritjes së popullsisë në të cilën çdo person punon me një orar të caktuar të orëve të punës dhe kapitali amortizohet pjesërisht duke u përdorur. Kursimet janë burim i vetëm i investimit në kapital, që shprehë edhe kufizim në rritje.

Objektivi i firmave, është të maksimizojnë fitimin dhe produktin përfundimtar mund ta konsumojnë ose përdorin si kapital duke rritur gjendjen e kapitalit fizik ekzistues. Kapitali zhvlerësohet për shkak të konsumimit fizik me normën e zhvlerësimit që është gjithashtu variabël ekzogjen. Edhe teknologjia është egzogjene dhe e disponueshme për të gjithë pa pagesë dhe përmirësohet me normën e progresit teknologjik $g > 0$.

Tregjet - familjet edhe firmat i marrin çmimet e tregut si të dhëna pra janë çmimet që pastrojnë tregje, supozojmë një ekonomi me një popullsi që rritet me një normë konstante. Çdo person duke punuar përdorë kapitalin i cili amortizohet pjesërisht.

Ndërsa nga modeli Solow, Myle's (2009) në punimin e tij thekson se burim i vetëm i investimit është kursimi, në këto kushte shprehim se produkti i përgjithshëm ($\underline{Y}$) është

¹⁸ Ekonomia në shqyrtim është një ekonomi e mbyllur ku mungon sektori publik.

¹⁹ Familjet janë zotëruarit e faktorëve të prodhimit (kapitali fizik njëjtë me produktin përfundimtar dhe puna). Supozohet që popullsia dhe forca e punës në këtë ekonomi rriten me një normë rritjeje konstante n që është variabël ekzogjen sikurse kursimi S . Familjet kursejnë një pjesë konstante të të ardhurave të tyre dhe konsumojnë $(1 - s)$, duke mos maksimizuar dobinë.

prodhuar në kohën (t). Yt është i ndarë në mes të konsumit ($\underline{C}$) dhe investimeve (I) ndërsa zëvendësohet stoku i kapitalit ($\underline{K}$). Kapitalit (K) dhe puna (L) shprehen me numer të punonjësve, me orë pune, dhe kontributi i kapitali dhe punës shprehe nivelin e prodhimit, ku Myle (2009:8) e shprehë në këtë formë:

$$Y_t = F(K_t, L_t) \dots \dots \dots eq (2)$$

Është supozuar se ka kthime të normës së prodhimit, prodhimi ose mund të konsumohet ose të kursehet. Supozimi themelor i modelit është se kursimi (s) është pjesë fikse e prodhimit, që shprehet, $0 < s < 1$. Pra kursimi duhet të barazojë investimet në ekuilibër në kohën (t) atëherë niveli i investimeve jepet me anë të funksionit (eq.4, Myle. 2009:8) kemi eq.3:

$$I_t = s F(K_t, L_t) \dots \dots \dots eq(3)$$

Amortizimin si normë konstante (δ) të kapitali ekzistues plotësohet me investimev, atëherë kapitali në dispozicion në kohën (t +1) pasqyrohet nga investimi i ri dhe investimi për amortizimin e kapitalit ekzistues, Myle (2009:8):

$$K_{t+1} = I_t + \delta K_t = s F(K_t, L_t) + (1 - \delta) K_t \dots \dots \dots eq 4$$

Ekuacioni (4), tregon se nga akumulimi i kapitalit krijohet stoku i kapitalit i cili me pastaj me kohë transformohet. Fakt është, popullsia është në rritje, kushtet prandaj preferojnë variablën të ardhurat për frymë (GDP_{pc}).

Kthimit i vazhdueshëm i shkallës shprehet përmes funksionit të prodhimit në ekuacionin në vazhdim:

$$Y_t = L_t F \left(\frac{K_t}{L_t} \right) = L_t f(k_t) \text{ ku, } k_t \equiv \frac{K_t}{L_t} \dots \dots \dots \text{eq(5)}$$

Ndarja e ekuacionit (4) me punësimin L_t , sjellë ekuacionin e akumulimit të kapitalit:

$$\frac{K_{t+1}}{L_t} = s f(k_t) + \frac{1-\delta}{L_t} K_t \dots \dots \dots \text{eq(6)}$$

Kështuqë kemi rritjen e popullsi (n) me normë konstante, ndërsa oferta e punës rritet:

$$L_{t+1} = (1+n) L_t \dots \dots \dots \text{eq(7)}$$

Duke përdorur këtë korrelacion të rritjes, ekuacioni 6 tregon se dinamika e raportit kapital - punë në varësi të kohës (t) transformohet si më poshtë²⁰:

$$(1+n) k_{t+1} = s f(k_t) + (1-\delta) k_t \dots \dots \dots \text{eq(8)}$$

Për të kuptuar ekuacionin (8), funksioni i prodhimit merr këtë formë: $f(k_t) = k_t^a$

Pra raporti kapital/punë duhet të jetë i kënaqshëm në një ekuilibër të qëndrueshëm afatgjatë duke filluar nga vlerat fillestare, $k_0 = K_0/L_0$, pas një kohë rritja fillon të ngadalësohet dukshëm duke mos u dyfishuar për një kohë të gjatë. Një shtetë (ekonomi) i qëndrueshëm definohet nga një raport konstant kapital-punë $k_{t+1} = k_t$, duke e shënuar me (k) vlerën kapital - punë në ekuilibër, përmes ekuacion (8) fitojmë ekuacionin (9):

$$s f(k) - n + \delta k = 0 \dots \dots \dots \text{eq(9)}$$

²⁰ Shih: Sie shprehë përmes ekuacioni (7) ne punimin e tij Myle (2009: 8).

Zgjidhja e ekuacionit (9) quhet shtetë i qëndrueshëm i raportit kapital - punë dhe mund të interpretohet si vlera k , ekonomia në ekuilibër afatgjatë.

Modeli egzogen i shehë IHD si rrrjedhë e kapitalit, efekti i tyre në rritje është i kufizuar, ndikojnë në nivelin e të ardhurave të qëndrueshme shtetërore, pra vendosin një nivel të lartë të ekuilibrit por nuk ndikojnë në shkallën e konvergences drejt këtij ekuilibri. Përtej një niveli të caktuar akumulimi i kapitalit nuk kontribon në rritje të prodhimit për shkak të ardhurave të saj në pakësim, për këtë arsye nuk ka efektë afatgjatë të IHD në rritje.

Ne moderuam këtë perspektivë për vendet në moster të cilat shumica supozohet se janë largë nga konvergjenca, ju duhet edhe një kohë e gjatë për të arritur këtë (raportit kapital/punë). Megjithatë, si analogji për disa vende në mostër theksojmë, Jude C. (2012) e cila në gjetjet e saj nuk është arritur efekti i konvergences dhe thekson se shkalla e kohëzgjatjes dhe efekti i përkohshëm i IHD varet nga dinamika e secilit vend ndaj gjendjes së qëndrueshme të tij. Si përmbledhje, modeli i rritjes Solow parashikon konsumin për kokë banori të arrijë një kufi nëse nuk ka progres teknik prandaj varet nga norma e kursimit. Me këtë studim, qëllimi ynë është që të sigurojmë se paku një hyrje në teorinë e rritjes ekonomike. Edhe pse ky model është kritikuar si i paqëndrueshëm, mbetet një kontribut i rëndësishëm në teorinë e rritjes për një analizë të normës së rritjes së ekuilibruar.

2.1.2 Modeli endogjen i rritjes

Modelet endogjene marrin parasysh rritjen ekonomike afatgjatë dhe progresin teknologjik e konsiderojnë si mekanizem endogjen për të shpjeguar burimin e rritjes. Ndërsa në modelin

egzogjen rritja për frymë është e kufizuar për shkak të zvogëlimit të kthimit të kapitalit, produkti marxhinal i kapitalit përputhet me normën e amortizimit, kështu që prodhimi marginal neto është zero Myle (2009:15). Modeli Endogjen rritjes (Romer, P. (1986), Lucas, R. (1988) nënvizon rolin e shkencës dhe teknologjisë, kapitalin njerëzor dhe zhvillimit ekonomik.

Ndikimet e IHD-ve në rritjes ekonomike, duke vepruar si një motor i difuzionit teknologjike që vijnë nga bota e zhvilluar dhe duke u drejtuar në vende në zhvillim. Ndryshe nga qasja egzogjene, në studimin tonë i konsiderojmë IHD si rrjedhë më komplekse, që përmban kapital dhe teknologji. Kjo rezulton të ketë një ndikim të rëndësishëm në rritje afatgjate. Përveq rritjes së nivelit të gjendjes së qëndrueshme të ardhurave, IHD ndikon në shpejtësinë e konvergjencës në këtë ekuilibër. Kjo është e mundur për shkak të kompenzimit të kthimit të pakësuar ndaj kapitalit nga rritja e kthimit nga teknologjia. Kjo është baza teorike për testimin e përhapjes teknologjike në nivel agregat.

Në modelin endogjen (Myles, 2007a) ofronë njohuri të rëndësishme në burimet e rritjes, faktorë të ndryshëm përcaktojnë rritjen duke u nisur nga: akumulimi i faktorëve të prodhimit,²¹ kursimi në nivel kombëtarë, përparimi i teknologjisë dhe njohurive në R & D përmes rritjes së investimeve dhe efikasiteti i punës në procesin e prodhimit nga përdorimi i teknologjisë së avancuar. Modelet Solow (dhe Swan)²² tregojnë se ndryshimi teknologjik

²¹Punë dhe kapital.

²² Ekuacioni Solow-Swan (1956). $Y=f(K,L)$ funksioni i prodhimit.

$Y=GDP; A=teknologjia; K=kapitali; L=puna; \frac{DK}{dt} = Sy - \delta K$, ekuacioni i akumulimit të kapitalit; s = pjesë e kursimit nga GDP ($0 < s < 1$); δ = shkalla e amortizimit (merr pjes) $0 < \delta < 1$; Solow-Swan analizuan se si keto dy ekuacione bashkeveprojnë. Y dhe K janë variabla endogjene; s dhe δ është shkalla e rritjes së forcës së punës (L) si parameter egzogjen. Rezultati varet nga forma e saktë funksionale e funksionit të prodhimit dhe vlera e parametrevë.

drejton rritjen, por rritja e teknologjisë nuk është përcaktuar në kuadër të modelit (është ekzogjene), megjithatë nuk tregon se investimet kapitale janë të parëndësishme ($A \uparrow \Rightarrow \uparrow y$) dhe $\uparrow y \Rightarrow \uparrow MP_k$, pra, $\uparrow k$.

Kjo do të thotë se, teknologjia e mirë rritë prodhimin, dhe krijon mundësi të reja për investime kapitale. Modeli AK, është njëri ndër modelet e rritjes endogjene, përveq modelit të Rebelo's i jepë rëndësi ndërhyrjes së qeverisë dhe Luca's i cili i jep përparësi njohurive.

Si nismëtar i Modeli AK- konsiderohet Romer (1986), e konsideron kapitalin të vetmin kontribut në procesin e prodhimit, sipas tij prodhimi dhe kapitali rritet me ritëm të njëjtë.

Funksioni i prodhimit sipas modelit AK merr formën, Myle (2009:16):

$$Y_t = AK_t \dots\dots\dots \text{eq.(1)}$$

Ku, K përfshinë “kapital- punë”, duke supozuar prodhimin e vazhdueshëm marginal të kapitalit:

$$MP_k = \frac{dy}{dk} = A, \text{ pra, rritja afatgjatë është e mundur.}$$

Rritja e teknologjisë është endogjene, pra supozohet se teknologjia varet nga procesi i investimeve që gjenerojnë ide të reja, njohuri dhe të mësuarit.

Arrow (1962:155-73), supozon $A = g(K)$, të mësuarit në lidhje me teknologjinë e pengon rënien e prodhimit marginal.²³

$$A = g(K) \text{ ku, } \frac{dK}{dK} > 0 \dots\dots\dots \text{eq.(2)}$$

$$\text{Specifikimi për: } A = K^\beta \quad \beta > 0$$

Funksioni i prodhimit të Cobb-Dauglas:

$$Y = AK^\beta L^{1-\beta} = [K^\beta] K^\beta L^{1-\beta} = K^{1+\beta} L^{1-\beta} \dots\dots\dots \text{eq.(3)}$$

²³Economic Growth Models B - Princeton University .Press.princeton.edu/links/.../slides/chap8b.ppt

If $a+b = 1$, produkti marginal i kapitalit është formuluar në ekuacionin në vazhdim:

$$\frac{Y}{dK} = L^{1-a} \dots \dots \dots \text{eq. (4)}$$

Vazhdojmë të paraqesim interpretimin e modelit, (AK), sipas interpretimit të ekuacioni (1)

Myles (2009:16). Niveli i investimeve, me një normë të kursimit (s) në kohën (t), është:

$$I_t = sAK_t.$$

Pra model gjeneron rritje të qëndrueshme, të ardhurat konstante nga kapitali nënkuptojnë që rritja e produktit është e njëjtë me rritjen e stokut të kapitalit, duke formuar ekuacionin (5) i cili shprehë kushtin për akumulimin e kapitalit (Myles, 2009: 16):

$$\begin{aligned} K_{t+1} &= sAK_t + (1 - \delta)K_t \\ &= (1 + sA - \delta)K_t \dots \dots \dots \text{eq.(5)} \end{aligned}$$

Provojmë, $sA > \delta$, do të thotë se investimet do ta tejkalojnë normën e amortizimit, niveli i kapitalit do të rritet në mënyrë njëtrajtshme me $sA - \delta$.

Prodhimi dhe konsumi rriten në mënyrë të njëtrajtshme, duke siguruar një rritje të qëndrueshme. Institucionet relevante për shembull, qeveria mund të zgjedhë modelin e duhur të rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshem, Banka Botrore, (2008:4). Si përfundim, teoria e rritjes endogjene, e cila thekson kapitalin njerëzor dhe risitë dha mundësi të reja për njohjen e burimeve të rritjes ekonomike. Thelbi i teorisë së re, është “*rritja është pasojë e vendimeve racionale ekonomike*”.

2.2 Shqyrtim i literatures teorike të Investimeve të Huaja Direkte

Definicioni i Investimeve të Huaja Direkte

Shqyrtimi teorik mbi IHD tregon një përpjekje të fuqishme të studiuesve për të shpjeguar fenomenin IHD si një faktor që nxitë rritjen ekonomike. Autorë të ndryshëm dhanë modele të ndryshme për IHD dhe rritjen afatëgjatë, duke i bërë këto modele thelbësore për studimin e këtyre marrëdhënieve. Para së të njihemi me teori dhe autorë që janë marrë në vazhdimësi me marrëdhëniet dhe efektet IHD dhe rritjes ekonomike do njihemi me konceptin e IHD.

Një përkufizim i gjërë i IHD është dhënë nga OECD (Benchmark FDI" 1999:7), "*Investimet e Huaja Direkte sipas OECD (2007), reflektojnë synimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm të një njësie rezidente në një ekonomi (investuesi direkt), në një njësi rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrja e investimit direkt). Interesi i qëndrueshëm nënkupton ekzistencën e një marrëdhënie afatgjatë ndërmjet investitorit direkt dhe ndërmarrjes dhe në një shkallë të konsiderueshme të ndikimit në menaxhimin e ndërmarrjes.*" (§7 dhe §8 Benchmark OECD Definition)²⁴

Edhe FMN-ja²⁵ e përkufizon investimin e jashtëm si "*direkt*" kur një investitor mban 10% ose më shumë të pasurisë së një ndërmarrjeje jashtë vendit, mjaftueshëm për t'i dhënë investitorit një masë kontrolli në menaxhimin e saj. IHD është ndarë në tre komponente: Kapitali, kreditë brenda kompanisë dhe fitimet e riinvestuara nga filialat e huaja por duke mos eliminuar fonde shtesë që krijohen nga tregjet e kapitalit si në nivel lokal dhe ndërkombëtar. Dallohen dy lloje të ndryshme të IHD-ve: Investime Portofoli dhe IHD.

i) Investimet e Huaja Indirekte Portofolio (IHIP,) karakterizohen nga:

- Investimet e Huaja Indirekte Portofoli, blen letra me vlerë;

²⁴ Organisation for Economic Co-operation and Development, 1996, OECD Benchmark Definition of Foreign Direct Investment, 3rd ed. (Paris).

²⁵ Përkufizimet e IHD-ve janë të përfshira në manualit të Bilancit të Pagesave: botimi i pestë (BPM5) (Washington, DC, Fondi Monetar Ndërkombëtar, 1993) dhe përkufizim të detajuar Benchmark e Investimeve të Huaja Direkte: Edicioni i tretë (BD3) (Paris, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik -operim dhe Zhvillim, 1996).

- Investimet e Huaja Indirekte Portofoli, synon fitime afatshkurtëra por me rreziqe më të mëdha;
- Investimet e Huaja Indirekte Portofoli, është individ apo institucioni;
- Investimet e Huaja Indirekte Portofoli, janë më të paqëndrueshme në kohë recesioni se IHD (Gheorghe Savoie. 2012: 2.);
- Investimet e Huaja Indirekte Portofoli, nënkupton blerjen e titujve në tregjet ndërkombëtare, nuk përfshin transferimin e aseteve.

ii) Investimet Huaja Direkte (IHD) - fitimi, dividendë dhe fitimet e riinvestuara bëhen përmes:

- IHD bënë krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta apo degëve në vendë të huaja duke blerë kontrollin dhe ushtrimin e menaxhimit të investimeve;
- Investimet Huaja Direkte kanë aftësi menaxheriale;
- Investimi i Huaj Direktë synon kthimin në afat të gjatë;
- Fitimi është i kompanisë;
- IHD përfshinë dhënien përmes investimit në një korporatë, dhe përfshinë asetet fizike dhe të paprekshme (Suzana Popoa. 2012:2).

2.2.1 Klasifikimi i Investimeve të Huaja Direkte sipas vendit të origjinës

IHD vijnë përmes Ndërmarrjeve Shumëkombëshe të cilat përveç selisë në vendin e origjinës bëjnë diversifikimin e e filialeve në vende të ndryshme. Kushtet për ekzistencën e

IHDve vertikale dhe horizontale prezantohen në tabela 3. Edhe nga këndvështrimi teorik, IHD ndahet në dy kategori²⁶, horizontale dhe vertikale.

Tabela nr.3: *IHD vertikale dhe horizontale, Protsenko A. (2003:19).*

IHD vertikale dhe Horizontale	Vertikale	Horizontale
Karakteristikat e vendit:		
-Madhësia absolute e tregut	i vogël	i madh
-Madhësia relative e tregut	-	i ngjashëm
-Faktorët relativë të brendshëm	ndryshëm	ngjashëm
- Shpenzimet tregtare /barrierat	ulëta	memse /larta
-Barrierat tarifore	ulëta	larta
Ekonomitë e shkallës:		
-Nivel firme	-	i madh
-Nivel filiale	-	i vogël

Caves (1971:25) është nisur nga vendi i orgjinës dhe qëllimi i IHD-ve ato i klasifikoi si:

i)IHD Vertikale (VIHD)-Ndërmarrjet shumëkombëshe (MNE-s) vertikale selinë e firmës e kanë të ndarë nga prodhimi duke ndarë edhe zinxhirin e prodhimit të tyre në faza të ndryshme në vende të ndryshme, gjejnë mënyrën për të ulur shpenzimet e tyre të prodhimit Helpman (1984:457); Markusen (1999:338). IHD vertikale, përfshin një

²⁶ Sipas (Navaretti dhe Venables, 2004:300) IHD Horizontale (HIHD) janë më të përhapura kudo, ndërsa IHD Vertikale (VIHD) janë drejtuar kohëve të fundit në vendet në zhvillim (G. H. Hanson, R. J. Mataloni, Jr., dhe M. J. Slaughter (2003:6).

decentralizim gjeografik të zinxhirit të prodhimit të firmës. IHD vertikale referohen si “IHD në kërkim të efijences” pasi motivi kryesor për investime është për të përmirësuar koston e efektivitetit të prodhimit duke shfrytëzuar koston e lirë të punës dhe burimeve natyrore në vendin pritës. Linjat e ndara të prodhimit të varura nga kosto më e lartë dhe shfrytëzon burimin e lirë natyror dhe njerëzorë (Markusen 1984), në këtë lloj të IHD shkojnë zakonisht industri të makinerive dhe elektronike (Hanson, et al (2001).

ii) *IHD Horizontale (HIHD)*-Ndërmarrjet shumëkombëshe (MNE-s) horizontale zhvillojnë aktivitete të njëjta në vende të tjera duke marrë një pjesë të tregut të synuar. Firmat zgjedhin IHD horizontale për të ju shmangur barrierave tregtare. Madhësia e tregut kontribuon në zhvillimin e IHD horizontale. Kushtet për paraqitjen e IHD horizontale janë:

- Redukton flukset tregtare;
- Kur kostot e importit janë të larta për shpenzimet e investimit;
- Kur përhapet kosto fikse mbi një pjesë të madhe të prodhimit në një vend të huaj (p.sh hidrocentrale);
- Ulet kosto marginale e prodhimit që mund të ndryshojë sjelljen e konkurrentëve;

Janë investorët si kërkues tregu që synojnë tregun e brendshëm të vendit pritës, prodhimi vendas konsiderohet më efikas për të depërtuar në treg, se eksportet nga vendi origjinës. IHD horizontale, prodhojnë të njëjtin produkt në njësi të shumta dhe përmes eksporteve depërtojnë në filialat në vende të huaja (Haile & Assefa, 2006) cituar nga Jude C. (2012). Ky lloj i IHD është treg kërkues, meqenëse hyrja në tregje është e kushtueshme për shkak

të barrierave komerciale, kostove të larta të transportit, ndërmarjet prodhojnë në drejtim të tregut të brendshëm.

iii) Konglomerat- përzierje e IHD-ve horizontale dhe vertikale apo investim i një natyre tjetër në filiala jashtë vendit në krahasim me investimin në vendim e origjinës.

Caves (1974:38), përcakton një firmë shumëkombëshe si një ndërmarrje që kontrollon dhe menaxhon qendrat e prodhimit (njësitë) të vendosura në të paktën dy vende dhe menaxhohen dhe kontrollohen nga e njëjta firmë. Kontribuesit kryesorë të IHD-ve në nivel global janë Ndërmarrjet Shumëkombëshe (MNE).

2.2.2. Klasifikimi i IHD sipas motivit të investitorit

Teoria Eklektike e Dunning përmes paradigmës OLI, theksoi llojet e IHD-ve, ndërsa Jere Behrman shpjegoi objektivat e ndryshme të IHD-ve:

-IHD-kërkuese të burimeve;IHD-kërkuese të tregut;IHD-kërkuese të efijencës;

-IHD - kërkuese tënjohurive;IHD - kërkuese të aseteve strategjike.

- *Kërkuese të burimeve*, Investitorët e huaj kërkojnë çmime të ulëta të lëndëve të para, kosto të ulët për njësi të punës së pakualifikuar, punës me kualifikim të lartë, infrastrukturën fizike (portet, rrugët, pushtetin, telekomunikacionin), niveline teknologjisë.

-*Kërkuese të tregut*, IHD kërkuese e tregut është e lidhur zakonisht me madhësinë e tregut dhe të ardhurat për frymë, rritja e tregut, qasjen në tregjet rajonale dhe globale, preferencat e konsumatorit dhe struktura e tregut të brendshëm. Zakonisht preferohen tregje

të reja, të mëdha. Mundësi unike për disa lloje të shërbimeve për të cilat prodhimi dhe shpërndarje duhet të jenë të njëkohëshme.

-Kërkuese të eficiencës, IHD është e motivuar duke krijuar burime të reja të konkurrencës dhe shkojnë aty ku shpenzimet e prodhimit janë më të ulëta. Para marrjes së vendimit, investitorët e huaj i konsiderojnë si shumë të rëndësishme çmimin e faktorëve të prodhimit dhe anëtarësimin në integrimet rajonale. IHD kërkuese të efikasitetit zgjedhin elemente të IHD vertikale e cila do të jetë më e dobishme për kompaninë. Është e preferuar ndarja gjeografike e fazave të ciklit të jetës së produktit duke hapur degë në vende të tjera të ndryshme nga vendi ku vepron kompania ” mëmë.” Zakonisht të tilla investime bëhen nga vende të zhvilluara duke përfituar nga ekonomitë e shkallës.

Me diversifikimin e produkteve ulët risku i humbjes së tregut nga krizat ekonomike apo ndryshimi i preferencave të konsumatorëve, rritet mundësia e përfitimeve në kosto të prodhimit etj.

-Kërkuese të njohurive, kompanitë investojnë në mënyrë për të fituar qasje në teknologji të re apo blerjen e disa markave apo produkteve. Preferohen nga vendet në zhvillim të cilat kanë kaluar pragun minimal të njohurive dhe janë në gjendje të përdorin teknologjinë dhe njohuritë (ekspertizë dhe trajnime menaxheriale).

-Kërkuese të aseteve strategjike, ndjekin operacionet strategjike nëpërmjet blerjes së firmave ose aseteve ekzistuese në mënyrë që të mbrojnë avantazhet specifike të pronësisë për të mbështetur ose avancuar pozitën e saj konkurruese globale.

2.2.3 Investimet e Huaja Direkte sipas formës së organizimit

IHD, kanë ndikim të drejtpërdrejt dhe të tërthortë në variablat ekonomike, por këtondikime mund të ndryshojnë sipas llojeve të IHD-ve. Në standardet e FMN- së, OECD-se dhe Bankes Botrore janë këto forma të organizimit të IHD-ve:

- *IHD Greenfield*, që përfshijnë investime të huaja duke ndërtuar objekte të reja prodhimi, shpërndarje ose kërkimë në vendin pritës;
- *IHD Brownfield*, kur investitori i huaj investon në objekte ekzistuese në vendin pritës (Johnson. 2006:13). Këto investime nganjëherë janë klasifikuar edhe si bashkime dhe blerje (WIR. 2009), duke krijuar linjat e prodhimit dhe zëvendësimin e paisjeve pas blerjes së një firme të huaj Sharan (2011:13-15). Rasti i privatizimit të ndërmarrjeve që kanë operuar me humbje në Kosovë p.sh. Ferronikel, Klllokot fabrika e ujit, vreshtaria Stone Castle, M& Sillosi etj., janë shembuj tipik të Brownfield.
- *Zgjerimi i kapitali*(investime të reja shtesë) nënkuptohet financimi shtesë i kapitalit me qëllim të zgjerimit të kapaciteteve ekzistuese. Investime të tilla në Kosovë ka më së shumti dhe kontributi më i madh është nga diaspora.
- *Huat midis kompanive*, transferimi i kapitali nga një kompani jashtë vendit në një kompani tjetër brenda vendit, kundrejt normave përkatëse të interesit. Ekzistojnë edhe forma të tjera të IHD që nuk kanë të bëjnë me transferim të kapitalit por që luajnë rol në zhvillimin ekonomik të vendit në formë të nënkontraktimeve, licencimeve dhe marrëveshjeve franshizë, etj.

2.2.3.1 Modelet teorike të Investimeve të Huaja Direkte (IHD)

Me paraqitjen e fenomenit IHD janë diskutuar edhe modele të tyre me qëllim të përzgjedhjes së variablave më të përshtatshme për studim. Varësisht çfarë aspekti teorik analizojmë IHD, përcaktohem edhe për modelin e tyre. Njihen nëntë modele teorike të investimeve të huaja direkte Faeth I. (2008:165-96):

(1), përcaktuesit e teorive të hershme të IHD-ve (1), përcaktuesit e IHD-ve bazuar në teorinë e tregtisë neoklasike (2), avantazhet e pronësisë (4), ndryshoreve agregate (5), modelet e avantazheve të pronësisë, vendndodhjes dhe internalizimit (6) modelet horizontale dhe vertikale të IHD (7), modeli i njohurive-kapitale (8) modelet e diversifikimit të llojllojshmërisë së IHD (9) variablave të politikave. Secila prej nëntë teorive kanë nxjerrë përcaktuesit përkatës të IHD-ve.

Prandaj, analiza e përcaktuesve të IHD nuk duhet bërë vetëm me një model teorik. IHD-të shpjegohen më gjerësisht nga një kombinim i faktorëve të shumëllojshëm, siç janë: avantazhet e pronësisë apo ekonomia aglomerate, madhësinë e tregut dhe karakteristikat e tij, faktorët e kostos, shpenzimet e transportit, mbrojtjen, faktorët e rrezikut dhe variablave të politikës. Meqenëse studjojmë IHD dhe efektin e tyre në rritje, trajtojmë edhe modelet ekonometrike dhe statistikore që merren me këtë çështje duke u ndarë së pari në katër grupe kryesore. Klasa e fundit c) Dunning, (1985:228-1992;1988:3;1980:9-31), grupi katër (iv) janë modele të IHD-ve sipas paradigmës Eklektike të Dunning të ristrukturuara përmes katrorëve të vegjël dhe përbëjnë pjesën më të madhe të numrit të modeleve të ndërtuara pas identifikimit të një faktori kyç. Fillimisht gjeneron modele me “faktorë të vetëm” nga modeli 1 deri 21 (shih Tabela nr.4, modelet ekonometrike, faqja e shënimeve).

2.3 Teoritë e Investimeve të Huaja Direkte

Investimet Huaja Direkte shihen si një mënyrë për të rritur efikasitetin e përdorimit të burimeve në vendin pritës. Ato perceptohen si një përpjekje për të stimuluar rritjen ekonomike sidomos në vendet në zhvillim. Një përshkrim i kujdesshëm i bëhet përfitimeve të shumta që sjellin IHD në vendin pritës dhe një formulim i përgjithshëm pozitiv i qëndrimeve për IHD²⁷. Përgjigjejet në shqetësimet për IHD nuk do të jenë debat i gjërë në këtë punim dhe konsiderohen si kufizime.

Megjithatë, tabela 5 paraqet teoritë kryesore që adresohen në ndërkombëtarizimin e biznesit dhe shënuan hapat e zhvillimit të ekonomisë si shkencë.

Duket se ekziston një konsensus i gjërë se IHD është e rëndësishme, më të rëndësishëm janë burimet, përmes të cilëve teknologjia e përparuar është transferuar në vendin pritës. IHD çon në produktivitet më të lartë në firmat e vendit pritës, veçanërisht në sektorin e prodhimit. Është dëshmuar se sasia e teknologjisë së transferuar është e kushtëzuar nga karakteristikat e vendit pritës si, konkurrenca e vendit pritës, niveli i investimeve të brendshme, niveli i arsimit, nëse janë të mjaftueshme do të rrisin shkallën e transferimit të teknologjisë.

Në përgjithësi këto teori mund të klasifikohen në tri klasa dhe theksi më tepër do të jetë teoria e investimeve të huaja.²⁸

²⁷Megjithatë është e dobishme për të shqyrtuar shkurtimisht statistikën themelore mbi IHD-të, në mënyrë që të jepet një analizë në retrospektivë dhe vijuese të IHD-ve, që do të bëhet në kapitullin në vazhdim.

²⁸Vendet në mbarë botë patën mundësi për të shfrytëzuar avantazhet e tyre të pronësisë, lokacionit në kuadër të së cilës janë edhe përcaktuesit institucional dhe ndërkombëtarizimit, duke dëshmuar se paradigma eklektik

Tabela nr.5:Klasifikimi në tri klasa i teorive ekonomike.

Teoritë e tregtisë	Teoritë e qasjes tradicionale	Teoritë e faktorëve të diversitetit
-Teoria krahasuese e përparësisë absolute (Adam Smith, 1776). -Teoria e Avantazheve krahasuese relative (David Ricardo, 1817). Teoria e avantazheve krahasuese në skemën e përgjithësuar (Mihail Manoilescu, 1929). Teoria Modeli e gravitetit komercial (Walter Isard, 1954). Heckscher-Ohlin Modeli teorik (Eli Heckscher 1919, Bertil Ohlin, 1933), -Paradoksi Leontief"s (Wassily Leontief, 1954). Teoria e bazuar në hipoteza Linder (Staffan Burenstam Linder, 1961). -Teoria e vendndodhjes. -Teoria e të metave të tregut (Stephen HYMER, 1976, Charles P. Kindleberger, 1969, Richard E. Caes, 1971), -Teoria e faktorëve specifik me modelin R, etj	-Teoria e Investimeve të Huaja Direkte, -Teoria e avantazheve monopoliste (Stephen HYMER), Teoria e trajtimin nga jo-disponueshmëria (Irving B. Kravis, 1956), Teoria hendeku teknologjik (Posner), Modeli teorik Uppsala, Teoria Porter Diamond (Michael Porter), Teoria e shpërndarjes së Informacionit (Rogers 1962), Teoria Paradigma Eklektik (John H. Dunning), etj .;	Teorinë e sjelljes së firmës Richard M. Cyert dhe James G. M (1963), Yair Aharoni, (1966), Teoritë e paparashikuara, teoria e kontratës, teoria e shkallës, -Teoria ndërkombëtarizimi (Peter J. Buckley dhe Mark Casson, 1976, Rugman, 1981), Teoria e ciklit të jetës së produktit Raymond Vernon, 1966), Teoria e rritjes së firmës (Edith Penrose, 1959), Teoria e kostos së transaksionit, etj

Burimi: Rugman & Hodgetts (2003:28), dhe analizë thelluar e literaturës nga autori

(OLI), është teoria më e përshtatshme për të analizuar avantazhe e vendndodhjes dhe përcaktuesit institucional të IHDve prej nga niset edhe studimi.

2.3.1 Klasifikimi i Teorive Ekonomike të Tregtisë dhe IHD-ve

Aspekti teorik mbi IHD ka çuar në njohje më të mirë të motiveve që shtyejnë një ndërmarrje të huaj për të investuar në vend tjetër. Teoria makro e IHD-ve i jep rëndësi investimit nga një “vend specifik” e jo në një “firmë specifike,” Heledd Straker (2009:1-7). Teoria makro²⁹ e IHD njihet si teori tradicionale klasike makroekonomike e cila supozon se norma e fitimit shkon në vendet e industrializuara për shkak të kapitalit të mjaftueshëm dhe konkurrencës së brendshme që i detyron firmat të investojnë në vende të pa zhvilluara, Cantwell, Pitelis, Sugden, (2000:13).

Edhe qasja neoklasike nuk e thekson drejtpërdrejt fitimin si motivin e investimit, por pohon se për shkak të mungesës së fuqisë punëtore dhe shpenzimeve relativisht të larta të punës në vendet e pasura transferohen objekte të prodhimit në vende të varfëra Cantwell (2000:14), Caves (1999:39). Teoritë ekonomike që janë marrë me IHD në nivel makro:

- Teoria e Tregut të Kapitalit³⁰ (The Theory Capital Market);
- Teoria Makro-ekonomike Dinamike³¹ e IHDve (The Theory of FDI Dynamic Macro-economic);
- Teoria e Kursit të Kembimit³² (The Theory of Exchange);
- Teoria e Gjeografise Ekonomike³³ (The Theory Economic Geography);

²⁹ Teoria klasike e nivelit makro u bazua në konceptin e një tregu konkurrues të përkryer, kërkesës dhe fitimeve në rritje të vazhdueshme duke kompenzuar disavantazhet si i huaj përmes çmimeve të ulëta.

³⁰Teoria rrjedha e Kapitalit sugjeron se kapitali (financiar) lëviz midis vendeve të ndryshme që kanë norma të interesit të ndryshme (HYMER, 1979). Ky shpjegim ishte i dështuar.

³¹Sipas të cilës koha e investimeve varet nga ndryshimet në mjedisin makroekonomik (Sanjaya Lall 1997:125).

³²Teoria e rrisht të Kursit të Kembimit (The Exchange Rate Risk Theory), Aliber (1970:17), shpjegon sjelljen e investimeve të huaja direkte në formën e fuqisë relative të monedhave të ndryshme.

³³Sipas teorisë së IHD-ve në bazë të gjeografisë ekonomike qeveritë mund të ndikojnë në burimet brenda juridiksionit, me politika të ndryshme (Storper 1996, 1997; Sassen 1991, 1994).

- Teoria e Terheqjes –Gravititet³⁴ të IHDve (The Theory Drawing of FDI);
- Teoria e Investimeve të Huaja Ndërkombëtare-Vendendodhja (The Theory – Location International Investment)³⁵;
- Teoria e Analizes Institucionale³⁶ (The Theory of Institutional Analysis).

Kontributi i Coase (1937:15) në nivel firme si teori makro³⁷ e IHD ka dhënë shpjegime të përgjithësuara dhe nuk ka marrë prasysh detaje të tjera, përderisa firma investon diku tjetër, kështu që solli një qasje të re “teorinë në nivel mikro³⁸” e Ndërmarrjeve Shumëkombëshe që e shehë më të rëndësishme “firmën specifike se vendin specifik”.

Pionier i teorisë mikro konsiderohet Hymer’s (1960:69). Edhe Dunning’s u ndikua nga kjo qasje revolucionare (e teorisë mikro), theksoi rëndësinë e avantazheve të pronësisë së një firme (duke futur paradigmen e tij eklektike aq të diskutueshme). Përcaktuesit e përshtatshëm të IHD brenda një vendi stimulojnë IHD dhe krijojnë zingjirimin e vlerave pozitive nga eksternalitetet.

³⁴Në qoftë se dy vende janë shumë afër, sa i përket gjeografisë, ekonomisë dhe kulturës, atëherë flukset e IHD-ve midis vendeve janë më të larta. Teoria e Gravititetin përfshin variabla tradicionale të tilla si madhësia e vendit, shkalla e zhvillimit, distanca, gjuha e përbashkët etj.

³⁵Teoria makroekonomike Dinamike e IHD-ve, sipas të cilës koha e investimeve varet nga ndryshimet në mjedisin makroekonomik (Sanjaya Lall 1997:125).

³⁶E zhvilluar nga Saskia Wilhelms (1998) shqyrton rëndësinë e kornizës institucionale në flukset e IHD. Sipas kësaj teorie stabiliteti politik është faktor kyç i një kornize institucionale të shëndetshme. IHD përcaktohen më shumë nga variablat institucionale dmth. politika, ligjet dhe zbatimi i tyre. Katër institucione që kontribuojnë në flukset e IHD-ve janë qeveritë, tregjet, arsimit dhe socio-kultura (Wilhelms, 1998).

³⁷ Sipas teorisë së nivelit makro e investimeve të huaja direkte (IHD), vendet me kapital të zhvilluar investojnë kapitalin e tyre dhe punën intensive në vende që kanë hendek të kapitalit dhe fuqi të lirë punëtore me qëllim të maksimizimit të fitimit.

³⁸ Shihet se një teori e re e ka zëvendësuar një të vjetër, por shihet se janë të ndikuara nga njëra - tjetra. Vlerësime dhe kritika kanë dhënë autorë të shumtë në mesin e të cilëve janë edhe Caves (1999:26), Yamin (1991:41-75), Cantwell (2000), Pearce (2005:3) , dhe Heledd Straker (2009:7).

Hulumtimi i bërë mbi sjelljen e firmave shumëkombëshe të motivuara nga produktiviteti i lartë në tregje të huaja (Faeth, 2009:170), përmblodhi shpjegimet e autorëve Heckscher-Ohlin (1933), Macdougall (1960:66) dhe Kemp (1964:176), mbi përfitimet dhe përcaktuesit e IHD në tregje të huaja. Megjithatë nuk duhet lënë pa një vështrim tabelar, (Tabela nr. 6, teorit dhe përcaktuesit e IHD-ve, *faqja e shënimeve*) të teorive dhe autorë që janë marrë me këtë çështje ndër vite, me gjithë kundërshtitë sa i përket përfitimeve apo humbjeve që ka vendi pritës duke hapur dyert Korporatave Multinacionale (MNC).

2.3.2 Teoritë klasike të ndërkombëtarizimit të IHD në nivel mikro

Teoria klasike e tregtisë në mënyrë efektive përshkruan skenarin ku një vend gjeneron të mallrave dhe shërbimeve në të cilat ajo ka një përparësi. Koncepti i ndërkombëtarizimit siç është shënuar në një artikull të parë nga Hayes dhe Abernathy (1980), performanca e deficitit tregtar të një kombi nuk mundet gjithmonë të shpjegohet nga fenomene makro-ekonomike dhe duhet pranuar rolin që luan sipërmarrësi në shpjegimin ndërkombëtarë të aktiviteteve tregtare të një kombi, Morgan E. R., Katsikeas S. C.(1997:71).³⁹Edhe pse TERMI ndërkombëtarizim është përdorur gjerësisht, Piercy (1981) dhe Turnbull (1985) përshkruajnë ndërkombëtarizimin si lëvizje e jashtme e operacioneve të një firme. Prandaj përshkrimi i ndërkombëtarizimit nga Welch dhe Luostarinen, 1988:36) si “... *procesi i përfshirjes në rritje të operacioneve ndërkombëtare*” merrë në konsideratë ndërkombëtarizimin dhe rritjen e firmave të brendshme dhe të jashtme.

³⁹ http://www.st-andrews.ac.uk/business/distance/Economics/Reading/Critique_trade_theories.pdf

Dunning (1980:163-190) dhe Fayerweather (1982) kanë adresuar dhe zhvilluar teorinë e prodhimit ndërkombëtar duke e zgjeruar, sugjerojnë se prirja e një firme për të investuar jashtë varet nga avantazhet që ofron një vend tjetër. Kjo Teoria e bën të qartë se jo vetëm dallimet e burimeve dhe avantazheve të firmave por qeveria e huaj në vendin pritës luan një rol në përcaktimin aktiviteteve të jashtme të investimeve, Morgan E. R., Katsikeas S. C.(1997:70).

Ndërsa teoria tradicionale e IHD-ve, shpjegohet kryesisht nga motivet dhe përcaktuesit e IHD-ve dhe aktivitetet e MNE-së nga perspektiva e vendeve të zhvilluara. Autorët që janë marrë, Hymers (1960) me teorinë monopoliste, Vernon (1966) me teorinë e ciklit të jetës së produktit, Buckley dhe Casson (1976) me teorinë e internalizimit, Dunning's (1976) me Paradigmen eklektike të prodhimit ndërkombëtar.

Kojima (1978) me teorinë e zgjerimit marginal të industrializimit, theksoj se është paradigma eklektike që gjerësisht njihet si më e përshtatshme për të shpjeguar prodhimin ndërkombëtar dhe motivet dhe kushtet e MNE-së, sepse integroi teorinë paraardhëse të ndërkombëtarizimit, teorinë e përparësisë monopoliste të Hymers⁴⁰ dhe avanzhet e lokacionit. Meqenëse teoria në nivel makro e IHD, theksonte maksimizimin e fitimit duke i dhënë më shumë rëndësi „vendit specifik”, dallon nga teoria në nivel mikro e

⁴⁰Kindleberger (1969), HYMER (1972), kanë deklaruar se IHD është rezultat i drejtpërdrejt i një mjedisi të papërsosur kudo në botë.

ndërmarrjeve shumëkombëshe e HYMER'S (1960:49), që i jep rëndësi „firmës specifike.”⁴¹,

Janë teoritë ekonomike në nivel mikro të IHDve, që deri diku mund t'i japin përgjigje pyetjeve⁴² të shumta për motivin e investitorëve:

- Teoria e avantazheve specifike të ndërmarrjes,
- IHD dhe tregu oligopolistik,
- Teoria e internationalization (ndërkombëtarizimit),
- Teoria eklektike.

2.3.2.1 Teoria e avantazheve specifike të ndërmarrjes

Hymers (1960)⁴³ është pionier i teorisë ekonomike të kompanisë shumëkombëshe, me disertacionin e tij në vitin 1960 tërhoqi vëmendjen për operacionet ndërkombëtare të MNE-së, duke shpjeguar se teoritë tradicionale ndërkombëtare kishin vështirësi në shpjegimin e motiveve të MNEsë dhe angazhimin e IHD-ve.

⁴¹Pearce, (2005:4-5), theksoj se drejtues për ndërmarrje shumëkombëshe janë firmat individuale, në vend se kapitali i vendit, duke mbështetur idetë e HYMER'S se kompanitë shumëkombëshe mund të egzistojnë në një treg të papërsosur.

⁴²Sipas, Solomon Mamo Woldemeskel (2008:204), janë disa pyetje që kërkojnë përgjigjeje: Pse kompanitë shumëkombëshe (MNCs), preferojnë hapjen e degëve jashtë vendit dhe jo të bëjnë eksportimin ose licencimin e produkteve të tyre ? Si e gjejnë vendin të investojnë ? Pse ata investojnë ?

⁴³Sipas Morgan. E., Katsikeas S.C (1977:70), teoria e shtetit e tregut të papërsosur thekson se firmat vazhdimisht kërkojnë mundësi të tregut të ri dhe vendimi i tyre për të investuar jashtë shtetit shpjegohet si një strategji për të përfutur aftësive të caktuar, të mos ndahen nga konkurrentët në vendet e huaja (HYMER, 1970).

Megjithatë, teoria e avantazheve monopoliste⁴⁴ e Hymers nuk mund të shpjegojë pse MNE-të zgjedhin IHD në vend se të zgjedhin eksportimin dhe licencimin si formë më e mirë.

Teza HYMER-it (1960, 1970:52), botuar në vitin 1976, ka dy kontribute të padiskutueshme:

- Kontributi i parë - Koorparatat Multinacionale (MNC),
- Kontributi i dytë -Operacionet ndërkombëtare, Investimet portofoli⁴⁵(pronësinë e plotë ose të pjesëshme të kapitalit, licencimet, etj).

Interesimi i HYMERs ishte më shumë për operacionet ndërkombëtare të kapitalit, se për rritjen e Shoqërive Shumëkombëshe. Teoria HYMERs⁴⁶, është me e ngushtë se teoria eklektike Dunning. Nga vështrimi i autorëve pas Hymer's, avantazhet e pronësisë së Korporatave Transnacionale (TNC), janë varësisht nga dinamizmi i ekonomisë.

Meqenëse Hymers përmend dështimet e tregut dhe avantazhet e firmës, ai nuk përmend koston e transaksionit të Coase-s, si operon firma në një vend të huaj (sepse në zhvillimin e transaksioneve specifike kërkohen asete shtesë). HYMER'S kritikohet kur thotë se firmat arrijnë deri te fitimi përmes zgjerimit, duke përdorur avantazheve të pronësisë. Sipas Yamin (1991:66-75), oligopolet kanë sukses përmes madhësisë së tyre dhe jo përmes avantazheve të pronësisë, megjithatë ai cekë se kohëve të fundit fuqia e tregut është e panevojshme, ndërsa avantazhet e pronësisë janë të rëndësishme në suksesin

⁴⁴Hymers formoj teorin e tij të avantazheve monopoliste, nisur nga tregjet jo perfekte (të metat e tregut) dhe qasja e organizimit industrial si arsye e ndërkombëtarizimit të aktiviteteve të IHD në MNE (Parry, Thomas G. (1977), cituar nga Beiguang Zhu (2008:12-24).

⁴⁵Dështimet e tregut, që ka të bëjnë me lëvizjen e kapitalit, merr drejtimin e rrezikut dhe pasigurisë.

⁴⁶Nga HYMERs, janë ndikuar autorët pasardhës Caves (1999:7), Dunning., Rugman (1985:26), Pearce (2005:32), Yamin (2000:10), në të kuptuarit e natyrës dhe suksesit të ndërmarrjes shumëkombëshe.

e MNEsë. Hymers⁴⁷ sipas Yamin (2000:13), pa dashje ka shpjeguar në teorinë e tij mikro të firmës edhe avantazhet e lokacionit të dyja teorive makro, kur thekson se punëtorët amerikanë më shumë dëshirojnë të punojnë në firmat amerikane që veprojnë jashtë Amerikës sesa në firmat e ndonjë vendi tjetër. Kjo shpjegon se dy teoritë vetëm së bashku mund të qartësojnë shumë çështje që kanë të bëjnë me aktivitetin e Ndërmarrjeve Shumëkombëshe dhe investimeve të tyre jashtë vendit.

Kufizimet⁴⁸ kryesore të HYMER-s kanë të bëjnë me mendime neoklasike. Mbështetja nga mendimtarët klasikë, Allyn Young, Edith Penrose dhe George Richardson, mund të ndihmojnë në sqarimin e parashikimeve më të sakta të HYMER-s. Kjo nuk e heqë kontributin e jashtëzakonshëm dhe unik të HYMER-s.

2.3.2.2 Teoria e ciklit jetësor të produktit

Teoria Cikli i jetës produktit e zhvilluar nga Vernon (1966, 1971, 1974) ofron një shpjegim teorik që ka të bëjë më shumë me vetë biznesin sesa me ekonominë. Sipas Vernon konkurrenca për koston më të ulët e dërgon prodhimin jashtë vendit. Vendi orientohet nga eksporti duke formuar një cikël të prodhimit në vendet e huaja, Vernon (1966, 1971)⁴⁹.

Përfitojnë së pari vendet e industrializuara duke u ngopur tregu i tyre, pastaj nga përparësitë e krijuara (konkurrenca) produkti gjenë treg kudo për t'u shitur. Kjo teori përcakton fazën e

⁴⁷ Qëllimi i Oligopolit është për të hequr konfliktin, asetet e mëdha domosdo e rrisin konkurrencen e tij që inkurajon inovacionin (të cilin Hymers nuk e thekson).

⁴⁸ Ideologjia marksiste e HYMER-s ka luajtur një rol kryesisht në parashikimet e tij për bashkëpunim të Ndërmarrjeve Shumëkombëshe (MNE-s) dhe recetën e tij për planifikim qendror (Christos N. Pitelis, 2005:39).

⁴⁹ Për dallim nga tregtia ndërkombëtare, Wells (1968, 1969) ku prodhimi i huaj bëhet konkurrentë në tregjet e vendeve pritëse të eksportit dhe del në pah konkurrenca e importit.

rritjes – në ciklin e jetës së produktit – si faza kur eksportet rriten dhe investimi i huaj shkon për fabrika prodhuese në vende që kanë kërkesë në rritje për produktin. U krijua si një përgjigje të dështimit të teorisë Heckscher-Ohlin (1933),⁵⁰ e tregtisë ndërkombëtare. Sipas teorisë Vernon, firma ngritë objekte të prodhimit jashtë vendit për ato produkte të cilat janë të standardizuara dhe pjekura në vendin e origjinës (Sethi et al. 2003). Vernon konsideron se analiza e teorisë së avantazheve relative monopoliste ishte statike dhe nuk ka mundur të shpjegojë se si ndërmarrjet mund të zhgjedhin në mes eksporteve dhe IHD-ve. Vernon, duke kombinuar teorinë e avantazheve monopoliste, avantazhet e ciklit jetësor të produktit dhe vendndodhjen e ndërmarrjeve që investojnë jashtë i dha dinamizëm teorisë se tij për IHD. Ai ndau ciklin e jetës së produktit në tri faza:

- *Faza e re e produktit*, produkti prodhohet në vendin e origjinës dhe futet në tregje të huaja përmes eksportit në faza të hershme;

- *Faza e pjekurisë së produktit*, me zhvillimin e teknologjisë dhe hyrjes së konkurrentëve të huaj, kostoja e prodhimit bëhet shqetësim për firmat dhe faktori më i rëndësishëm. Prandaj investimet në vende të huaja në këtë rast janë më të dobishme se eksportet. Firmat janë të detyruara për të investuar dhe për të prodhuar në vende tjera në mënyrë që të arrijnë ekonomitë e shkallës, të ulin koston e prodhimit dhe rritjen e konkureshmërisë së produkteve;

⁵⁰ Sipas kësaj teorie, vendet do të prirën për të gjeneruarmallradhe shërbime të cilat shfrytëzojnë eksportin e sasive të mëdha të faktorëve të prodhimit që ata posedojnë, ndërsa ata do të importojnë mallra dhe shërbime që kërkojnë sasi të mëdha të faktorëve të prodhimit të cilat mund të jenë relativisht të pakta në vendin e tyre, (Heckscher dhe Ohlin, 1933). Prandaj, kjo teori e shtrin konceptin e përparësi ekonomike duke pasur parasysh përparësinë dhuratë nga natyra dhe kostot e faktorëve të prodhimit.

- *Faza e produktit të standardizuar*, produkti bëhet plotësisht i standardizuar, firmat do të përpiqen për të zhvendosur prodhimin e tyre në vende me kosto të ulët në vende në zhvillim (Vernon, 1966:190-207). Sipas Dunning (1993:71), teoria e ciklit jetësor të produktit e kombinuar me avantazhet monopoliste dhe avantazheve të vendndodhjes konsiderohet interpretimi i parë dinamik i prodhimit ndërkombëtar dhe tregtisë ndërkombëtare.

2.3.2.3 Teoria e ndërkombëtarizimit (brendësimit)

Teoria e ndërkombëtarizimit (internalization)⁵¹ Buckley dhe Casson e IHD-ve, erdhi nga teoria e koston së transaksionit të Coase (1937). Teorema Coase është aplikuar gjerësisht në hulumtimin mbi aktivitetin e brendshëm të ndërmarrjes (konteksti kombëtar), ndërsa Buckley dhe Casson paraqitën këtë teori në studimin e ndërkombëtarizimit të MNE-së dhe aktivitetet e IHD-ve. Megjithatë, teoria e internalizimit dështoi të shpjegojë se pse MNE-të investojnë për të prodhuar jashtë dhe cilin vend e zgjedhin për të investuar. Buckley dhe Casson (1976; 1985:7,12), zhvilluan teorinë bazuar me konceptin e internalizimit, që përfaqësojnë një teori afatgjatë të MNE-së. Kjo teori si parakusht për analizën teorike merr tregun e papërsosur. Teoria e internalizimit thekson se ndërmarrjet preferojnë më shumë të mbajnë avantazhe monopolistike brenda ndërmarrjes për shkak të papërsosshmërisë së

⁵¹ Buckley (1982, 1988) dhe (1976, 1985), sjellë shqetësimet e internalizimit apo zgjerimit të operacioneve të drejtpërdrejta të firmës në pronësi të përbashkët dhe kontrollin nga Tregje të ndërmjetme të aktiviteteve të kryera që lidhin firmën për klientët. Firmat do të fitojë në krijimin tregut të tyre të brendshëm të tillë që transaksionet mund të kryhet në një kosto më të ulët brenda firmes.

tregut dhe kostos së transaksionit. Tregjet e papërsosura janë proces i ndërkombëtarizimit⁵². Arsyeja që ndërmarrjet zgjedhin ndërkombëtarizimin janë çmimet e tregut të produkteve të ndërmjetme. Produktet e ndërmjetme përfshijnë lloje të ndryshme të njohurive dhe ekspertizës, të tilla si patenta, know-how, markën dhe reputacionin. Për shkak të çmimeve të produkteve të ndërmjetme, ndërmarrjet do të përballen me vështirësi⁵³ në vlerësimin e çmimit të produktit të ndërmjetëm gjatë transaksionit të jashtëm.

2.3.2.4 Teoria (OLI) e prodhimit ndërkombëtar dhe evolucioni i saj

Paradigma Eklektike e Dunning (OLI) e prodhimit ndërkombëtar (1976:395-418, 1981) - është një teori përrreth së cilës është zhvilluar kryesisht e gjithë literatura mbi kompanitë shumëkombëshe (MNCs). Paradigma "OLI" ofron një shpjegim të plotë të mënyrave më të mira për të hyrë në tregjet e huaja. Kjo teori konsiderohet si më e përshtatshme për këtë studim, prandaj për evolucionin e saj njihemi në vazhdim.

Paradigma eklektike Dunning e prodhimit ndërkombëtar është integrimi i shumë teorive të ndërkombëtarizimit. Ajo mbulon teorinë e tregtisë ndërkombëtare, pra teoria e zakonshme e faktoreve dhunti të Hecker – Ohlin, (1919, 1933), teorinë e avantazheve monopoliste të Hymers (1960), teorinë e kostos së transaksionit të Coase-së (1937), teorinë e internalizimit të Buckley dhe Casson (1976), dhe idenë e përparësisë së lokacionit të Dunning-ut. Ai jep shpjegime relativisht të plota të motiveve në zgjedhjen e lokacionit të MNE-ve, mënyres së hyrjes në treg dhe preferencat dhe aktivitetet e IHD-ve. Dunning, thekson se prirja e një

⁵²Kur ky proces ndodhë përtej kufijve kombëtare, ndërmarrjet do të bëhen MNEs.

⁵³Këtë e shkakton pasiguria e tregut dhe kosto e lartë e transaksionit.

firme për fillimin e prodhimit të huaj do të varet nga tërheqjet e veçanta të vendeve pritese (avantazhet e pronësisë, vendndodhjes dhe ndërkombëtarizimit) në krahasim me një vend tjetër.

Evolucioni i Paradigmës Eklektike Dunning

Paradigma OLI, është ndër kornizat teorike më me ndikim në hulumtimin e përcaktuesve të IHD-ve, pavarësisht kufizimeve (Cantwell & Narula, 2001)⁵⁴. Korniza OLI, u zgjerua me treguesit institucionalë (Dunning, 2006), të cilët janë bërë përcaktues të fuqishëm në zgjedhjen e variablave. Analiza e të dhënave parësore përmes pyetsorëve e bërë për Kosovë përfshinë tregues institucionalë për t'u analizuar, me qëllim të përmledhjes më të gjerë të përcaktuesve që rekomandon teoria OLI e Dunning-ut (2006). Paradigma eklektike ofron pra një kuadër tërësor për të hulumtuar rëndësinë e faktorëve që ndikuan në zgjerimin e ndërmarrjeve shumëkombëshe. Megjithatë, sugjeron se zbatimi i saj ndodhë në varësi të motivit të investitorit, në varësi të vendit, firmës apo rajonit (Dunning's, 2001:176). Faktorët e lokacionit (L) dhe të internalizimit (I) tregojnë se pse firmat angazhohen jashtë vendit (Dunning's, 1993:145)⁵⁵.

Ndërsa avantazhet e pronësisë (dhënia e licencës dhe shfrytëzimi i avantazheve të zotëruara) zhvillohen më shumë në mungesë të mallrave dhe shërbimeve të ndërmjetme, dëshmi e dështimit të mundshëm të tregut (Tecce, 1986:285-305). Duken se nuk ndikojnë në njëra tjetrën të tri llojet e avantazheve; megjithatë, ekziston bashkëveprim i

⁵⁴Kufizimet i pranojnë edhe Dunning's (2001), i cili në vazhdimësi ka bërë përpjekje për zgjerimin e përcaktuesve të IHD me variabla shtesë.

⁵⁵Duke u bërë konkurente, firmat e huaja ulin koston shtesë që bëjnë me krijimin dhe funksionimin e tyre jashtë vendit Dunning's, (1988:2).

vazhdueshëm në mes tyre. Kjo u dëshmuar se investitorët e huaj interesohen për kosto të punës dhe produktivitet (Bevan dhe Estrin dhe Mayer, 2004:45), cituar nga Beiguang Zhu (2008:12-24).⁵⁶ Megjithatë, origjina e teorisë eklektike nisë nga debati në simpoziumin ndërkombëtar për dhënien e çmimeve Nobel në vitin 1950, kur ai ishte në përfundim të disertacionit të Doktoratës e cila si libër dhe u publikua në vitin 1958 “Dunning 1958”.

Dunning thekson (Dunning, 2000a dhe b) se ai ishte i ndikuar nga Buckley dhe Casson (1976:74), të cilët merreshin me Ndërmarrje Shumëkombëshe (1976). Konceptin e parë të ndërkombëtarizimit Dunning e ka hasur në shkrimet e J.C. McManus (1972) dhe më pas të Nils Lundgreen. Përfundimisht Dunning thekson se dy përparësitë (O) dhe (L), vijnë në shprehje vetëm përmes (I), ndërkombëtarizimit të firmave në vend të huaj (1993, 1995, 1998, 2000). Dunning propozoi në teorinë Eklektike disa nga përfitimet që rrjedhin nëse firmat kanë këto avantazhe:

- ✚ Përparësi të pastra (neto) që kanë disa kompani, si privilegjet e pronësisë (O), apo monopolin që kanë një grup i firmave; firmat e huaja përdorin masat dhe mjetet për të përvetësuar tregje që janë në interesin e tyre; këto masa dhe mjete kanë synim aktivitete me vlerë të shtuar jashtë kufijve kombëtar të tyre.

Dunning theksoi se Teoria Eklektike “OLI”, është teori që më së miri shpjegon faktorët përcaktues të prodhimit ndërkombëtar, por nuk është më e mira në shpjegimin e Ndërmarrjeve Shumëkombëshe. Qartë shpjegon se IHD duhet orientuar nga eksporti, kërkues të burimeve dhe investimeve në industri strategjike. Dunning thekson se teoritë e

⁵⁶ Megjithatë, kohëve të fundit janë përqëndruar në krijimin e aseteve dhe infrastrukture institucionale në vendin pritës, Narula dhe Dunning's, (2000).

tregtisë ndërkombëtare nuk janë në gjendje të shpjegojnë mirë transaksionet ndërkombëtare të mallrave dhe shërbimeve.

Pardigma “OLI” (bazuar në teorinë ekonomike dhe organizative), merret me shpjegimin e variablave të shumta si përcaktues të IHD. John Dunning (2001:1-19), theksoi se kritikën drejtuar teorisë eklektike nuk e bëjnë atë të diskutueshme, p.sh.:

- Teoria e Ciklit jetësor të produktit është pak e rëndësishme kur aplikohet tek investimet burim kërkuese;
- Teoria Oligopoliste e Knickerbocker, (1973) as që mendohet të përdoret në tregje të shumta (vende të shumta) përveç se në një strukturë të veçantë të tregut;
- Shpjegime për IHD ka dhënë edhe teoria normative makroekonomike e Kojima (1982:2,1978:22), por ai arriti të japë shpjegime domethënëse vetëm për investime brenda një industrie;
- Edhe Aliber (1970:286) u mundua të shpjegojë aktivitetin e IHD përmes teorisë së monedhës së fortë, por zgjerimi i shpejtë IHD në vende me monedhë të dobët e vë në dyshim këtë teori.
- Ndërsa teoria e Diversifikimit e Rugman (1980:370), nuk ka mundur të shpjegojë pse investorët e huaj investojnë pa hezitim në sektorë strategjikë (kërkues të aseteve) përkundër jo stabilitetit politik apo lëkundjes së kursit të këmbimit në vendin ku investojnë.

Investimet e Huaja Direkte gjatë aktivitetit të tyre kërkojnë vende që sapo kanë filluar të industrializohen sepse tek ato gjejnë përparësinë e pronësisë dhe të vendndodhjes të cilët në

vendet e tyre nuk i disponojnë. Poashtu, varësisht nga faza e zhvillimit, burimet e saj, politikat e qeverisë, puna intenzive e disponueshme apo sektorët e industrisë si prodhimi, transporti, turizmi, ndërtimi, ato vende bëhen cak i Ndërmarrjeve Shumëkombëshe si përcaktues të teorisë “OLI”. Po ashtu përparësia e vendndodhjes bëhet më e madhe nëse vendi pritës i investimeve krijon një sistem ligjor, infrastrukturë, kulturë biznesi, kapital human dhe politika të orientuara pro investitorëve.

2.3.2.5 Avantazhet e teorisë eklektike Dunning

Paradigma eklektike (bashkim i tri teorive të ndryshme) me një fokus të përbashkët, konkurrencës dhe inovacionit, në vend të marrëveshjeve të fshehta të oligopolit, përparësive të pronësisë si një element konkurrues, në vend të heqjes së konfliktit. Pra kuadri teorik përfshin si kornizë të saj të dy avantazhet makroekonomike, vendndodhjen dhe avantazhet mikroekonomike të pronësisë. Ndryshim tjetër nga Hymer's është se Dunning hulumton koston e transaksionit të Coase-së. Poashtu Dunning⁵⁷ merret edhe me faktorin „kohë”, që ishte injoruar më parë. Dunning zhvilloi një teori eklektike të IHD-ve, e cila quhet OLI paradigmë. OLI i referohet avantazheve si pronësia, vendndodhja dhe ndërkombëtarizimi. Duke operuar në një treg të vendit të huaj ka shumë kosto dhe këto "kosto të të qenit i huaj" që përfshijnë mosnjohjen e kushteve të tregut, kulturës, ligjeve dhe shpenzime të tjera.

Për t'u bërë konkurrent i një firme të huaj duhet të ketë disa avantazhe, $IHD = O + L + I$:

⁵⁷ Dunning kombinon Coase dhe Hymer's, duke theksuar se avantazhet e pronësisë duhet mbrojtur dhe zhvilluar në vend se të shiten apo licencohen siç sugjeronte Hymer's

i) *Përparësitë e pronësisë (Ownership of Specific Advantages- O)*: U jep fuqi firmave të jenë mbi konkurrentët e tjerë p.sh. me teknologji superiore, teknika të menaxhimit, qasje të lehtë në financa, ekonominë e shkallës, etj., janë përparësitë krahasuese, specifike për firmën, që ndërmarrja shumëkombëshe ka ndaj firmave vendase për t'i shërbyer tregjeve të veçanta.

Me qëllim të tejkalimit të avantazhit të “informacionit” që kanë ndërmarrjet vendase, një firmë e huaj mund të shfrytëzojë këto përparësi (Johnson A, 2006) që firmat vendore nuk e kanë. Dunning dhe Lundan (2008:101-102) cekin karakteristikat e pronësisë: Të drejtat pronësore, të pekshme dhe të paprekshme; kapacitetet inovative; grumbullimi i përvojës; qasja e caktuar me inpute të veçanta.

ii) *Përparësitë specifike të vendndodhjes (Location - specific advantages- L)*: janë përparësitë e vendit specifik. Kjo përfshin akses në kosto të ulët të burimeve natyrore, infrastrukturë të përshtatshme, stabilitet politik, stabilitet makroekonomik, etj., janë motivime shtesë për IHD. Këto avantazhe përcaktojnë se sa tërheqës është një vend për prodhim. Dunning dhe Lundan (2008:101-102) theksojnë këto avantazhe: çmimet e inputeve; produktiviteti dhe cilësia; shpenzimet e transportit; infrastruktura; legjislacioni.

iii) *Përparësitë e trupëzimit -Internalisation advantages (I)*

Dunning (1988) ka përmbledhur tre llojet e dështimit të tregut si më poshtë:

- Ato që dalin nga pasiguria e tregjeve të së ardhmes, rreziku dhe pasiguria e kostos së transaksionit, etj;
- Ato që rrjedhin nga paaftësia e firmave për të shfrytëzuar ekonomitë e prodhimit në shkallë të gjerë .
- Ato që ndodhin nga transaksioni i deshtuar i njohurive dhe të shërbimit.

Faktorë që ndikojnë në vendimin firmes për të prodhuar vet të mirat ose shërbimet, apo për t'u mbështetur në një prodhues lokal. Dunning dhe Lundan (2008:101-102), theksojnë përparësitë e ndërkombëtarizimit: kontrolli i tregut; ndërkombëtarizimi i eksternaliteteve; shmangia e pengesave të qeverisë.

2.3.2.6 Infrastruktura institucionale-zgjerimi i kornizes Dunning's

Dëshmitë ekzistuese tregojnë se për efikasitetin pozitiv të IHD në rritjen dhe konkurueshmërinë, kërkohet nga institucionet hartimi, përmirësimi dhe promovimi sistematik i IHD në vendin pritës, sidomos nga Agjensioni për Promovimin e Investimeve, në Kosovë promovimin e investimeve e bën agjensioni qeveritar (APIK).

Ky punim shton stimuj institucionalë në analizen e pyetsorëve në literaturën e investimeve bazuar në paradigmen eklektike Dunning (1988), avantazhet e vendndodhjes, si faktorë të rëndësishëm të gravitetit të investitorëve të huaj, duke analizuar qëndrimet dhe besimin e investitorëve të huaj, masën, në të cilën ata kërkojnë të bëhen ndryshime në faktorë të caktuar që ata i konsiderojnë pengese, ose stimulimi më i madhë në faktorë të caktuar që ata i konsiderojnë tërheqës. Prandaj ne kemi shfrytëzuar një sërë të dhënash dhe qëndrimesh që kryesisht punojnë në promovimin e investimeve bazuar në teorinë Dunning, avantazhet e vendndodhjes.

Faktorët e vendndodhjes Dunning's -infrastruktura institucionale

Avantazhet vendndodhjes janë përcaktues të rëndësishëm që ndikojnë në vendimin e firmave të zgjedhin për të prodhuar në vendin e tyre apo jashtë vendit, Dunning, (1998), Hennart dhe Park, (1994).

Përmes teorisë së IHD të Dunning, shtjellohen edhe qendrimet ndaj IHD, duke integruar me shumë qëndrimet kejnzaniste dhe neoklasike.

Tabela nr.7:*Konfigurimi i tre grupeve të avantazheve, të Dunning's*

Avantazhet specifike të pronësisë	Përparësitë internalizimit (shfrytëzimi ose të shmangia nga dështimi i tregut)	Avantazhet e vendndodhjes
Për të zvogëluar kostot e transaksioni	Kapitali	Stabiliteti politik
Për të shmangur ose shfrytëzuar ndërhyrjen e Qeverisë (Kuota, kontrolli të çmimit, dallime në taksa, etj)	Teknologjia	Politikat Qeveritare
Për të arritur integrimi me ekonomi të perparuara	Menagjimi dhe organizimi	Stimujt nxites dhe dekurajues
Për të kontrolluar furnizimin e inputeve	Marketingu	Infrastruktura
Për të kontrolluar pengesat e tregut	Bashkangjijtja ekonomive të zhvilluara	Kuadri institucional (komercial, ligjor dhe burokratik).
		Punonjës të aftë dhe të lirë
		Madhësia e tregut dhe rritja e tij
		Kushtet makro-ekonomike
		Burimet natyrore

Burimi: Dunning's (1995; 2006). Përmbledhje nga autori.

Faktorët më të rëndësishëm të vendndodhjes konsiderohen: (1) Stabiliteti politik; (2) Politikat qeveritare; (2) Stimujt nxitës dhe destimulues; (4) infrastruktura; (5) kuadri institucional, (6) ligjor dhe burokracia, (7) kosto e punës-punonjës të aftë me paga të ulëta,

(8) madhësia e tregut dhe rritja e tij, (9) kushtet makro-ekonomike dhe (10) burimet natyrore.

Analiza e përgjithshme përmes pyetsorëve të shtrirë në 306 kompani të huaja në Kosovë që masin mjedisin ekonomik dhe institucional në Kosovë, mbështetë qëndrimet kejnziane – në favor të masave fiskale dhe ndërhyrjen e qeverisë për tërheqjen e IHD-ve, dhe neoklasike që preferon tregun e lirë, bazë të mirë ekonomike dhe personel tëkualifikuar. Nga të anketuarit është mjaft interesante sepse qëndrimet e shumica prej tyre mund të klasifikohen si kejnziane kryesisht nga Europa Juglindore (Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi, Rumani dhe Bullgari) ndërsa ka edhe të atillë që janë nga Europa Qendrore (Gjermani, Austri, Zvicër, Holandë, Britani e Madhe, etj.) që janë neoklasikë në qëndrimet e tyre. Duke kërkuar më shumë IHD në Kosovë, është vendimtare të gjejmë shkaktarët e madhësisë së kostos së kompanive të huaja që veprojnë në Kosovë.

Edhe pse Kosova ofron burime të trashëguara natyrore dhe njerëzore, ajo duhet të ofrojë edhe një klimë miqësore të bërit biznes, shërbime shtetërore me çmime konkurruese - norma tatimore të ulëta, subvencione nga qeveria, garantim të investimeve siç e thekson Rojec et al. (2007). Faktorë tërheqës për investitorë konsiderohen edhe infrastruktura më cilësore (transport rrugor, hekurudhor dhe ajror, telekomunikim më cilësor), efikasitet i qeverisë (sundim të mirë të ligjit, luftim i korrupsionit, luftim i pengesave burokratike), ofrimi i një sistemi arsimor cilësor, zyrtare shtetëror profesional.

Duke parë rëndësinë e IHD është bërë përpjekje që përmes 306 pyetsorëve të strukturuar (të plotësuar nga kompani me kapital 100% të huaj), të mund të njihemi me

shumicën e përcaktuesve të IHD të cekur më lartë nga këndvështrimi i investitorëve të huaj që veprojnë në Kosovë.

Infrastruktura institucionale për IHD- Raporti i Investimeve Botërore (1998:4) ka deklaruar se e përbashkët për të gjitha shtetet është: përmirësimi i kornizës rregullatore të IHD-ve, zhvillimi dhe forcimi i politikave dhe stabiliteti makroekonomik, klimë miqësore dhe promovim të investimeve.

Edhe Dunning (1981), Dunning dhe Lundan (2008) theksojnë se cilësia e institucioneve në vendet me importe të larta rritë shpënzimet. Edhe infrastruktura jo e mirë dhe rreziku politik reduktojnë fluksin e IHD Clarke dhe Logan (2008). Investimet po orientohen në vende që kanë një siguri politike, klimë të favorshme investive, siguri ligjore dhe institucionale në vendin pritës sepse këto rrethana krijojnë kushte të favorshme për fitime ekonomike. Schneider & Frey (1985:170) argumentuan se nëse kapitali i huaj mirëpritet duke i siguruar të drejten pronësore dhe lirinë civile, favorizon edhe më shumë tërheqjen e IHD-ve.

Është e dobishme të analizohen edhe faktorët politikë, ekonomikë që mund të tërheqin ose jo IHD në Kosovë:

- Klima politike është pjesërisht e favorshme për IHD nëse shohim legjislacionin për investime, ndërsa i pafavorshëm konsiderohet jo stabiliteti politik, klima e dobët e investimeve, burokracia, niveli i lartë i korrupsionit.

- Klima ekonomike -pjesërisht nuk është e favorshme për të tërhequr IHD kur është fjala për një treg të vogël dhe standard të ulët, bilanc të pagesave negative, ndërsa favorizohet nga kushtet makroekonomike siç janë inflacioni, kursi i këmbimit dhe borxhi i ulët.
- Është mjaft tërheqëse fuqia punëtore e mjaftueshme që e bën të lirë, e kualifikuar, që redukton koston e prodhimit të kompanive të huaja, krijon mundësi afagjatë punësimi.

Diskutimin e çështjeve bazë në nivel qendror për tërheqjen e investitorëve, siç janë vendosja e prioritetëve, formulimi i politikave dhe strategjive, shërbimet që duhet ofruar duhet të jenë të qarta për të gjithë, pa lënë pengesa në veprimin praktik të tyre. Edhe përkundër kontributit të ndërmarrjeve kosovare në punësim dhe zhvillim të vendit, mungesa e kapitalit, vështirësitë e qasjen në financa, infrastrukturë e dobët, politika dhe shërbime institucionale jostimuluese, taksa jo shumë të favorshme në kufi dhe konkurrenca jo reale, ka bërë që produktiviteti i ndërmarrjeve kosovare të jetë i ulët, i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat në rritje të popullatës.

2.4 Diskutime dhe debate empirike - IHD dhe rritja ekonomike

Ky punim analizon efektin e IHD në rritjes ekonomike një ndër temat më të debatuar kohëve të fundit në mbarë botë, prandaj është e rëndësishme që të njohim punën empirike të studimeve të mëprashme. Analiza empirike është e fokusuar në dimensionin makro- dhe

mikro-ekonomik duke nxjerrë në pah mekanizmat e transferimit të teknologjisë drejtëpërdrejt nga kompanitë shumëkombëshe dhe indirektë⁵⁸ nga filialet për firmat lokale.

Kur IHD ndodhë në industrinë e burimeve, investimet e brendshmenë industrisë e lidhura mund të stimulohen. Poashtu kërkojmë çfarë është efekti i IHD-ve në Investime të brendshme, progresi teknologjik dhe së bashku të gjitha në rritjen ekonomike.

Meqenëse studimi ynë është ndikuar nga fusha mikro dhe makro-ekonomik edhe modeli ynë është gjithëpërfshirës.

2.4.1 IHD burim i kapitalit fizik

Ne kemi zhvilluar dy modelet e rritjes egzogjene dhe endogjene, për të ilustruar mekanizmat nëpërmjet të cilëve IHD ndikon në rritje. Fluksi hyrës i kapitalit fizik që vjen nga Investimet e Huaja Direkte konsiderohet faktor i rritjes së aftësisë prodhuese të vendit; megjithatë efektet e tyre janë të vonuara në krahasim me transferin e teknologjisë. Efekti i kthimit të pakësuar të akumulimit të kapitalit (Sollow), nuk mund të sigurojë rritje afatgjatë. Duke marrë strukturën e modelit të rritjes së Sollow (1957) dhe ndarjen e aksioneve të kapitalit në të huaja dhe vendorë nxjerrim konkluzione në lidhje me rolin e IHD -ve në rritjen ekonomike. Nëse shikojmë në drejtim të rrjedhës së kapitalit efekti i tij është i kufizuar në sigurimin e nivelit të qëndrueshëm të të ardhurave në një ekonomi. Themi se IHD ka vendosur një ekuilibër, por nuk ndikon në shkallën e konvergencës drejt

⁵⁸ Transferi indirekt merr formën e përhapjes horizontale të teknologjisë (brenda të njëjtës industri) dhe vertikale (brenda industrisë). Përhapjet horizontale janë ende të diskutuara në literaturë për shkak të rezultateve të perziera. Disa theksojnë efektin pozitiv për firmat lokale, për shkak të lëvizjes së punës dhe kryerjes së shërbimeve të demonstrimit të shakthësive në firmat lokale. Ndërsa të tjerat theksojnë efektin negativ të konkurrencës që ju bëjnë firmave lokale.

këtij ekuilibri. Do të thotë se përtej një niveli të caktuar të akumulimit të kapitalit, kapitali nuk kontribuon për të rritur prodhimin për shkak të pakësimit të ardhurave të tij.⁵⁹

Ne ju kemi përshtatur këtij qëndrimi në studimin tonë kur kemi matur efektin e konvergjencës për vendet europiane dhe kemi gjetur se janë në gjendjen e tyre të ekuilibrit drejt procesit të konvergjencës. Sipas mendimit tonë si grup, vendet e EQ dhe Juglindore kanë hyrë në një proces zhvillimi ku raporti kapital / punë është i lartë dhe siguron një rritje afatgjatë. Megjithatë, vendet si të ndara efekti afatgjatë i IHD në rritje varet nga dinamika dhe gjendja e qëndrueshme e secilit vend (Ballkani Perendimore larg nga konvergjenca)⁶⁰

Në studimin tonë IHD i shohim më komplekse,⁶¹ ndryshe nga modeli engzogjen i rritjes (që shihte IHD vetëm si rrjedhë kapitali), IHD shohim se përmbajnë kapital dhe teknologji, prandaj themi se IHD do të kenë efekte afatgjatë në rritje. Megjithatë kur në studimin tonë e vëmë në korelacion njërin me tjetrin, kontributi i IHD në rritje nëpërmjet akumulimit të kapitalit nuk është i vlefshëm. Në të kundërtën kur flukset e larta të IHD janë të lidhura me përshpejtimin e progresit teknologjik gjejmë se efekti i tyre në rritje është pozitiv. Edhe studime tjera empirike si Marco Neuhaus (2006:24) dhe Brems (1970:320-331), IHD i konsiderojnë si një instrument të rëndësishëm për transferim të kapitalit fizik dhe njohurive nga vendet e zhvilluara në vendet në zhvillim, do të thotë se ato sjellin aftësi financimi, qasje në teknologji, aftësi administruese dhe hyrje në tregjet e eksporteve. Këtë e kanë përforcuar edhe më shumë autorë të tjerë, dhe sidomos Acemoglu D. (2008:861

⁵⁹ Për këtë arsye, nuk ka efekte afatgjatë.

⁶⁰ Këtu është fjala për 7 vende të caktuara brenda grupit të cilat kanë një rritje ekonomike më të lartë ndërsa nuk kanë një dinamikë dhe qëndrueshmëri ekonomike afatgjate.

⁶¹ Jemi përqëndruar në analizën e përhapjes së progresit teknologjik sipas modelit endogjen të rritjes (Romer, 1990, Boreinsztei, 1998), korniza analitike e zhvilluar na lejojnë që progresi teknologjik është funksion i IHD.

Epilogu),⁶² se Investimet në kapitalin fizik dhe njerëzor janë largpamëse dhe varet nga shpërblimet që individët presin nga investimet e tyre.

Edhe Johnson (2005:8), Easterly dhe Levine (2001) arrijnë të vërtetojnë se investimi në kapitalin fizik është relativisht i parëndësishëm në shpjegimin e rritjes ekonomike drejtuar në afat të gjatë, është progresit teknologjik për shumicën e vendeve që sjellë rritjen. Ndërsa, Bond, et al (2004), këto vlersime i konsideron të shpejtuara duke theksuar se investimet në Brownfield (Bashkime dhe blerje) mund të mos nxisin për një kohë rritjen për faktin se me privatizim mund të reduktojnë numrin e të punësuarve dhe menaxhimin por pas një kohe krijon punësim dhe produktivitet të lartë. Këtë nuk mund ta themi kur është fjala për investime Greenfield,⁶³ sepse ato veq kanë krijuar kapitalin fizik, punësim dhe rritje të produktiviteti, megjithatë mbizotëron mendimi se rritja ekonomike duhet të ndodhë përmes transferit të teknologjisë, se nëpërmjet rritjes së aksioneve të kapitalit dhe punës. Investimi Greenfield rritë stokun e kapitalit fizik në vendin pritës, i cili mund të jetë i konsiderueshëm (ndërtimi i fabrikave dhe i stabilimenteve të reja të prodhimit, etj.) dhe shumë i rëndësishëm sidomos për ekonominë në zhvillim.

Stokun e kapitalit fizik në vendin pritës Johnson (2005:8) e paraqet në këtë mënyrë:

$$K_{HC} = K_{DOM} + K_{MNE} \dots \dots \dots eq.(1)$$

Ku, K_{DOM} , është kapitali fizik në vendin pritës, K_{MNE} , është kapitali fizik i kompanive të huaja dhe K_{HC} , është totali i kapitalit në vendin pritës pas hyrjes së kompanive të huaja.

⁶²Një pjesë e madhe e librit “Introduction to Modern Economic Growth” prej 1008 faqe, përveç tjerash është fokusuar në të kuptuarit fizik dhe njerëzor akumulimin e kapitalit (Kapitujt 8-11).

⁶³ Investimi Greenfield nënkupton që MNE ndërton stabilimente të reja të prodhimit, shpërndarjes ose kërkime në vend pritës.

2.4.2 IHD kanal i përhapjes së teknologjisë

Vendet në procesin e tranzicionit janë të interesuara për teknologji të huaj dhe vazhdimisht janë të shqetësuara të kenë qasje sa më parë në to. Në mungesë të financave, i shohin si një mundësi IHD. Statistikat tregojnë se importet e teknologjisë janë të ulëta në raport me sjelljen e teknologjisë nga IHD. Shihet se IHD konsiderohen zgjidhje për problemet e tranzicionit. Kjo na bën të mendojmëse kanali kryesor për transfer të teknologjisë vërtet janë IHD. Nëse theksojmë vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (si pjesë e mostrës sonë) shihet se kanë krijuar masa të shumta për të tërhequr investitorë të huaj.

Për të ndodhur transferi i teknologjisë: së pari duhet që firmat e huaja të disponojnë teknologji superiore, dhe së dyti intensiteti i lidhjeve tregtare në mes firmave të huaja dhe atyre të brendshme të jetë i zhvilluar dhe së treti filialat e huaja ofrojnë paga më të larta dhe pritet lëvizje e punëtorëve në mes dy grupeve të firmave. Pra duhet të ekzistojë së paku një minimum i përfshirjes së firmave lokale në transaksione me firmat e huaja.

Autorët si Lipsey, (2004); deMello, (1997), Borenztein et al., (1998), Campos dhe Kinoshita, (2002), Blonigen dhe Wang, (2004), i konsiderojnë IHD si kanale kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike njëkohësisht.

Hulumtimi i mekanizmave të transferit teknologjik në nivel mikro është rritur, Javorcik dhe Spatareanu (2008); Nicolini dhe Resmini, (2010), etj., ndërsa në nivel makro, Balasubramanyan et al. (1996), Borenztein et al., (1998), Alfaro et al., (2004), Rodriguez – Clare (2004), Li dhe Liu, (2005); Adams (2009), përgjithësisht ata gjetën praninë e faktorëve kushtëzues në vendin pritës për të përfituar nga IHD.

Johnson (2005:10), ka numëruar disa nga këto kanale të cilat domosdoshmërisht disa prej tyre vetëvetiu ndodhin:

- Përhapja mund të ndodhë kur inxhinierët e MNE-së japin informacion në lidhje me teknologjinë e përdorur tëprodhimit;
- Përhapja mund të ndodhë kur një firmë punëson punonjës që kanë punuar më parë në ndonjë firmë komkurente dhe ka njohuri se si përdoret teknologjia;
- Nga punësimi i stafit të ri me njohuri të larta për teknologjinë, edhe pse asnjëherë nuk ka punuar në ndonjë firmë vendore;

Johnson (2005:8-12), procesin e përhapjes së teknologjisë në nivel mikro kur e përshkroi u nis nga Javorcik (2004:1-27). Nëse përhapja nuk ka ndodhur përmes kanaleve të mësipërme, atëherë ajo ndodh kur MNE bënë marrëveshje me firmat vendore për blerjen e mallrave të ndërmjetme.

Lidhje tjetër në mes MNE-së dhe firmave vendore mund të bëhet kur MNE shesin direkt produktet e tyre firmave vendore, ndërsa firmat vendore përfitojnë nga kjo dhe përmirësojnë mallrat e tyre (Javorcik, 2004). Firmat e huaja këtë nuk do ta bënin me dëshirë, prandaj shpesh ata zgjedhin që mallrat e tyre t'i prodhojnë në një vend pritës dhe i shesin në një vend krejt tjetër pritës.

Nëse nisemi nga ky këndvështrim, MNE mundohen të shmangin përhapjen e teknologjisë në firmat e brendshme. Megjithatë kjo ka ndodhur nëse firmat vendore kanë përmirësuar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve dhe si rezultat i kësaj është rritur produktiviteti total i faktorëve, janë bërë konkurrentë me firma të jashtme dhe në një afat më të gjatë është rritur edhe rritja ekonomike. Prandaj janë të nevojshme dhe duhet mirëpritur Kompanitë e huaja dhe teknologjia që sjellin ato.

Johnson (2005: 9), së pari modeloj avantazhin e teknologjisë së firmave të huaja në krahasim me firmat e vendit pritës.

$$A_{MNE} > A_{DOM} \text{eku} \dots \text{eq.}(2)$$

Ku, A_{MNE} përfaqëson nivelin e teknologjisë që posedojnë ndërmarrjet shumëkombëshe (MNE), dhe A_{DOM} përfaqëson nivelin e teknologjisë që posedon një firmë e brendshme.

Në kohën t , rrjedha e investimit të MNE ka një avantazh më të madhë të teknologjisë superiore në krahasim me firmat e vendit:

$$A_{MNE,t} - A_{DOM,t} > 0 \dots \text{eq.}(3)$$

Përhapja e teknologjisë nga firmat e huaja do të dëmtojë avantazhet e firmave konkurruese, ndërsa do të bëjë që të jenë konkurrenca firma të reja që deri atëherë nuk ishin.

Dallimi midis rrjedhës së teknologjisë dhe përhapjes së teknologjisë (eksternaliteteve të teknologjisë) është se rrjedha e teknologjisë nuk i jep menjëherë efektet pozitive.

Për shembull, përdorim $0 \leq \beta \leq 1$ për të përshkruar rrjedhën e teknologjisë në firmat vendore të cilat i përdorin në prodhim si një avantazh i firmave të huaja.

Kur ndërmarrjet shumëkombëshe janë të suksesshme ato parandalojnë rrjedhën e teknologjisë në firmat vendore dhe, β është afër zeros. Nëse ndodh që rrjedha e teknologjisë në kompanitë vendore të jetë e madhe, atëherë, β është afër 1.

Në këtë rast kemi vetëm rrjedhë të teknologjisë, jo përhapje të saj.

Por si mund të ndodhë përhapja e teknologjisë ?

Johnson (2005:10) thekson se “*miratimi i suksesshëm i teknologjisë së firmave të huaja nga një firmë e vendit pritësnënkupton se një përhapje e teknologjisë ka ndodhur*”

Prandaj në vazhdim duke i inkorporuar aftësitë dhe njohuritë e vendit pritës vërtetojnë se është bërë përhapja e teknologjisë së huaj në vendin pritës.

Dhe së fundi theksojmë autorë që kanë hulumtuar se transferi i teknologjisë në vendin pritës ka ndodhur me ose pa dëshirë të firmave të huaja, Findlay, (1978); Romer, (1993); Markusen dhe Venables (1999); Veugelers dhe Cassiman (2004) dhe kohëve të fundit Tang et al . (2008); Thangavelu, et al (2009) dhe Waldkirch, (2010), Cristina JUDE (2012:8), prandaj sugjerojnë qeveritë e vendeve pritëse se duhet të krijojnë rregulla që ato të sjellin teknologji të pastra.

Megjithatë *“është e vështirë për të dalluar kanale të veçanta për transferimin e teknologjisë, sepse mekanizmate përhapjes së IHD-ve janë komplekse dhe shpesh të ndërvarura”*, Kinoshita (2002, f.5).

2.4.3 Kapaciteti absorbues (niveli i pragut) dhe IHD në vendin pritës

Ne testojmë hipotezën nëse transferimi i teknologjisë është i kushtëzuar nga kapacitetet absorbuese të firmave pritëse. Kemi gjetur se firmat në vendet pritëse përfitojnë nga përhapja pozitive horizontale nëse niveli mesatar i shkollimit është i mjaftueshëm për të absorbuar teknologjinë e huaj. Kompanitë vendore kanë punonjës të kualifikuar që do të konkurrojnë me firmat e huaja; megjithatë pagat e larta në kompani të huaja tërheqin punëtorët e kualifikuar vendorë.

Ekziston një komplementaritet në mes variablave endogjene, kapitalit njerëzor dhe arsimit. Ndërsa, dëshirojnë të përdorin teknologjinë e huaj, qasja në të kërkon shpenzime shtesë të transferimit apo adaptimit, prandaj Johnson (2005), supozon si shumë studiues tjerë se rrjedha e teknologjisë nuk përhapet automatikisht. Duhet të jetë aftësia e firmës së vendit pritës që të mund të absorbojë rrjedhën e teknologjisë dhe kjo kërkon edhe kosto shtesë për adoptim.

Tece (1997:528) tregoi se kostoja e transferimit të teknologjisë në vendin pritës është e konsiderueshme në çfarëdo forme që të bëhet (me dëshirë apo jo).Për t'u njohur me rrjedhën e teknologjisë, Johnson (2005)⁶⁴ përdorë:

$$0 \leq \gamma \leq 1, \dots\dots\dots \text{eq.(4)}$$

Paraqetsasinë e rrjedhës së teknologjisë që mund ta absorbojnë firmat në një vend pritës. Ndërsa variabla, (γ), është përcaktuar si “*kapaciteti absorbues i firmës në vendin pritës*” Ata e përshkruajnë kapacitetin absorbues (aftësia thithëse) të lartë kur (γ) është afër 1, Ndërsa kur kapaciti absorbues ifirmësështë i ulët,(γ) është i afërt me 0.

Johnson (2005:11), paraqet efektin spillovers (rrjedhje) të firmave të huaja që veprojnë në vendin pritës dhe poashtu kapacitetin absorbues të vendit pritës, përmes pragut të aftësive thithëse të vendit pritës.

Prandaj termi, “pragu⁶⁵” (THRESHOLD) i kapaciteteve absorbues në vendin pritës diskutohet aq shumë, dhe mungesa e plotësimit të tij nuk sjell përfitimet nga eksternalitetet pozitive të IHD-ve. Kushti “prag”do të thotë se nuk ndodh përhapja e teknologjisë në vendin pritës nëse nuk kalohet ky prag, pra nën këtë prag aftësia absorbuese e firmave vendore është më e ulët se sa nevojitet. Ky term është aplikuar kohë më parë në studime empirike Boreinsztein et al (1995; 1998) dhe është bërë mjaft i përhapur (analizat empirike për IHD pothuajse të gjitha e aplikojnë).

⁶⁴Të njëjtën rrugë të arsyetimit, për shembull e ndjekin edhe në Glass dhe Saggi (1998).

⁶⁵Ideja e një niveli te pragut të kapaciteteve absorbuese është përdorur më parë në studimet empirike të tilla si Borensztein et al (1998).

Ekuacioni në vijim përshkruan se si një firmë vendore është prekur nga rrjedha e teknologjisë së huaj.

$$ADOM_{t+1} = \beta \gamma DOM_t (AMNE_{ti} - ADOM_{ti}) \dots\dots\dots eq. (5)$$

Meqenëse variablat e ekuacionit janë përshkruar më lart, atëherë β është madhësia e rrjedhës së teknologjisë, ndërsa γ përfaqëson kapacitetin absorbues të firmës vendore. Nga kjo shihet se të dy variablat janë të lidhura pozitivisht me njëra tjetrën, pra, kapaciteti absorbues në vendin pritës ka qenë i mjaftueshëm për të tërhequr rrjedhën e teknologjisë së firmave të huaja.

Pra, kushti “Pragu” (Threshold): $\gamma \geq \gamma_c$, aq i kërkuar nga firmat e huaja në këtë rast është plotësuar, është më i madh ose i barabartë me pragun e kërkuar, nga plotësimi i tij rrjedhin edhe përfitimet e vendit pritës.

Shembujt e kapitalit njerëzor mund të përfshijnë kapacitetin e inovacionit, kreativitetin, know-how dhe përvojën e mëparshme, kapacitetin e të mësuarit dhe arsimimin. Prandaj nevojitet orientimi i politikave arsimore në vendet në zhvillim të drejtohen nga rritja e shpenzimeve për një shkollim më cilësor në të gjitha nivelet.

Alfaro (2003), analizoi efektin e IHD në ndërveprim me kapitalin human dhe konstatimi më i rëndësishëm i këtij punimi është se efekti i IHD-ve në rritjen ekonomike është e varur nga niveli i kapitalit njerëzor në dispozicion në ekonomin pritëse. Ka një ndërveprim të fortë pozitiv midis IHD dhe nivelit të arritjeve arsimore (masë për kapitalin njerëzor). Veçanërisht, i njëjti ndërveprim nuk është i rëndësishëm në rastin e investimeve të brendshme, dhe ndodhë kjo kur natyra e teknologjisë dallon nga ajo e IHD.

Ngjashëm me Alfaron janë rezultatet e studimit tonë, është gjetur një ndërveprim i fortë në mes IHD dhe kapitalit human në rritjen ekonomike, prandaj IHD janë të kushtëzuara nga kapitali human në 24 vende europiane për vitet 2004-2014.

Ndërsa Celeste Amorim et al. (2011) në rezultatet e tyre tregojnë nevojën e një pragu minimal të kapitalit njerëzor dhe në R & D në biznes, në mënyrë që të rritet ndikimi pozitiv i IHD-ve në rritjen ekonomike. Pragjet e vlerësuara nga këta autorë tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e vendeve të OECD është ende nën nivelin minimal të kapaciteteve absorbuese të nevojshme për të fituar me praninë e IHD.

Literatura empirike thekson se me përjashtim të Olofsdotter (1998) dhe Carkovic dhe Levine (2002), pjesa më e madhe e studimeve kanë gjetur si të rëndësishëm nivelin e pragut (kapacitetin absorbues), në matjen e kapitalit human dhe në bashkëveprim me variabla tjera (si më e zakonshme konsiderohet variabla $IHD*HC$ dhe $INV *HC$).

Autorët vlerësuar një gamë të gjerë të pragjeve minimale të arsimit (12% -16% e popullsisë me të paktën një diplomë kolegji). Ndërsa në studimin tonë gjejmë një mesatare të përgjithshme prej 14.3 %, por e pamjaftueshme për të dhënë një efekt pozitiv në rritje (shkaku se 17 vende në mostër kishin mestaren e tyre më të ulët se 14.3 %, ndërsa vetëm 7 vende mbi 14.3 %)

Është studimi i Borensztein et al. (1998) që bëri në një kampion prej 69 vendeve në zhvillim për periudhën 1970-1989 dhe si masë të kapitalit njerëzor përdori nivelin fillor dhe të mesëm të viteve të shkollimit të meshkujve [tëndërtuar nga Barro dhe Lee (1993)] . Rezultatet e tyre tregojnë se vetëm vendet me një mesatare prej 0.52 viteve të shkollimit të

mesëm mashkullor do të përfitojnë pozitivisht nga investimet e huaja direkte, prej 69 vendeve vetëm 46 vende kanë qenë më lart se niveli i vitit 1980.

Në studimin tonë arritëm të gjenim një prag shkollimi në mesatare mbi 14.3 % si masë e kapitalit njerëzor. Kjo masë e përgjithshme kapitali human nuk konsiderohet e mjaftueshme për të kontribuon në rritjen ekonomike ndërsa HC konsiderohet tërheqese për IHD kur u perdorë termi ndërveprim në mes tyre.

2.4.4 Roli i IHD në rritjen ekonomike (diskutime dhe debate empirike)

Duke parë se në mbarë botën qeveritë punojnë në drejtim të krijimit të klimës miqësore për IHD, meqenëse IHD kontribuojnë direkt në formimin e kapitalit në vend përmes ndërtimit të fabrikave, sjelljes së makinerive, përmirësimit të transportit dhe në mënyrë indirekte përmes krijimit të punësimit, eksportit, konsumit dhe kursimeve edhe vemendja është përqëndruar tek ato.

Analiza e marrëdhënieve në mes IHD dhe rritjes ekonomike në studimi tonë dha rezultate të njëanshme (rritja ekonomike ka efekte pozitive në IHD ndërsa IHD nuk ka efekt në rritje) shërben për të debatuar për këtë çështje, duke bërë një vështrim studimeve tjera, për të arritur në një përfundim se IHD dhe rritja ekonomike përcjellin njëra tjetrën, por jo gjithmonë dhe në të gjitha rastet.

Megjithatë, për një marrëdhënia pozitive në mes IHD dhe rritjes është e varur nga kushtet e vendit pritës, disa prej të cilave janë: niveli i kapitalit njerëzor, politikat e qeverisë, infrastruktura, lokacioni, efikasiteti i institucioneve, Balasubramanyam, et al. (1996).

Edhe në studime tjera gjejnë argumente se nivele të larta të IHD janë të lidhura me norma të larta të rritjes ekonomike De Mello (1997), Boreinsztein (1998), Chong. et al.(2010a).

Studimi i bërë nga JUDE C. (2012:chap.6), shihet në radhën e studimeve që gjejnë efektin pozitiv të IHD në rritje. Në rezultatet e saj, konfirmon se duke kombinuar efektin negativ në akumulimin e kapitalit me përhapje pozitive, ka konfirmuar një ndikim të përgjithshëm pozitiv të IHD në rritjen ekonomike në CEEC. Kjo tregon se marrëdhënia IHD-rritja është e dominuar nga komponenti përhapje. Ndryshe nga studimi ynë që zbulojmë prapë e kapacitetit absorbues të ekonomive pritëse (pra rritja ekonomike varet nga ndërveprimi i variablave IHD *HC), ajo gjenë se efektet e IHD në CEEC nuk janë të varura nga ky prag. Duke përdorur një ekuacion të njëkohshëm autorja në fjalë ka gjetur se IHD shkakton rritjen dhe rritja nga ana tjetër tërheq IHD. Pra lidhja është pozitive në dy drejtimet, gjë që shpesh nuk ndodh.

Megjithatë ka edhe studime që identifikuan një korrelacion negativ në mes IHD dhe rritjes ekonomike dhe disa më të rëndësishmet janë: Durham (2004), Lyroudi (2004), Carkovic Levine (2005) dhe Lipsey (2006). Lidhja negative është raportuar edhe nga Lyroudi dhe Papanastasiou (2004:98) nëpërmjet analizës Bayesian dhe Carkovic dhe Levine (2005:197) i cili mori rezultate negative në nivelin e arsimimit, zhvillimit ekonomik dhe tregtisë.

Se cilat janë rrethanat që mbështesin përhapjen pozitive të IHD, këtë më së miri e argumentojnë Borensztein, et al., (1998), Xu, (2000) dhe Alfaro, (2003),⁶⁶ të cilët sugjerojnë se niveli arsimor, tregjet e zhvilluara financiare dhe kushtet tjera në ekonominë pritëse luajnë një rol të rëndësishëm që efektet pozitive të IHD të materializohen. Efekti i përhapjes shpesh është matur edhe në mënyrë indirekte përmes fuqisë së bashkëveprimit të IHD-ve me kapital njerëzor; kjo ka treguar të ketë një efekt të rëndësishëm pozitiv në rritjen ekonomike siç sugjerohet në Borensztein et al. (1998) dhe Xu (2000)⁶⁷.

Mecinger (2003) analizoj marrëdhënien në mes IHD dhe rritjes ekonomike në vende në tranzicion në periudhën kohore 1994-2001 dhe raportoi se kishin një lidhje negative. Vendet në tranzicion ishin në periudhën e transformimit të tyre ekonomik dhe politik; investimet kishin hyrë me privatizim, që do të thotë se investimet greenfield ishin të pakta. Ndërsa vendet ishin në tranzicion, mjetet nga privatizimi i përdorën më shumë për importe dhe konsum, jo në shtimin e prodhimtarisë. Një praktikë e tillë është gati e njëjtë në shumicën e vendeve në tranzicionin fillestar, prandaj edhe efektet e IHD në rritje janë fare të vogla ose negative.

Ka studime të cilat kanë gjetur një efekt të përzier të IHD në rritje (Alfaro., 2003:1-31). Një analizë empirike që ajo bëri duke përdorur të dhëna ndër-vende për periudhën 1981-1999, raporton se IHD ushtron një efekt të përzier mbi rritjen, varësisht se cilin sektorë analizon. Rritja në sektorin primar ka një efekt të rëndësishëm negativ në rritje, në

⁶⁶Hirschman (1958: 109) theksoi se jo të gjithë sektorët kanë të njëjtin potencial për të absorbuar teknologji të huaj ose për të krijuar lidhjet me pjesën tjetër të ekonomisë. Ai vuri në dukje, për shembull, “lidhjet janë të dobëta në bujqësi dhe në miniera.”

⁶⁷Rasti i studimit tonë, raportuam rezultate pozitive të IHD *HC në rritjen ekonomike në vendet (QE, EJA).

sektorin e prodhimit një efekt pozitiv dhe i rëndësishëm dhe në sektorin e shërbimeve një efektë të paqartë.

Qëndrimi i përbashkët është se rezultatet ishin relative për efektin e IHD në rritje.

Disa nga shpjegimet, vlerësimet, kritikrat, diskutimet, rishikimet, theksimet, qëndrimet dhe provat e autorëve dhe institucioneve relevante për IHD dhe rritje ekonomike janë paraqitur në tabelën në fund të punimit (tabelat 8, IHD dhe rritja ekonomike efektet pozitive dhe tabela 9, efektet negative dhe të dobëta në mes të IHD-ve dhe rritjes ekonomike, *faqja e shënimeve*).

2.4.4.1 Marrëdhëniet mes rritjes ekonomike, IHD dhe investimeve të brendshme

Kjo pjesë përmban analizë empirike të efekteve të IHD në dinamikën e investimeve të brendshme në Evropën Qendrore dhe Juglindore dhe studime tjera empirike nga autorë të ndryshëm. Nisemi nga studimi ynë për të matur shkallen në të cilën flukset e IHD-ve janë shndërruar në investime produktive.⁶⁸

Megjithatë nisemi nga këndvëshrimi pozitiv se IHD nuk janë vetëm një shtesë në kapitalin ekzistues, por ato mund edhe ta ndryshojnë strukturën ekzistuese të aksioneve të kapitalit. Prandaj ne kemi parashruar pyetjen se si reagojnë investitorët lokalë kur hyjnë IHD, pra a janë zëvendësuese apo plotësuese⁶⁹ të investimeve të brendshme.

⁶⁸ IHD në fakt është një rrjedhë financiare e cila në fakt nuk garanton transformimin e saj në kapitalin fiks.

⁶⁹ Cristina JUDE (2012:chap.5), IHD mund të jenë plotësuese të investimeve të brendshme, kur kërkesa për mallrat e ndërmjetme stimulon prodhimin e furnizuesve lokalë dhe inkurajon ata për të bërë investime të reja.

Në studimin tonë rezultatet janë në përputhje me disa studime tjera,⁷⁰ IHD kanë ndjekur strukturën ekzistuese të ekonomisë duke shkuar në industri ku tashmë ishin shumë firma lokale dhe rritja e konkurrencës ka çuar në një efekt grumbullimi jashtë (crowding-out). Kjo analizë është bërë përmes katrorëve të vegjël të përgjithësuar duke përdorur modelin e Efekteve Fikse (FE).

Analiza jonë për vendet e Europës Qendrore dhe Juglindore sugjeron se ekziston një zëvendësim në mes IHDve dhe investimeve lokale (është karakteristike se shumica e vendeve në mostër në periudhën e matjes kanë kaluar nëpër fazën më tërëndësishme të privatizimit, një arsye më e fortë që e kemi një rezultat të tillë).

Kundërshtarët e IHD argumentojnë se nga grumbullimi i investimeve të brendshme krijohet efekti negativ në rritje ekonomike (Braunstein dhe Epstein., 2002:23); Huang Y, (1998, 2003:3). Është e ditur se IHD kontribuojnë direkt përmes fluksit të kapitalit (ndërtimit të fabrikave të reja) dhe sjelljen e paisjeve të reja (transferi teknologjik).

Megjithatë, efekti i tyre në ekonominë pritëse është edhe më i madhë në formë të përhapjes së investimeve nëpërmjet efekteve indirekte (krijimit të lidhjeve me firmat vendore) megjithatë shpesh ndodh që inputet e tyre i marrin nga importi dhe nuk kanë nevojë për lidhje të tilla.

Kjo ndodh më shumë në vendet në tranzicion kur IHD vijnë në formë të blerjeve dhe bashkimit (përmes privatizimit) dhe shpesh zënë vendin e firmave vendore përmes konkurrencës duke mos kontribuar në rritjen ekonomike në vend.

⁷⁰ Ndërsa rezultate të ngashme për shembull ka gjetur në studimin e saj, JUDE C. (2012:chap.5) të cilin e ka bërë në vend të CCECs.

Mileva, (2008:13-19), përdor panelin dinamik dhe teknikën fikse për të vlerësuar efektin e IHD-ve, kredive dhe portofolit të huaj në rrjedhën e investimeve të brendshme. Përfshin 22 vende, prej të cilave 11 shtete të reja anëtare të BE-së, vendet candidate që nga viti 2005 (Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Maqedonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia) duke gjetur se IHD kanë kontribuar pak në investimet e brendshme.

Në anën tjetër përfshin edhe 11 ekonomitë tjera në tranzicion (Shqipëria, Armenia, Bjellorusia, Gjeorgjia, Kazakistani, Kirgistani, Moldavia, Rusia, Taxhikistani, Ukraina dhe Uzbekistani) dhe gjen se këto vende mbi 54 % të kapitalit të huaj e marrin në formë kredie nga sektori i shërbimeve bankare i huaj të cilin e financon kompania “mëmë” duke u vërtetuar se ka kontribuar në formimin e kapitalit fiks në vend.

Ndërsa vendet në BE, kanë shfrytëzuar më shumë investimet e portofolit që lidhet me tregun e tyre më të zhvilluar. Pra në vendet në tranzicion treguesit më të fortë që rrisin investimet në afat të gjatë janë, kreditë, ndërsa investimet e huaja portofoli kanë efekt të kufizuar në rritjen e investimeve të brendshme.

Borensztein et al. (1998) ka testuar efektin e IHD-ve në rritjen ekonomike duke shfrytëzuar të dhënat mbi rrjedhën e Investimeve të Huaja Direkte në 69 vendet në zhvillim për periudhën 1970-1990 dhe ka gjetur se IHD-të “grumbullojnë” investimet e brendshme.

Ngjashëm me Borensztein janë edhe rezultatet e studimit tonë në 24 vende europiane kemi një koeficient negativ dhe të rëndësishëm kur bashkëveprojnë IHD me INV të brendshme.

Alfaro në punimin e saj (Alfaro, 2003:3) citon “*në sektorin primar, hapësira për lidhjet në mes të filialeve të huaja dhe furnizuesit lokal është shpesh e kufizuar Sektori i prodhimit ka një variacion të gjerë të aktiviteteve të lidhjes intensive. [Në] sektorin terciar qëllimin për ndarjen e prodhimit në faza diskrete dhe nënkontraktimin nga pjesë të mëdha të firmave të pavarura të vendit është gjithashtu e kufizuar.*”Raportit Botëror të Investimeve (2001: 138).

Autorët theksojnë si rezultat i “të mësuarit, demonstrimit, krijimit të efekteve, lidhjes ndërmjet firmave të huaja dhe vendase”, efekti i grumbullimi jashtë dobësohet apo edhe anulohet në afat të gjatë, IHD do të ketë efekte pozitive në sipërmarrjen e brendshme.

Në të gjitha studimet në vendet në zhvillim dhe tranzicion kishin fluks hyrës të ulët në vitet e para të hyrjeve të tyre, ndërsa ato rriteshin në një afat më të gjatë. Edhe efektet spillovers në këto vende ishin të parëndësishme sepse mungonte lidhja me firmat lokale dhe firmat e huaja grumbulloheshin në një teren të caktuar pa u integruar me tregun e brendshëm.

Krijimi i konkurrencës së firmave të huaja dhe mospërhapja e njohurive në firmat vendore bën që të largohen vetë nga tregu firmat vendore.

Kjo tregon se sa i rëndësishëm është krijimi i marrëdhënjëve të përbashkëta në mes firmave të huaja dhe atyre vendore.

KAPITULLI III: Stabiliteti Makroekonomik dhe Institucional përcaktues i IHD dhe rritjes ekonomike në Kosovë

3.1 Vështrim i përgjithshëm imazhit të Kosovës

Kosova, një vend në qendër të Ballkanit në kuadër të Europës Juglindore, që nga viti 1999 ka kaluar nëpër një proces të konsolidimit të shtetësisë dhe krijimit të funksioneve në nivel qendror dhe lokal. Që prej rënies së regjimit të sundimit serb, i cili u bë përmes luftës shkatërruese, qeveria e re ka miratuar legjislacionin e ri ngjashëm me BE për të bërë ndryshime. Duke kaluar nëpër një fazë tranzicioni, ekonomia e Kosovës është duke përjetuar një situatë të rritjes ekonomike të positive por e pamjaftueshme, varfërisë së theksuar, një platformë e dobët politike dhe ekonomike pa një zbatim praktik të një strategjie kombëtare industriale për 16 vite.

Zhvillimi i Kosoves është largë vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore e ndeshur nga shumë sfida ekonomike, politike dhe të sigurisë. Meqenëse Kosova është qeverisur deri në vitin 2008 nga një protektorat ndërkombëtarë atëherë edhe reformat makro-ekonomike, demokratizimi dhe siguria ndahen në faza. Faza e parë 1989-2008 karakterizohet nga sfidat emergjente të mbijetesës pas luftës deri në formimin e shtetësisë e karakterizuar si periudhë e mundimshme në plotësimin e standardeve të BE, problemeve kufitare dhe njohjes së pavarësisë së vendit. Ndërsa si zhvillime pozitive janë liberalizimi i tregtisë, reformat e këmbimit valutore, privatizimi në shkallë të gjërë. Ndërsa periudha pas 17 shkurt 2008, karakterizohet si fazë e cila synim ka integrimin në BE, megjithatë në agjendë ishin zhgjedhjet elektorale, pengesat doganore dhe dialogu me Serbin. Ka përparim në drejtim të

organizimit të ndërmarrësis me prioritet NMV, reforma bankare, reforma në infrastrukturë dhe arsim (logjistikë dhe trajnim të mësimdhënësve për ngritje të cilësis). Mjaftë pak është bërë në drejtim të reformave makroekonomike dhe strukturore, heqjes së pengesave doganore, konsolidimit të reformave makro-ekonomike, shtrirjes së gjërë të taksave (evazion i lartë fiskal sidomos në veri të Kosovës), paqëndrueshmërisë politike dhe sociale.

Me problematike konsiderohen dimenzioni i tregut të punës dhe eksportit por nuk është më mirë dukuria e korrupsionit, energjitika dhe krimi i organizuar (transparency International dhe freedom House 2014). Vlenë të theksohen përparimet që janë bërë në fushen e legjislacionit, rregulloreve të punës, licencimit dhe lejeve të biznesit dhe sidomos efikasiteti i Administratës Tatimore. Ndërsa varfëria e theksuar, papunësia e lartë sidomos tek të rinjtë dhe një sistem arsimor i dobët (USAID 2014), paraqet një dështim në qeverisjen e autoriteteve qeveritare në vend. Sipas Freedom House reformat demokratike në Kosovë janë përmirësuar por janë largë standardeve të Evropës. Si vend në tranzicion Kosova ka ngecur në pavarësinë mediave, procesit zgjedhor, qeverisjes demokratike, zbatimin e dobët të ligjit, luftimit të korrupsionit në institucione publike. Ndërsa qëndron më mirë në reformat gjyqësore, shoqëri civile, luftimi i korrupsionit në gjyqësor, dhe liria e lëvizjes së pakicave.

Analiza makroekonomike zbulon foton e vërtetë të ekonomisë së saj e cila tregon se GDP-në për frymë 2.935 euro në 2013, varfëria e përgjithshme 29.7% , mbi 10.2% të kosovarëve jetojnë nën kufirin e varfërisë (ASK. 2013). Duke llogaritur rritjen reale të BPV prej 3.0 përqind për vitin 2015, e pamjaftueshme për zbutjen e varfërisë dhe papunësisë (35%, 2014). GDP është i përbërë nga këto komponente kryesore: Konsumi

Final i Ekonomive Shtëpiake (KFESH) prej 87.3 përqind, Konsumi Final i Qeverisë (KFQ) në 16.2 përqind, Formimi Bruto i Kapitalit (FBK) në 27.6 përqind, Eksporti Neto në 31.6 përqind. Remitancat 620.83 milionë Euro (ASK, 2013), kontribuojnë në rritjen ekonomike, megjithatë nuk janë burim i qëndrueshëm i të ardhurave (ASK, 2014).




Figura 1: Statistika e treguesve vitalë të ekonomisë së Kosovës në 2013 (nga autori).

Rritja ekonomike shihet se është e përcaktuar nga ecuria pozitive e konsumit, ndërsa investimet dhe neto eksportet vlersohen se kanë ndikuar negativisht në normën reale të rritjes ekonomike. Rritja e konsumit gjatë vitit 2014 është si rrjedhojë e rritjes së remitancave, kredive konsumuese dhe shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë (BQK, 2015). Ndërsa investimet e përgjithshme në vitin 2014 u karakterizuan me rënje të konsiderueshme, si rezultat i rënjes së investimeve publike

Edhe neto eksportet kanë kontribuar negativisht në rritjen e GDP-së gjatë vitit 2014 edhe pse ka pasë rritje të eksporteve, megjithatë importet e larta e humbin rendësinë

eksporteve edhe ashtu të ulta. Me stabilitetin institucional dhe bilancin tregtare, Kosova nuk qëndron mirë edhe pse statistikat vitale të ekonomisë inkurajojnë rritjen e IHDve.

Në Kosovë, Agjensioni për Promovimin e Investimeve (APIK) agjencion qeveritar, Nisma Ekonomike për Kosovën (ECIK) me seli në Vjenë zhvillojnë aktivitete si: seminare, reklama për investime, këshillime, njoftime për valën e privatizimit dhe bizneset konkurruese, konferenca, ekspozita, faqe inerneti me qëllim të njohjes së investitorëve me Kosovën, procedurat për të depërtuar më lehtë në asetet strategjike në sektorë të caktuar të ekonomisë etj.

Si të promovoni një imazh pozitiv për Kosovën:Strukturë moderne ligjore në pajtim me BE; Popullatë e re, 75% nën moshën 35 vjeçare; Monedha zyrtare Euro stabile; Taksa të ulëta në krahasim me fqinjët; Sistem tatimor i thjeshtë; Njohuri të mjaftueshme për punë dhe teknologji; Resurse natyrore të mjaftueshme; Qasje në BE dhe tregje fqinje; Përkrahja e bizneseve nga institucionet; Procedura të shpejta për t'u regjistruar (2 ditë); Sistem i sigurt bankar. APIK është përqëndruar në tri fusha: (1) Krijimi i imazhit kombëtar, (2) Përmirësimi i klimës së biznesit, (3) Ofrimi i shërbimeve ndaj klientëve.

Institucionet e vendit duhet të bëjnë edhe më shumë në dhënien e informacionit të mirë për Kosovën, sepse interesi për t'u marrë me rastin e Kosovës është i shumëfishtë:

- ✚ Së pari, Kosova në shtator të vitit 1999 i hapi dyert e saj për kthimin e pupullatës së dëbuar nga okupimi serb, hapi dyert e donatorëve nga mbarë bota për rindërtimin e vendit, përkrahu sektorin privat dhe liberalizoi ekonominë e saj;

✚ Së dyti, përvoja e Kosovës është dobishme dhe interesante, vendi më i ri në Europë, një popullsi relativisht e re, norme rritje 1.5%, dinamike në krahasim me vendet europiane, i nevojitet një përkrahje politike dhe ekonomike nga vende me fuqi vendosëse.

Në këtë fazë tranzicioni që gjindet Kosova, ndryshimet ligjore janë në funksion të përmirësimit të ligjeve që mirëpritin nga bizneset.

3.1.1 Zhvillimi institucional dhe mbështetja ligjor për investimet e huaja në Kosovë

Me qëllim të zhvillimit më të shpejtë ekonomik të Kosovës, janë formuar organizata të veçanta si Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham), Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB), Këshilli Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik (NCED), Dhoma Tregtare e Grave të Kosovës, Këshilli Ekonomik Këshillues (EAC) një bashkërendim i prioritetëve (Ministria e Financave, Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës), në mes të qeverisë dhe biznesit privat për një platformë të përbashkët për reforma më të lehta dhe më të suksesshme të pakove fiskale në vend.

Veprojnë Kompani të Huaja (shoqëri tregtare), të cilat prej momentit të regjistrimit konsiderohen si degë në Kosovë dhe nuk kanë identitet të personit juridik. Pas regjistrimit i gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e themeluara në bazë të ligjit të zbatueshëm. Reformat legjislative përmirësuan Ligjin për Investime të Huaja Ligji Nr.02/L-33 (2006), duke e shfuqizuar me implementimin e Ligjit të ri Nr. 04/L-220 në dhjetor 2013 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës 2014: 1-09), dhe bashkë me këtë shfuqizohet edhe Ligji

Nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes Ligjit Nr. 03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Qëllimi i këtyre reformave ligjore është garantimi i investitorëve të huaj, trajtimi i tyre ngjashëm me biznese vendore. Është me interes të madh zbatimi i ligjit Nr.03/L-090 për partneritet publiko-privat dhe koncesione për 40 vjet që ua mundëson investitorëve të kenë në shfrytëzim sektorë strategjik si energji, miniera, transport dhe për sektorë të tjerë me mundësi zgjatjeje deri në 100 vjet, etj,

Kosova transportin ajror e ka mjaft të frekuentuar, përveç diasporës së gjerë, është mjaft atraktiv për t'u vizituar edhe nga të tjerë duke realizuar brenda vitit mbi 1 milionë pasagjerë. Investitori turk ka emëruar aeroportin "Limak Airpot de Lyon" i dhënë në koncesion për një periudhë 20-vjeçare (Investimet Turke dominuan në vitin 2014). Gjendja fiskale, është e qëndrueshme duke pasur parasysh se shpenzimet kapitale në infrastrukturë janë rreth 10 përqind e GDP-se për 3 vitet e fundit, 2011-2013, (FMN. 2014).

Kosova njihet si një vend në të cilin kanë vepruar gjigantë të mëdhenj ekonomikë si Trepça, KEK dhe shumë të tjerë. Që nga vitet e 60-ta Kosova ka depërtuar me produktet e saj (pjesë makinerie, akumulatorë, tekstil, minerale), në mbarë botën. Meqenëse janë 600 Ndërmarrje Shoqërore (NSH), nën portofolin e Agjensisë për Promovimin e Investimeve (APIK), të cilat sot janë shumica prej tyre të shkatërruara apo të amortizuara, nga këto ndërmarrje Agjensioni Kosovar i Privatizimit (AKP) ka privatizuar mbi 500 prej tyre. Ato posedojnë asete të llojeve të ndryshme dhe vende të ndryshme brenda dhe jashtë Kosovës.

Duke qenë të shpërndara në këtë formë rezulton se janë shitur 772 kompani të reja dhe po ashtu edhe rreth 400 asete janë shitur përmes likuidimit (AKP, 2012, KIESA, 2013).

Zonat ekonomike periferike, të cilat janë në konsolidim e sipër kanë mbështetje ligjore që nga viti 2005 me Ligjin 04/L-129 (www.assembly-kosova.org), praktikat e para pas aprovimit të Ligjit nr. 03/L- 129, përmirësimet e bëra me ligjin nr.04/L-159 ne 2013, kanë ndihmuar në vënien në veprim të këtyre zonave me interes të veç antë. Veprojnë: Parku i Biznesit në Drenas (janë 33 kompani), Mitrovicë dhe Skënderaj (zona të grumbullimit të bizneseve), të cilat mund të çojnë në një reduktim të kostos së prodhimit në dobi të investitorëve të huaj. Po ashtu Parku industrial i Holandës Zinkunue në Prizren, Zona Industriale në Shirokë me sipërfaqe 50ha tokë dhe me 33 kompani, ende nuk janë në funksion Parku Teknologjik në Shtime dhe Skënderaj, Parku i Biznesit në Vushtrri dhe Zona Ekonomike në Lipjan (OECD. 2013:38).

Kodi Doganor lejon krijimin e zonave për qëllime të prodhimit dhe të eksportit dhe qeveria e Kosovës kohët e fundit miratoi krijimin e zonave ekonomike të veçanta në komunat e Gjakovës dhe Mitrovicës (APIK dhe MTI. 2014). Agjencia për Promovimin e Investimeve të Kosovës (APIK) vlerëson 5091 kompani të huaja të regjistruara, të gjitha llojeve dhe madhësive që aktualisht nuk veprojnë të gjitha në Kosovë, prej tyre të regjistruara janë 1369 me kapital 100% të huaj, prej tyre rreth 30% nuk funksionojnë (ASK.2014, vlerësimi me pyetsorë 2014 dhe baza e të dhënave nga ATK.2014.).

Termi IHD në Kosovë

Investimii Huaj Direkt si term në Kosovë është pronësia e plotë apo e pjesshme e një kompanie në një vend të huaj, ku kontrollin mbi aktivitetin e ka investitori i huaj.

Njihen dy lloje të investimeve të huaja direkte, aktive në Kosovë:

- ✚ Investimet e portofolit, ku nuk ka qëllim apo interes për të kontrolluar një ndërmarrje. Qëllimi i investimeve të portofolit është për të marrë një kthim të mirë financiar, si në rastin e investuar në aksione, obligacione, bono, etj
- ✚ Investimi i huaj direkt vjen në formë të drejtëpërdrejtë, nëpërmjet ndërtimit të objekteve dhe makinerive, është një investim i prekshëm.

Institucionet përgjegjëse dhe legjislacioni për IHD

Në Kosovë monitorimi i IHD bëhet nga viti 2004 nga Banka Qendore e Kosovës (BQK), përmes bilancit të pagesave dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK). Ndërsa promovimin e investimeve dhe ndihmën e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), e bën Agjensioni për Promovimin e Investimeve (APIK-KIESA).

Derisa Rregullorja e vitit 2001 mbi Investimet e Huaja në Kosovë ofronte një kornizë solide për IHD, Ligji Nr. 02/L-33 në prill 2006 dhe politikat e tjera që janë implementuar ndihmuan dhe inkurajuan investimet e huaja në Kosovë, duke garantuar investitorët e huaj se investimet e tyre do të mbrohen dhe trajtohen në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me standardet e praktikave të pranueshme ndërkombëtare. Investitor i huaj definohet personi fizik që nuk është banor i përhershëm i Kosovës, një biznes apo organizatë tjetër,

entitet apo asociacion i themeluar jashtë juridiksionit të Kosovës i trajtuar njësoj sikurse ndërmarrjet e ngjashme vendore (Ligji Nr. 02/L-33. 2006), shfuqizuar me implementimin e Ligjit të ri Nr. 04/L-220 në dhjetor 2013. “Shoqëri e Huaj Investuese” (Kuvendi i Kosovës, 2006:3), do të thotë çdo shoqëri tregtare të Kosovës ose formë tjetër të shoqërisë të themeluar ligjërisht në Kosovë nëse:

- ✚ Së paku njëzet e pesë përqind (25%) të kapitalit të saj është kontribuar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një investitor i huaj;

- ✚ Kontrollohet nga një ose më shumë investitorë të huaj në bazë të:

- i) një kontrate të shkruar; ii) aksioneve ose të drejtave të ngjashme pronësore të cilat lejojnë ushtrimin e votës; iii) shumicë në këtë shoqëri, osetë drejtën për emërimin e shumicës së bordit të drejtorëve ose ndonjë organi tjetër mbikqyrës.

Trajtimi jo diskriminues, mbrojtja dhe siguria e vazhdueshme, transferet e kapitalit mund të bëhen lirisht dhe investitorët e huaj mund të sjellin personelin e specializuar për të mbështetur veprimet e tyre të biznesit. Kompensimi në rast të nacionalizimit apo shpronësimit, duke përfshirë edhe pagesën e interesit sipas nenit 8.2a. Ligji Nr.02/L-33 për investime të huaja (Kuvendi i Kosovës, 2006:3-6). Kompenzimit në rastin e shkeljes së ligjeve të aplikueshme dhe ligjit ndërkombëtar për Kosovën, transferimi i lirë si dhe përdorimi i pakufizuar i të ardhurave.

Janë krijuar përveç zonave ekonomike të veçanta që kanë mbështetje ligjore(Ligji për zona ekonomike Nr. 03/L-129), edhe zona të bizneseve për mbledhjen dhe ruajtjen e prodhimeve vendore të cilat janë në Deçan, Drenas, Shtime dhe Gjilan. Poashtu janë duke krijuar Parqe

të Bizneseve, në të cilat duhet të ketë stimuj fiskalë të veçantë. Legjislacioni në përmirësim e sipër siç është Ligji për Investime të Huaja Nr. 04/L-220, neni 16 i jep juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të biznesit në Gjykatat e Kosovës. Investitorët e huaj janë të lirë, megjithatë, për të rënë dakord mbi arbitrazhin ose një tjetër alternativë për zgjidhjen e kontesteve.

Furnizuesit mund të eksportojë mallra dhe shërbime pa qenë e nevojshme për të mbledhur TVSH nga blerësit e huaj. Furnizuesit mund të kërkojë kredi për taksat mbi inputet, duke kompensuar ato taksame kërkesën për rimbursim (Kida N. 2014). Tatimi në të Ardhurat personale (nga 5,10,20 % në 4,8, 10%), shkalla e pagesës së pensioneve është 5% nga punëtori dhe 5% nga punëdhënësi.

Sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (Nr 03 / L-162), humbjet tatimore dhe kapitale mund të barten deri në shtatë vite të njëpasnjëshme. Eliminimi i tatimit të dyfishtë bëhet duke u bazuar në Ligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (Nr.03 / L-13), ku një tatimpagues rezident i cili merr të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës nëpërmjet një selie të përhershme jashtë Kosovës dhe i cili paguan tatim në atë fitim në cilindo shtet do të lejohet një kredi tatimore sipas kësaj rregulloreje në shumën e barabartë me shumën e tatimit të paguar në gjendje të tillë.

Dogana 10%, kodi doganor përdorakcizë për mallra luksoze, pije, duhan, stoli, etj. Ligji Nr 03 / L-109, më qëllim të nxitjes së prodhimit vendas, aplikohen një normë të reduktuar të zero përqind të taksave doganore për importin dhe eksportin emallrave të caktuara kapitale, lëndëve të para, inputet e prodhimit bujqësor, dhe të shërbimeve. Ekziston korniza

ligjore që stimulon aktivitetin ekonomik të investitorëve të huaj e cila bëhet përmes organizatës qeveritare Agjensioni për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK), dhe Agjencia për Promovimin dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve të Mesme dhe të Vogla (KIESA-s), duke promovuar sidoms eksportet. Qëllimi kryesor i këtij divizioni është të promovojë në tregun e jashtëm prodhimet dhe shërbimet e prodhuara dhe ofruara nga kompanitë që veprojnë në tërë territorin e Kosovës.

Investimet janë të garantuara që prej momentit kur Kosova është bërë anëtare e Agjencisë për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA) që garanton investime në Kosovë deri në vlerën prej 20.000.000 €. Po ashtu duke qenë anëtare e organizatës Overseas Corporation Investimeve Private (OPIC), investitorëte huaj kanë të siguruar kapitalin e tyre nga rreziku politik (APIK.2012).

Po ashtu ndihmojnë në promovimin e investimeve, krijimin e imazhit pozitiv, nxitjen e diasporës për të investuar në Kosovë, dhënien e garancioneve kreditore, këshillimeve, etj. nga Austria Kontrollbank (OeKB) dhe ECIK, ndërsa nga Gjermania përmes agjencionit Euler Hermes Kreditversicherung.

3.1.2 Indikatoret e të bërit biznes në Kosovë

Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore (Doing Business, 2014)⁷¹, vlerësimi për 11 tregues të të bërit biznes dhe disa reformave, janë nxjerrë përfundime edhe për Kosovën.

Tabela 10: *Të Bërit Biznes, indikatorë, B.B (2015:9) për Kosovë (2012:9; 2013:7. 2015)*

Indikatorë	Ndryshimi në klasifikim 2014	DB 2014 Rank	DB 2013 Rank	DB 2012 Rank	Nryshimi në klasifikim 2013
Lehtësia e të berit biznes	+51	75	126	170	+44
Që ka të bëjë me ndërtimë	+9	135	144	177	+33
Lejet	..	..	..	..	..
Furnizimi me energji elektrike	+4	112	116	122	+6
Regjistrimi i pronës	+42	34	76	74	-2
Marrja ë Kredisë	Pa ndryshime	23	23	23	Pa ndryshim
Mbrojtja e investitorëve	+38	62	100	176	+76
Pagesa e taksave	-19	63	44	48	+4
Tregtia përtej kufirit	+6	118	124	133	+9
Zbatimi i kontratave	Pa ndryshime	138	138	139	+1
Zgjidhja e paafësive paguese	-77	164	87	86	-1

⁷¹<http://www.doingbusiness.org>

- Lehtësia e të bërit biznes(2014) e vë Kosovën në vendin e 72-të nga 189 ekonomitë ose 51 pozita më mirë(Shqipëria në vendin e 68-të);
- Mbrojtjen e investitorëve në vendin e 62-të apo 38 pozita më mirë (Shqipëria në vendin 131);
- Regjistrimin e pronës vendin e 34, pozitë mjaft volitshme, 42 pozita më mirë (Shqipëria 118);
- Marrjen e kredive vendi 23, më mirë se vendet e EJT-së, (Shqipëria në vendin e 36-të).
- Furnizimin me energji elektrike në vendin 112, 4 vende më mirë (Shqipëria 152);
- Marrjen e lejeve të ndërtimit (dhe punë që kanë të bëjnë me ndërtim), në vendin e 135 ose 9 pozita më mirë se viti 2013;
- Pagesën e taksave në vendin e 63-të ose 19 pozita më keq se në vitin 2014, por shumë më mirë se në vende të rajonit;
- Tregtinë ndërkufitare vendi 118 (Shqipëria e 95-ta);
- Sigurimin e kontratave, në vendin e 138, etj., nuk ka ndryshime nga viti 2013;
- Zgjidhja e paftësive paguese, në vendin e 164 ose 77 pozita më keq se një vit më parë(Shqipëria e 44-ta).

Sipas Bankës Botërore *”Klima e mirë e investimeve është një shtyllë jetike për strategjinë e një shteti për të stimuluar rritjen ekonomike, e cila pastaj gjeneron mundësi për të varfërit, që të kenë punë më produktive dhe të ardhura më të larta”*OSCE (2006:1-156).

Mjedisi aktual i biznesit në Kosovë karakterizohet edhe nga infrastruktura jo e mirë, mbrojtja e investitorëve të dobët, eksporte të ulëta, norma të larta të interesit nga bankat

komerciale, mungese e ekspertizës, qeverisje e dobët, promovim i dobët i vendit, zbatim i dobët i ligjit, që paraqet vështirësi në zbatimin e kontratave, zgjidhjen e kontesteve dhe të drejtave të pronës, megjithatë taksa të ulëta, fuqi punëtore e re dhe burime natyrore të shumta janë tërheqëse për investitorë të huaj.

Cikli i reformave dhe konkurrueshmëria

Reformae vitit 2009 në norma tatimore (DB. 2010. pp.62-63), dhe reformat e fundit janë(DB. 2015. pp.17-19):

- Licenca vjetore e biznesit 400 Euro;
- Tatimit mbi të Adhurate Koorporatave 10 përqind, orët e harxhuara 29;
- Tatimi në pronë 0.15 -1% (m²);
- Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH) shkalla tatimore 16%, në 18 dhe 8% nga shtator 2015 orët e harxhuara 87;Kontributi i punonjësve 5 % dhe i punëdhënësve 5 %;
- Bizneset e themeluara (reforma në vitin 2011), mund të marrin njëkohësisht Çertifikatën e biznesit bashkë me numër fiskal vetëm për 2 ditë (nga 7 sa ishte), duke ju ikur procedurave të zgjatura nga ATK;
- Është eliminuar detyrimi për të pasur kapital fillestar gjatë regjistrimit të biznesit (reforma 2013);
- Për të shpejtuar procedurat dhe ulur kohën e humbur gjatë regjistrimit të një biznesi (reforma 2014),janë hapur zyra one -stop shop;

Tabela 11: *Krahasueshmëria edisa treguesve me disa vende të EJL8, 2014⁷², në US\$.*

Vendet	PBK për kokë banori (US\$) 2014	WB Lehtësia e Bërjes Biznes Klasifikimi 2015 (189 shtete)	WEF Indeksi i Konkurrencës Globale (GCI) 2014-2015 (144 shtete)	WEF Klasifikimi i përgatitjes së rrjetit 2014 (144 shtete)
Kosova	3,890	75	N/Ë	N/Ë
Shqipëria	4,700	68	97	95
Bos.Herc.	...	107	N/N	68
Bullgaria	7,030	38	54	73
Kroacia	13,330	65	77	46
Maqedonia	4,800	30	63	53
Mali i zi	7,260	36	67	61
Serbia	5,730	91	94	93

- Në sektorin e ndërtimit janë eliminuar kërkesa për vlefshmërinë e eprojeve kryesore të ndërtimit, tarifatat për miratimet teknike nga komuna, reduktimi i tarifës për leje ndërtimi, vënien e një skeme të retë inspektimit në fazë, uljen e taksës për leje ndërtimi etj.;

Sipas raportit të Bankës Botërore “Doing Business 2014”, Kosova ka GDP për frymë 3,890\$, duke qenë në pozitën më të ulët në rajon. Ndërsa në vendin më të lartë qëndron Kroacia, Mali i Zi dhe Bullgaria. Kurse sa i përket lehtësisë së të bërit biznes Kosova (75) qëndron në pozitë më të ulët sesa Maqedonia(30), Mali i Zi (36), Bullgaria(38), Kroacia (65), Shqipëria (68). Kurse është në pozitë më të mirë (75) se Serbia në vendin e 91 dhe Bosnja e Hercegovina në vendin e 107.

⁷²Burimi: World Bank. (World Bank Group, 2013& Doing Business 2014.)

Nëse vlerësojmë Indeksin e Konkureshmërisë Globale (GCI), për Kosovë nuk ka vlerësim, ndërsa sa i përket vendeve të tjera (EJL-së), Shqipëria gjendet në pozitë më të pavolitshme duke u klasifikuar në vendin e 97-të nga 144 vende. Ndërsa në pozitë më të mirë qëndron Bullgaria (54), Maqedonia (63), etj. Ndërsa klasifikimi sipas përgatitjes së rrjetit në 2014, për Kosovë nuk ka të dhëna ndërsa për vende të tjera është kjo renditje duke qenë në pozitë më të mirë Kroacia, ndërsa në vendin e fundit është Shqipëria, pozita 95 nga 144 vende.

Nga vlerësimete bëra shihet se Kosova në disa tregues ka ngritje, ndërsa në disa të tjerë ka ulje të performancës, e kjo është rezultat jo vetëm i përmirësimit të indikatorëve të përzgjedhur por është edhe rezultat i përparimit të tyre në fusha të caktuara. Sa i përket Raportit të Politikave të NVM-ve të OBEZh-it 2012, Kosova është në pozitë më të mirë se Bosnja, por ajo mbetet pas Malit të Zi, Kroacisë, Maqedonisë, Shqipërisë dhe Serbisë (MTI. 2014:13). Mbetet edhe shumë për të bërë në përmirësimin e këtyre treguesve, për të qenë konkurrenente së paku me vendet fqinje, sepse gjithnjë më shumë investitorë nga Kosova preferojnë të investojnë në vendet fqinje si Maqedonia dhe Serbia.

Në vlerësimet e fundit Kosova ka arritur përmirësime në disa fusha (Kosovo Doing Business 2016. pp. 9-10, *Doing Business*), janë bërë këto vlerësime: fillimi i biznesit në vendin e 47-të, zgjidhja e paftësisë paguese në vendin e 163-të, zbatimi i kontratave 48, tregti përtej kufijve 71, pagesa e taksave 67, mbrojtja dhe monitorimi i investitoreve në vendin 57, marrjen e kredive 28, regjistrimi i pronës 32, shfrytëzimi i energji elektrike 124 dhe marrja e lejeve të ndërtimit renditet në vendin e 136-të.


3.2 Stabiliteti makroekonomik përcaktues i rritjes ekonomike dhe i IHD

Meqenëse PBB reflekton madhësinë e mundshme të tregut të ekonomisë së Kosovës, është faktor i rëndësishëm i cili do të vlerësohet. Meqenëse do të matet vetëm vlera monetare e produkteve të krijuara në lloje të ndryshme të aktiviteteve ekonomike gjatë një viti (GDP), atëherë nuk do të matet vlera përfundimtare e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të prodhuara, plus të ardhurat neto të fituara nga jashtë (GNP).

Prandaj kemi: $PBB = \text{faktori i GNP - neto të ardhurat nga jashtë}$.

Nga parametrat ne vijim, në Kosovë nuk është një rritje e kënaqshme e PBB-së që nga viti 2000 deri 2010, e sidomos pas vitit 2011 - 2014. Norma e rritjes së GDP është ngritur mesatarisht 4.0%, gjatë dekadës së kaluar duke mos rritur mirëqenien e popullsisë. Kjo rritje e moderuar ekonomike ka ndikuar deri diku në rritjen e pagave në sektorin publik (rreth 80 mijë punonjësve), në mesatare prej 360 euro (Shqipëria është konkurente) më e ulëta në Europë.

Nga madhësia e GDP-së Kosova është një shembull klasik i varfërisë cila kërkon një shtytje të madhe përmes ndryshimit të menaxhimit të ekonomisë dhe stimujve të veçantë për investitorë të huaj të cilët do të jenë burim i rëndësishëm i rrjedhës së kapitalit. Sipas të dhënave në dispozicion nga Autoriteti Qendror Fiskal (AQF. 2002), FMN(2004) dhe Riinvest (2002-2004), GDP në vitin 2000 ishte 1 miliardë e 427 milionë e 152 mijë euro, ndërsa në vitin 2013 kap shifrën prej 5 miliardë euro ose 366 përqind më shumë se në vitin 2000.



Grafiku 1: Vlerat e GDP-së , GDP-së për frymë dhe të popullsisë sipas viteve €, Autori.

Ndryshimet në vlera relative janë domethënëse, por që as për së afërmi nuk i plotësojnë kërkesat në rritje të rreth 2 milionë banorëve në Kosovë të cilët jetojnë për vetëm me 2935 euro në vit për frymë (2013) më e ulëta në Europë. Rritja e BVP-së për frymë duket se në vitet e fundit është stimuluar rritja e pagave (60%) në sektorin publik në tre vitet e fundit.

GDP për frymë është paraqitur në grafik, sipas metodës së shpenzimeve me çmime aktuale pas korrigjimit (mijë€) së bashku me GDP-në dhe popullsinë. Në Kosovë ky tregues nuk është joshës për investitorë (fuqia blerëse në vend është e ulët).

Ndërsa rritja e GDP-së për frymë pas 14 viteve është rritur vetëm 26 %, që do të thotë se mirëqenia e popullatës së Kosovës po ndryshon me hapa të vegjël në krahasim me vendet Europiane. Për të krahasuar nivelin e PBB-së për frymë të popullsisë në Kosovë me

mesataren e Komunitetit European e më gjerë, bëjmë llogaritjen në US\$, sipas formulës së më poshtme:

$$\text{PBB për frymë, 2012} = \frac{\text{PBB}}{\text{Numri mesatar vjetor i popullsisë}} = \frac{6,499,938,584 \$}{1,798,645} = 3.613\$$$

Burimi: World Development Indicators (2014), nga autori.

GDP për frymë në vitin 2012 për Kosovë, vlerësuar në US\$. GDP (US\$ 6,499,938,584), për Kosovë viti 2012. Numri i popullsisë në Kosovë në vitin 2012, sipas Bankës Botërore. Ky tregues merret për bazë edhe për llogaritjen e treguesit të rëndësishëm të zhvillimit të kapitalit human (zhvillimit njerëzor), që mban parasysh edhe treguesin e zgjatjes mesatare të jetës dhe të shkallës së arsimimit (këtë të fundit e kemi analizur në kapitullin katër).

Një tregues i rëndësishëm për studimin e niveleve është vlera absolute e 1% të rritjes së PBB-së, e cila llogaritet me këtë formulë:

$$\text{Vlera e 1\% të rritjes} = \frac{\text{Niveli i bazës}}{100} = \frac{3.613\$}{100} = 33 \$,$$

Pra, vlera absolute e 1% të rritjes është, 33\$ për Kosovë. Në qoftë se PBB-ja për frymë për vendet e BE-së në 2012, rritet 1 % (d.m.th. 320 USD), atëherë në vendin tonë, që të sigurohet kjo shtesë e prodhimit duhet që vlera mesatare e rritjes së PBB-së për frymë të rritet 8.8 %.

320\$

Bëjmë një llogaritje të thjeshtë : ----- x 100 = 8.8 %

3613\$

Sipas përlllogaritjeve të bëra, Kosova ka ritmin më të ulët të rritjes së prodhimit për frymë duke qenë prapa Shqipërisë (80 \$), dhe të gjitha vendeve të tjera të Europës. Mesatarja Botërore e rritjes së prodhimit për frymë është 120\$, SHBA 499\$, Komuniteti evropian 320\$, Italia 301\$, Greqia 245\$, Turqia 150\$, Shqipëria 80 (Ilia Telo. 2013.14-16). Prandaj vetëm me një rritje vjetore prej rreth 9 % në vit (së paku 7 vite me radhë), Kosova mund ta arrijë një mirëqenie si në vendet e BE-së që kanë pasur në vitin 2012.

Për një vlerësim më gjithëpërfshirës⁷³ Vlera Bruto e Shtuar –VBSH në Kosovë, është bërë në tri kategori:

- Shërbime, vlera e shtuar (% e PBB), nga kjo shihet se sektori i shërbimeve kontribuon më së shumti në PBB, në Kosovë (56-58%).
- Vlera e shtuar në industri në Kosovë (% e PBB), sillet nga 26% në vitin 2006 në 29% në vitin 2013 do të thotë se industria rritet por me ritme të ulëta.
- Bujqësia i korrespondon ndarjeve ISIC 1-5 dhe përfshin pylltarinë, gjuetinë dhe peshkimin si dhe kultivimin e kulturave dhe të prodhimit blegtoral. Kontributi i bujqësisë sillet nga 15-17%.

Ndërsa, rritja ekonomike në Kosovë mbështetet kryesisht nga konsumi dhe remitencat në rritje si burim financimi, investimet private edhe pse të qëndrueshme,

⁷³ Sipas „shpenzimeve” është përdorur si emërues për Kosovë, vlerësimi US\$(B.B), duke iu referuar Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit Industrial (ISIC).

mbështeten nga kreditë bankare nga investitorë të huaj me norma të larta, janë të qëndrueshme.

Tabela 12: *Treguesit makro-ekonomikë në Kosovë në vitet 2008-2013, në mil.euro.*

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
IHD	366.45	287.41	365.80	393.86	228.64	259.02
Rritja ekonomike	7.2%	3.5%	3.2%	4.5%	2.5%	3%
Remitenca	608.72	585.70	584.33	584.81	605.63	620.83
Remitanca/IHD	166%	204%	160%	148%	265%	240%
Deficiti tregtar	-1,729,773	-1,770,213	-1,861,768	-2,173,183	-2,228,883	-2,149,748
Eksportet	198,463	165,328	295,957	319,165	275,204	293,919
Importet	1,928,236	1,935,541	2,157,725	2,492,348	2,504,087	2,443,667

Burimi: BQK, 2014 (nga autori).

Rritja ekonomike pozitive është e ndihmuar edhe nga IHD në Kosovë, nga kapitali i riinvestuar (23% të IHD), i cili ka trend rritës, ulje të deficitit fiskal si rezultat i rritjes së eksporteve dhe ulje të importeve. Edhe përkundër këtyre treguesve makro-ekonomikë, në Kosovë nuk ka një dinamikë në zhvillim ekonomik.


Ndërsa tregues shqetësues është shkalla e punësimit shumë e ulët në Kosovë, në vitin 2012 është 25 përqind, ndërsa papunësia zyrtare është 30.9 përqind në 2014 prej 35 përqind (nga burime joformale arrin në 45%). Sipas anketës së Business Environment and Enterprise Performance Surveys (BEEPS), në 2009 është vlerësuar se në Kosovë është i nevojshëm kualifikimi për një mori profesione. Që në ditët e para të pas luftës pjesa dërmuese e punëtoreve të kualifikuar në Kosovë janë sistemuar në organizata të huaja ndërkombëtare, me paga më të larta 40-50% në krahasim me pagat vendore.

Me një papunësi të lartë rreth 35 % dhe kryesisht (55%) të rinj 18-24 vjeçar, nuk është e vështirë të gjejë punëtorë me paga të ulëta cilido investitor. Kjo stimulon informalitetin që konsiderohet të jetë rreth 37.8%, që do të thotë nuk kanë një kontratë pune (World Bank in Kosovo, Country Snapshot, 2013:7). Çdo vitë në Kosovë kërkojnë punë rreth 30 mijë të papunë dhe kryesisht janë të rinjë (AMNVM, 2012). Ndërsa ata të cilët punojnë në institucione konsiderohen si më të favorizuar në krahasim me sektorin privat, përkundër faktit që marrin një pagë mesare prej 360 euro.

Për çdo katër vite paga në Kosovë është rritur për 0.5% (2004-2007, për 5.5% nga viti 2007-2010 dhe 16% për vitet 2010-2013, pra ende nuk është dyfishuar paga mesatare në Kosovë edhe pas 10 viteve. Mirëpo i është afruar pagës mesatare të vendeve të Ballkanit, duke u bërë gjithnjë më pak konkurruese (konkurrente është Shqipëria me pagë mesatare më të ulët se në Kosovë). Po ashtu është mjaft sfiduese që papunësia afatgjate është mjaft e lartë ku të rinjtë presin për punë deri në 7 vite. Kjo do të thotë se tregu i punës në Kosovë mundëson që të gjinden punëtorë me paga edhe më ulëta se sa mesatarja, këtë e dëshmon informaliteti i lartë në tatimit në paga duke kontribur më së paku në buxhetin e Kosovës (ATK.2014).

Një shembull mjaftë largëpamës, ishte plani veprimit nga (SRKPV), në vitet 2010-2012 (OBEZH, 2010b), duke ju ofruar të rinjëve arsimin profesional, punësim sidomos në sektorin privat, trajnim, etj. Edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ka një strategji të tillë e cila kërkon veprim konkret dhe të shpejtë. Të dhënat për pagën minimale në vende të rajonit, e vendosin Kosovën në vendin e fundit (130 Euro në vitin 2011). Më pastaj Shqipëria me pagë minimale prej 156 Euro (2013), ndërsa janë të përafërta vendet si Maqedonia (178€), Serbia (188€) dhe Mali i zi me 193€. Kurse përkundër krizes

në Greqi paga minimale është e lartë (684€ në vitin 2014) dhe konsiderohet si vend që ka ofertë të mjaftueshme të njerëzve me arsimin profesional, nënkupton se produktiviteti i tyre është më i lartë.



Grafiik 2: Niveli i pagës minimale në Ballkan (ASK. MMS.ODA 2014).

Turqia ka pagë minimale prej 425€. Ka dallime edhe në pagat sipas sektorëve në Kosovë, duke u renditur pagat me kualifikime të ulëta, janë në sektorin e ndërtimit, hotelieri dhe tregti me pakicë, ndërsa pagat më të larta janë në sektorin e shërbimeve. Kosova është konkurrenente me punëtorë në moshë të re 18 - 24 vjeç. Kontribut ka dhënë edhe shkalla e emigrimit e të rinjëve për disa vite dhe kthimi i tyre në Kosovë duke sjellë me vete jo vetëm përvojën por edhe njohuri në profesione të ndryshme (BB. 2010. Raport nr. 53185-XK Kosova 2009. pp.30-141).

Nëse i referohemi moshës së të pa punëve kemi të rinj të papunë prej 55.3 % të moshës 25-34 vjeç, ndërsa të punësuar të kësaj kategorie janë 9.8 %, është një tregues mjaft ë ulët kur kemi parasysh se në treg dalin rreth 30.000 të rinj që kërkojnë punë. Papunësia në

mesin e femrave është më e madhe për 10% se te meshkujt. Ndërsa varfëria e përgjithshme është 29.7 përqind; varfëria ekstreme është 10.2 përqind.




Figure 2: Tregu i punës.(Kosovo Agency of Statistics, Labor Market Outcomes. 2012)


Të punësuarit në sektorin publik janë 80.816 në 2013, prej tyre 43 përqind në arsim, 17 përqind në shëndetësi dhe siguri publike 18 përqind, dhe të tjera 22 përqind. Tregues tjetër i rëndësishëm për stabilitetin e ekonomisë së Kosovës është borxhi i ulët (10.63%) në raport me GDP.

Çfarë i nevojitet Kosovës që të përshpejtojë rritjen ekonomike ?

Kosovës i nevojitet një agjendë re e rritjes ekonomike, “ konkurueshmëria” e jo remitencat dhe orientimi nga eksporti. Me agjendën e deritanishme të rritjes nuk mund të presin rritje

ekonomike⁷⁴ më të lartë në afatëgjatë. Në Kosovë janë të theksuara pengesat strukturore, një vend në tranzicion dhe larg integritit në BE. Megjithatë, mesatarja e rritjes ekonomike në Kosovë nga 2008 deri 2013 (rreth 4%), ka kontribuar në ngritjen e mesatares ekonomike Europiane. Kosova njihet si vend me të ardhura të ulëta por ka arritur t'i menaxhojë financat publike. Investime kapitale në infrastrukturë dhe rritja e pagave ka qenë e vazhdueshme.⁷⁵

Procesi i zhvillimit kërkon inpute të reja, veçanërisht aftësitë njerëzore për përdorim dhe menaxhim të teknologjisë, biznesit, institucioneve, etj. Edhe përkundër këtyre, vlera relative e rritjes ekonomike është pozitive, por nëse e masim sa rritja ekonomike është ulur (kur në vitin 2000 është 5.4%, ndërsa 3% në vitin 2013), atëherë kemi:



Grafiku 3: Pasqyra e rritjes ekonomike në përqindje sipas viteve në € (autori)

⁷⁴ Rritja ekonomike është matur si ndryshim përqindje e Bruto Produktit Vendore. Rritja ekonomike i atribuohet akumulimit të kapitalit njerëzor dhe fizik dhe rritjen e produktivitetit që rrjedhë nga novacionet teknologjike. Rritja ekonomike është edhe rezultat i zhvillimit të produkteve të reja dhe shërbimeve.

⁷⁵ Country Kosovo Snapshot Aprill 2015. The World Bank Group in Kosovo.pp. 2.

Shkalla e uljes ekonomike = $(V_b - V_a) / V_a \times 100\% = (GDP_{Gb_{2013}} - GDP_{Ga_{2000}}) / GDP_{Ga_{2000}} \times 100 = (3\% - 5.4\%) / 5.4\% \times 100 = -2.4\% / 5.4\% \times 100 = -44.44 / 14 \text{ vite} = -3.1\%.$

Kjo do të thotë se rritja ekonomike në Kosovë është në rënie prej 3.1 përqind. Ose, nëse i referohemi sa është rritja mesatare për 14 vite atëhere duke mbledhur vlerat e rritjes ekonomike ne raport me vite :

Mesatarja e rritjes ekonomike = $55.5/14 = 3.96$ ose rreth 4%.

Ndërsa mesatarisht popullsia e Kosovës rritet prej 1.5 % në vit, ndërsa ka një ulje nga viti 2011. Kur krahasojmë dinamikën e rritjes së popullsisë dhe rritjes ekonomike ato nuk janë simetrike njëra me tjetrën. Si rezultat mund të themi se gjatë periudhës 15 vjeçare (2000-2014), ekonomia e Kosovës me një rritje të moderuar nuk ka qenë në gjendje të adresoj shumë nevoja të shoqëris. Kësaj gjendje i ka ndihmuar eksporti i vogël, kryesisht i lëndëve të para dhe gjysëmprodukteve nga industria nxjërrese.

3.2.1 Investimet e Huaja Direkte në Kosovë

IHD në Kosovë konsiderohen si një nxitës i rritjes ekonomike derisa agjenda qeveritare e Kosovës është në favor të tyre. IHD mund të maten si, flukset hyrëse brenda një kohe si dhe aksionet e akumuluar (fitimet e pa shpërndara, borxhin ndaj kompanisë mëmë dhe rezervat). Rrjedha e kapitalit buron si IHD, Investime portofoli dhe investime të tjera.

Hyrjet neto të IHD-ve së bashku me investimet e brendshme formojnë investimet totale si pjesë e PBB-së të pasqyruara në bilancin e pagesave, si shuma e ekuitetit, kapitalit afatgjatë dhe kapitalit afatshkurtër. IHD sipas komponenteve të saj në miliona euro, është e ndarë në tre komponente (kapitali, kredia brenda kompanisë, riinvestimi). Kapitalin aksionar në vlerë 30.4 milionë në vitin 2004, ndërsa në vitin 2013 është 78.1 milionë euro.

Fitimi i riinvestuar është rritur nga 9.1 milionë në vitin 2004 ndërsa në 2013 është 71.3 milionë euro. Transaksione tjera kapitale rriten në 92.1 milionë në vitin 2013 ndërsa në vitin 2004 ishin 3.5 milionë, të gjitha këto bëhen nga jorezidentët në ekonominë e Kosovës. Ndërsa investimet dalëse, konsiderohen investimet e ekonomisë së Kosovës jashtë saj të cilat janë rritur në vitin 2013 në krahasim me vitet e kaluara, që është një lajm dyfish pozitiv.

Tabela 13: *Komponentetë IHD para korrigjimit të statistikave 2014*

Vitet	Kapitali aksionar 1	Fitimi ë ri investuar 2	Transaksione tjera kapitale 3	IHD 4=1+2+3
2004	30.4	9.1	3.5	42.9
2005	65.6	16.8	25.2	107.6
2006	185.6	24.8	78.8	289.2
2007	276.4	41.6	113.0	431.0
2008	197.4	56.2	88.0	341.5
2009	196.5	57.2	23.2	276.9
2010	223.1	73.3	34.7	331.1
2011	270.9	58.0	49.4	378.2
2012	141.3	45.6	26.4	213.3
2013	78.1	71.3	92.1	241.5

Burimi: (BQK, 2014, seri kohore).

Gjatë një dekade e gjysmë Kosova ka marrë IHD nga vende të ndryshme, mirëpo për shkak të situatës ekonomike dhe politike, IHD në Kosovë nuk arsyetojnë pritjet.

Vlerësimi i shkallës së rritjes së IHD-ve në Kosovë është bërë sipas formulës duke përfshirë fluksin për një dekadë e gjysmë (2000-2013):

$$\text{Shkalla e rritjes së IHDg} = (P_1 - P_0) / P_0; P_1 = \text{viti aktual}; P_0 = \text{viti paraprak}$$

Është e domosdoshme të përmirësohet edhe më tutje klima e biznesit dhe politikat për investime të jenë më atraktive.

Tabela 14: Elasticiteti i IHD, korigjimet e statistikave të fundit, 6/2015)

Viti	Fluksi IHD-Neto	Shkalla e rritjes së IHD
2000**	231	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = *$
2001**	266	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 15\%$
2002**	300	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 12.7\%$
2003**	302	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 0.06\%$
2004	42.9	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = *$
2005	107.6	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 150\%$
2006	294.8	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 173\%$
2007	440.7	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 49\%$
2008	369.5	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = -16.1\%$
2009	295.5	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = -20\%$
2010	368.5	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 24.7\%$
2011	384.4	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 4\%$
2012	229.1	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = -40\%$
2013	280.2	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 22\%$
2014	Deri:6/2014/42.7; ndërsa,1-12/2014/ 151.2 milion Euro	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = -46$
2015	1deri6/2015/163.9 milion Euro	IHDRr = $(P_1 - P_0) / P_0 = 183\%$

Shënime : (*) , me këtë simbol theksohen vitet bazë,
 **Janë investimet e private dhe IHD, kalkuluar nga autori.

Sipas statistikave të para në Kosovë (2000-2003), IHD janë vështirë të identifikohen, prandaj ato janë matur së bashku me investimet private në vend, pa investime publike të cilat janë rritur nga viti 2000 në 2003 vetëm 31përqind (231 mil. deri 302 mili.euro). Në vitin 2002 IHD dhe investime private janë rritur për 12.7 % ose 300 milionë euro, ndërsa në vitin 2003 rritja e tyre është më e ulëta e konsideruar ndonjëherë për vetëm 0.06%.

Nga viti 2004 IHD janë statistikat e para zyrtare nga ASK dhe BQK vlera e të cilave është më e simbolike 42.9 milionë euro. Viti 2005 konsiderohet si viti më i suksesshëm i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që reflekton edhe në rritjen e IHD prej 150% ose 107.6 mil.euro. Duke iu referuar rezultateve të mëposhtme, rritja e IHD ka shkuar deri 173% në 2006. Një rritje prej 173% e IHD në vitin 2006 është më e madhja që ka ndodhur ndonjëherë, ndërsa viti 2007 konsiderohet si vit që Kosova mori më së shumti IHD në vlerë prej 440.7 mil. euro (ky vit në mbarë globin konsiderohet me fluksin më të madh të IHD), ose 49 % me shume se një vit më parë. Megjithatë, ekonomia e Kosovës pas një konsolidimi të fluksit të kapitalit në vend u godit nga kriza e eurozonës së vitit 2008 që u reflektua edhe në fluksin e IHD të cilat ranë në minus 16.1 % (IHD kontribuan në financimin e llogarisë rrjedhëse rreth 80%).

Ndërsa ulet fluksi hyrës i IHD, ulet qëndrueshmëria e llogarisë rrjedhëse ndaj IHD-ve (nga viti 2009 më 77% në 2010 me 71%, kurse viti 2011 me 60%). Fluksi i IHD në 2009 ulet 20 %, dhe vetëm në 2010 arrijnë një shkallë rritjeje prej 24.7 %. Në vitin 2012 IHD financon llogarinë rrjedhëse me 60% në 2013 me 76%. Mesatarja (2008-2013) financimit të llogarisë rrjedhëse nga IHD është 71%.

Efekti i krizës zgjerohet sidomos në vitin 2012 me rënie të madhe minus 40 % të IHD apo vetëm 229.1 mil. euro, ndërsa 2013 me 280.2 milionë ose 22% më shumë se një vit më parë. Viti 2014 me 151.3 milionë euro ose 46 % më pak se në vitin 2013. Shihet se gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2015 është një konsolidim investimeve duke marrë 163.9 mil.€ ose 183% më shumë se në gjashtëmuorin e parë të vitit 2014 (ndërsa në vitin 2015 fluksi hyrës është 324. mil.€, në tremujorin e parë të vitit 2016 ka një hyrje të IHD-ve prej 66 mil. € ose 20% më pak se në tremujorin e parë të vitit 2015, pra është një trend rënës i IHD-ve).

3.2.2 Dinamika e IHD në Kosovë


Kudo në botë dinamika e IHD është shumë pozitive dhe e varur jo vetem nga rrjedha globale por edhe nga faktorë të brendshëm të vendeve pritëse. Një gjë është e qartë se më e madhe të jetë GDP e një vendi aq më të larta janë IHD dhe anasjelltas.

Në rastin e Kosovës tendenca IHD me GDP është pothuajse asimetrike, dhe me tendencë drejt rënies së IHD-ve, sidomos pas vitit 2010. Prandaj edhe në Kosovë jo të gjithë faktorët e brendshëm (faktorët ekonomik dhe institucional), kanë ndikim pozitiv në PBB dhe në tërheqjen e IHD. Kjo dëshmon se në Kosovë kadobësi institucionale, politike dhe ekonomike që pengojnë ardhjen e IHD-ve.

Këtë mund ta shohim edhe nga diagnostifikimi grafik i hyrjeve të IHD për Kosovë, megjithatë prapakishtë të tërheqin një paralele me diagnostifikimin e prurjeve të IHD që ka bërë Zoto O. (2012:100), për Shqipërinë.


Mirëpo krahasuar me Shqipërinë Kosova është largë shkallës së prurjeve të IHD-ve. Autorja Zoto O. (2012:100), në grafikun 4 paraqet lidhjen e IHD me GDP në Shqipëri e cila është pozitive, rritja e GDP është përcjellë me rritje të vazhdueshme dhe të shpejt të IHD-ve, diagnostifikuar deri në vitin 2010.

Në rastin e Shqipërisë “Ekziston një lidhje pozitive midis IHD-ve dhe Produktit të Brendshëm Bruto, Sa më i lartë niveli i PBB-së aq më i lartë edhe niveli i IHD-ve. E veçantë në këtë rast është edhe paraqitja e të dy variablave vetëm me trend rritës ndryshe nga vende të tjera ku tendenca e GDP-së është më fluktative veçanërisht pas krizës së fundit globale..”(O. Zoto.2012.100).



Grafik 4:Prurjet e IHD (në milionë US\$) dhe GDP reale në Shqipëri.

Nëse shikojmë nga pikëpamja grafike në Kosovë, IHD dhe GDP-së nuk janë në lidhje pozitive njëra me tjetrën deri në vitin 2006, viti 2007 ka lidhje pozitive me GDP ndërsa përsëri nga viti 2008 e tutja lidhja pozitive shkëputet me tendence të rënjes së IHD-ve.



Grafik 5: Prurjet e IHD(në milionë Euro) dhe GDP real në Kosovë (Autori).

Kjo tregon se në periudhën 2005-2006 klima ekonomike ka qenë jo e qëndrueshme në krahasim me vitet para 2004 (ku vërshuan donacionet dhe privatizimi). Viti 2007 konsiderohet se ka lidhje pozitive, ndërsa në vitet në vazhdim lidhja ka trendë negativë. Shumë vende të prekura nga kriza kanë asimetri të rritjes së IHD në raport me GDP, si në rastin e Kosovës.

E veçantë e kësaj analize është se GDP është rritur në vazhdimësi, ndërsa IHD ka një trajektore me fluktacione por kryesisht në rënie. Ngjashëm si në vende të tjera IHD edhe në Kosovë nga kriza globale e fundit IHD-të janë përgjysmuar.

Pra të dy variablat kanë një tendencë largimi nga njëra- tjetra.

Viti 2007 konsiderohet si vitë i flukseve më të larta të IHD që ka pasur ndonjëherë, 440 milionë euro (BQK, 2008). Nga të dhënat e BQK-së (2014), vlerësohet të kenë hyrë në Kosovë në vitin 2004 IHD neto prej 42.9 milionë euro apo në 2013 prej 280.2 mil., euro, edhe pse simbolike rritja ekonomike është nxitur nga IHD në sektorin e shërbimeve pas


krijimit të filialave të para të sitemit bankier, kompanive të sigurimit, patudshmërisë, konsulencës etj. Nëse e krahasojmë trendin rritës të GDP dhe IHD, konstatojmë se nuk kanë trend rritës linear. Viti 2006 dhe 2007 dhe 2008, periudhë kjo me një trend jo të ekuilibruar në mes GDP dhe IHD. IHD në vitin 2007 arrijnë kulminacionin me 440.7 milionë euro, si asnjëherë tjetër, përcjellë edhe nga GDP në rritje jo të theksuar. Në vitet 2009 dhe 2010 në krahasim me vitin 2007, niveli i tyre ishte i ulët, në 47%.

Ndërsa viti 2008 tregon trendin ulës të IHD, nuk shoqërohet me ulje të GDP por me rritje të saj. Kjo vërteton se jo gjithmonë efekti i IHD shprehet në të njëjtin vit por me vonesë kohore. Kjo është shprehur edhe në vitet në vazhdim. Viti 2013 tregon se kriza në rënie e eurozonës nuk ka pasur ndikim të madh në Kosovë dhe IHD nuk janë rritur më shumë se 22 përqind në krahasim me vitin 2012, ndërsa përmirësuan deficitin e llogarisë rrjedhëse. Është karakteristike për Shqipërinë, përkundër ndikimit më të madh të krizës së eurozonës, IHD nuk janë ulur por përkundrazi janë rritur. Shqipëria ka përmirësuar imazhin e saj negativ duke e klasifikuar në kategorinë e vendeve me të ardhura të mesme dhe një nivel më të lartë të mirëqenies së popullsisë.

Ndërsa, po të vështrojmë historikisht pjesëmarrjen e IHD në GDP në rastin e Kosovës në vitet 2000-2003, sillet nga 12.5 % deri 16.2 % (investime private dhe IHD), ndërsa në vitin 2004 kjo pjesëmarrje është e ulët 1.5% (vetëm IHD).

Në vitin 2005 pjesëmarrja është 6% ndërsa një vit më vonë është 10%, në vitin 2007 ka një rritje prej 13%. Në vitin 2008 deri 2011, ka një ulje (10, 7.1, 8.5 dhe 8 %) të pjesëmarrjes së IHD në GDP, ndërsa kjo ulje theksohet në vitet 2012 me 4.7% dhe 2013 me 5%. Ndërsa

ka një ulje të IHD në vitet 2012 dhe 2013 dhe 2014, nënkupton se jo vetëm se vijnë pak investitorë të rinj të huaj në Kosovë, por shumë prej tyre janë larguar tashmë. Ndërsa në 2015 pritet rritje e fluksit të IHD-ve meqenëse deri në muajin maj ka rritje tre herë më shumë se një vit më parë. Ndërsa ndikimi pozitiv i IHD në rritjen ekonomike në vitin 2007 (piku i IHD në Kosovë) me 440.7 milionë euro ose 13% ë GDP me rritje ekonomike 8.3%, e klasifikuar si rritja më e madhe në Europë. Ndërsa prej 3% në vitin 2013, prapë më ë madhja në Europë.



Grafiku 6. Përqindja e IHD në GDP për periudhën 2000-2013 në € (nga autori)

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike e kanë remitencat që ndihmojnë konsumin, procesi i privatizimit, fitimi i riinvestuar (23% i IHD) i kompanive, eksportet edhe pse të ulëta kanë trend rritës. Hapja e ekonomisë së Kosovës në vite i kalon 77 përqind të GDP-së (2007), do të thotë se vendi është i hapur për IHD. Kapitali i huaj ka hyrë në Kosovë menjëherë pas luftës në mënyra të ndryshme por kryesisht përmes importeve.


Objektivat e planifikuara, siç janë zgjerimi i prodhimit vendor dhe promovimi i eksporteve, nuk u arritën. Me hapat që janë ndërmarrë pas vitit 2012 nga ministritë përkatëse (MTI, MZHEK, KIESA, APIK), ka përmirësime në eksporte, megjithatë përqindja e mbulimit të importit me eksporte është e ulët (12.8% në 2014). Rritja e eksporteve dhe investimeve ka gjeneruar shkëmbimin me kompani të huaja duke importuar mallra kapitale. Elasticiteti i eksporteve është në rritje nga viti 2005-2014, rritja mesatare është 49 përqind, ndërsa importet edhe pse të larta elasticiteti rritës i tyre është më i ulët rreth 14 përqind.

3.2.3 Investimet private, IHD dhe kapitali human në Kosovë

Nga analiza përshkruese e investimeve të brendshme, IHD-ve dhe kapitalit human shihet se investimet e brendshme në raport me GDP kontribuojnë më shumë se IHD në formimin e kapitalit bruto në Kosovë. Investimet e huaja direkte kanë hyrë më shumë përmes privatizimit se investimeve Greenfield, kontributi në rritjen e kapitalit të përgjithshëm në vend në formë partneriteti është më i lartë (sektori banakar, telekomunikacioni, energjitika, miniera, ndërtimtari, patundshmëri, etj.). Investimet Greenfield janë të ulëta dhe kjo reflekton edhe në punësimin më të ulët.

Ndërsa analizojmë kontributin e kapitalit human në tërheqjen e IHD në Kosovë dhe kontributin e tij në investime të brendshme shihet se kapitali human është tërheqës për investitorë të huajt. Nëse masim kapitalin human në përqindje të popullsisë (shkollimi i mesëm dhe i lartë) në Kosovë përqindja e tij është e ulët në raport me rajonin. Duke parë se raporti i nxënësve dhe studentëve në raport me popullsinë në vitin 2000 ishte vetëm 6%

(90507 nxënës dhe 20100 studentë) ky numër është rritur në 10 % të popullsisë (106951 nxënës dhe 65315 studentë në universitetet publike dhe private) në vitin 2013.



Grafik 7: Investimet e brendshme, IHD në bashëkveprim me HC në Kosovë, 2004-2014, në US\$, WDI, 2015, nga autori.

Kontributi i kapitalit human në tërheqjen e IHD,⁷⁶ është më i madh se efekti i tij në investime të brendshme, për shkak të teknologjisë së avancuar që disponojnë investitorët e huaj. Pra kapitali human në Kosovë është tërheqës për IHD dhe IHD tërheqë kapitalin human (keto variabla kanë dhënë rezultatet të njëjta edhe në analiza ekonometrike për 24 vende pjesëmarrëse edhe Kosova).


Kontributi i IHD në rritjen ekonomike në Kosovë është i ulët efekti zëvendësues (crowding-out) që kanë IHD në Kosovë,⁷⁷ IHD nuk plotësojnë - grumbullim brenda (Crowdin-in)

⁷⁶ IHD disponojnë me teknologji të avancuar në krahasim me investimet e brendshme.

⁷⁷ Rezultate të ngjashme të efektit "crowdin-out", janë gjetur edhe në rezultatet ekonometrike, kapitulli katëri këtij studimi nëmostrën prej 24 vendeve europiane pjesëe së cilës është edhe Kosova.

mjaftueshem investimet e brendshme ne Kosovë dhe kjo reflektohet ne efektin e IHD pozitive por i parëndësishëm në rritjen ekonomike (një nalogji me rezultatet ekonometrike).

Bashkëveprimi i kapitalit human me IHD dhe investime të brendshme në Kosovë paraqitur në grafikun në vazhdim, shihet sa tërheqës për IHD është kapitali human në krahasim me investimet e brendshme, një sinjal që politikat arsimore duhet t'i orientojnë nxënësit më shumë në shkollim të mesëm profesional dhe firmat vendore duhet te investojne ne trajnimin e punetoreve. Ndërsa sektorët, sektori i shërbimeve ka marrë përqindjen më të lartë të IHD-ve sepse është krijuar monopol i bankave te huaja në Kosovë, konkurenca e krijuar largoj nga tregu kosovarë bankat vendore. Nëse shohim kapitalin e riinvestuar të kompanive të huaja në Kosovë që nuk i kalon 23 % vijnë në përfundim se diversifikojn fitimet e tyre në vendin e origjines për ose për shkak të efektit te krizes në vendet ku është selia e kompanisë ose investojnë fitimet e tyre në vende tjera.




*Grafiku 8: Performanca e IHD *HC dhe INV.BR*HC, US\$ WDI, nga autori.*

Megjithë normat larta të interesit firmat vendore kryesisht financimin e bëjnë përmes kredeve nga bankat e huaja sepse mundësitë e burimeve të financimit janë të kufizuara, disfavorizojnë kthimet pozitive të investimeve. Edhe në nivel vendi investimet agregate në sektorin e shërbimeve në vitin 2013 kontribuojnë në 56 përqind (sistem bankar, sigurime, ndërtimtari, telekomunikacion, patundshmëri), në sektorin e industrisë 29 përqind (industria përpunuese dhe industria nxjerrëse), në bujqësi 15 përqind (agrobiznes). Është gjetur se gati 70 përqind e fluksit të IHD janë përqëndruar në zona urbane dhe fare pak në zona rurale). Ekonomia e Kosovës në vitin 2015 do të ketë rritje të ekonomisë nga kërkesa e brendshme (konsumi si komponentë kryesore, investimet publik, remitancat dhe një trend rrites i IHD), ndërsa bilanci tregtar i përkeqësuar nga eksportet e ulëta (prodhimi i ulët vendor).

3.2.4 Kompanitë e huaja që veprojnë në Kosovë


Kompanitë e huaja të cilat kanë hyrë në Kosovë, kanë kontribuar në mbulimin e mungesës së kapitalit në vend duke sjellë rreth 3 miliardë euro IHD (2004-2014), përveç investimeve portofoli.



Grafiku 9: Kompanitë huaja sipas sektorëve të ekonomisë (Burimi: APIK. 2012, kalkuluar nga autori)

IHD kontribuan në stabilitetin financiar në vend, ku bankat paraqesin vlerën më të madhe financiare me kapital të huaj, sollën ekspertizë dhe trajnim të punëtorëve të punësuar në kompani, edhe në bizneset lokale. Sektori bankar në Kosovë është i dominuar nga bankat e huajame rreth 90% të të gjitha aseteve bankare. Sektori mikrofinanciar në Kosovë ka funksionuar që nga viti 1999. Shumica e institucioneve mikrofinanciare (IMF) ishin themeluar nga organizata të huaja të cilat përveç donacioneve kanë themeluar edhe organizata mikrofinanciare. Kompanitë në Kosovë janë nga shumë vende të botës, megjithatë dominojnë bizneset nga Shqipëria.

Dominojnë kompanitë në sektorin e tregtisë, me 38.9 përqind (2011). Viti 2009 konsiderohet si vit që u regjistruan më së shumti kompani të huaja, 386 kompani vetëm me kapital 100% të huaj.



Grafiku 10: Kompanitë e huaja me 100% kapital të huaj 2000-2014 (ASK.2014, nga autori).

Ndërsa sipas ASK (qershor 2014), numri i ndërmarrjeve me kapital 100% të huaj gjithsej janë 1365, vetëm në periudhën 2013 janë regjistruar 43 biznese me 100% kapital të huaj ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014 janë regjistruar 30 biznese të tilla. Me kapital të përzier janë gjithsej 3726, nga viti 2000 deri në qershor 2014, kemi totalin prej 5091 ndërmarrje të huaja në Kosovë me 100% kapital të huaja dhe me kapital të përzier, të cilat nuk janë të gjitha aktive. Bazuar në anketimin e bërë në 306 biznese të huaja dega në Kosovë, konstatohet se janë mbyllur 70 biznese (22.87%), pas ushtrimit të aktivitetit nga 1 deri në 3 vjet dhe i përkasin viteve 2008 deri 2014.

Nga kjo konkludojmë se një pjesë e kompanive të huaja që vijnë në Kosovë, nuk dëshirojnë të paguajnë tatim edhe pse normat tatimore janë më të ulëta në Europë. Mirëpo kontributi i përgjithshëm i tyre është i madh në të ardhurat e buxhetit të Kosovës meqenëse

bizneset kosovare kryesisht janë të mesme dhe të vogla, prandaj nuk janë konkurrencte me kompani të huaja. Kompanitë që më së shumti krijojnë vlerë të shtuar të lartë janë kompanitë në sektorin e shërbimeve nga viti 2000 si dhe biznese prodhuese dhe përpunuese të themeluara nga viti 2007e tutje. Bizneset me kapital 100 % të huaj janë regjistruar në vitet e para të pasluftës, të nxitura nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Vetëm në vitin 2000 janë regjistruar 100 ndërmarrje. Ky ritëm ka vazhduar deri në 2002, kur ishin regjistruar 128 ndërmarrje të huaja.

Pra, vetëm 3 vitet e para pas luftës kanë hyrë në Kosovë 338 ndërmarrje me kapital 100 përqind të huaj. Ndërsa ka ulje të bizneseve të regjistruara 2003 në 2005, për 47 përqind. Kontribues në tërheqjen e investitorëve në periudhën 2000-2005 (gjithsej 500), pa llogaritur edhe rreth 1000 biznese me kapital të përzier, është procesi i privatizimit i cili edhe pse me pengesa ka sjellë kompani të huaja të cilat edhe sot janë të suksesshme në vend. Sipas të dhënave (IPAK dhe ASK. 2012), Investitorët e huaj aktivitetin e tyre ekonomik e kanë shtrirë në sektorët si në tabelën 11. Meqenëse Kosova në vitet e pasluftës (qershor 1999 deri 2003), qëllim parësor kishte rindërtimin e vendit, nxitu kompani të huaja të sjellin makineri dhe ekspertizë profesionale duke ndihmuar vendin. Përveç donacioneve të shumta në Kosovë, erdhën kompani serioze në sektorin bankar. Filialat e para nga Gjermania dhe Austria në fillim si banka të vogla “Micro-enterprise Bank” ndërsa tani konsiderohen si banka më të fuqishme në vend (PCB), etj.

Nga të dhënat viti 2011, shihet se kontributin më të rëndësishëm në punësim e ka dhënë sektori i përpunimit me 6736 punëtorë, tregtia me 4953 punëtorë, sektori bankar dhe i shërbimeve financiare 4428 punëtorë dhe sektori i ndërtimit me 2253 punëtorë. Ndërsa

sektorët tjerë kontribuojnë më pak në punësimin në Kosovë. Nga vlerësimi empirik gjejmë rezultatin (nga anketa në 306 biznese të huaja që veprojnë në Kosovë) se kontributin në punësim është i vogël në krahasim me numrin e bizneseve të huaja dhe kapitalin e tyre. Është parë se nga 306 bizneset e anketuara 50% të tyre nuk kanë asnjë punëtor të punësuar. Ndërsa punësimi më i madh ishte në sektorin bankar, ndërtimtari dhe në sektorin e përpunimit.

Nga vlerësimet (APIK), deri në vitin 2012 janë punësuar gjithsej 24611 punëtorë⁷⁸. Meqenëse statistikave zyrtare për numrin e bizneseve me kapital 100% të huaj, janë shumë të sakta (1369, deri në qershor 2014), atëherë edhe anketimi është bërë vetëm në këto „Kompani -Dega në Kosovë”. Ndërsa statistikave për kompanitë e huaja me kapital të përzier, ka dallime sa i përket evidencës së tyre nga ASK dhe ARBKO, sepse në vazhdimësi ka mbyllje të bizneseve të tilla (ATK, 2015 www.atk-ks.org), nga Administrata Tatimore e Kosovës ku nga 306 biznese të anketuara, janë pasive 70 prej tyre.

Megjithatë merret si e dhënë se ekzistojnë 5091 biznese që kanë hyrë në Kosovë nga 2000-qershor 2014, dhe prej tyre aktive janë 3973 biznese edhe ato mund të ndryshojnë varësisht nga sezona e punës, mund të jenë më të ulëta (në 2010 ishin 3523 kompani të regjistruara (MTI, APIK. 2010), ndërsa deri në qershor 2014 janë të evidentuara 5091 biznese. Ka me shume biznese nga Shqipëria (531), ndërsa fuqia ekonomike është e madhe te bizneset e vendeve, Gjermani, Turqi, Itali, SHBA, Kroaci dhe Austri. Nga 401 biznese të vogla nga Kina shumica prej tyre janë shuar mbrenda 3 viteve.

⁷⁸ Prandaj bëjmë një krahasim të statistikave zyrtare të të punësuarve nga kompanitë e huaja dhe rezultatet e anketës. Vijmë në një përfundim të njëjtë se kompanitë e huaja nuk kontribuojnë mjaftueshëm në punësim në Kosovë.

Tabela 15: Numri i ndërmarrjeve të huaja në bazë të vendeve të origjinës (2000/2014)

Nr.	Vendi	Nr. ndërmarrjeve jo sezonale	Nr. ndërmarrjeve Sezonale	Total aktive	Total jo Aktive	Gjithsej
1	Shqipëri	531	310	841	115	956
2	Maqedoni	438	277	715	89	804
3	Turqi	405	270	675	120	795
4	Kinë	401	5	406	210	616
5	Gjermani	293	190	483	161	644
6	Itali	147	95	241	98	339
7	SHBA	115	100	215	105	320
8	Bullgari	99	45	144	74	218
9	Kroaci	85	52	137	38	176
10	Austri	83	32	115	108	223
Total		2597	1376	3973	1118	5091

Burimi: (ASK, APIK. MTI, Qershor 2014), nga autori.

Shumica e ndërmarrjeve të huaja (4292 ndërmarrje në 2011, janë të Mikro me 1-9 të punësuar, rreth 93.3%, Kompani të Vogla me 10-49 punëtorë janë 4.63%, ndërmarrje të Mesme 50-249 punëtorë janë 1.07% të tyre ndërsa Kompani të mëdha me mbi 250 punëtorë janë 0.3%, kontributi i këtyrë të fundit është rreth 50% të investimeve (MTI, ASK, APIK, 2011).

Në Kosovë veprojnë kompani të huaja të sukseshme, veçanërisht bankat:

- Pro Credit Bank (PCB), Institucion Financiar Ndërkombëtar, me 55 filiala mbi 1200 punëtorë;
- Raiffeisen Bank Kosovo (RBKO), nga Austria, ka 52 filiala, dhe mbi 1000 punëtorë;
- NLB Prishtina sh.e, ka 50 filiala;
- Banka për Biznes (BpB), 57% kapital të huaj, ka 41 filiala;

- TEB sh.e, Banka Kombëtare Tregtare – Dega Kosovë, ka 26 filiala;
- Banka Komerciale (Komercijalna Banka), Dega Mitrovicë, ka 9 filiala;
- Turkiye Is Bankasi - Dega Prishtinë, ka vetëm 1 filialë;
- Xella International Group, pjese e Cooperation Haniel, investim Greenfield, Silikat;
- Wertheim, Kompani Austriake, Softwer të sofistikuar që zhvillohet nga Rrota;
- MC- mobile communication-Komunikimi GmbH, nga Frankfurti vepron në Prishtinë;
- Kolm Pfluger/Etlinger, nga Austria, prodhuese e llojeve të sallatave dhe perime të konservuara, vepron në Shtime me mbi 150 vende pune;
- Ipko net-Telekomi Slloven;
- Kamilla Chocolate,Aeroporti Ndërkombëtar Turko-Francez Limak-Aeroport de Lyon;
- Konsorciumi amerikan-turk Bechtel – Enka;
- Konsorciumi turk Limak-Çalik-KEDS;
- Shar-cem;
- KS – Sigal - Austria;
- INSIG-Shqipëri etj.

Firmat që veprojnë si ‘franchise’ ndërkombëtare, duke përfshirë Coca-Cola, RC Cola, FedEx, UPS, DHL, Deloitte, Booz Allen Hamilton, Price waterhouse, Hertz, shekullit 21, dhe Microsoft të pranishme në Kosovë (KIESA. 2014). Ka poashtu edhe shumë organizata mikrofinanciare të huaja që veprojnë në Kosovë (mbi 115). Kosova ka investitorë të


suksesshëm me kapital të përzier duke përfshirë edhe investimet nga diaspora (remitancat ne investime kapitale), siç janë:

- Ferronikeli pjesë e Kompanisë Shumëkombëshe Cunico N.V, investim në minierë që kontribuon në 50% të eksporteve të gjithmbarshme të Kosovës në Itali, Gjermani, Spanjë, Indi, Kinë dhe Kore, ka të punësuar mbi 1000 punëtorë;
- Kllokot, fabrika e ujit e cila ka arritur të investojë 4 milionë euro ku është prezent në Shqipëri, Maqedoni dhe Zvicër;
- Vreshtaria Stone Castle, në Rahovec është Fabrika e verërave ndër më të mëdhatë në rajon që eksportet e saj bëhen në Gjermani, Angli, Austri, Belgjikë, Zvicër etj.;
- Hotel Theranda në Prizren që është shembull i mirë i privatizimit;
- Tofta, kompani hoteliere por edhe prodhuese e peshkut ka bërë që rajoni i Burimit (Istogut), të jetë ndër vendet më turistike për të shijuar kënaqësinë e servimit të peshkut dhe freskisë së natyrës;
- M&Sillosi, prodhuesi miellit ndër më të mëdhenjtë në Kosovë është një storie e suksesshme e privatizimit;
- Birra Peja, si fabrikë me traditë gati 50 vjeçare, tani ka të punësuar mbi 612 punëtorë ku prodhohen mbi 900 mijë litra birrë të kualitetit më të mirë në rajon etj.

3.2.5 Shpërndarja e IHD sipas aktivitetit ekonomik dhe origjinës në Kosovë

Ne shqyrtojmë përhapjen e diferencuar të krijuar nga investimet e huaja direkte evropiane dhe jo evropiane, në sektorë të ekonomisë së Kosovës, dhe pyesim nëse përhapja ka qenë e

dobishme në nivel kombëtar apo mund të jetëe rënduar nga pabarazitë rajonale. Në mënyrë figurative, shprehet aktiviteti i kompanive të huaja në Kosovë.



Grafiku 11: IHD në Kosovë sipas aktivitetit ekonomikë në % (nga autori).

Shpërndarja e Investimeve të Huaja Direkte në sektorët gjatë periudhës 2000 deri 2014 janë në nivel kombëtar është: shërbimet bankare, transporti dhe telekomunikacioni, pasuria e patundshme, ndërtimtaria dhe minierat.

Numri i investitorëve është rritur dukshëm kur kemi parasysh se në vitin 2000- 2001 (sipas të dhënave nga ASK dhe raportit hulumtues të Riinvest (2002:15) janë regjistruar vetëm 318 biznese me pjesëmarrje të kapitalit të huaj. Ndërsa në vitin 2014 llogaritet të jenë rreth 5800 biznese të huaja, prej tyre mbi 2800 janë që funksionojnë, ndërsa të tjerat të pa aktivizuara apo në pritje për të filluar aktivitetin tyre. Pjesa e hyrjeve të kapitalit është rritur ndjeshëm që nga viti 2000-2014, që së bashku me remitancat konsiderohen kontribues të rritjes ekonomike në Kosovë. Po të krahasojmë formën e realizimit të IHD për vitin 2001 dhe 2002, janë tri forma kryesore (sipas raportit hulumtues të Riinvest 2002:16):

- Investime të përbashkëta (Joint venture), përfshirë edhe transferin teknologjik 53 %;
- Investime Huaja Direkte vetëm me investitorë të huaj, 39 % ;
- Investime në kanale distribuimi ë të tjera 8 % ;

Edhe pas pesëmbëdhjetë viteve ndryshimet e kësaj përbërjeje janë në favor të Investimeve të përbashkëta ose Joint Venture (ASK, qershor 2014). Ndërsa kur është fjala për shpërndarje strukturore të fluksit të kapitalit të IHD-ve në vitin 2001 (RIINVEST, 2002:16), sektori me marrje më të lartë të IHD-ve ishte sektori i shërbimeve me 63% të kapitalit i ndjekur nga industria, transporti, turizmi dhe bujqësia. Ndërsa për shumë vite dominoi sektori i shërbimeve, kohëve të fundit kemi një trend rritës të sektorëve të tjerë, në 2007 Transport dhe Telekomunikacion 29.3%, në 2008 shërbimet financiare me 34.9%, në 2009 shërbimet financiare me 25.5%, në 2010 ndërtimtaria me 24.9 %, në 2011 ndërtimtaria me 34.3 %, në 2012 patundshmëri me 31.7 %, viti 2013 përsëri doninojnë patudshmëria, shërbime dhe ndërtimtaria (KIESA, Profili ekonomik 2013).

3.2.5.1 IHD sipas origjinës në Kosovë

Në Kosovë rreth 90 vende kontribuan në IHD, ndër të gjitha, Gjermania (325.4 mil.euro) është vlerësuar me fluksin më të madhtë IHD, duke kontribuar 14% të investimeve totale në vend prej 2 miliard342 mil., euro (2007-2013). Pozicioni i tillë i Gjermanisë është për shkak të kostos së pagave të ulëta dhe kërkesës për shërbimet financiare bankare, sigurimeve dhe telekomunikacionit.

Rezultatet tona sugjerojnë se IHD me origjinë të BE-së luan një rol të veçantë në Kosovë, duke ndihmuar në rritjen e produktivitetit të brendshëm në mënyrë të konsiderueshme. Kjo ka rol të veçantë për Kosovën dhe konsiderojmë se është një përgjegjësi e politikave të BE-së të vazhdojë të promovojë integrimin ekonomik (dhe rrjedhën e IHD) të Kosovës brenda saj. Përsa i përket përqëndrimit gjeografik brenda territorit të Kosovës, vihet re që IHD-të janë përqëndruar kryesisht në Prishtinë me rrethinë, Ferizaj dhe Prizren, ku vetëm Prishtina ka 60 përqind të totalit të kompanive me kapital të huaj dhe të përbashkët.

Kur është fjala për origjinën e kapitalit nuk ka ndryshime të theksuara. Kryesisht në vitin 2001 investitorët ishin nga Turqia, Italia, Gjermania, Zvicra, Sllovenia, Austria, Norvegjia, SHBA, Irlanda, Maqedonia, Shqipëria, Bullgaria, (ASK. 2001), etj. Shtetet me hyrjet më të mëdha në Kosovë në vitin 2013 janë: Gjermania (325.4 milion euro), Britania e Madhe (279 mil. Euro), Sllovenia (201.5 mil. euro), Austria (124.9 mil. euro), Zvicra (129.5 mil. euro), Turqia (83.3 mil. Euro), Norvegjia (117.5 mil. Euro), Shqipëria (80.1 mil. Euro), Serbia ka një pjesëmarrje jo të rëndësishme (0.6 mil. Euro), Maqedonia (17.32 mil. Euro), SHBA (61.51 mil. euro) dhe vende tjera 42.2 milion euro.

3.3 Rrjedha globale e IHD sipas grupimit të ekonomive dhe efektet në vendet pritëse - Analizë krahasuese me Kosoven

Qëndrimet për IHD kanë evoluuar me kohë, në vitet e para të shekullit XX trajtoheshin rëndë IHD, ndërsa depresioni i madhë i vitit 1929 i dha fund kësaj. Megjithatë duke parë

zgjerrimin e shpejt të IHD kudo vendosen kufizime për IHD. Kriza e borgjit e vitet të 80^{ta} ishte njëri element që riorganizoj qëndrimin për IHD, ndërsa ndryshimi i natyrës së IHD e ndryshoj atë edhe më shumë.⁷⁹


Qeveritë e të gjitha vendeve heqën kufizimet dhe stimuluan ardhjen e tyre. Masa të tilla nxiten ardhjen e IHD duke u rritur në vitet e 90ta në 20% më shumë dhe 50% e tyre duke shkuar në sektorin e shërbimeve. Këto ndryshime sollën dominimin e sektorit të shërbimeve në vitet 2002-2010 rreth 60% - 70% të IHD globale (Raporti Botëror i Investimeve 2011) i përbën ky sektorë.

Ky trend është duke u zëvendësuar me sektorët⁸⁰ e prodhimit dhe përpunimit sidomos pas vitit 2011, në disa vende të botë si Brazil, Kinë etj. (WIIR. 2014). Ndërsa studime të shumta përpqen të gjejnë lidhjen pozitive në industrin e prodhimit dhe të përpunimit, megjithatë është natyra e secilit vend që përcakton rëndësin e secilit lloj të IHD-ve. Vështirësit e ekonomisë globale u pasqyruan edhe në rrjedhën e IHD-ve në ekonominë botërore. Rritja e IHD u favorizua pas rënjes së theksuar që pësuan vendet e zhvilluara.

Fluksi i ulët hyrës i IHD në vendet në tranzicion në vitet 1970ta, reflektohet ndjeshëm rritja e tij pas vitit viteve të 90ta, ndërsa hyrjet e IHD në vendet në zhvillim nga viti 2012 i kanë tejkaluar vendet e zhvilluara.

⁷⁹ Në vitete e pasluftës IHD u orientuar kryesisht në sektorin e industris nxjerrëse (konsideroheshin si shfrytëzuese të këtyre burimeve me perfitime të vogla për vendin pritëse) dhe të naftës, ndërsa pas viteve të 80^{ta} ato u përfshin edhe ne sektorë të tjerë, prodhim, shërbime , teknologji të lartë, etj.

⁸⁰ Edhe studimet përpqen të gjejnë lidhjen pozitive në industrin e prodhimit dhe të përpunimit, megjithat është natyra e secilit vend që përcakton rëndësin e secilit lloj të IHDve.



Grafiku 12: Fluksi hyrës i IHD në botë në çdo pesë vite (1970-2013). US \$ në milionë, bilion dhe trilion, WIR, '14, nga autori.


Nëse nisemi në retrospektivë prurjet globale të IHD (grafiku 12), nga vitet e 70-ta ishte 13 miliard US\$, ndërsa pesë vite më pasë (1975) IHD rriten rreth 99%. Ndërsa fluksi hyrës pëson një rënjë rapide në vitin 1980 në 24 miliard \$ duke u përmirësuar në 56 miliard \$ në vitin 1985. Dhjetë vjeqari i ardhëshëm (1985-1995) përsëri ka një stagnim, që karakterizohet nga një periudhë ku shumica e vendeve që tani janë në zhvillim ishin në fazën e kalimit nga ekonomi e izoluar, komuniste, në një ekonomi tregu.

Në viti 2000 arrinë fluksi hyrës i IHD⁸¹ globale në 1.41 trilion \$, me një ulje 41 % në 2001 dhe përsëri ulje 18% në 2003. Kjo rënjë ka vazhduar edhe në vitet 2004-2006. Bumi i hyrjeve të IHD të vitit 2007 me 2 trilion \$ dhe rritja ekonomike 2%, ende nuk është përsëritur, flukset e IHD në 2008 kanë rënë në 1.8 trilion \$, ndërsa në 2009 IHD kanë

⁸¹Hyrrjet për një regjion janë edhe dalje për regjionin tjetër ose vendin.


rënë në 1.2 trilion\$, duke u këndellur në vitin 2010 (1.42 trilion dollar), ndërsa vitet 2011 dhe 2014 nuk kanë pasë dallime të mëdha. Viti 2015 reflekton një trend në rritje të IHD-ve. Rrjedha globale e IHD në çdo pesë vite merr një pamje jo shumë optimiste në vitet e fundit.

Ndërsa hyrjet globale pas periudhës 1999 sipas grupimit të ekonomive (grafiku 13), në periudhë çdo pesë vite, tregon trendin në rritje të fluksit hyrës të IHD në vendet në zhvillim.



Grafik 13: Trendi global i IHD-ve sipas grupimit të ekonomive, çdo pesë vite (WDI, 2015), nga autori.

Jo vetëm gjatë viteve të krizës por dhe pas saj, të favorizuara janë vendet në zhvillim duke u rritur në mesatare prej 6 përqind, ndërsa ekonomitë e zhvilluara vetëm 2 përqind. Kjo është reflektuar edhe në rritjen e IHD-ve.



Grafiku 14: IHD neto në Ballkan, vitet 2005-2012 (Burimi: UNCTAD. 2013), nga autori.

Është e rëndësishme të thesohet se flukset hyrese të IHD në vendet e rajonit dhe ballkanit (grafik nr. 14), janë më të mëdha që nga viti 2005 deri në 2012: Vendet si Bullgaria mori mbi 4 miliard \$, Rumani mbi 6.5 miliard \$, Hungaria 5.4 miliard \$ (në vitin 2005). Në 2007 IHD shkojnë në Bullgar mbi 12 miliard \$ IHD, Rumani në 2008 mbi 13 miliard \$, Kroacia në 2008 mbi 4 miliard \$, Serbia në 2007 tërhoqi 2.7 miliard \$, ndërsa në vitin 2012 një ulje prej 2.5 miliard \$. Mbeten tërheqëse për një dekadë rresht pothuajse të njëjtat vendet. Shqipëria renditet e dyta në kuadër të EJT-së me 793 milion euro pas Serbisë.

Në eurozone shumica e vendeve kanë rritje të lehtë që si mesatare sillet prej -0.6 sa ishte në 2012 në -0.4 në 2013. Karakteristikë kryesore e vendeve të eurozonës është se të gjitha shtetet thelluan nivelin e borgjit publik. Mbetet përsëri ritmi më i lartë rritjes së GDP në vendet në zhvillim prej 4.5% në 2013. Ndërsa Evropa Qendrore dhe Lindore


(EQL), ka një rritje ekonomike solide në 2013 prej 2.3 përqind. Treguesit me solid janë në ekonomitë në zhvillim, ndërsa me pakë pozitivë janë treguesit ekonomik të Eurozones.

3.3.1 Një pasqyrë IHD-ve dhe faktorëve kushtëzues në EQ dhe EQL dhe Kosovë

Ndërsa në kemi përdorur variabla standarde që rekomandon Dunning's të tilla si rritja e GDP për frymë, madhësia e qeverisë, remitancat dhe investimet e brendshme. Ndërsa, Boreinsztein, et al. (1989), Yeaple (2003), rekomandojnë të përdoren “aftësitë” të përfaqësuara nga niveli i shkollimit sekondarë në vendet pritëse (si në rastin tonë). Ndërsa janë marre flukset hyrëse neto të IHD-ve të çdo viti si përqindje e GDP-se, nuk është marrë stoku i përgjithshëm i tyre.

Përveqë se janë testuar në kapitullin katër këto variabla, në vazhdim bëhet paraqitja e trendit të tyre. Tërheqja e IHD ka qenë një shtyllë kryesore e "zhvillimit" të Europës e cila me kohë kishte bërë reformat e saj politike dhe ekonomike. Në fillim të viteve 1980, investimet ishin zgjeruar shumë përveq Europës edhe në kontinente tjera, megjithatë zona europiane konsiderohet tërheqëse dhe e veçantë në preferencat e investitoreve nga mbarë bota dhe sidomos nga vendet aziatike.

Kjo preferencë është si rezultat i nivelit të lartë të zhvillimit të vendeve të zhvilluara (EQ) të cilat në politikat e tyre përfshijnë koncesione tatimore dhe privilegje të veçanta për investitorët e huaj.



Grafiku 15: Mesatarja⁸² e IHD ne 24 vende europiane për vitet 2004-2014, parqitja grafike nga autori.

Ndërsa vendet në zhvillim (EJL) pas viteve të 90ta me specifikat e tyre të veqanta (vende të dala nga një regjim komunistë, të dala nga lufta dhe vende të përfshira në njëprivatizim masiv) janë bërë tërheqëse për investitorë të huaj. Nëse shtojmë edhe periudhat e reformave të tyre, ku qeveritë e vendeve pritëse, zhvilluan legjislacion të ri për të përmirësuar kushtet për investime dhe mjedisin e biznesit për të tërhequr IHD. Grafiket (15) dhe (16) tregojnë flukset hyrëse të IHD-ve dhe GDP në 24 vende europiane, duke filluar nga Kosova me fluks hyrës të ulët, me një mesatare vjetore të hyrjeve të IHD prej 378. milion US\$, në 11 vite (2004-2014). Shqipëria mori çdo vite mesatarisht 876 milion US\$, Maqedonia 380 mil.US\$, Mali i Zi 748 milion, Kroacia 2.425 milion, Bosnja e Hercegovina 663 mijon, Serbia 2.361 milion, Sllovenia 726 miljondhe Bullgaria 4.744 milion euro.

⁸²Mesatarja: $[1/n \sum |x-x|]$

Ndërsa Rumania 6.316 milion, Hungaria 16.577miljon, Polonia 14.411miljon, Portugalia 8.210 milion, Republika Ceke 7.528 milion, Republika Sllovake 2.729 milion, Estonia 1.828miljon, Lituania 1.119 milion, Suedia 16.052miljon, Holanda 265.932 milion, Austria 19.196miljon, Gjermania 52.867 milion, Zvicra 20.436miljon, Norvegjia 3.422 milion dhe Italia 18.263 milion US\$.

Mesatarisht shtatë vendet e EJT-së,⁸³ çdo vitë kanë marrë së bashku 7.831 milion US\$, pra më pak se Portugalia si e vetme 8.210 milion US\$ dhe vende të tjera në zhvillim. Do të thotë se në mostren prej 24 vendeve ka dallime të mëdha sa i përket hyrjeve neto të IHD, më së shumti janë pozicionuar në vendet antare të BE-se, vende të zhvilluara dhe në zhvillim. Ndërsa në vitin 2014 një ecuri pozitive të hyrjeve të IHD kanë vendet: Italia, Zvicra, Holanda, Suedia, Estonia, Portugalia, Hungaria, Sllovenia, Bosnja e Hercegovina, Mali i zi, ndërsa vendet tjera ende vuajnë nga një trend rënës të IHD-ve. Ndërsa paraqitja në grafik nr. 47 në shtojca A, IHD si % e GDP ka një trajektore lineare drejtë rënjes nga viti 2010 deri 2014. Ndërsa vënja në marrëdhënje të IHD me GDP për frymë në grafik.nr.53 në shtojca A, tregon se egziston një marrëdhënje pozitive në mes IHD e varur dhe GDP për frymë e pavarur. Do të thotë se egziston një marrëdhënje pozitive një drejtimëshe në mes dy variablave, rritja ekonomike stimulon prurjet e IHD në vendet europiane, ndërsa IHD nuk ka efekte statistikishte të rëndësishëm në rritje edhe pse është me shenjë pozitive.


Produkti i Brendshem Bruto (PBB), kjo variabël është përdorur shpesh në teorinë e rritjes për të shqyrtuar ekzistencën e teorisë konvergjencës (Solow, 1956). Një shenjë negative e GDP-së në vitin parë (2003) mund të tregojë se ekonomitë në mostër kanë tendencë të

⁸³ Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Kroacia.

konvergojnë në të njëjtin nivel të të ardhurave me kushtë që të gjitha variablat tjerë janë të barabartë (konvergjencë e kushtëzuar grafik nr.55 shtojca A).

Është marrë GDP me çmimet e blerjes (shuma e vlerës së shtuar nga të gjithë prodhuesit rezident në një ekonomi, plus taksat mbi produktin dhe minus subvencionin që nuk janë përfshirë në vlerën e produktit). Pra grafiku nr.55 (shtojca A) tregon se ekziston një lidhje negative midis logaritmit të GDP fillestare dhe rritjes së GDP për frymë (GDPgpc) të vendeve pritëse.

Megjithatë, linja është nxitur kryesisht ulët nga disa vende në tranzicion të EJT-së në mesin e të cilave është edhe Kosova me rritje të GDP për frymë më të ulët në Europë ndërsa ka rritje ekonomike më të lartë në Europë (mesatare 4% për një dekadë) duke kontribuar në rritjen e mesatares europiane.



Grafiku 16: Vlersimi i performances së PBB-së në vitet 2003 dhe 2014 në 24 vende europiane, WDI vlersuar në US\$, kalkuluar nga autori.

Siç mund të shihet nga Grafik 16, një trend i ngjashëm me atë të IHD shfaqet në lëvizjene PBB-së. Dallohet Gjermania me një rritje më të lartë GDP-së në vitin 2014 krahasuar me 10 vite më parë, ndërsa trendë pozitivë të GDP kanë edhe vendet Holanda, Italia, Zvicra, Surdia, Polonia, dhe Rumani. Vendet tjera në mostër kanë një rritje të ulët të GDP-së vitit 2014 nëse e krahasojmë me vitin 2004. Do të thotë se kriza e 10 vjeçarit të shekullit XXI ka prekur më shume vendet në zhvillim se sa vendet e zhvilluar.

Rritja ekonomike, përfaqësuar nga rritja reale vjetore e GDP për frymë (GDP_{gpc})


PBB për frymë është shkalla vjetore e rritjes së Produkti i Brendshëm Bruto në raport me popullsin. Ritmet e rritjes së GDP për frymë, në 24 vendet janë të përcjellura nga ritmet e GDP reale. Prandaj, vendet me rritje të ulët të GDP për frymë gjatë periudhës 2004-2014 kanë detyrimisht GDP fillestare të ulët grafik nr.55 në shtojca A tregon një tendencë drejtë rënjes së GDP fillestare në raport me rritjen, vendet e varfëra konvergojne drejtë vendeve më të përparuara dhe anasjelltas.

Sipas statistikave të Bankës Botërore (grafiku 17),⁸⁴ në vitin 2014 mesatarja e rritjes vjetore e GDP për frymë (GDP_{gpc}) për vende në tranzicion është: Kosovë (2.22%), Shqipëri (2 %), Mali i Zi (1.42%), Maqedoni (3.62%), Bosnjë e Hercegovinë (1.40%), një GDP për frymë të ulët, por rritja mesatare është më e lartë se në vende e zhvilluara.

Edhe vendet në zhvillim: Sllovenia (2.63%), Bullgaria (2.51%), Rumania (2.13%), Polonia (3.41%), Hungaria (3.96%), Lituania (3.95%) dhe Estonia (2.42%) konsiderohen si vende që për një dekadë kanë një mesatare positive të rritjes vjetore të GDP-së. Ndërsa

⁸⁴<http://data.worldbank.org/data-catalog/world-development-indicators>

vendet që kanë një normë mesatare të ulët të rritjes së GDPsë për frymë në vitin 2013 janë: Norvegjia (1.10%), Zvicra (0,75%) , Austria (0.35%), Vendet tjera të zhvilluara europiane (Holanda, Gjermania, Suedia, Italia, Norvegjia, Austria dhe Zvicra) kanë arritur të dyfishojnë GDP fillestare 2003, në vitin 2010. Kriza globale dhe europiane penguan ritmin e deritashëm (2011-2014) të rritjes së GDP, pra GDPfillestare në vitin 2010 nuk dallon shumë nga e vitit 2014. Ndërsa vendet që kanë një trendë rënës të rritjes së GDPsë për frymë ne vitin 2014 janë, Serbia -1,34% dhe Italia -2.22%.




Grafiku 17: Mesatarja e rritjes së GDP për frymë për 11 vite, në 24 vende europiane, burimi WDI, 2015, llogaritjet e autorit.

Mund të konkludojmë se vendet e zhvilluara edhe pse kanë një GDP për frymë më të lartë, kanë një rritje ekonomike më të ulët dhe shpesh negative në periudhën e studimit (2004-2014), siq e parashikojnë edhe rezultatet ekonometrike të studimit tonë, ekonomitë në

zhvillim konvergojne drejtë ekonomive të zhvilluara. Paraqitja përmes stata 12, regresioni linearë në grafik nr. 45, shkalla e rritjes se GDP për frymë për 11 vite ka një trajektore në rënje e ndikuar nga vendet e zhvilluara.

Në vazhdim, Grafiku (18) dhe (19) paraqesin Investimet e brendshme dhe Remitancat, si përqindje e GDP-së. Investimet e brendshme shfaqin një prirje rritëse të ngjashme me shumicen e vendeve duke mos e tejkaluar vleren relative prej 25 përqind të GDP. Eshte nje sinjal se baza ekonomike e vendeve në moster është nga investimet e brendshme dhe vendet në zhvillim duhet të bëjnë më shumë në përmirësimin e ambientit të biznesit.

Edhe në grafikun nr.46 shtojca A, regresioni linearë tregon një tendence në rënje të investimeve të brendshme por kanë një marrëdhënje pozitive me rritjen e GDP për frymë.




Grafik 18: INV. Brendshem (GCFC) si përqindje e GDP-së për 24 vende europiane në US\$, nga Autori.

Në rrjedhën më të lartë të Investimet të brendshme (përfaqësuar nga GCFC) që tejkalon 25 përqind gjatë viteve 2004-2014 janë tre vende, Estonia, Shqipëria dhe Republika Çeke.


Remitancat –paraqitja figurative e remitancave grafik nr. 19 dhe grafik nr.50 në shtojca A, na jepë të kuptojmë se fluksi i tyre dallon shumë nga një vend në tjetrin. Fluksin mesatarë vjetor si përqindje e GDPsë në grafik nr.19, tregon se fuks më të lartë ka Bullgaria, për dallim nga 23 vende tjera. Asaj i afrohet (një të tretën më pak) Hungaria, përfituese e radhes është Kosova, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia. Këto vende kanë një diasporë të gjërë prandaj janë përfitueset më të mëdha të remitancave për vitet 2004-2014, trendi i tyre është në ulje edhe në këto vende. Remitancat nuk konsiderohen burim i qëndrueshëm i të ardhurave dhe rritjes ekonomike edhe pse në disa vende i kanë tejkaluar disa herë flukset e IHD-ve (Kosova në 2014/840 mil€ në 2015/752.4 mil.€ hyrje remitanca).

Remitanca të ulta kanë vendet e zhvilluara Suedia, Holanda, Autria, Gjermani, Zvicra, Norvegjia dhe Italia dhe Sllovenia. Kurse vendet tjera në zhvillim të Europës Lindore kanë një trend në rënje të vazhdueshme të remitancave. Ndërsa grafik 50 në shtojca A, tregon se trendi është lineare dhe një ulje të pa përfillshme edhe për një kohë të shkurtër. Do të thotë se trendi rrites mund të fillojë të bjerë.



Grafiku 19: Remitancat, mesatarja vjetore për vitet 2004 -2014. Nga autori.

Madhësia e qeverisë, gjetjet kryesore statistikore të shpenzimeve të përgjithshme të qeverisë për vendet Europiane -arrijnë në 48.2 % i GDP-se, me një ulje me 0.04 nga viti 2013.Studimet ekzistuese mbi ndikimin e shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike ende japin rezultate të paqarta.



Grafiku 20: Mesatarja e Shpenzimeve të Përgjithshme të Konsumit Final të Qeverisë US\$, nga autori.

Argumentet pozitive janë të vlefshme sepse janë krijuar të mira publike më të mëdha, si arsimi, infrastruktura, etj., duke krijuar një mjedis të favorshëm ekonomik për investime private. Në bazë të të dhënave të fundit të shpenzimeve në dispozicion sipas funksionit ekonomik për vitin 2014, më shumë se gjysma është përkushtuar për mbrojtje sociale (19.5%) respektivisht 7.2%. PBB-së, shërbimeve të përgjithshme publike (6.7% e PBB-së), edukim (4.9% e PBB-së) dhe çështjet ekonomike vetëm 4.2% e PBB-së. Ndërsa nivelet më të ulta janë gjetur në Lituani (34.8% të GDP-se), Rumani (34.9%) dhe Zvicra 33.7% të GDP-së. Ndërsa shpenzimet e mbrojtjes sociale, kanë arritur në një pikë të ulët në vitin 2008 (27.8% të shpenzimeve totale), që ishte kulmi e krizes financiarë dhe ekonomike.

Ndërsa sipas matjes së mesatares vjetore për 11 vite (2004-2014), vendet që kanë mesatare më të lartë të shpenzimeve qeveritare (WDI, 2015), janë, Suedia, Holanda dhe Mali i Zi. Nëse shikojmë shpenzimet qeveritare si mesatare vjetore në grafik 20, shihet se shpenzimet më të mëdha kanë vendet e zhvilluara siç është Holanda të ndjekura nga vendet si Sllovakia, Kroacia, Serbia, Kosova ndërsa më të ultat janë në Bullgari dhe Maqedoni. Edhe parqartja në grafik të shpërndarë nr. 51, në shtojca A, tregon një tendencë drejt rritjes por në % jo të lartë.

Kapitali Human - Variabël me rëndësi në përcaktimin e rritjes ekonomike dhe të IHD-ve është absolutisht kapitali human. Për shumicën e njerëzve kapital do të thotë, llogari bankare, uzina, linja të aksioneve, etj.

Forma të tilla të prekshme të kapitalit nuk janë lloji i vetëm i kapitalit, janë edhe shkollimi, një kurs trajnimi, shpenzimet e kujdesit mjekësor apo mesimi, dhe janë quajtur

kapitali human sepse njeriu nuk mund të ndahet nga to, dhe konsiderohen forma me e rëndësishme kapitalit njerëzorë. Shumë studime kanë dëshmuar se shkollimi i mesëm dhe i lartë në masë të madhe ka rritur të ardhurat e një personi. Rritja e vazhdueshme e të ardhurave për frymë është pjesërisht për shkak të zgjerimit të njohurive shkencore dhe teknike. Bota sotë i quan “tigrat aziatik”, sepse u rriten me shpejtesi duke u mbështetur në një, forcë punëtore të arsimuar, të trajnuar që në mënyrë të shkelqyer përdore teknologjinë moderne. Paraqitja e kapitalit human në stata 12, tregon se në te gjitha vendet regjistrimi në nivelin e mesëm të shkollimit ka tendencë drejtë renjës.


Ndërsa praqitja e kapitalit human në ndërveprim me IHD në grafik nr. 54 ne shtojca A, ka një marrëdhënje pozitive pra IHD dhe kapitali human preferojnë njëra tjetren. Ndërsa matja e marrëdhënjes se kapitalit human me rritjen e GDP për frymë ne grafik nr.52, shtojca A, tregon se nuk ka ndonjë efekte të rëndësishëm në rritje, nevojiten investime në stimulimin dhe rritjen e cilësis se kapitalit human sidomos në vendet në zhvillim.

3.3.2 Analizë krahasuese IHD në vendet EQ, EJT dhe Kosovës

Europa në vitin 2014 ka përfituar nga kthimikompanive më të rëndësishme globale. Njëmbëdhjetë vende evropiane janë në mesin e 25 vendeve me tërheqje në arenen globale. Katër ekonomitë më të mëdha të Bashkimit Evropian Britania e Madhe (4), Gjermania (6), Francë (10), dhe Itali (20) kanë fituar këto pozicione në vitin 2013, ndërsa Spanja renditet e 18ta⁸⁵. Përveç kësaj, shumë ekonomi të vogla të Europës Perëndimore dhe Veriore kanë

⁸⁵ <http://www.atkearney.com/research-studies/foreign-direct-investment-confidence-index/full-report>

dalë në sipërfaqe duke u kapur nga radaret e investitorëve⁸⁶: Zvicra (14), Suedia (16), Belgjika (21), Holandë (22), dhe Danimarka (23) të gjithë hyjnë në 25 vendet me tërheqëse në Europë. Ndërsa japin një vështrim të pëgjithshëm të vendeve më tërheqëse në Europë, ne ndalemi në vendet që janë pjesë e analizës krahasuese me Kosoven dhe pjese e mostrës kërkimore dhe teknikave ekonometrike.




Grafik 21: Performanca e IHD ne vendet EJT7 (IHD në vitin 2004 dhe 2014), në US\$, nga autori.

Duke paraqitur në vazhdim performancën e IHD në vendet e EJT₇, vijme në një konkluzion s'egjatë një dekade (2004-2014) ka pasur levizje të mëdha ciklike e hyrjeve të IHD në Shqipëri, Kroaci dhe Serbi, ndërsa levizje të tilla nuk shihen në vendet tjera. Në vitin 2004 fluksin më të madhë të IHD e kanë marrë Kroacia dhe Serbia, ndërsa fluksin më të ulët të IHD Kosova, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

⁸⁶ The 2014 A.T. Kearney Foreign Direct Investment Confidence Index®

Dallohet me hyrjet mesatare më të mëdha të IHD në vitin 2013, Serbia dhe Shqipëria. Ndërsa vendi që ka tërhequr IHD më së paku IHD në vitin 2013 konsiderohet Bosnja e Hercegovina. Vendet si Bosnja dhe Kroacia kanë marrë në vitin 2013 fluksin më të ulët hyrës IHD në vitin 2013 në krahasim me flksin që morën vitin 2004.

Ndërsa në vazhdim shohim fluksin mesatar hyrës të IHD për vitet 2004-2013, një analizë tredit të tyre për 24 vende europiane.




Grafik 22: Hyrjet neto të IHD në Kosovë dhe Shqipëri, 2004-2014, WDI, US\$(nga autori).

Kosova renditet e fundit sa i përket prurjeve të IHD në rajon, gjithashtu karakterizohet me një trend ulje dhe ngritje të IHD duke u kosideruar viti 2007 si viti që më së shumti ka marrë IHD, ndërsa më së paku ka marrë në vitin 2005. Trend rritës të IHD kemi edhe në vitin 2011 dhe 2013 ndërsa ulen ndjeshem hyrjet e IHD në vitin 2014. Mesatarisht Kosova ka marrëçdo vitë IHD në vlerë prej 378. MiljonUS\$ për 11 vite rreshtë.

Ndërsa Shqipëria, fluksin më të lartë të hyrjeve neto të IHD ka marrë në vitin 2009 ndërsa më të ultin në vitin 2005. Trendi i IHD në Shqipëri ishte në rritje të vazhdueshme deri në vitin 2009, më pastaj vazhdoi një trend rënës deri në 2012 por jo më ulët se mbi


800 milion US \$. Ndërsa viti 2013 ka rritje të IHD duke u ulur në vitin 2014. Shqipëria për 11 vite mesatarishtë mori 876 milion US\$.



Grafik 23: Hyrjet neto të IHD në Maqedoni dhe Mal i Zi 2004-2014, WDI, US\$ (nga autori).

Maqedonia ka marrë më shumti IHD në vitin 2007, ky trend ka vazhduar me ulje ngritje deri në vitin 2013, ndërsa hyrjet me të ultat për 11 vite konsiderohet se janë marrë në vitin 2014. Maqedonia mesatishte mori 380 milion US\$.


Ndërsa Mali i Zi ka pasë një trend pozitiv të IHD që nga viti 2004 duke arritur kulminacionin në vitin 2009, ndërsa trendi fillon të bjerë me shpejtësi deri në vitin 2013 duke u stabilizuar me një rritje të ulët në vitin 2014. Nga të gjitha vendet e EJT₇ Mali i Zi mori më shumë IHD në raport me popullsinë dhe si një vend i vogël. Mesatarisht për 11 vite ka marrë mbi 748 milion US\$ pra më pak se Shqipëria (876 milion US\$), por më shumë se Maqedonia apo Kosova.



Grafik 24: Hyrjet neto të IHD në Kroaci dhe Bosnjë Hercegovina, 2004-2014, WDI

Kroacia ka një trajektore pozitive të IHD deri në vitin 2008, me pastaj në vitet në vazhdim trendi ulet shumë sidomos në vitin 2010. Në vitin 2011 ka një rritje më të madhe të IHD se një vite me parë duke vazhduar edhe në vitin 2012 ndërsa ky trend rritës pëson një ulje të madhe në vitin 2013 dhe 2014. Mesatarisht për vitet 2004 deri 2014 ka marrë IHD në vlerë 2.425 milionUS\$, më shumë se Serbia ndërsa me pak se Bullgaria dhe Rumania.


Edhe Bosnja e Hercegovina konsiderohen me hyrje të IHD ngjashëm me vendet tjera në tranzicion, ndërsa ka prurje më pak se Shqipëria. Rritja më e lartë ka ndodhur në vitin 2007 një trend tillë ka përfshire tërë globin. Pas vitit 2007 trendi bie në mënyre enorme ku arrin pikën më të ulët në vitin 2009. Fillon një këndellje në dy vitet në vazhdim, megjithatë edhe viti 2012 dhe 2013 është më i ulët se në dy vitet paraprake. Në vitin 2014 fluksi hyrës i IHD ka një rritje të barabartë me vitin 2005, disa herë më shumë se vitin 2009 viti që më së paku ka marrë IHD për 11 vite. Mesatarisht për 11 vite marrjet janë mbi 663 mijonUS\$, me pak se Shqipëris dhe Mali i zi.



Grafik 25: Hyrjet neto të IHD në Serbi dhe Slloveni, 2004-2014, WDI (nga autori).

Hyrjet e IHD në Serbi karakterizohen me trendin më të lartë në vitin 2006 në krahasim me vende tjera që në vitin 2007 morrën më së shumti IHD. Nga viti 2007 deri në vitin 2010 ka një rënje në mbi një million US\$ nga sa mbi 5 miliard US\$ në 2007. Ndërsa lëkundjet më të mëdha janë në mes viteve 2011 dhe 2013, ndërsa rënje më të madhe për 11 vite Serbia ka në vitin 2014. Mesatarja e prurjeve të IHD në Serbi konsiderohet të jetë 2.361 milion US\$, më e lartë se në Slloveni ndërsa më e ulët se në Kroaci, është shumë më përpara se Kosova, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi apo Shqipëria.

Ndërsa në Slloveni është një trend krejt tjetër duke u nisur nga viti 2004 një fluks hyrës jo i lartë dhe vazhdojnë hyrjet e IHD të rriten në vitin 2007 në 2011 dhe se fundi në 2014 merr më së shumti IHD duke ju ofruar fluksit të viti 2007 pra është një kthim i fuqishëm i IHD që nuk ka ndodhur në ndonjë nga vendet e ish Jugosllavisë. Mesatarisht për 11 vite Sllovenia ka marrë vetëm 726 milion US\$.




Grafik 26: Hyrjet neto të IHD në Bullgari dhe Rumani, 2004-2014, WDI (nga autori).

Bullgaria konsiderohet një vend me fluks më të madhë të IHD në vitin 2007 dhe më pastaj ka trend ulës të vazhdueshëm deri në vitin 2014. Mesatarisht Bullgaria merrë 4.744 milionUS\$ pra më pak se Rumania.

Ndërsa Rumania merrë IHD në vitin 2008 aq sa ka marrë Bullgaria në vitin 2007. Mirëpo trendi në Rumani në vitet 2004 deri 2008 ka ulje dhe ngritje të hyrjeve të IHD ndërsa në Bullgari trendi ishte vazhdimisht në rritje. Rumania në vitin 2009 njësoj si Bullgaria ka trend rënës të IHD deri në vitin 2013. Ndërsa fillon rritja e fluksit neto të IHD në vitin 2014 në krahasim me Bullgarin ku nuk ka rritje të IHD në këtë vitë në krahasim me vitin paraprak. Mesatarisht për 11 vite ka marrë 6.316 milionUS\$.


Hungaria është ndër vendet që në vitet 2004 -2014 ka marre mesatarisht 16.577miljon US\$, pra më shumë IHD se vendet e EJT7 dhe sidomos Bullgaris dhe Rumanisë. Viti 2008 konsiderohet viti më i sukseshëm i hyrjeve të IHD por vitet ne vazhdim trendi pëson rënje dhe ngritje, së fundi viti 2014 ka trend hyrës pozitiv.



Grafik 27: Hyrjet neto të IHD në Hungari dhe Poloni, 2004-2014, WDI (nga autori).


Hungaria konsiderohet ndër vendet europiane në zhvillim që ka fluks hyrës të IHD më të madhë gjatë viteve 2004 deri 2014, pikun më të lartë të hyrjes neto të IHD e ka arritur në vitet 2007 dhe 2008. Po të bëjmë krahasimin të mesatares, Hungaria ka marrë 16.577 mil.,US\$, radhitet në vendin e 6 pas 5 vendeve, Holandës, Austris, Gjermanisë, Zvicrës dhe Italisë ndërsa qëndron më mirë se 18 vendet që janë përfshirë në studimin tonë (24 vende europiane).

Ndërsa Polonia mesatarisht ka marrë 14.411miljon US\$ për 11 vite. Qëndron më mirë se 17 vende në moster pos pas Hungarisë dhe 5 vendeve më të zhvilluara. Dinamika e hyrjeve të IHD ka lëkundje të mëdha sidomos mes viteve 2004-2007 dhe 2010-2014. Portugalia ka hyrje të IHD më të ulta se vendet që janë anëtare të BE-së, qëndron larg flukseve hyrese të IHD të Polonisë me vetem 8.210 milion US\$ hyrje mesatare çdo vitë. Ndërsa nëse shiqojmë fluksin real të hyrjeve, viti që më së shumti tërhoqi IHD është viti 2006 dhe 2012, është pozitive se viti 2014 e tutje ka trend rrites në krahasin me shumicën e vendeve që kjo nuk është duke ndodhur.




Grafik 28: Hyrjet neto të IHD në Portugali dhe ReblublikenÇeke, 2004-2014,

Republika Çeke, karakterizohet me hyrje neto të IHD me oscilime poshtë -lartë që janë simetrike uljet dhe poashtu edhe rritjen, afërsisht në vlera US\$ të njëjta, karakteristikë që nuk është në vend tjera. Si performancë mund të afrohet me vendet si Rumania dhe Bullgari, prandaj mesatarisht çdo vite hyrjet e IHD janë 8.210 milion US\$. Nëse krahasohet me Portugalin në vitet e fundit ka trend negativ të hyrjeve neto të IHD-ve.



Grafik 29: Hyrjet neto të IHD në Reblubliken Sllovake dhe Estoni2004-2014, WDI (nga autori).


Republika Sllovake, mori mesatarisht për cdo vitë nga 2.729 milion US\$ dhe renditet me marrje më të mëdha EKL-7, Estonisë dhe Lituanisë ndërsa krahasuar me disa vende në zhvillim të Evropës lindore është shumë prapa tyre. Më së shumti hyrje të IHD ka marrë në vitet 2006 deri 2008 dhe 2011, ndërsa më së paku në vitet 2009, 2012 dhe 2014. Pra çdo 3 vite ka levizje pozitive ose negative dhe se fundi 2014 konsiderohet ka filluar cikli negativ i radhës në përputhje me trendet botrore të terheqjeve të IHD të ndikuara nga krizat e fundit. Ndërsa, Estonia ka trend rënës të IHD nga viti 2008 deri në vitin 2013 kurse viti 2014 merrë më shumë IHD se viti praparak. Edhe në Estoni kulminacioni i IHD është arritur në vitin 2007. Mesatarisht çdo vitë ka marrë nga 1.828milion US\$.



Grafik 30: Hyrjet neto të IHD në Lituani dhe Suedi, 2004-2014, WDI (nga autori).

Lituanisë mesatarisht ka marrë cdo vitë nga 1.119 milion US\$, duke u karakterizuar me ulje ngritje me cikle 5 vjeqare, trendi ulës i vitit 2004 përmiresohet duke arritur piku më i lartë i prurjeve të IHD në 2007, përsëri ka rënje më e ulta në 2009. Në vazhdim fillon cikli i dytë 5 vjeqare rritës 2010 deri 2013 me ulje – ngritje jo të dallueshme dhe viti 2014 me trend rënës. Lituania nuk renditet në vendet, që janë tërheqëse për investitorët e huaj në 11 vitet e fundit ashtu si edhe Kosova, Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina.

Ndërsa Suedia mesatarisht cdo vitë ka marrë nga 16.052 milion US\$. Nga viti 2004 deri 2009 ka pasë një trend hyres të IHD pozitiv edhe përkundër krizes së eurozones dhe krizave tjera globale. Kjo performancë pozitive vazhdoi të bjerë me ritme të larta në vitet 2010 deri 2013 ndërsa viti 2014 bëhet tërheqëse për investitorë të huaj sikurse Holanda dhe Zvicra, me trendin në rritje të IHD në 2014.




Grafik 31: Hyrjet neto të IHD në Holandë dhe Austri, 2004-2014, WDI (nga autori).

Holanda sipas statistikave të Bankës Botrore (2015), ka marrjet më të mëdha të IHD në krahasim me vendet në moster. Mesatarishte hyrjet neto vjetore të IHD janë 265.932 mi.\$.


Austria mesatarisht mori çdo vitë nga 19.196 milion IHD, apo 3 miliard më shumë se Suedia dhe me pak se Holanda, Zvicra dhe Gjermania. Më së shumti mori IHD në vitin 2004 dhe 2007 ndërsa më së paku në vitin 2010. Pas këtij viti, trendi i fluksit hyrës të IHD është në rritje.

Gjermania hyn në kuadër të 6 vendeve më tërheqëse në Europë dhe në listen e 25 vendeve më tërheqëse në botë. Mesatarishte mori çdo vitë mbi 52.867 milion US\$, më së shumti në vitin 2006 dhe 2012 dhe tre here më shumë se Italia por shumë më pak se Holanda.



Grafik 32: Hyrjet neto të IHD në Gjermani 2004-2014, WDI (nga autori).

Ndërsa, Zvicrra meqenëse nuk përdorë valuten euro ka transmetuar më pak krizen e zonës euro. Edhe përkunder levizjeve negative në shumicën e vendeve europiane ajo ka një trend rritës të IHD të lartë në vitin 2014, ka marrë mesatarisht çdo vite 20.436 milion US\$.



Grafik 33: Hyrjet neto të IHD në Norvegji 2004-2014, WDI (nga autori).

Norvegjia mesatarishte çdo vite mori nga 3.422 milion US\$ apo 1 miliard më shumë se Kroacia dhe katër herë me pak se Suedia. Së fundi Italia, ka pësuar goditje të forta nga kriza globale dhe kriza në Greqi, ndërsa në arenën ndërkombëtare Italia është ndër 4 vendet europiane që pëlqehen më së shumti nga investitorët e huaj jashtë Europës.

KAPITULLI IV: Metodologjia e Studimit

4.1 Metodologjia e të dhënave parësore

Të dhënat parësore janë mbledhur nga pyetsorë të strukturuar, direkte dhe me email. Një mundësi e mirë e kontaktit me telefon dhe email, ka shpejtuar kohën e mbledhjes së të dhënave në periudhë tre mujore (26 shtator deri 26 dhjetor 2014). Janë përfshirë kompani që kanë vepruar nga viti 2000 deri 2014, kompani që kanë shuar veprimtarinë e tyre nëpër vite me qëllim të njohjes më reale të pengesave që hasën gjatë punës së tyre). Janë 500 kompani të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme prej të cilave 306 prej tyre kanë pranuar të bëhen pjesë e këtij hulumtimi, ndërsa 194 kompani refuzojnë të jenë pjesë e tij me arsyetimin se është kohë fundviti e papërshtatshme. Ndërsa përfshirja territoriale ishte e qëllimshme (është përfshirë tërë territori i Kosovës).

Kompanitë e anketuara kriter kishin të plotësonin në tërësi pyetësin (Anketat ishin konfidenciale). Refuzuan të përgjigjen më së shumti kompani të huaja nga qytetet, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj, Podujeva dhe Lipjani. Ndërsa nuk kanë hezitur të përgjigjen sidomos kompanitë e huaja që veprojnë në Prishtinë dhe rrethinë.

Është përdorur pyetsori ballë për ballë për 200 kompani, ndërsa 106 pyetsorë janë kryer me email. Prandaj, ekzemplarët përfshijnë gjithsej 306 të anketuar (zhvilluar bashkërisht dhe të vetëadministruar), me saktësi prej 95.5% në gjithsej kampionin prej 1369 Kompani me 100% të kapitalit të Huaj në Kosovë.

Përmes pyetësorëve të strukturuar janë anketuar investitorët e huaj që kanë investuar në Kosovë). Pyetsori është i formuluar⁸⁷ pëmes alternativave.

Fokus grupi – popullata dhe kampionimi

Fokus grupi (të dhënat parësore), janë përzgjedhur investitorët huaj që kanë vepruar apo veprojnë në Kosovë. Peshimi i mostrës së grupit të parë bëhet në bazë të pjesëmarrjes së përafshuar të këtyre grupeve në popullsinë e mostrës, ndërsa përzgjedhja e të anketuarve bëhet sipas metodologjisë së rastësisë në regjistrin e popullatës. Kampionimin e studimit e përbëjnë investitorët e huaj me 100% kapital të huaj. Kampionimi është kampion rastësor, përfaqësues i të gjithë popullatës.

Pyetësorët iu dërguan 306 investitorëve me kapital 100% të huaj duke selektuar në mënyrë të rastësishme kompani në gjithë Kosovën (në dhjetë sektorët kryesorë), përmes adresës elektronike, me telefon dhe ballë për ballë. Kampioni i studimit është rastësor, kampion përfaqësues i të gjithë popullatës së investitorëve të huaj (me 100 % kapital të huaj).

Popullata në këtë studim është 1369 investitorë të huaj, mjaftueshëm për të anketuar 306 investitorë të huaj (Tabela 25, Shtojca B). Llogaritja e madhësisë së kampionit e bazuar në konsideratat e mëposhtme, dhe për një kampion të rastësishëm të thjeshtë u supozua sa vijon:

- Niveli i besimit 95 %;
- Niveli i mosbesimit 5 %;

⁸⁷Pyetësorët e strukturuar janë marrë nga faqja e internetit të cilën e ka përdorur autorja Dervisholli S., (2011:72-78) në mikrotezën e saj. meqenëse është konsideruar i përshtatshëm në vërtetimin e hipotezës se trete dhe pyetjes së tretë të kërkimit. <http://scholarworks.rit.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=8039>

- Shprehja e saktë e pikëpamjeve të investitorëve të huaj, të pritshme janë 80 përqind.

Nga madhësia e popullatës përfitua kampioni i studimit (numri total i investitorëve të me 100% kapital të huaj (n=1369), në të gjitha regjionet e Kosovës të përfshira në këtë studim. Përfitohet një kampion prej N=306, (The Research Advisors (2006), e mjaftueshme edhe përkundër refuzimit të 194 kompanive (nga kampioni i planifikuar prej 500 investitorëve). Niveli i përgjigjjeve të vlefshme (response rate) 95%, mungojnë nënpërgjigje në disa pyetje të cilat nuk e prishin saktësinë dhe rëndësinë e anketimit.

Anketat (ekzemplari i hulumtimit) është përdorur për periudhë kohore 2000-2014 dhe kampionim të investitorëve me 100 përqind kapital të huaj, nuk janë marrë investitorët me kapital të përzier.

Përmbajtja e pyetsorëve

Pyetësi siç tregohet në Shtojcën B, është i ndarë në 3 seksione. Pjesa e parë: informacioni ka përfshirë udhëzime të anketuarve për qëllimin e përdorimit të pyetsorit dhe udhëzimeve si të plotësohen pyetsorët dhënë i ndarë nga pyetësi. Në rastin e pyetjeve me zgjedhje është udhëzuar të vëhet në kuti shënimi saktë dhe në disa raste përgjigjet në këtë seksion janë dhënë me shkallë 1 ose 10. Emrat e kompanive janë mbajtur konfidencialë, bazur në dëshirën e të anketuarve dhe etikës shkencore.

- ✚ *Pjesa e dytë (Shtojca B), përfshin pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e elementeve kryesore të veprimtarisë së kompanive dhe pengesave që kanë hasur gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Aneksi përbëhet nga 12 module me temat përkatëse:*

- Lloji kryesor i biznesit; viti i themelimit; selia e vendndodhjes; numri i të punësuarve; vitet e të bërit biznes në Kosovë; qarkullimi i realizuar në vite; cila është madhësia e investimit që kanë bërë, renditja e ambientit të biznesit; çfarë i ka tërhequr për të investuar; vështirësitë sipas prioritetëve; veprimet më të rëndësishme të qeverisë; komente shtesë.

✚ *Pjesa e tretë e Anketës (Shtojca B)*, përfshin mundësitë dhe planet e kompanive të huaja për të investuar në Kosovë. Aneksi përbëhet nga 12 module me temat përkatëse:

A planifikoni në të ardhmen të investoni në Kosovë?; Sa tërheqëse e konsideroni Kosovën për të investuar?; Si e vlerësoni nivelin dhe cilësinë e informacionit në mjedisin e biznesit?; Si jeni informuar për Kosovën?; Cila është zona juaj me interes për të investuar?; Çfarë ju tërheq më së shumti në Kosovë?; A është kjo herë parë që ju keni investuar në Kosovë?; A do të riinvestoni përsëri, a keni një datë të caktuar për një investim shtesë?; Cilat janë arsyet që ju hezitoni të investoni?; Çfarë stimuluj të veçantë do t'ju pëlqenin nga Qeveria e Kosovës ?; Metoda e përdorur është anketimi, të dhënat janë përpunuar dhe analizuar më tej me anë të metodave statistikore përshkruese përmes grafikëve të ndryshëm. Hipoteza e tretë pra vërtetohet përmes pyetësorëve të strukturuar me qëllim të paraqitjes sa më reale të opinionit të investitorëve të huaj për mjedisin ekonomik dhe institucional në Kosovë.

4.2 Metodologjia e të dhënave dytësore

Pasi që studimi trajton problematikën e IHD-ve dhe të rritjes, për identifikimin e objektivave është krijuar një strategji kërkimi që ka mundësuar të përdoret metodologji e veçantë për secilën hipotezë të studimit. Meqenëse fenomeni IHD ka krijuar një literaturë të gjerë teorike dhe empirike ka qenë një prioritet gjetja e literaturës më meritore dhe të kohës së fundit që ka trajtuar lidhjen dhe ndikim e IHD dhe përcaktuesve të tjerë në rritjen ekonomike. Duke pasur si objektiv IHD dhe rolin e tyre në rritjen ekonomike atëherë edhe literatura përfshin dy segmente, modelet e rritjes dhe rritja e produktivitetit nga përdorimi i teknologjisë dhe njohurive të cilat vijnë përmes IHD-ve.

Qasja e trajtimit të këtyre dy segmenteve është bërë në nivel makro dhe mikro, prandaj për një trajtim më të mirë të këtij fenomeni është filluar së pari me analizë në nivel mikro duke vazhduar në nivel makro. Mirëpo të dy nivelet janë trajtuar në pjesën e literaturës meqenëse qasja mikroekonomike nuk mund të studiojë fenomenin IHD-neto pa u atakuar me faktorë makro dhe as qasja makroekonomike nuk mund të studiohet pa atakuar sjellje dhe agjentë të ndryshëm ekonomik.

Të dhënat e përdorura për modelimin ekonometrik janë të dhëna dytësore dhe janë marrë nga baza e të dhënave të Bankës Botërore, Teguesit e Zhvillimit Botëror (WDI). Të gjitha ndryshoret e përdorura janë të bazuara në të dhënat vjetore nga viti 2004 deri në vitin 2014, nga 24 vendet e rajonit. Informacioni për shumicën e treguesve makro është marrë nga WDI, ndërsa informacioni për kapitalin human është marrë nga shumë burime si nga ASK, INSTAT, WDI, Barro dhe Lee, etj.

Analiza empirike e të dhënave dytësore është fokusuar në dimensionin makroekonomik dhe mikroekonomik për të gjetur se çfarë efekti kanë IHD në rritjen

ekonomike, në investimet e brendshme në transferin e teknologjisë dhe faktorin më të rëndësishëm kapitali human (matja e nivelit të aftësive dhe njohurive të tyre).

Jemi përcaktuar në modelin empirik të katrore të vegjël të përgjithësuar (GLS) metodën e Efekteve fikse dhe Efekteve Rastësore⁸⁸, sepse këto metodë përdoret shumë në studime empirike me panel të dhënash dinamike dhe është efektive edhe kur në ekuacion ndërthuren variabla egzogjene dhe endogjene njëkohësisht.

Për shpjegimin empirik të problematikës janë përdorur këto instrumente hulumtuese. Studimi përdor një panel të dhënash në të cilat vendet janë njësi të vëzhgimit. Mjetet e regresionit të shumëfishtë dhe linear dhe të korelacionit të përdorura në procesin e vlerësimit janë ato të dizajnuara në mënyrë specifike për panelin e të dhënave, të tilla si metoda e Përgjithshme e Katrorëve të Vegjël (GLS) kombimuar me testet e Efekteve Fikse (FE) dhe Efekteve të Rastit (RE), testin e Hausman (Rho), testin Wald, testin parimiwise të shkakësis Granger, etj.

-Për të vërtetuar hipotezën e parë, shikohet lidhja e variablave të pavarura logaritmi i GDP fillestare, IHD si përqindje e GDP, kapitali human⁸⁹ në raport me popullsinë, Investimet e brendshme në raport me GDP, Shpenzimet e Konsumit të Përgjithshëm Qeveritarë në raport me GDP, Remitancat në raport me GDP, Ndërsa rritja e GDP për frymë është variabël e varur si në ekuacionin (14a). Hipoteza e parë gjithashtu teston variabla që bashkëveprojnë me njëra tjetrën (kapitalit human dhe investimet e brendshme me IHD).

⁸⁸Shih referenca: Lee, Y., J.A. Nelder, and Y. Pawitan (2006).

⁸⁹ Kapitali human përfaqësohet nga edukimi sekondar i shkollimit, nxënësit e regjistruar (niveli i mesëm i lartë në raport me popullsinë).

-Ndërsa hipoteza e dytë, kërkon ndërtimin e një ekuacioni në një afat më të gjatë kohor në të dy anët e ekuacionit për shumicën e variablave (log-log). Përveç log_IHD në ekuacion përfshihet edhe log_ritja e GDP për frymë, ndërsa për kapitalin human provohet edhe me dy vite prapa, lag_HC, lag1_HC, lag2_HC, ndërsa përcaktues të tjerë të IHD-ve siç janë për investimet brendshme, shpenzimet e përgjithshme të konsumit final qeveritar dhe remitancat së bashku ndërtojnë ekuacionin (15).

-Fokus grupi (të dhënat dytësore), janë përzgjedhur shtatë variabla: logaritmi i GDP_fillestare, IHD, ritja e GDP për frymë, investimet private, kapitali njerëzor (numri i nxënësve të regjistruar në nivelin sekondar të shkollimit në raport me popullsinë), shpenzimet e përgjishme qeveritare dhe remitancat.

Programi STATA version 12, ka shërbyer për përpunimin statistikor të dhënave dytësore, ndërsa përmes SPSS janë paraqitur rezultatet e pyetsorëve.

Përshkrimi i kampionimit të dhënave dytësore

Mostra përfshin 24 vende në Europë, dhe stratifikimi i mostrës bëhet sipas një grupimi, të përfshira janë vende të zhvilluara dhe vende në zhvillim apo në tranzicion, në mesin e të cilave është edhe Kosova.

Ndërsa janë permblodhur variabla të kombinuara varësisht nga kërkesa e hipotezave, për analizë në nivel makro (Tabela ne Shtojca A. Variablat e regresionit). Faktorët tërheqës të rritjes ekonomike dhe të IHD janë studiuar nën qasjen sasiore duke shfrytëzuar të dhënat nga seritë kohore për secilin vend për 11 vite (2004-2014) në US \$ nga Banka Botërore (WB), Treguesit e Zhvillimit BotrorëWDI, duke formuar një panel të dhënash për 24 vende

europiane dhe gjithsej janë 264 vëzhgime. Shumica e variablave janë gjetur në raport me GDP si standard në literaturë përveç kapitalit human që është në raport me popullsinë.

4.4 Përshkrimi i modelit teorik

Ky seksion jep një informacion të mjaftueshëm teorik nga studime më të thelluara dhe të besueshme në lidhje me lëvizjen e kapitalit dhe ndikimin e tij në rritjen ekonomike, sidomos në vendet në zhvillim. Qasja e vlerësimit është e njëjtë sikurse te Boreinsztein et al.(1998) e modifikuar në disa variabla, ndërsa metodat e përlogaritjes për të dhënat e panelit janë katrorët e vegjël (LS) dhe katrorët e vegjël të përgjithshuar (GLS), Efekteve Fikse (FE) dhe Efekteve Rastesore (RE) të cilat më gjërësishtë do të përshkruhen të zgjedhja e modeli empirik.

Boreinsztein, et al, (1995), ka zhvilluar një model teorik që përfshin progresin teknologjik si drejtues kryesor i rritjes ekonomike në afat të gjatë. Ngjashëm si te Romer theksohet se ndikimi i IHD në rritje vjen si rezultat i prodhimit dhe përdorimit të mallrave të reja. Pra IHD konsiderohen një kanal që transferone teknologji dhe ide të reja në vendin prites duke ulur koston e aktiviteteve të bizneseve lokale nga risitë që përdorin. Ndërsa kapitali njerëzor me aftësi të mjaftueshme së bashku me teknologjinë e transferuar, përshpejtojnë progresin teknologjik në vend. Qeveritë duke stimuluar IHD të maksimizojnë eksternalitetet teknologjike nëpërmjet krijimit të sektorëve të ndërmjetëm të mallrave dhe shërbimeve.

Ky model përdor përveç IHD dhe kapitali human, investimet e brendshme dhe disa variabla tjera të kontrollit (ndërsa përdor edhe termin ndërveprim mes variablave).

Një grup i ekonomistëve si Robertson, et al. (1998), Jones, (1995:8), janë marrë me studimin se në cilat situata përfiton rritja ekonomike nga kapitali hyrës. Ndërsa grupi i dytë i ekonomistëve Borensztein et al. (1995) dhe Lucas (1990), theksojnë se rritja ekonomike ndikohet përveç përmes fluksit hyrës edhe përmes kapitalit human.

Grupi i dytë i ekonomistëve konsiderohen si formuluesit e ekuacioneve më të fundit të rritjes ekonomike, edhe themeli teorik i punimit është modeli i rritjes endogjene që e konsideron progresin teknologjik si motorin kryesor të rritjes afatgjatë sepse krijon llojllojshmëri të mallrave të reja kapitale. Megjithatë, këto teknologji të avancuara mund të vëhen në praktikë vetëm nëse kapitali njerëzor është mjaftueshëm i përgatitur dhe i shkolluar, mbi nivelin e pragut minimal të përcaktuar. Pra duhet që stoku i kapitalit njerëzor të ketë aftësi të mjaftueshme për të thithur teknologjinë e avancuar. Këtë e kanë potencuar edhe autorë si, Nelson dhe Phelps (1996), Benhabib dhe Spiegel (1994) të cilët e konsiderojnë stokun e kapitalit njerëzor si kufi për aftësinë absorbuese të teknologjisë në vendet në zhvillim. Afërsisht njëjtë kanë vepruar edhe Barro dhe Sala-i-Martin (1995, kap.6), mirëpo shpesh në studimet e tyre është vërejtur një efekt jo i fortë kur IHD dhe kapitali njerëzor janë vënë në komplementaritet.

Pra modeli analitik i rritjes i Borensztein et al. (1995, 1885) ka një formë të ndryshme nga modeli klasik, sepse merr shkallën e teknologjisë si faktor endogjen i drejtpërdrejtë që ndikon në rritje

Gjithashtu theksohet se grumbullimin i kapitalit të përgjithshëm në vend e bëjnë më shumë IHD-të se investimet e brendshme, dhe më pastaj konkurenca dhe cilësia i rrisin investimet totale dhe ky proces nxit flukset hyrëse të IHD edhe më shumë.

Në vazhdim do të demonstrohet modeli teorik endogjen i rritjes ekonomike i Boreinsztein et al. (1995, 1998).

Në projektimin e rritjes ekonomike fillojmë duke pasur parasysh marrëdhënien e IHD dhe ecures ekonomike nëpërmjet kapitalit human dhe investimeve të brendshme, efekteve gjerësisht në 24 vende europiane. Efektet në vendin pritës shprehen përmes progresit teknik si rezultat i thellimit të kapitalit që shprehet përmes krijimit të shumëllojshmërisë së mallrave kapitale në shfrytëzim siç sugjerojnë autorë si Romer (1960), Grosman dhe Helpman (1991), Boreinsztein et al. (1998), Barro dhe Sala-i-Martin (2005), Aghion (2003), etj.

Sipas këtyre studieve ekonomia prodhon të mira konsumi sipas një procesi vijues të teknologjisë, që paraprakisht niset nga kuadri i modelit të rritjes Sollow (1956).

Baza e modelit të Sollow është funksioni i prodhimit, ku prodhimi varet nga kontributi i kapitalit dhe punës. Gjithashtu përmban një indeks të produktivitetit i referuar si rritje teknologjike. Pra një rritje në rritjen teknologjike nënkupton një prodhim më të lartë me kapital dhe punë të njëjtë. Pra supozohet se funksioni i prodhimit karakterizohet nga kthimet e vazhdueshme të shkallës. Findlay (1978) zhvilloi modelin e Sollow dhe supozoi se norma e rritjes së transferit teknologjik është një funksion në rritje të IHD-ve, duke argumentuar se rritja e kapitalit të huaj rritë kapitalin vendas.

Pra sa më e lartë shkalla e transferimit të teknologjisë, aq më i ulët është hendeku i teknologjisë në ekonominë prirëse dhe njëkohësisht edhe pjesmarrja e kapitalit të huaj në stokun e përgjithshëm të kapitalit në vend.⁹⁰

Modeli i rritjes Solow zakonisht përfaqësohet nga funksioni i prodhimit të Cobb-Dauglas i cili merr formën (pra kapitali njerëzor është futur në modelin e Solow).⁹¹

$$Y_t = A H_t^a K^{1-a} \dots \dots \dots \text{eq. (1)}$$

Ku, A përfaqëson gjendjen e jashtme (egzogjene) të "mjedisit" apo ndryshimi teknologjik (teknologjia si faktor egzogjen), ku (a) është pozitive dhe <1 , H përfaqëson kapitalin njerëzor, dhe K përfaqëson kapitalin fizik (hyrja totale e kapitalit fizik në ekonominë prirëse). Gjendja e mjedisit nën A përfshin variabla të llojllojshme të kontrollit dhe të politikës duke ndikuar në nivelin e prodhimit në ekonomi. Supozoni se kapitali njerëzor⁹² H është një dhuratë e dhënë, ndërsa kapitali fizik përbëhet nga një grumbullim i shumëllojshmërive të ndryshme të të mirave kapitale. Në këtë mënyrë grumbullimi i kapitalit bëhet nëpërmjet zgjerimit të një numrit të varieteteve të ndryshme të të mirave kapitale, çdonjëra e shënuar me $x(j)$ si në Ethier (1982), Barro dhe Sala-i-Martin (1995:36-

⁹⁰ Kapitali i huaj në vend nxitë aktivitetet e ndërmjetme duke krijuar efektin „sinergji” në investimet e përgjithshme në vend.

⁹¹ Sipas Solow (1956), prodhimi për punëtorë është një nga variablat më të rëndësishme që përcakton PBB për frymë (matur si pjesa e punëtorëve në popullsinë e përgjithshme), për të shpjeguar këtë e pjestojmë ekuacionin (1) në të dy anët duke përfutur ekuacionin (1.1) që na ndihmon për të shpjeguar prodhimin për punëtorë kështu edhe rritjen e PBB për frymë. $Y / L = A K^a L^{1-a} / L = A (K/L)^a$ Sipas këtij ekuacioni rritja e qëndrueshme e PBB vjen si rezultat i rritjes së stokut të kapitalit fizik pas zhvlerësimit ekzistues, rritjes së fuqisë punëtore dhe cilësisë së punës së tyre dhe progresit teknologjik i cili përmirëson produktivitetin total të faktoreve (TFP).

⁹² Theksi i modelit tonë është se, duhet të ketë një sasi të caktuar të kapitalit njerëzor, për të prodhuar lloje të ndryshme të mallrave kapitale nga firmat vendase dhe të huaja. Sa më i madh të jetë numri i firmave të huaja (kompanive multinacionale) që veprojnë në ekonomi dhe sa më i lartë të jetë niveli i kapitalit njerëzor, aq më e lartë do të jetë norma e rritjes.

38, 53)⁹³, cituar nga Abdel-Hameed M. Bashir (1999:2), supozoj se funksioni prodhimi (stoku i kapitalit vendas) jepet në ekuacionin në vijim⁹⁴:

$$Y = A H^{(1-\alpha)} \sum_{j=1}^N (k_j)^\alpha \dots \dots \dots \text{eq.}(2)^{95}$$

Që i bie se, i tërë kapitali është një përbërje e një vazhdimësie të varieteteve të të mirave kapitale, secila prej tyre duke qenë e shënuar me $x(j)$ ose (k_j) , përderisa N është numri i përgjithshëm i varieteteve të të mirave kapitale.

Supozoni se ekzistojnë dy lloje të firmave që prodhojnë të mira kapitale: firmat vendore dhe të huaja që kanë ndërmarrë një investim të drejtpërdrejtë në ekonomi.

Firmat vendore prodhojnë n varietete nga numri i përgjithshëm N , dhe firmat e huaja prodhojnë $n^* = N - n$ varietete, që është⁹⁶:

$$N = n + n^* \dots \dots \dots \text{eq.}(3)$$

Meqenëse në këtë punim është përdorur modeli teorik endogjen i përdorur nga Boreinsztein (1998:115), transferin teknologjik⁹⁷ (TP) e konsideron nxitës të rritjes atëherë ndjekim

⁹³ Ekuacioni i përdorur nga Barro dhe Sala-i-Martin: $Y_t = A^*(K_t)^\alpha (H_t)^{1-\alpha} \lambda / * H^c$

⁹⁴ Progresi teknologjik pra zgjerohet në të gjitha ndërmarrjet prodhuese (N firma), dmth, $k_j = k_j + 1 = K$, prandaj ekuacionin (2) mund të shkruhet si: $Y = A H^{(1-\alpha)} (NK)^\alpha N^{1-\alpha}$

⁹⁵ Ku $0 < \alpha < 1$, Y është prodhimi agregat, H është stoku i kapitalit njerëzor në ekonomi, k_j ose $x(j)$ janë llojellojshmëria e mallrave kapitale të podhuara nga firma jth, A është një parametër i teknologjise. Të angazhuara në procesin e prodhimit janë N firma, prej tyre janë (n) firma vendase dhe (n^*) firmat e huaja, ku $N-n$ paraqet firmat e huaja n^* (MNC).

⁹⁶ Pra vendet me teknologji të prapambetur rriten më shpejt, nëse terheqin teknologji të avancuar. Kjo është në përputhje me efektin "konvergencë" në literaturën e rritjes.

Kur kombinohen llojellojshmëria e mallrave që prodhojnë firmat vendase dhe të huaja, krijohet stoku i përgjithshëm i mallrave të llojlojshme (llojlojshmëri e mallrave totale). Transferi i teknologjisë është nxitësi kryesor i rritjes. Kur ka një rritje në larminë e mallrave kapitale ose një përmirësim në cilësinë e mallrave kapitale ekzistuese, atëherë ka ndodhur transferi i teknologjisë i cili rrit rritjen ekonomike.

funsionin e kuadrit teorik të rritjes, një mekanizëm që përbën një zinxhir të ekuacioneve, për të ardhur deri te një model empirik endogjen i rritjes.

Kështu, akumulimi i kapitalit bëhet nëpërmjet zgjerimit të gjitha llojeve të kapitalit, duke formuar stokun e brendshëm të kapitalit (nga riformulimi i ekuacionit 2 formojmë ekuacionin 4):

$$K = \{ \int_0^N x(j)^{1-\alpha} dj \}^{1/(1-\alpha)} \dots \text{eq. (4)}$$

Ku, secili jepë nga, $x(j)$ - paraqet secilin lloj të mallrave kapitale.

Firmat vendase prodhojnë (n) lloje të mallrave, ndërsa firmat e huaja prodhojnë (n*) lloje të mallrave duke formuar totalin e llojeve të mallrave kapitale që shprehet me (N).

Terma të rëndësishëm janë (si ne ekuacionin 3): (n*/N), (N/N*) dhe H.

Pra rritja varet pozitivisht nga përqindja e mallrave të prodhuara nga firmat e huaja (n*), kjo për arsye se prania e firmave të huaja lehtëson prodhimin e mallrave kapitale. Gjithashtu H, është i lidhur pozitivisht me rritjen. Dhe së fundi, rritja varet negativisht nga përqindja e mallrave të prodhuara në një ekonomi me teknologji të prapambetur (N) në krahasim me mallrat e prodhuara në një ekonomi me teknologji më të përparuar (N*), pra (N/N*).

Pra vendet me teknologji të prapambetur rriten më shpejtë, nëse tërheqin teknologji të avancuar. Kjo është në përputhje me efektin "konvergjencë" në literaturën e rritjes.

⁹⁷Rritja e shumëllojshmërisë së mallrave kapitale ose përmirësimi i mallrave ekzistuese (N) ndodh nga progresi teknologjik (TP) i cili sjell rritjen (g):(N) - TP - g

Kur kombinohen llojllojshmëria e mallrave që prodhojnë firmat vendase dhe huaja, krijohet stoku i përgjithshëm i mallrave të llojllojshme (llojllojshmeri e mallrave totale). Transferi i teknologjisë është nxitesi kryesor i rritjes. Kur ka një rritje në larminë e mallrave kapitale ose një përmirësim në cilësinë e mallrave kapitale ekzistuese, atëherë ka ndodhur transferi i teknologjisë i cili rritë rritjen ekonomike.

Gjithashtu supozoni se firmat e specializuara prodhojnë çdo varietet të të mirës kapitale, dhe ua japin atë me qera prodhuesëve final të të mirave me një normë të qeramarrjes $m(j)$. Kërkesa më e favorshme për çdo varietet të së mirës kapitale, $x(j)$, përcaktohet me barazimin e normës së qiramarrjes $m(j)$ dhe të prodhimtarisë marginale të të mirave kapitale në prodhimin e të mirave përfundimtare. Ky kusht është:

$$m(j) = A (1 - \alpha) H^{\alpha} x(j)^{-\alpha} \dots \dots \dots \text{eq. (5)}$$

$x(j)$ - paraqet kërkesën e barazuar për secilin lloj të mallrave kapitale,

$m(j)$ - paraqet normën e qiramarrjes,

Si rrjedhojë, një rritje në varietetin e kapitalit kërkon përshtatjen e teknologjisë në dispozicion në vendet më të përparuara për të lejuar futjen në përdorim të një lloji të ri të të mirave kapitale. Ky proces i përshtatjes së teknologjisë me nevojat vendore kërkon një çmim fiks të instalimit, F , për se të mund të bëhet prodhimi i llojit të ri të kapitalit dhe ky çmim varet negativisht në raportin e numrit të firmave të huaja që operojnë në ekonominë pritëse me numrin e përgjithshëm të firmave (n^* / N). Ky supozim synon kapjen e idesë që firmat e huaja i sjellin ekonomisë në zhvillim një përparim në njohuri, e zbatueshme në prodhimin e të mirave të reja kapitale që tashmë mund të jenë në dispozicion në

vendetëtjera. Rrjedhimisht, IHD-tëjanë kanali kryesor i progresit teknologjik në këtë kuadër duke e lehtësuar përvetësimin e teknologjinë së nevojshme për të siguruarlloje të reja të kapitalit.

Përveç kësaj, ne e mendojmë ekzistencën e një efekti "catching-up"⁹⁸(efekti i zënies së hapit, barazimit, me ekonomitë e tjera) në progresin teknologjik për të pasqyruar faktin se më e lirë është të imitosh prodhimet që tashmë ekzistojnë se sa të krijosh prodhime të reja në kufirin e inovacionit dhe vendet qëkanë një prag shkollimi mbi minimalin e kërkuar, këtë e bëjnë më lehtë. Kjo zbatohet duke supozuar se çmimi i instalimit varet pozitivisht nga lloji i kapitalit të prodhuar në mënyrë vendore krahasuar me atë të prodhuar në vendet më të përparuara (të cilin e shenojmë me N^*). Kjo nënkupton se, vendet me N/N^* më të ulët mundësitë e imitimit i kanë më të mëdha dhe në këtë mënyrë çmimi i përvetësimit të teknologjisë se re është më i ulët. Kështu, ne e marrim për të vërtetë formulimin e mëposhtëm funksional për çmimin e instalimit:

$$F = F \frac{n^*}{N}, \frac{N}{N^*}, \text{ ku } \frac{\partial F}{\partial (n^*/N)} < 0 \text{ dhe } \frac{\partial F}{\partial (N/N^*)} > 0 \dots \dots \text{eq. (6)}^{99}$$

Një interpretim alternativ i Eku. (6) mund të jepet në kuadër të "shkallëve të cilësisë"¹⁰⁰.

Rritja e varieteteve në numër, mund të shpjegohet si një përmirësim në cilësi i të mirave ekzistuese. Në qoftë se prania e firmave të huaja zvogëlon çmimin e përmirësimit të cilësisë

⁹⁸Teoria e ekonomive të shkallës diskuton se një firmë mund të zvogëlojë shpenzimet e përgjithshmetë prodhimit duke përhapur kostot fikse mbi një numër të madh të mallrave të prodhuara. Nëse një firmë i arrin të dyja, të hyjë në një industri në fazat e hershme si dhe të kapë ekonomitë e shkallës, atëherë ka fituar një avantazh të madhë ndaj konkurrentëve të saj (Isak Johansson. 2012:18).

⁹⁹Shih në referenca: Xuan-Vinh Vo., Jonathan A. Batten (2006:6-11).

¹⁰⁰Sikurse, Grosman dhe Helpman (1991).

së të mirave kapitale ekzistuese, ajo do të prodhojë marrëdhënie të njëjtë negative midis IHD-ve dhe çmimit të instalimit. Për më tepër, ideja catching-up (zënies së hapit me ekonomitë e tjera) do të mund të ri-shpjegohej si kuptim (domethënie) se çmimi i përmirësimit të një të mire-kapitale ekzistuese është më i vogël sa më e ulët të jetë cilësia e saj. Përveç çmimit fiks të instalimit, posa e mira kapitale të jetë paraqitur, pronari i saj duhet të shpenzojë një çmim të vazhdueshëm të mirëmbajtjes për periudhë kohore.

Kjo është e ngjashme me idenë e egzistimit të një çmimi të vazhdueshëm marginal (të kufizuar) të prodhimit të $x(j)$ e barabartë me njësinë, dhe se ato të mira kapitale janë tërësisht të zhvlerësueshme. Duke supozuar se norma e interesit (r) që përballlet firma është konstante¹⁰¹, atëherë përfitimet për prodhuesin e një lloji të ri të kapitalit j , të shënuara me $\Pi(j)$ ipen me: ∞

$$\Pi(j) = -F(n_t^* / N_t, N_t / N_t^*) + \int_t^\infty [m(j)x(j) - x(j)] e^{-r(s-t)} ds \dots \text{eq. (7)}$$

Maksimizimi i përfitimeve për prodhuesin e një lloji të ri të kapitalitsi në ekuacionin (7) nga (5) gjeneron nivelin e mëposhtëm të ekuilibrit për prodhimin e secilës të mirë kapitale $x(j)$:

$$x(j) = HA^{1/a} (1-a)^{2/a} \dots \text{eq. (8)}$$

Vëreni se $x(j)$ është i pavarur nga koha, që nënkupton se, në çdo çast niveli i prodhimit të çdo të mire të re është i njëjtë. Për më tepër, niveli i prodhimit të varieteteve të ndryshme

¹⁰¹Campbell dhe Harvey (2001) tregojnë se firmat në mënyrë tipike aplikojnë çmim të vazhdueshëm të kapitalit kur bëhet vlerësimi i vendimeve të buxhetimit të kapitalit.

është gjithashtu i njëjtë falë simetrisë në mes të prodhuesve. Duke zëvendësuar eku. (7) me funksionin e kërkesës eku. (5), përfitojmë shprehjen e mëposhtme për normën e qerasë:

$$m(j) = 1/(1-a) \dots \dots \dots \text{eq. (9)}$$

Jep normën e qerasë me të cilën tejkalohet çmimi marginalmbi shpenzimet e mirëmbajtjes. Së fundmi, supozojmë se ka hyrje të lirë, dhe kështu, shkalla e kthimit (r) do të jetë e tillë që fitimet janë të barabarta me zero. Duke e zgjidhur kushtin zero të përfitimit lejon:

$$r = A^{1/a} \Phi f(n^*/N, N/N^*)^{-1} H \dots \dots \dots \text{eq. (10)}$$

$$\text{Ku: } \Phi = a(1-a)^{(2-a)/a}$$

Për të mbyllur modelin, kemi nevojë ta përshkruajmë procesin e grumbullimit të kapitalit, i cili drejtohet nga vendimet e kursimeve. Edhe pse, për thjeshtësi, nuk e prezantojmë tregtinë ndërkombëtare në këtë model, kjo nuk është një ekonomi e mbyllur falë pranisë së firmave të huaja. Megjithatë, firmave të huaja duke qëndruar konstante në një situatë të qëndrueshme-shtetërore, kushtet e ekuilibrit janë të njëjta me ato që mbizotërojnë në një ekonomi të mbyllur. Prandaj supozojmë se individët e shtojnë në maksimum funksionin e dobisesi vijon:

$$\Pi(j)t = \int_t^\infty C s^{1-\sigma} / 1-\sigma \times e^{-\rho(s-t)} ds. \dots \dots \dots \text{eq. (11)}$$

Ku, C paraqet njësitë e konsumit të mirave përfundimtar Y , duke pasur parasysh një normë të optimale kthimi nga konsumi (r), në kushte standarde është:

$$C_t - C = 1/\sigma(r - p) \dots\dots\dots\text{eq.}(12)$$

Në ekuilibër të qëndrueshëm të shtetit, shkalla e rritjes së konsumit duhet të jetë e barabartë me normën e rritjes së prodhimit (g). Pra me zëvendësim, ata patën një shprehje për normën e rritjes në ekonomi në zhvillim (që përfshin të dy firmat e huaja dhe vendase).

Analiza në këtë hulumtim përdorë modelin e Borensztein, De Gregorio dhe Wha-Lee (1995:9), i cili do të ketë sukses për të gjetur sa është rritja (g) nga kapitalin njerëzor (H) dhe variabla të tjera.

Norma e rritjes në ekonomitë në zhvillim që përfshijnë firmat e huaja dhe ato vendore shprehet në këtë mënyrë:

Së fundi, duke zëvendësuar eq. (10) me Eq. (12), përfitojmë shprehjen e mëposhtme për normën e rritjes së ekonomisë:

$$g = 1 / \sigma [A^{1/a} \psi F (n^*N, N / N^*)^{-1} H - \rho] \dots\dots\dots\text{eq. (13)}$$

Ekuacioni (13)¹⁰² tregon se IHD-të, të cilat maten me pjesën e prodhimeve të prodhuara nga firmat e huaja në numrin e përgjithshëm të prodhimeve (n^*/N), zbret çmimin e futjes së varieteteve të reja të të mirave kapitale, duke ngritur në këtë mënyrë normën me të cilat janë futur të mirat e reja kapitale. Çmimi i futjes së të mirave të reja kapitale është gjithashtu më e vogël për shumë vende të pazhvilluara; që do të thotë se, vendet që prodhojnë më pak lloje të të mirave kapitale se sa vendet kryesore – vendet me N/N^* më të ulët gëzojnë kosto më të ulëta të përvetësimit të teknologjisë, dhe do të tentojnë rritje më të shpejtë.

¹⁰²Borensztein et al (1995:7-9).

Për më tepër, efekti i IHD-ve në normën e rritjes së ekonomisë është pozitivisht i lidhur me nivelin e kapitalit njerëzor, që nënkupton se, sa më i lartë të jetë niveli i kapitalit njerëzor në vendin pritës, aq më i lartë është efekti i IHD-ve në normën e rritjes së ekonomisë.

Modeli i mëparshëm (eq.13) tregon se si IHD, e cila matet me (n^*) redukton kostot e prezantimit të varieteteve të reja të mallrave kapitale dhe rritjen e normës në të cilën mallrat e reja kapitale janë futur.

Është e lehtë për të parë ndërveprimin midis kapitalit njerëzor dhe IHD-ve, bazuar në modelin empirik të Boreinsztein et al. (1998), me të dhëna empirike panel në 24 vende në Europë.

Shtojmë në ekuacionin themelor të Boreinsztein, et al (1995:9;1998:121), efektin e ndërveprimit në mes IHD dhe Investimeve të brendshme përveç se kemi shtuar më parë ndërveprimin në mes IHD dhe HC, remitancat dhe shpenzimet e qeverisë në formulimet si në vijim:

$$g = C_0 + C_1 \text{ FDI} + C_2 \text{ FDI} \times H + C_3 H + C_4 Y_0 + C_5 X_1 \dots \text{eq. (14)}$$

Ku : g = përfaqëson shkallën e rritjes vjetore të GDP për frymë ($\hat{y}_{it}$)

FDI= IHD në raport me GDP.

H = Kapitali Human, përfaqësohet nga shkalla e regjistrimit të nxënësve, niveli sekondar i shkollimit në raport me popullsinë duke e aplikuar kohë më parë nga Romer (1993, IV) kishte gjetur efektin pozitiv të kapitalit human në IHD.

Y_0 = GDP fillestare për frymë matet si vlerë e logaritmit të GDP në vitin 2004 për të kapur efektin "Catch up" – është procesi i konvergencës drejt niveleve të ekonomive më të përparuara (N/N^*).

A ose X_{it} = grupi i variablave që janë futur si përcaktues të rritjes ekonomike.

Në regresion vërejmë se ka nga një koeficient për IHD dhe kapitalin human që bashkëveprojnë përveç se janë përfshirë njëherë veç e veç. Ndërsa e njëjta ndodhë edhe me variablat IHD në bashkëveprim me Investime të brendshme, ndërsa janë përfshirë në (X) edhe faktorë të tjerë (remitancat dhe shpenzimet e qeverisë).

Lucas, mbështet grupin e sipërpërmendur e ekonomistëve, për nivelin e teknologjisë, si faktor endogjen në teorinë e fundit të rritjes, kontributin plotësues të IHD-ve dhe kapitalit njerëzor me rritjen ekonomike. Ai e quajti ndryshimet në kapitalin njerëzor, si pikë e parë, duke përdorur studimin Anne Kruegers (1968) të dhënat, duke zëvendësuar punën me punë efektive. Pika e dytë, ishin përfitimet e jashtme të kapitalit njerëzor, roli plotësues i kapitalit njerëzor dhe nivelin e teknologjisë në prezantimin e rritjes, të cilat i hetuan ky grup i ekonomistëve.

Një analizë të tillë e kanë bërë edhe autorë tjerë, Barro dhe Sala-i-Martin (1995:chapter 12), duke përdorur pothuajse të njëjtat variabla të këtij modeli, por me teknika të ndryshme. Rritja e të ardhurave për frymë (GDP_{gpc}) është përdorur si rezultat i rolit të variablave të kontrollit, ndërsa investimi i brendshëm dhe kapitali njerëzorë prezantuan për të paraqitur efektet indirekte të IHD-ve. Paraprakisht të theksojmë se vlerësimi ekonometrik për hipotezën e parë bëhet duke adoptuar ekuacionin themelor (14)

të Boreinsztein et al. (1998:121) ide e tij konsiderohet niveli absorbimit të teknologjisë ($\gamma \geq \gamma \text{ threshold}$) ku, ($\gamma \text{ threshold}$) është niveli i pragut minimal të kapaciteteve absorbuese të një vendi, i aplikuar edhe nga Johnson A. (2005:8-11)¹⁰³, Teece (1997), Glass and Saggi (1998), Barro dhe Sala-i-Martin (2005:9), dhe formuluar ekuacionin në vazhdim (14a) që e konsideron rritjen ekonomike të varur.

Adoptimi i modelit të Boreinsztein et al. (1998) është bërë së pari :

- Janë shtuar variabla tjera në model përveç variablave kryesore të modelit eq.(14), në ekuacionin(14a) si më poshtë.
- Janë përdorur përveç variables bashkëvepruese (IHD*HC) ashtu si te Boreinsztein (1998), ku IHD është si burim i efekteve teknologjike, pra IHD në interaksion me kapitalin human, që arsyetohet në kuptimin se është e nevojshme një fuqi punëtore e kualifikuar për të bërë më produktiv fluksin e financave duke përfituar maksimalisht nga IHD, në ekuacionin (14a) shtohet edhe një variabël shtesë bashëvepruese (INVE.BR.*IHD) Investimet Brendshme nëndërveprim me IHD, ndryshe nga Boreinsztein (1998), ndërsa ai ka përdorur (Investimet e .Bendshme * HC).

Tani si ekuacion empirik kryesor i regresionit për hipotezen H_1 , ku variabël e varur është norma e rritjes së GDP për frymë (GDPgpc) konsiderohet ekuacioni në vazhdim:

¹⁰³Ekuacioni (4) i Johnson (2005:11): $A_{DOM, t+1} = \beta \gamma_{DOM, t} (A_{MNE t1} - A_{DOM, t1})$ përshkruan se siniveli i teknologjisë së një firme në vendit pritës është prekur nga një rrjedhje “spillovers” e teknologjisë së bazuar në kapacitetin absorbues γ të firmës vendase ($\gamma \geq \gamma$), megjithatë ne deshirojnë të theksojnë se sipas Boreinsztein (1998) nuk ka efekte spillover neseaftësia thithëse (γ) e firmës në ekonomin pritëse është nën nivelin e pragut minimal të kerkuar ($\gamma \leq \gamma$). Johnson me tej thekson në ekuacionin e (6), Funkcioni i prodhimit $Y_{HC} = F(A_{HC}(K_{HC}, L_{HC}), K_{MNE}, KK_{MNE})$; përshkruan se si flukset hyrëse të IHD-ve mund të ndikojnë në rritjen ekonomike të vendit pritës: K_{HC} -kapitali fizik në ekonomin pritëse, K_{MNE} -kapitali fizik nga jashtë, KK_{MNE} -stoku i njohurive nga jashtë, L_{HC} -stoku i punës, A_{HC} -përfaqëson nivelin teknologjik të vendit pritës.

$$\text{LogGDP}_{\text{gpc}} = \alpha_{0it} + \beta_1 \text{IHD}_{it} + \beta_2 \text{H}_{it} + \beta_3 \text{IHD}_{it} \times \text{H}_{it} + \beta_4 \text{Y}_{0it} + \beta_5 \text{INVES.PRIV}_{it} + \beta_6 \text{INV.PRIV}_{it} \times \text{IHD}_{it} + \beta_7 \text{SHP.P.K.F.Q}_{it} + \beta_8 \text{REM}_{it} + u_{it} + \varepsilon_{it} \dots \dots \dots \text{eq. (14a)}$$

Ku kemi, (i) është vendi, (t) është koha-periudha, (α_i) është koeficienti parameter specifik i vendit, (GDP_{gpc}) masë për shkallën e rritjes së GDP për frymë, X_{it} është matricë që paraqet përcaktuesit e tjerë të rritjes (përveç IHD, Kapitali human dhe Y_0), si janë Variablat: INV.BR.-Investimet e Brendshme, SHP.P.K.F.Q.- Shpenzimet e Përgjithshme të Konsumit Final të Qeverisë; REM.-Rremitancat.

μ_{it} – Dallimi i variabla të veçanta në vende të ndryshme të vëzhguara ose variabla të paverifikuara;

ε_{it} - Terma të gabimeve të rastësishme.

Së dyti, duke shfrytëzuar literaturën mbi përcaktuesit e shumtë të IHD ne mund t'i argumentojmë përcaktuesit e IHD në hipotezën e dytë, nëse IHD i paraqesin në formë funksionale të përcaktuesve të ndryshëm: $\text{FDI} = f(g_y, M)$, ku (M) përfaqëson vektorin e variablave përkrah rritjes së ekonomisë së vendit që kontribuojnë në përcaktimin e IHD-ve. Apo, duke u bazuar në një model empirik të ngjashëm me atë të Asiedu (2002) shqyrtojmë përcaktuesit e IHD dhe ndikimin e tyre në rritjen ekonomike me theks të veçantë në disa vende të Europës.

Ekuacioni merr formën:

$$\log_IHD_{it} = a_{0it} + \beta_1 \log_y_{vit} + \beta_2 HC_{it} + \log_1 \beta_3 HC_{it} + \log_2 \beta_4 HC_{it} + \beta_5 GCFC_{it} + \beta_6 REM_{it} + \beta_7 SHPQ_{it} + u_{it} + \varepsilon_{it} \dots \dots \dots eq.(15)$$

Ne përdorëm logaritmin natyral log_log për dy variablat IHD varur dhe rritjen e GDP për frymë e pavarur ((log_IHD_{it} = log_GDP_{gpc}), nga vendi (i) në periudha (t). Ndërsa është përdorur vonesa kohore për variabla të caktuara (lag_1 dhe lag_2) në ekuacion për kapitalin human (matja e kapaciteteve absorbuese në vendet pritëse).

Së treti: Kombinimi i një seksioni kryq të dhënave nga seri kohore është mjaft e dobishme kur dëshirojmë të analizojmë performancën e rritjes ekonomike nga ecuria e IHD-ve në një rajon prej 24 vende të Europës. Nga të dhënat e panelit (gjatësore dhe të kryqëzuara) në dispozicion vlerësohet ekuacioni i regresionit të shumfishtëndërmjet vendeve duke përdorur format e ekuacioneve të FE, RE dhe testin Hausman dhe Geanger Causality.

4.3.1 Modeli Empirik

Modeli ynë empirik i regresionit është ndikuar nga modeli teorik i regresionit që përdori Boreinsztein, et al (1998:115-135). Të dy modelet dallojnë në lidhje me klasifikimin e variablave shpjeguese, kapitali njerëzorë (matja e niveli të pragut minimal të arsimit të mesëm) në rastin tonë matet me regjistrimi bruto i nivelin sekondarë të shkollimit në raport me popullsinë, ndërsa autori matjen e kapitalit humam e bënë me koeficientin e viteve mesatare të shkollimit.

Ne gjithashtu, kemi reduktuar variablat që masin tregun financiare dhe variablat institucionale meqenese vëzhgimet në modelin tonë janë më të vogla dhe disponueshmëria e të dhënave nuk ishte e lehtë.

Siq është theksuar, këto variabla do të analizohen duke përdorur analizen panel për vitet 2004-2014. Përdorim vitin e kaluar të dhënave në dispozicion për IHD, GDP për frymë, GDP_fillestare dhe Kapitali human, që të shohin rritjen afatgjate të tyre në kohën rënjes globale 2008. Me një bazë të dhënash jo të gjatë por me shume vende (24), u krijuan vëzhgime të mjaftueshme (265) për rezultate bindëse.

Përdoren tre teknika të panelit që përdoren më së shpeshti, janë katroret e vegjël të përgjithësuar (GLS), modeli e Efekteve Fikse dhe Efekteve të Rastit, Hill, Griffith dhe Lim, (2008)¹⁰⁴. Modeli GLS përdoret mirë kur baza e të dhënave është e shkurtër dhe të dhëna të kryqëzuara. RE supozon se të dhënat janë mbledhur rastësisht ndërsa FE e thotë të kundërtën, por çdo variablë e pamatur mbetet konstante gjatë gjithë kohës, si vlera historike do të mbahen si fikse (efekte e vazhdueshme fikse gjatë gjithë regresionit) kjo na mundëson të përqëndrohemi në efektet anësore të variablave shpjeguese të përfshira në regresion, Hill, Griffith, Lim, (2008:398).

Shihet se modeli FE do të përdoret më mirë në ekuacionin e rritjes (për të cilin do të shihni detajet në Shhtojca A). Ndërsa testi Hausman do të zbulojë në mënyrë eksplicite nëse mostra është e rastit apo fikse. Testi krahason vlersimet e koeficienteve nga modeli FE nëatë RE, Adkin, i koeficientëve të efekteve të rastit është josimetrik, dhe statistika e $Hi^2(Ch^2)$ është e rëndësishme, që do të thotë se mostra nuk është e rastit.

¹⁰⁴ Modeli FE dhe RE ka aftësi që të analizojnë një panel të gjërë por janë të bazuara në supozime të ndryshme.

Kjo bënë që të përdoret modeli FE si zgjidhje më e saktë. Në rastin tonë të gjitha të dhënat janë mbledhur nga burimi kryesore WDI, ndërsa vetëm për kapitalin human janë marrë nga Entet e statistikave të vendeve që janë të varura nga madhësia, transparenca dhe disponueshmëria e tyre.

Ekuacioni i rritjes ekonomike:

$$\text{Log_GDP}_{\text{GPC}_{i,t}} = \alpha_{i,t} + \beta_1 \log_1 Y_{0i,t} + \beta_2 \text{IHD}_{i,t} + \beta_3 \text{HC}_{i,t} + \beta_4 \text{IHD} * \text{HC}_{i,t} + \beta_5 \text{GCFC}_{i,t} + \beta_6 \text{IHD} * \text{GCFC}_{i,t} + \beta_7 \text{REM}_{i,t} + \beta_8 \text{SHP.P.K.F.Q}_{i,t} + u_{i,t} + \varepsilon_{it} \dots \text{eq. (1)}$$

Ekuacioni i IHD-ve:

$$\text{Log_IHD}_{i,t} = \alpha_{i,t} + \beta_1 \log_1 \hat{y}_{i,t} + \beta_2 \text{HC}_{i,t} + \beta_3 \log_1 \text{HC}_{i,t} + \beta_4 \log_2 \text{HC}_{i,t} + \beta_5 \text{GCFC}_{i,t} + \beta_6 \text{REM}_{i,t} + \beta_7 \text{SHP.P.K.F.Q}_{i,t} + u_{i,t} + \varepsilon_{it} \dots \text{eq. (2)}$$

- $\text{Log_}\hat{y}$ =logaritmi natyral i shkallëssë rritjes së GDPsë për frymë ($\text{Log_}\Delta \text{GDP}_{\text{GPC}_{i,t}}$),është variabël e varur (eq. 1)
- Log_IHD = logaritmi natyral i Investimet të Huaja Direkte si përqindjee GDPsë ($\text{Log_IHD}/\text{GDP}_{i,t}$),është variabele varur (eq. 2).
- (a) koeficienti i konstantës (vlersues i panjohur për cdo vend) përfaqëson vendin (eq. 1 dhe 2).
- (i = 1, 2, N) vendi
- (t = koha) viti
- β , është koeficienti për variabla të pavarura (eq. 1 dhe 2).
- $u_{i,t}$ është termi i gabimit dhe μ_{it} – dallimi i variabla të veçanta në vende të ndryshme.

Për ekuacionin e parë, konsiderohet më i përshtatshëm modeli i efekteve fikse ndryshe nga modelet e tjera ekonometrike. Gjithashtu, për shkak të fuqisë së modelit, paraqet me pak rrezik për heteroskedasticitet dhe autokorrelacion. Kjo për shkak se vlersimi në nivelin individual mbetet i qëndrueshëm, pavarësisht nga prania e heteroskedasticitetit dhe autokorrelacionit (Hill, Griffith, Lim, 2008). Rreziku i autokorrelacionit është minimizuar për shkak të vlersimit të Efekteve Fikse.

Çdo ndryshore që nuk ndryshon me kalimin e kohës do të jetë pikërisht collinear me variablen kohë - dummy Hill, Griffith, Lim (2008: 398), për këtë arsye do të hiqet nga modeli, kështu që nuk ka variabla të mbetura qëdo të jenë collineare.

Për ekuacionin e dytë, më i përshtatshëm konsiderohet modeli i efekteve të rastit. Mostra është zgjedhur rastësisht (janë përfshirë vende në zhvillim shtatëmbëdhjetë,¹⁰⁵ të zhvilluara shtatë),¹⁰⁶ $N=24$, periudhë kohore e shkurtër (paneli ka një sasi të barabartë të vëzhgimeve në kohë (vitet) $T=11$ për secilin vend pra kemi $N=24 < T=11$, ndërsa të dhënat janë të balancuara¹⁰⁷). Modelet që përdoren për analizën e të dhënave panel janë përshkruar hollësisht në vazhdim.

¹⁰⁵ Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Hungaria, Polonia, Portugalia, Republika Çeke, Republika Sllovake, Lituania dhe Estonia.

¹⁰⁶ Gjermani, Zvicrra, Auatia, Holanda, Italia, Norvegjia dhe Suedia.

¹⁰⁷ Paneli jo i balancuar sipas Wooldridge(2002, p.275), shkakton probleme të mëdha në vlersim prandaj kjo është një përparësi në rastin tonë.

4.3.2 Përshkrimi i metodave të studimit në analizen e të dhënave panel

Analiza e të dhënave panel dhe metoda e përdorur në këtë hulumtim për Investimet e Huaja Direkte dhe rritjen ekonomike, mundëson studimin e dinamikës së ndryshimit të rritjes ekonomike në njërin anë dhe gjetjen e përcaktuesve të IHD në anën tjetër, me një panel të dhënash me seri kohore të shkurtër (11 vite). Të dhënat panel kombinohen me seri kohore dhe të dhëna të kryqëzuara të 24 vendeve, duke rritur cilësinë e të dhënave. Duke përdorur informacion të përkohshëm për seri (kohë) dhe vendi (seksion kryq), është zhgjidhur problemi i variablave që mungojnë ose janë të humbura (Hsiao, 1986).

Një zhgjidhje do të bënte, kontrollimi i rezultateve me metoden e Efekteve fikse dhe Efekteve të Rastit Hill, Griffith, dhe Lim (2008); Green, (2012: 420). Modeli FE dhe modeli RE, kanë aftësinë për të kapur të dhëna të gjëra dhe me periudha të shkurtëra, por që janë të bazuara në supozime të ndryshme.

Modeli RE supozon se të dhënat mbledhet në mënyrë të rastësishme, ndërkohë që në metoden e efektet fikse të dhënat nuk mbledhen në mënyrë të rastësishme (Hill, Griffith, Lim 2008 fq. 398). Me fjalë të tjera, modeli RE rrezultatet janë më të mira në qoftë se 24 vende janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme bazë të disponueshmërisë së të dhënave. Kjo e bënë të justifikuar përdorimin e modelit të efekteve të rastit (RE) në ekuacionin e IHD si funksion i variablave tjera shpjeguese. Ndërsa është përdorur edhe modeli Efekte Fikse, të dhënat e mbledhura për hipotezën parë, disa variabla të pavarura në disa vende nuk janë zgjedhur rastësish, dhe vlerat që mungojnë do të mbahen fikse, Hill, Griffith, Lim, (2008:398). Për të vertetuar se cilën metodë të përdorim, testi Hausman zbulon nëse mostra është e rastit apo fikse Adkins, Hill (2008).

Nëse nga testi del se Hipoteza është zero dhe statistika Hi katrore (χ^2) e rëndësishme, do të thotë se mostra nuk është e rastit. Kjo bënë të kuptojmë se duhet zgjedhur metoden e Efekte Fikse (proceduren e komanades “xtreg”, për zgjedhjen e FE, dhe RE dhe komanda tjera që janë përdorur në Stata 12, janë në shtojcën A).

Kjo është forma më e përshtatshme e modelit të efekteve fikse (FE):

$$y_{it} = \alpha + x_{it}\beta + v_i + \varepsilon_{it}$$

Në këtë model $v_i + \varepsilon_{it}$, term i gabimit (mesatarja 0, e pakorreluar me vetveten, e pakorreluar me x , e pakorreluar me (v) , dhe homoskedastik). Mund të përblehet në $\varepsilon_{it} = v_i + \omega_{it}$, duke supozuar se (ω_{it}) është një term, gabime konvencionale dhe përshkruhet më mirë (v_i) .

Të dy ekuacionet kanë për qëllim vlersimin e koficienteve β , ku modeli (FE) siguron vlersimin „known as the within” dhe përdorë katroret ë vegjel (LS) për të kryer vlersimin, ndërsa (RE) vlerësues ka një (matrix) mesatare e ponderuar „between and within” me ekuacionin përfundimtarë:

Kjo është forma më e përshtatshme e modelit të efekteve të rastit (RE):

$$y_{it} = \alpha + x_{it}\beta_1 + s_i\beta_2 + z_t\beta_3 + v_i + \varepsilon_{it}$$

Vlersimi „between (2’’) tregon se vlersimi i dy koeficienteve (β_1, β_2 ¹⁰⁸), është e mundur të vlersohen pa vlerësimin e β_3 , për shkak se (z) ¹⁰⁹ është një konstante në të gjitha vëzhgimet; regresioni-vlerësuesi koeficienti (intercept) do të jetë një vlerësim i (alfa) $\alpha + z\beta_3$.

Vlersimi „within estimator’’ për koeficientet $\beta_1, \beta_2, \beta_3$ (3’’) si mase sigurie, ofron një vlerësim të β_3 , të efekteve të faktorit, në kohë të ndryshme. Vlersimi „within estimator’’ gjithashtu vlerëson ui për vi . Më saktësisht (ui) është një vlerësues i, $vi + si\beta_2$.

4.3.2.1 Metoda e Efekteve Fikse

Model i efekteve fikse ka një përparësi sepse merrë parasysh karakteristikat individuale të vendeve (heterogjenitetin e supozimeve individuale) duke krijuar mundësinë që të gjithë koeficientët të jenë të njëjtë për të gjitha vendet. Për shkak të fuqisë së modelit, shumë prej supozimeve paraqesin me pak rrezik se në modele tjera. Për shembull, natyra e modelit FE na bërë që të mos shqetësohemi për heteroskedasticitetin dhe autokorelacionin. Kjo për shkak se vlersimet e fiksime të gabimeve standarde (robust standard estimation) në nivel vendi mbeten të qëndrueshme pavarësisht nga prania e heteroskedasticitetit dhe autokorelacionit (pra është minimizuar autokorelacioni për shkak të vlersimit të efekteve fikse).

Çdo variabël që nuk ndryshon me kalimin e kohës do të jetë pikërisht kolineare (collineary) me variablen kohore fikse dhe do të heqet nga modeli, kështu që nuk ka variabla kolineare të mbetura (Hill, Griffith, Lim, 2008:398), edhe pse prapë se prapë nuk janë hequr të gjitha shqetësimet për supozime tjera të mundshme, së paku ato janë zbutur.

¹⁰⁸ (X_{it}) cëndron për variablat e pavarura vlerat e të cilëve mund të ndryshojnë në kohë.

¹⁰⁹ (Z), vlerat e variablave të pavarura që nuk ndryshojnë gjatë gjithë kohës.

Praprakisht është matut baza e të dhënave a është e balancuar (me xtset) dhe tregon se kemi panel tëbalancur. Në qoftë se ne ende i konsiderojmë dy ndryshore shpjeguese kjo mund të shkruhet si¹¹⁰:

$$y_{it} = \beta_{0i} + \beta_{1i}x_{1it} + \beta_{2i}x_{2it} + e_{it} \quad t=1, \dots, T \dots \text{eq. (1)}$$

Mbledhen të dy anët e ekuacionit dhe pjestohen me T:

$$\frac{1}{T} \sum_{t=0}^T y_{it} = \beta_{0i} + \beta_{1i} \frac{1}{T} \sum_{t=0}^T x_{1it} + \beta_{2i} \frac{1}{T} \sum_{t=0}^T x_{2it} + \frac{1}{T} \sum_{t=0}^T e_{it} \dots \text{eq. (2)}$$

Dihet se parametrat beta nuk ndryshojnë me kalimin e kohës, mund të thjeshtojmë këtë si:

$$\bar{y}_{it} = \frac{1}{T} \sum_{t=0}^T y_{it} = \beta_{0i} + \beta_{1i} \frac{1}{T} \sum_{t=0}^T x_{1it} + \beta_{2i} \frac{1}{T} \sum_{t=0}^T x_{2it} + \frac{1}{T} \sum_{t=0}^T e_{it}$$

$$\bar{y} = \beta_{0i} + \beta_{1i}x_i + \beta_{2i}x_i + e_i \dots \text{eq. (3)}$$

Ne tani kemi mesataren vlerave e (y_{it}) gjatë gjithë ekuacionit, duke zbritur (eq.3) nga (eq. 1), kemi:

$$y_{it} - \bar{y}_i = \beta_{0i} + \beta_{1i}(x_{1it} - x_{1i}) + \beta_{2i}(x_{2it} - x_{2i}) + (e_{it} - e_i) \dots \text{eq. (4)}$$

¹¹⁰ Aplikuar nga Carter Hill, Griffiths dhe Lim (2012), [cituar nga Agermark A., Albrektsson D., (2014:12:14)],

Nga kjo rrjedhë : $\tilde{y}_{it} = y_{it} - \bar{y}_i$ (dhe e njëjta vlen edhe për x dhe e), kjo mund të përshkruhet si:

$$\tilde{y}_{it} = \beta_1 x_{1it} + \beta_2 x_{2it} + e_{it} \dots\dots\dots \text{eq. (5)}$$

Në ekuacionin 5, mungon koeficienti i konstatntës (β_{0i}), konstantja është rikthyer dhe pranuar nga katrorët e vegjël (Least Squares) gjatë gjithë mesatareve të (x_{1it}) të regresionit.

$$\tilde{y}_{it} = \beta_{0i} + \beta_1 x_{1i} + \beta_2 x_{2i} + e_{it}$$

Koeficientet, β_1 dhe β_2 janë vlerësuar nga ekuacioni (5) dhe për këtë arsye ne mund të llogarisim koeficientët individuale, sipas efekteve fikse:

$$\beta_{0i} = \bar{y}_i - \beta_1 \bar{x}_{1i} - \beta_2 \bar{x}_{2i}^{111} + e_{ij} \dots\dots\dots \text{eq. (6)}$$

Dihet se me vlersimin e modelit të Efekteve Fikse variablat e parashikuara (të pavarura) varen nga variacioni i variablës së varur, ndërsa rezultatet e koeficienteve merren duke mos i ndryshuar variablat parashikuese që masin supozimet individuale gjatë gjithë kohës.

Një disavantazh i përdorimit të variablave dummy në modelin efektve fikse është se kur ka shumë seksione kryq të dhënave dhe seri kohore, përfshihet një numër më i madhë i variablave dummy të cilat heqin shumë shkallë të lirisë, duke rezultuar në një test statistikor me pak të fuqishëm.

¹¹¹ Ose forma e njëjtë e eq. 5.2, sipas (Townsend et al. (2013:74). $y_{ij} = \beta_{0j} + \beta_1 x_{1ij} + e_{ij}$

Për më tepër, përdorimi i variablave dummy nuk tregonë direkt se çfarë ndryshimi mund të shkaktojë linja e regresionit me kalimin e kohës dhe mbi vende.

4.3.2.2 Metoda e Efekteve të Rastit

Meqenëse përdorim modelin e Katroreve të Vegjël të Përgjithësuar (GLS) dhe jo OLS, si përparësi kemi (Wooldridge 2002, p.281, 282):

- OLS nuk është efikas në krahasim me një GLS kur përdorim RE.
- OLS prodhon vlerësime të qëndrueshme të β , por gabimet standarde nuk janë të shumë kuptueshme.

Ajo çfarë e dallon modelin e efekteve të rastit është se mund të përdorim numër të vogël të parametrave, vlerësim efikas, dallimet mes vendeve (heterogjeniteti) shihen si të rastit, C_i pra janë të pa lidhur me X_t për të gjithë (t).

Prandaj parametrat e koeficientit (β_{0i}) janë ndarë në dy pjesë:

Së pari, ne nxjerrim matricen e kovariancës një vlerësues të termave të gabimit (u_{0i}).

Së dyti, ne përdorim strukturën e kovariancës në vlerësimin i (β_{0i})¹¹².

$$\beta_{0i} = \beta_0 + u_{0i} \dots\dots\dots (6)$$

β_0 = mesatarja e koeficientit të konstantes që përfaqëson popullatën, kurse $u_{0i} \sim N(0, \sigma^2_{u_0})$ është heterogjeniteti individual i mesatares së popullatës, dhe është i pavarur nga $e_{ij} \sim N(0, \sigma^2_e)$

¹¹²Shih ne referencen: Townsend et al. (2013).

Sipas, Carter Hill, Griffiths and Lim (2012), nëse e lidhim ekuacionin (6) me ekuacionin (1) do të kemi¹¹³:

$$y_{it} = (\beta_0 + u_i) + \beta_1 x_{it} + \beta_2 x_{it} + e_{it} \dots \dots \dots \text{eq.7)}$$

Me riformulimin e koeficienteve ekuacioni merre formën:

$$y_{it} = \beta_0 + \beta_1 x_{it} + \beta_2 x_{it} + (u_i + e_{it})$$

ose,

$$y_{it} = \beta_0 + \beta_1 x_{it} + \beta_2 x_{it} + v_{it} \dots \dots \dots \text{eq.(8)}$$

Ky model supozon se vlerat e rezultatit y_{it} është i bazuar në nivelin e konstantes së popullates, β_0 , dhe variablat e veqanta shpjeguese, x_{it} , asocojnë me parametrat β_1 , dhe një komponente grup-specifik, u_{0i} .¹¹⁴

Kështu kemi, β_0 =parametrie mesatares së koeficientit,

v_i = termi i gabimeve që përmban dy lloje të gabimeve, termi i gabimeve¹¹⁵ të efekteve të rastit (cross country error) e_{it} -within-entity error, dhe termi i gabimeve për dallimet e supozuara individuale (time-series error) u_{it} – between-entity error, ose, $v_{it} = u_{it} + e_{it}$.

¹¹³ Cituar nga Agermark A., Albrektsson D., (2014:12:15).

¹¹⁴ Edhe pse modeli i efekteve të rastit mund të përfshijë më shumë komponentë komplekse të rastit ne e konsiderojnë një koeficient të vetëm, grupi - specifik për tu përqëndruar në zgjedhjen në mes të efekteve rastit dhe efekteve fikse.

¹¹⁵ Korrigjimet për një numër të vogël të vëzhgimeve, që rrjedhin nga puna MacKinnon dhe White (1985:305-325) dhe korrigjime për një numër të vogël të gabimeve të grupuara, të përshkruar në Cameron et al.(2011, f.8).

4.3.2.3 Testi Hausman

Për të vendosur nëse do të aplikojë modelin efekteve fikse ose modelin efekteve të rastit një test Hausman është i përshtatshëm për të vendosur. Ne kemi zhvilluar dy matës të cilët kanë veti të ndryshme në varësi të korrelacionit (α_i) dhe regresoreve, vecanërisht:

1. Nëse efektet individuale (u_i) janë të palidhura (pa korreluara) me variablat shpjeguese, vlersuesi i Efekteve të Rastit përputhet dhe është efikas, duke prodhuar parametra të qëndrueshëm β . Ndërsa vlersuesi Efekte Fikse është i përshtatshëm por jo efikas.
2. Nëse efektet individuale (u_i) janë të lidhura me variablat shpjeguese, vlersuesi i Efekteve Fikse është i përshtatshëm dhe efikas të prodhoj parametra të qëndrueshëm β , ndërsa vlersuesi Efekte të Rastit është në kundërshtim me këtë.

Këto dallime i qartëson një test i thjeshtë, testi Hausman i definuar si i tillë:

$$H = (\beta_c - \beta_e)' (V_c - V_e)^{-1} (\beta_c - \beta_e) \quad \text{ose}^{116},$$

Ku:

$\beta_c = \beta$ me kapuq dhe c , është vektori koeficientit që kujdeset për qëndrueshmëri.

β_e = është vektori i koeficientit që kujdeset për efikasitet,

V_c = është matrica i kovariances që kujdeset për qëndrueshmëri.

¹¹⁶ $\rho = (\sigma_u)^2 / (\sigma_u)^2 + (\sigma_e)^2$ ku, σ_u = sd gabimet brenda grupit u_i ; σ_e = sd gabimet (term i përgjithshëm i gabimit) e_i .

V_e = është matrica e kovariances që kujdeset për efikasitet.

Testi Hausman ilustruhet nga Johnston dhe Dinardo (1997:404).

Metodat dhe formulat e statistikave Hausman janë shpërndarë si χ^2 , rezultati i testit Hausman përshkruhet përmes $r()$:

- $r(\chi^2)$ χ^2
- Shkalla e lirisë për statistika r (df), numri i shkallëve të lirisë është shkalla e diferencës në variancën e matrices. Kur diferenca e caktuar është pozitive, ky është numri i koeficienteve të përbashkët që krahasohen në modele.
- $r(p)$ p-vlera për χ^2
- $r(\text{rank})$ rank of $(V b - V B)^{-1}$

Kur diferenca në matricen e variancës nuk është pozitiv, një Moore-Penrose përgjithësuar inverse është përdorur. Nga prania e korrelacionit, mund të priten ndryshime në vlerësimet e marra nga të dy modelet (Carter Hill, Griffiths dhe Lim, 2012), mirëpo në rastin tonë me një panel të shkurtër prej 11 viteve prania e korrelacionit nuk është problem. Megjithatë mbetet testimi i hipotezave me testin Hausman.

$H_0 : \text{Corr}(u_i, x_{kit}) = 0$ dhe $H_0 : \text{Corr}(u_i, x_{kit}) \neq 0$

KAPITULLI V: Rezultatet e Studimit

5.1 Rezultatet empirike ekonometrike të studimit

Për përmirësim të mëtejshëm të efikasitetit të procesit të vlerësimit, duke llogaritur testet e mësipërme për seksionet kryq dhe seri-kohore, ne do të përdorim të dy modelet varësishtë nga hipotezat e ngritura. Në rastin e hipotezës së parë, modeli i efekteve fikse¹¹⁷ mund të jetë më i përshtatshëm meqenëse janë përfshirë vende heterogjene sa i përket variablove shpjeguese të përdorura. Në këtë rast secili vend ka konstanten e vetë (intercept), ku përfshihen variabla kohë-dumi. Efektet Fikse nuk përdoren për të dhënat të cilat variacioni brenda cluster - robust është minimal ose ndryshimi i variablove me kalimin e kohës është i ngadaltë.

Edhe në hipotezë të dytë, kryhet testi Hausman i cili teston specifikat që lidhen për Efektet Rastit, duke sugjeruar më të përshtatshëm modelin e Efekteve të Rastit që e trajton konstanten (intercept) si shpërndarje të mesatares duke mosë eliminuar numrin e shkallëve të lirisë. Shpërndarja e mesatares së rastit tani është pjesë e termit të gabimit (ϵ it), megjithatë, nuk lejohen të kenë lidhmëri me variablat e pavarura.

Interpretimi dhe vlersimi i rezultateve të koeficienteve në tabelën 19, merren nga modeli i katroreve të vegjel (LS) me metodën e Efektet Fikse, ndërsa vlersimi i rezultateve të koeficienteve në tabelën e 22, merren nga modeli GLS me metodën e Efekteve të rastit.

¹¹⁷Efektet Fikse nuk përdoren për të dhënat të cilat variacioni brenda cluster –robust është minimal ose ndryshimi i variablove me kalimin e kohës është i ngadaltë.

Gjatë interpretimit të koeficienteve është e rëndësishme të kemi parasyshë supozimin se të gjitha variablat tjera janë konstante. Të gjitha të dhënat e vendeve janë jo stacionare, sepse vlera e F-statistik është më e madh se vlerat e t-studenti.

Vlerat kritike të testit janë: $p =$ vlera 1, 5 dhe 10 përqind (MacKinnon, 1996).

Shumica e variablave kanë vlera $p < 0.005$, refuzojnë hipotezen zero dhe tregojnë rëndësinë e tyre në model.

Ky kapitull jepë rezultatet e testimit të dy modeleve bazë, katroret e vegjel të përgjithësuar GLS.¹¹⁸

Grafikui IHD-ve (shih, grafikët 22 deri 33 në kapitulli III) tregojnë se në mostren prej 24 vendeve ka dallime të mëdha sa i përket hyrjeve neto të IHD, ku më së shumti janë pozicionuar në vendet anëtare të BE-se, vende tjera të zhvilluara dhe në disa vende në zhvillim. Mirëpo nëse shihet në këndvështrimin e përmirësimit të ecuris së rritjes së IHD në vitin 2014, vende që kanë filluar një trend pozitiv janë: Italia, Zvicra, Holanda, Suedia, mund të jetë për shkak të fuqisë blerëse të këtyre vendeve. Megjithatë, edhe Estonia, Portugalia, Hungaria, Sllovenia, Shqipëria, Mali i zi janë duke përfituar më shumë IHD ndërsa vendet tjera (Kosova, Maqedonia, Bosnja e Hercegovina) ende vuajnë nga një trend ulës të IHD-ve. Është e theksuar në disa nga vendet një rënje e rritjes së GDPsë për frymë për disa vitë të njëpasnjëshme (Serbi, Itali) disa vende të tjera kanë ende probleme nga reformat strukturore në vazhdim (Shqipëria) apo dhe ndryshimet politike dhe statutore të pazgjidhura mirë (Kosovë, Maqedoni, dhe Bosnjë e Hercegovinë). Prandaj shumica e kompanive humben interesin e IHD sepse normat e fitimit pësuan rënje.

¹¹⁸ Siç e përmendëm më sipër perdoren metoda e Efekteve Fikse dhe metoda e Efekteve të Rastit.

Gjithashtu, grafiku 17 e rritjes së GDPsë për frymë (në kapitullin e trete) paraqesin dallime në shkallën e rritjes së GDPsë për frymë në vitet kur janë vëzhguar vendet. Dallimet janë pozitive për vende në zhvillim ndërsa në vende të zhvillura kjo shkallë është më e ulët dhe negative. Kjo ka të bëjë me faktin se vendet e zhvilluara janë goditur më shumë nga kriza globale dhe në veqanti kriza europiane. Prandaj, mund të themi se vendet e pasura kanë një trajektore drejtë rënjes ekonomike në krahasim me vende në zhvillim të cilat kanë një shkallë pozitive të rritjes.

Ndërsa performanca e variablave të përdorura në model janë paraqitur me grafike përshkrues (grafik 17 deri 20 kap.III) dhe grafikët nr.45 deri 55 me scatter plot (grafik të shpërndarë) e regresionit lineare në shtojca A, gjithashtu grafikë të përpunuar nga autori me stata 12 (shtojca A, rezultatet ekonometrike nga tabela (a) testi FE dhe RE deri në tabelen (f dhe g) Matricat e korelacionit.

5.1.1 Paraqitja e statistikave përshkruese të dhënave panel

Tabela e (tabela 16) jepë një përmbledhje statistikore të shpërndarjes nga mesatarja të çdo variable sipas dy¹¹⁹ modeleve të analizuara.

Të dhënat përfshijnë variabla të gjendjes së mjedisit ekonomik përmes variablave të përfshira në model. Poashtu përfshihen numri i vëzhgimeve për çdo variabël, mesataren, shpërndarjen nga mesatarja, dhe pikat e minimumit dhe maksimumit që bëjnë intervalin rrethë të cilit luhaten vlerat e variablave.

¹¹⁹Modeli i parë me FE (rritja ekonomike e varur) dhe modeli i dyte RE (IHD e varur).

Tabela 16: Statistika përshkruese e të dhënave panel (24 vende) për vitet 2004-2014

Variable	Observations	Mean	Stand. Dev.	Minimum	Maximum
log_ΔGDPgro.pc~a (ŷ)	210	1.006541	.902363	-3.18799	2.51886
LogGDPfill	264	25.24811	1.841369	21.25839	28.95328
IHD	264	6.380687	9.898636	-16.15452	88.09634
HC	264	14.45674	4.971523	7.54	26.75
IHD_HC	264	88.67297	118.342	-178.5074	999.0125
INV.BR.~f	264	23.02217	3.914311	14.55275	38.2489
IHD_INV.BR.	264	151.0936	228.0288	-369.1633	1904.64
REM~m	264	4.948647	7.092913	.1208355	33.7
Sh.P.K.F.Q~o	264	18.68272	4.217964	6.205039	29.9406

Burimi: Të dhënat nga WDI (Kalkuluar nga autori)

Nga tabela nxjerrim konkluzionet si në vijim:

Së pari, në model konstatohet se vlerat e variablës rritja vjetore e GDP për frymë(log_ΔGDPgro.pc~a) rreth mesatares janë më të përqëndruara se variablet tjera sepse shpërndarja e vlerave është 0.9 njësi nga mesatarja 1 njësi, kjo shpërndarje është më e ulta. Variabla e dytë më mirë për nga shpërndarja pas rritjes vjetore të GDP për frymë, është logaritmi i GDP-së fillestare duke patur një mesatare 25 njësi me një shpërndarje nga mesatarja prej 1.8 njësi, që tregon se edhe në këtë rast shpërndarja është përqëndruar gjatë periudhës sonë të analizës. Te Investimet e brendshme (INV.BR.~f) shpërndarja e vlerave është 3.91 njësi nga mesatarja 23 njësi. Kjo tregon se këto variabla kanë shpërndarje të përqëndruar gjatë gjithë periudhës së analizës (2004-2014).

I njëjti konkluzion arrihet për të gjitha variablat përveq për IHD, remitanca dhe për variablat që ndërveprojnë me ndonjë variablë tjetër (IHD*HC dhe IHD*GCFC) për të cilat

do të kryhen testet për normalitetin e shpërndarjes së mesatares. Gjetjet e mësipërme ndihmojnë për të arritur te konkluzioni se interpretimi i mëtejshëm i variablave me anë të modelit ekonometrik do të ketë besueshmëri të lartë për shkakë se variablat kanë shpërndarje të përqëndruar të vlerave të variablave të tyre rrethë mesatares.

5.1.2 Testi i përcaktimit të modelit Efekt Fikse kundrejt Efekteve të Rastit

Dy hipotezat e ngritura për tu trajtuar duhet së pari të testohen të dhënat përmes testeve të përshtashme për të dhëna panel, në rastin tonë paneli heterogjen.

Në të dy modelet, FE dhe RE, është përdorur vlersimi i dallimeve individuale (mbetjeve) dhe metoda e cila ka më pakë dallime apo që dallimet janë eliminuar tërësisht merret si rezultat i vlersuar përfundimtarë. Në rastin tonë, për hipotezen e parë vlersuesi merret metoda e efekteve Fikse e llogaritur përmes katrorëve të vegjël (LS) të dhënave të transformuara sepse Efektet e Rastit nuk kanë eliminuar këto dallime.

Vlersimi sandwich llogaritet duke zbatuar formulën e zakonshme për të transformuar të dhënat dhe mbetjet, $\hat{u} = \tilde{y} - X\beta$.¹²⁰

Vlersimi i Efektet Fikse sipas Wooldridge (2002:275), kërkon kujdes të veçantë sepse gjatë heqjes së dallimeve në të dhëna mund të paraqitet korrelacioni serial¹²¹:

¹²⁰ Shihë referencat: Arellano (1987) dhe Wooldridge (2002:10.59), për rastin e Efekteve Fikse, dhe gjithashtu edhe Wooldridge (2002, Ch.10), Wooldridge J (2002:1-735).

¹²¹ Megjithatë në një panel si në rastin tonë me seri kohore të shkurtëra (prej 11 viteve), nuk ka ndodhur korrelacioni serial (më gjërësisht në paragrafët në vazhdim).

$$\text{Cor}(u_{it}, u_{i,t-1}) = -1/(T - 1)$$

Vlersuesi White-Allerano, fillimishte ka qenë i hartuar për këto raste. Mirëpo mund të përdoret më mirë të Efektet kohore Fikse.¹²²Në rastin tonë,¹²³ është përdorur komanda “testparm” për të parë nëse Efektet Kohore Fikse janë të nevojshme kur drejtojmë një model FE. Është kryer kjo provë për të vertetuar nëse Dummies për të gjitha vitet janë të barabartë me 0, është vertetuar se ato janë të barabarta me zero, nuk ka qenë e nevojshme të përdoren Efektet Kohore Fikse.

Metoda Pedroni, sipas Roy S., Mandal K., (2012:13), përfshin një grup të testeve për të argumentuar hipotezën zero e pa kointegruar në panelet heterogjene. Grupi i parë i testeve është quajtur "Brenda dimensionit" (within), Torres-Ryena (2007:25).

Ai përfshin panel-v, panel rho (r), e cila është e ngjashme me Phillips, dhe testi Perron (1988), paneli jo-parametrike (PP) dhe statistika të panelit parametrikë (ADF). Statistika e panelit jo-parametrike dhe statistika e paneli parametrik janë analoge me ekuacionin e thjeshtë të testit ADF, Roy S., Mandal K., (2012:13). Grupi tjetër¹²⁴ i testeve quhet "mes dimensioneve" (between), Torres-Ryena (2007:25). Kjo është e krahasueshme me grupin testeve të panelit që ka përdorur, Breuer et al. (1999).

Në testet "mes dimensioneve" përfshinë testet: grup-rho, grup-f, dhe statistikën e grupit-ADF. Prandaj testi Hausman është i mjaftueshëm për të bërë zhgjedhjen në mesë efekteve fikse apo efekteve të rastit.

¹²² Të dhëna të grumbulluara.

¹²³ (Siç theksohet në paragrafët në vazhdim të Efektet Kohore Fikse),

¹²⁴ (panel-v, panel rho (r) dhe testi Perron (1988))

Hipoteza e parë (H_1), trajton nëse IHD dhe variabla tjera të pavarura kanë efektë pozitivë në rritjen e GDP-së për frymë, është analizuar duke përdorur teknikën e vlersimit të Efekteve Fikse. Sipas Wooldridge (2002), metoda e Efekteve Fikse të dhënave transformon në një regresion grupor duke ruajtur dallimet individuale të vlersuara me llojin White (duke ruajtur të dhënave dhe njëkohësisht duke eliminuar gabimet e mbetjeve).

Vlersimi me metodën e Efekteve Fikse,¹²⁵ kontrollon heterogjenitetin duke përfshirë edhe variabla kohë-dummy për secilin grup (Wooldridge, 2006; 2009).

Megjithatë janë kryer të dy vlersimet¹²⁶ Fikse kundrejt të Rastit në kuadër të panelit, dhe në Hipotezen H_1 , fiton modeli FE.

Edhe të hipoteza e dytë (H_2) për zgjedhjen mes RE ose FE, është e rëndësishme të kryhet një test për të shqyrtuar këtë supozim (Wooldridge, 2006). Është zgjedhur testi Hausman (1978), për të zgjedhur në mes FE dhe RE. Prandaj ne përdorim opsionin RE, duke përdorur vlersimin e katrorëve të vegjël të përgjithësuar GLS (shuma e mesatares së ponderuar në kuadër të rezultatit të matricës).

Me komanden, `xtreg, re`,¹²⁷ vlerësimet e dhënave me përbërës ideosinkretik σ_u^2 , dhe komponentë individual σ_u^2 , përmes GLS është transformuar në variabël (z), për metodën e efekteve të rastit.

¹²⁵ Ajo është më e përshtatshme për testimin e të dhënave panel të paekuilibruara, ku ka kufizime apo vëzhgime që mungojnë në grupin e të dhënave panel (Asteriou dhe Hall, 2007).

¹²⁶ Modeli FE trajtonte dhënave që mungojnë në çdo seksion si parametra fikse, ndërsa modeli RE trajton të dhënave që mungojnë për çdo seksion si parametra jo fikse, por si të rastit (Asteriou dhe Hall, 2007).

¹²⁷ Shih në aneks shtese, metodën dhe formulat në detaje.

5.1.2.1 Zgjidhja e Hipotezes së parë dhe rezultatet e tabelave

Për nxjerrjen e rezultateve për, rritja ekonomike e varur, paraprakishtë do të duhen të kryhen disa teste¹²⁸:

- Tabelat a) dhe b) Testi i përcaktimit të efekteve fikse kundrejt efekteve të rastit,
- Tabelac) Testi Hausman,
- Tabelad) Testimi për efekte kohore fikse,
- Tabelae) Testimi për heteroskedasticitetin dhe zgjedhja e metodës së Efekteve Fikse për rritjen e GDP për frymë e varur,

1) Tabelat¹²⁹ a dhe b nga shtojca A –plotësojnë **tabelen 17- Zgjedhja FE kundrejt RE** (Testi i përcaktimit të efekteve fikse kundrejt efekteve të rastit)

Ngjashmëritë dhe dallimet në të dy modelet (FE/RE) e studimit

Rezultatet koeficientet mund të konstatohet se ka ngjashmëri dhe dallime në dy modele te regresionit. Duke pranuar se një konstante (intercept) është shumë më e madh në modelin Efekteve Fikse (40.60), është statistikisht e rëndësishme, në krahasim me konstanten RE (10.27 përqind), është një fillim i mirë.

¹²⁸Nga a , b , c,d dhe e, janë tabelat nga nxjerrja e rezultateve në Stata 12, të cilat mund ti gjeni në ShtojcaA.

¹²⁹Nga tabela (a) në shtojca A, plotësojmë tabelen 17 Efekteve Fikse: Shkalla vjetore e rritjes së GDP për frymë-e varur. Nga tabela (b) shtojca A, perseri plotësojmë tabelen 17, Efekteve të Rastit: Shkalla vjetore e rritjes së GDP për frymë-e varur.

Tabela 17: Zgjedhja FE kundrejt RE (Burimi WDI: Kalkuluar nga autori)

(Variablaë varur norma ë rritjes se GDPpc) Varriblat ë pavarura Koeficientet Gabimet standarde	Tabela (a) FE	Tabela (b) RE
logGDPfill _{it}	-1.624*** (0.208)	-0.395*** (0.082)
	5.851 (4.54)	3.20 (1.89)
IHD _{it}	0.006 (0.005)	0.001 (0.005)
IHD*HC	0.004* (0.002)	Mungon
HC _{it}	0.002 (0.030)	-0.058*** (0.019)
GCFC _{it}	0.063 (0.014)	0.057 (0.015)
IHD*GCFC	-0.002* (0.001)	Mungon
REM _{it}	0.025 (0.021)	0.005 (0.013)
SHP.P.K.F.Q _{it}	-0.041 (0.034)	0.002*** (0.021)
Konstantja	40.603*** (5.34)	10.275*** (2.311)
R-squares	403	230
Correlacioni	-975	0

Shenim: (Në kllapa janë gabimet standarde); RE : $p > |z|$ dhe [FE: $p > |t|$];

Nivelet e rëndësisë: ***1%, **5%, *10%; Kalkulimi nga autori.

Siç u tha në pjesen teorike, në modelin e efekteve fikse është e mundur heterogjeniteti individual prandaj është kapur nga një konstante (kjo është prova).

Sa i përket variablave dallimet e koeficienteve në dy modelet janë të vogla, vetëm në variablën e kapitalit human ndryshimi është i madhë, dhe atë në modelin FE ka koeficient pozitivë dhe i parëndësishëm ndërsa në modelin RE është negativë dhe i rëndësishëm.

Të dy modelet tregojnë një GDP_fillestare negative dhe ($p = 0.000$) statistikishtë e rëndësishme dhe një konstatim i përgjithshëm se rritja ekonomike kryesishtë varet nga rritja e investimeve të brendshme. Një tjetër ndryshim është se R-katror është shumë më e lartë në modelin FE krahasuar me RE. Ndryshimi ndodhë sepse në modelin FE konstantja kapë heterogjenitetin e vendeve, ndërsa efektete rastit për shkakë të mangësive teknike të vlersimit nuk mund të kapin dallimet. Prandaj fuqia shpjeguese në modelin RE është humbur

1) Testi Hausman (tabela c në shtojca A plotësojnë tabelen 18)

Për të vendosur në mesë të modelit efektet fikse dhe modelin efektet e rastit ne kemi përdorur një test Hausman. Çështja qëndron:

Nëse efektet unike (u_i) të rastit janë të lidhura me variablat e pavarura (regresor) në regresionin tonë.

Hipoteza zero H_0 = thotë se efektet e rastit nuk janë të lidhuara me regresor, dhe se modeli RE është i preferuar.

Hipoteza alternative H_1 = thotë u_i , është i lidhur me regresorët në modelin e efekteve fikse dhe është teknikë më e avancuar e vlersimit.

Tabela 18: Vlersimi i testit *Hausman*¹³⁰ në modelin panel për 24 vende, tabela c¹³¹

	Coefficient (b) Fixed	Coefficient (B) Random	(b-B) Diference	Sqrt (diag (V_b- V_B)) S.E
LogGDPfill	-1.51023	-.3906873	-1.119542	.1727806
IHD/GDP	.006199	.00911549	-.0029559	.
HC/Pop	.0025701	-.577948	.0603649	.0243275
GCFC/GDP~f	.0649064	.0577269	.0071795	.

Burimi WDI: Kalkuluar nga autori. Shënim¹³²: b = konsistent me Ho dhe Ha; marrë nga xtreg;

B = jo konsistent me Ha, coeficient nën Ho; marrë nga xtreg;

Test: Ho: Dallimi në koeficientët jo sistematike

CHI2 (4) = (b-B) [(V_b-V_B) ^ (- 1)] (b-B) = 31,30

Prob> CHI2 = 0,0000; (V_b-V_B nuk është definuar pozitivë)

Kjo është < 0.05 (të gjithë koeficientet janë të rëndësishëm), përdoren Efektet Fikse.

Rezultati i testit Hausman është shfaqur në tabelën 18 (në shtojcë tabela c) dhe është bindëse që hipoteza zero hidhet poshtë në nivelin e rëndësisë 1%. Rezultati i testit Hausman thotë se efektet unike janë të lidhura mevariabla të pavarura brenda modelit tonë, kështu

¹³⁰ Në këtë punim ne e konsiderojmë kryerjen e një testi për specifikimin e gabimeve propozuar nga Wu (1973) dhe nga Hausman (1978) për zbulimin e metodës së zakonshme të katrore të vegjël (OLS). Pragjykimi i problemeve në një model ekuacioni lineare Hausman (1978: 1259).

¹³¹ Përpunimi i të dhënave nga programi Stata 12 janë dhënë në Tabela 19 (Tabela 19 konsiderohet si tabela c në shtojcë A).

¹³² Note: b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg; B = inconsistent under Ha, coefficient under Ho; obtained from xtreg ; Test: Ho: difference in coefficients not systematic, chi2(4) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B) = 31.30, Prob>chi2 = 0.0000 ; (V_b-V_B is not positive definite). This is < 0.05 (i.e. coefficients are significant) Fixed effects used.

modeli i efekteve të rastit është i njëanshëm dhe vlersimi i koeficienteve (beta) të saj nuk do të shkrihen në parametrat e vërtetë të koeficienteve (beta) në mostra të mëdha. Prandaj vlersimi koeficienteve të fituar me efekte fikse janë të qëndrueshëm.

1) Testimi për efektet kohore¹³³ fikse

Për të parë nëse efektet kohore fikse janë të nevojshme gjatë drejtimittë një modeli FE, është përdorur komanda testparm. Ai është një test i përbashkët për të parënese të gjitha vitet janë të barabartë me 0, në qoftë se ato janë, atëherë nuk është e nevojshme të përdoren efektet kohore fikse, shtyp “ndihmë-testparm” (help- testparm).

Pas drejtimittë të modelit të efektit fiks, shkruajmë:

testparmvitet dhe kemi rezultatet në vijim (kemi tabelen d në Shtojca.A):

Prob>F është $0.8708 > 0.05^{134}$, kështu që nuk mund të refuzojmë hipotezen zero sepse koeficientet për të gjitha vitet janë të barabartë me zero, prandaj nuk ka nevojë¹³⁵ për Efektet Kohë Fikse në këtë rast.

Nga koeficientet e tabelës d, në shtojca A, plotësojmë ekuacionin në vijim:

Ekuacioni Efektet kohë Fikse:

¹³³Shënim: për më shume detaje rreth procesit praktik në stata 12, shihë në referencë.
<https://www.princeton.edu/~otorres/Panel101.pdf>

¹³⁴Shënim: . testparmvitet ; (1) vitet = 0; F(1, 179) = 0.03; Prob> F = 0.8708

¹³⁵ Pas vërtetimit të testit, dhe konstatimit se nuk ka nevojë të vlersohen edhe Efektet KOHORE Fikse, sepse është plotësuar kushti i kerkuar, nuk janë formuar tabelat prandaj edhe rezultatet nuk janë të interpretuara përmes kësaj metode. Vetem FE dhe RE është implikuar në rezultatet e studimit - rezultatet ekonometrike.

$$\text{Log}\Delta\text{GDP}_{\text{it}} = 47.12254 - 1.449186\log\text{GDP}_{\text{it}} + 0.0060911\text{IHD}_{\text{it}} + 0.0022707\text{HC}_{\text{it}} + 0.0635436\text{GCFC}_{\text{it}} + 0.0284214\text{REM}_{\text{it}} - 0.0315179\text{Shp.P.K.F.Q}_{\text{it}}$$

2) Testimi për heteroskedasticitet

Në këtë paragrafë shqyrtohet shkurtimisht vlersuesi i fuqishëm i kovariances të llojit sendviç (robust covariance estimators of the sandwich type), për të siguruar një bazë për trajtimin më të zgjeruar të tyre në një panel të dhënash¹³⁶.

Qasja vlersim i fuqishëm “robust estimators”, ka fituar popullaritet ndër statistikient dhe ekonometricist që nga fillimet e para të vlersimeve ekonometrike, Long dhe Ervin (2000)¹³⁷. Vlersimi i gabimet standarde më të fuqishme krijonë më pakë supozime (paragjykime) për dallime individuale në mesë vendeve si në rastin tonë (kur janë përfshirë të dhëna heterogjene), por krijojnë¹³⁸ më shumë variancë.

Kur përdoret ky efektë ka të ngjarë të jetë i rëndësishëm për saktësinë¹³⁹ e rezultateve. Në favor të përdorimit të tyre janë edhe Stock dhe Watson (2003).

¹³⁶Lexuesi për një trajtim të metutjeshem duhet ti referohet tekstit, Ekonometria, p.sh., Greene (2003), në të cilin ky paragraph është i bazuar.

¹³⁷Sipas Thomson (2011:4), kur duhet të përdoret vlersimi i fuqishëm i gabimeve standard (robust standard errors). Sipas tij ka një standard të dyfishtë se ku duhet të bazohemi. Literatura thekson se jo gjithmonë është gjë e mirë vlersimi i fuqishëm i gabimeve standarde. Megjithatë, sipas shumicës së ekonometricistëve në mesin e tyre edhe Giovanni Millo (2014:5), e arsyetojnë mjaftë mirë përdorimin e tyre.

¹³⁸Rritja variances shpesh na çon për të gjetur rëndësinë statistikore edhe kur ajo nuk ekziston (psh, në gabimisht refuzojmë një hipotezë zero, që është e vërtetë). Megjithatë fiton ana e mirë e përdorimit, sepse përmirëson dallimet në paragjykimet gjatë kryerje së testeve statistikore.

¹³⁹Argumenti qëndron se studjuesit duhet të mendojnë rreth tre karakteristikave kur i vendosin të dhënat: shpërndarja e gabimeve, shpërndarja e regresorve, dhe numri i afërm i vëzhgimeve përgjatë dy dimensioneve, hapsinore –vendi dhe kohore-vitet (kur gabimet standarde grumbullohen-Clustering).

Koeficientet¹⁴⁰ e tabelës në shtojcë A, efektet fikse “brenda” regresionit (within-regresion), janë dhënë në ekuacionin në vijim :

$$\log \text{GDP}_{\text{gpc}_{it}} = 37.70864 - 1.51023 \log \text{GDP}_{\text{fill}_{it}} + 0.006199 \text{IHD}_{it} + 0.0025701 \text{HC}_{it} + 0.0649064 \text{GCFC}_{it} + 0.0286658 \text{REM}_{it} - 0.0313851 \text{Shp.P.K.F.Q}_{it} + e_{it}$$

Prandaj modifikimi i Testi Wald sipas Fox dhe Weisberg, (2011), për grupin e heteroskedasticitetit, është një mënyrë e mirë për modelin e regresionit të Efekteve Fikse.

$H_0: \sigma^2(i) = \sigma^2$ për të gjithë (i) ; $\chi^2(24) = 956.05$

Prob> $\chi^2 = 0.0000$ (Prezenca e heteroskedasticitetit).

Zeroja është homoskedasticiteti (ose varianca konstante).

Hedhim poshtë si të pavlefshëm hipotezen zero dhe nxjerrim si përfundim heteroskedasticitetin,¹⁴¹ shkak: Prob> $\chi^2 = 0.0000 < 0.05$.

¹⁴⁰Një test për heteroskedasticitet për modelin e efekteve fikse është në dispozicion përmes komandës: xttest3. Ky është një program përdorues-i shkruar, për të instaluar dhe shtypur: ssc install xttest3 (rezultatet janë dhënë në Shtojcë A tabela e).

¹⁴¹Beck dhe Katz (1995:634-47), në kuadër të modeleve të shkencave politike me veshgime kohe dhe vendi (haptire) jo të gjatë në të dhënat panel korigjonte gabimet standarde me (PCSE), një vlerësues me veti të mira dhe shumë i fuqishëm kundër heteroskedasticitetit dhe korelacionit ndër-sektorial.

Përdorimi i metodave të fuqishme¹⁴² në regresion, plotëson të gjitha supozimet në një regresion me të dhëna panel. Ne do të përdorim njërin prej qasjeve të metodës së fuqishme të regresionit: regresionin me gabime standarde të fuqishme.

Si alternativë përdorim opsionin "robust",¹⁴³ për vlersimin egabimeve standarde duke përdorur matës të Huber-White¹⁴⁴ sanduiçë „sandwich – estimators“ sipas Thompson (2011:1-10),¹⁴⁵ janë kundër heteroskedasticitetit, pra verteton heteroskedasticitetin të njohur gjithashtu si Huber/White, (White, 1980, 1984).¹⁴⁶

Këto gabime të fuqishme standarde, Greene (2003: 322) Wooldridge (2002:263),¹⁴⁷ mund të merren me një mori të shqetësimeve të vogla rrethë dështimit për të përmbushur supozime, të tilla si probleme të vogla në lidhje me normalitetin, heteroscedasticitetin, etj.

¹⁴²Ne e dijme se dështimi për të përmbushur supozimet mund të çojë në vlersime të njëanshme të koeficienteve dhe sidomos të gabimeve standarde. Ky është një faktë pse gjithnjë e më shumë përdoret metoda e fuqishme (robust) e regresionit e cila merrë në konsideratë disa nga të metat që paraqiten në të dhëna

¹⁴³ Efektet Fikse kryejnë regresionin (within) gabimet standarde me Driscoll-Kraay. Këto gabime standarde janë shumë të fuqishme dhe të përgjithshme për tërë seksionin kryq të dhënave (me kushtë që vitet të jenë të mjaftueshëm të mëdha). Format e prerjes tërthore ("hapësinor") dhe kohore pas vlersimit të testeve duke përdorur "robust standard errors", janë dhënë rezultatet në tabelen 19 regresion 2, 3 dhe 4, për normalizimin e shpërndarjes së variancës për variabla të cilat nuk e kishin këtë shpërndarje (tabela 16, në statistikatat përshkruese). Vlesimi i rritjes ekonomike si variabël e varur përmes metodës së Efekteve Fikse.

¹⁴⁴Vini re se Thompson (2011) përdor "White" për heteroskedasticitet dhe jo për varësi, të njëjtin emër e përdorin ndryshe "BLUE" ekonometricist të tjere, i referohen rastit të heteroskedasticitetit dhe varësisë.

¹⁴⁵ Ndërsa për "cluster robust" apo grumbullimi gabimeve standarde, kontribut themeltar ka dhënë, Arellano (1987), i cili zyrtarisht i përdori në Stata, të njohura si "White – Allerano", dhe fusha tjera të statistikave, pas përdorimit nga Rogers (1993) cituar nga Giovanni Millo (2014:f.5). Robust standard error estimators for panel models: A unifying approach. MPRA. www.mpra.ub.uni-muenchen.de/54954/1/MPRA_paper_54954.pdf.

¹⁴⁶ Shih vlersues të fuqishëm të kovariancës-Huber /White, i cili aplikohet për modele të paneleve në një mjedis të efektet fikse (White 1980), Liang dhe Zeger (1986) dhe Arellano (1987), Greene (2003). Driscoll J, Kraay A (1998:549-60).

¹⁴⁷ Referenca origjinale për FGLS është, Parks (1967).

Robust standard errors: Komanda- reg. xtreg. dhe Opsioni - robust, heteroskedastik bënë vlersimin e fuqishen (robust) të gabimit standard edhe në modelin linear me panel.

Nuk janë regresionet e njëjta si më sipër, duke përdorur opsionin “fuqishme”.¹⁴⁸

Pra nëse krahasojmë rezultatet e fuqishme (robust FE në regresion 1, 2 dhe 3 në tabelën 19) ka ndryshime në gabimet standarde dhe t-testet (ka ndryshim edhe në koeficientët), në këtë shembull të veçantë, duke përdorur gabimet fuqishme standarde janë ndryshuar konkluzionet nga regresioni fillestar i katroreve të vegjël (LS).

Kjo sugjeron se problemet në thelbë nuk ishin të vogla, do të thotë se kishte dallime individuale të supozuara të dala nga të dhënat e 24 vendeve në studim.

Prandaj, pas këtij vlersimi rezultatet janë më bindëse. Rezultatet përfundimtare janë llogaritur nga STATA software vc.12 (Tabela 19).

Testimi për korrelacionin në seri

Sipas Baltagi, et al. (1912:1401-1406), korrelacioni i serive të kryqëzuara aplikohet në panele të mëdha me seri kohore të gjata (mbi 20-30 vjet).¹⁴⁹

¹⁴⁸Me opsionin i fuqishëm (robust), vlerësimet e koeficientëve nuk janë të njëjtë si në OLS të zakonshëm dhe gabimet standarde marrin parasysh çështjet që kanë të bëjnë heterogjenitetin dhe mungesën e normalitetit

¹⁴⁹Një test Lagrange-shumëzues për korrelacionin serial është në dispozicion përmes komandës xtserial. Ky është një program përdorues-i shkruar, për të instaluar atë shtyp: ssc install xtserial (xtserial y x1).

Meqenëse korelacioni nuk është problem në panele të vogla (me pak vite), në rastin tonë ne kemi vetëm 11 vite, kështu që nuk kemi korrelacion serial i cili bënë që gabimet standarde të koeficienteve të jenë më të vogla, ndërsa R^2 të janë më të lartë se sa që do të ishin në faktë. Prandaj nuk u praktikua një teknikëe tillë në të dhënat e panelit në rastin tonë.

5.1.2.2 Rezultateve përfundimtare pas diagnozifikimit të testeve GDPgpc-e varur

Pra komanda xtreg, i është përshtatur modelit të regresioni të dhënave paneli.

Në veçanti, xtreg është i përshtatshëm për të vlersuar se cili opsion është më mirë, vlersimi i panelit me modelin e Efekteve Fikse apo me modelin e Efekteve te Rastit.

Prandaj siç është përshkruar më lartë zgjedhja në mes Efekteve Fikse (FE) dhe Efekteve të Rastit (RE), përmes specifikimit të Katrorëve të Vegjël (Least Squares) është paraqitur më gjërësishtë në Shtojcen A.

Ekuacionit të rritjes i përshtatet më shumë opsionin i Efekteve Fikse (FE) si më poshtë:

Tabela 19: Rezultatet e vlersimit në bazë të efekteve fikse (FE¹⁵⁰: Shkalla e rritjes së GDP për frymë e varur, IHD e pavarur së bashku me variabla tjera shpjeguese, panel mbi një dekadë (2004-2014), kalkuluar nga autori.¹⁵¹

Regresion number Independent Variables	(1) FE Coefficient (Standard error)	(2) FE Robust	(3) FE Robust 2	(4) FE Robust 3
LogGDPfillestare	-1.510*** (0.189)	-1.510*** (0.179)	-1.491*** (0.174)	-1.496*** (0.174)
IHD	0.00620 (0.00542)	0.00620 (0.00798)	-0.0393 (0.0283)	0.0246 (0.0405)
HC	0.00257 (0.0307)	0.00257 (0.0235)	-0.0198 (0.0240)	-0.0213 (0.0239)
IHD*HC			0.00394* (0.00217)	0.00407* (0.00223)
INV %GDP	0.0649*** (0.0149)	0.0649*** (0.0167)	0.0608*** (0.0156)	0.0896*** (0.0282)
IHD*INV				-0.00290* (0.00163)
Remitancat % GDP (REM)	0.0287 (0.0215)	0.0287 (0.0174)	0.0191 (0.0190)	0.0145 (0.0197)
Shpenzimet e Përgjithshme të Konsumit Final Qeveritarë (SHPKFQ/GDP)	-0.0314 (0.0341)	-0.0314 (0.0243)	-0.0323 (0.0239)	-0.0399 (0.0259)
Constantja	37.71*** (4.861)	37.71*** (4.670)	37.64*** (4.619)	37.33*** (4.462)
Vëzhgimet	210	210	210	210
R-squared	0.398	0.398	0.406	0.416
Number of countryid	24	24	24	24
R ² Within				
R ² Between	404			
R ² Overall	432			
No. of countries below the threshold (start, end) = (24) 2004-2014	192 HC Pragu ≈ 14.3%			

Shënim: (i) *, **, *** tregojnë nivelin e rëndësise* p < 0.1 (10%), p < 0.05 (5%), dhe p < 0.01(1%). (ii) Variabël e varur rritja reale e GDP për frymë. (iii) Gabimet standarde të fuqishme janë përdorur dhe raportuar

¹⁵⁰ Testi Hausmantregon preferencën e efekteve fikse. Në vlersimet në kolonat në tabelën 19, rezultatet janë paraqitur në bazë të FE (Plumper & Troeger, 2007). Edhe Bond et al. (2001) sugjeron përdorimin FE në vlersimin e rritjes ekonomike kur ka vëzhgime të vogla (11) e bënë kalkulimin e mesatarës "kohë".

¹⁵¹ Variabël e varur: e shkalla rritjësë GDP për frymë për 24 vende, për të gjitha regresionet është përdorur teknika e Katoreve të vegjël (LS), metoda e Efekteve Fikse (FE). White heteroskedasticiteti, përputhet me gabimet standarde në kllapa, nga *, ** dhe *** duke treguar rëndësia në 10%, 5% dhe nivel rëndësie 1%.

në kllapa poshtë çdo vlerësimi të koeficientit. (iv) Kapaciteti absorbues i vendit, pragu (threshold) i nivelit të shkollimit (HC threshold $\approx 14.5\%$) për 24 vende.

Rezultatet përfundimtare¹⁵² të vlefshme për plotësimin e ekuacionit të metoda Efekteve Fikse (FE) për - shkalla e rritjes së GDP për frymë.

Nga të gjitha regresionet e ngritura në tabelen 19, shihet se asnjë variabël nuk është hequr nga ekuacioni, që do të thotë se nuk egziston korelacion në mesë variblave shpjeguese.

Siq shihet nga rezultati ka edhe hipoteza të pasakta, pra kanë vertetuar të kundërten e supozuar më parë.

Në ekuacionin regresiv GDP_fillestare e shprehur në milion euro, fluksi hyrës neto i IHD i shprehur në përqindje të GDP, kapitali human i shprehur me regjistrimin bruto të nxënësve në shkollimin e mesëm i lartë si përqindje e popullsisë e logaritmuar sipas modeli të rritjes endogjene Lucas (1998),¹⁵³ Investimet e Huaja Direkte në bashkëveprim me kapitalin human, investimet e brendshme si përqindje e GDP-së, IHD në ndërveprim me investime të brendshme, remitancat si përqindje e GDP-së, shpenzimet e përgjithshme të konsumi final

¹⁵²*Shënim:*Përfshihet metoda e fuqishme e vlersimit të regresionit (Robust Regression Methods), të bëjë ndryshime në vlerësimet që marrin në konsideratë disa nga të metat në të dhënat. *Ne do të shikojmë një qasje në regresionin "Robust" në gabimet standarde:* 1) Regresioni i fuqishëm duke përdorur rivlerësimet e katrorëve të vegjël.*Me vlersime të „Robust_1_2_3” testojmë „fuqin” e rezultateve për efekte të vëzhgimeve që mund do të kenë ndikim në rezultat, p.sh., të atyre vendeve që kanë marrë nivelet më të larta të IHD-ve dhe për normalitetin e shpërndarjes së të dhënave për kapitalin njerëzor. Rezultatet (në dispozicion) e regresionit me përjashtim të 7 vendeve të zhvilluara, Holanda, Gjermania, Zvicra, Austria, Italia dhe Suedia dhe 2 vende në zhvillim, Hungaria dhe Polonia të cilat kanë marrë nivelin më të lartë të IHD-ve në periudhën në mostër, të tjerat vende (1 vend i zhvilluar Norvegjia) dhe 13 vende në zhvillim përveq Kosovës dhe Maqedonisë, janë deri diku të ngjashme në marrjen e IHD për të gjithë kampionin. Rezultatet e HC në nivel agregat janë të përendësishme dhe negative në regresion 4 (FE-robust) tabela 19. Ndërsa kur HC kur ndërvepron me IHD jep rezultat pozitiv dhe të rëndësishëm në rritje. Do të thotë se me rritjen 10% të IHD*HC, rritja në GDP për frymë do të jetë 0.4%.*

¹⁵³ Mankiw et al. (1992) dhe Benhabib & Spiegel (1994) ishin ndër të parët që treguan në mënyrë empirike se një nivel i lartë i arsimit nxitë akumulimin e njohurive dhe aftësive për të mirën e shoqërisë në tërësi.

të qeverisë si përqindje GDP, përcaktuar si variabla të pavarura, ndërsa rritja e GDP për frymë shprehur në përqindje e përcaktuar si variabël e varur.

Fillimisht është parë shkalla e korrelacionit në mesë vlerave të ndryshoreve (e varur dhe të pavarura). Korrelacioni është negativë por që tregon një lidhshmëri të fort ndërmjet variablave (r ose $\text{corr}(u_i, X_b) = -0.975$).

Ekuacioni i regresionit (në rastin tonë modeli logaritmik) tregoi vlerë të rëndësishme statistikore $F^{154}(7,179) = 17.30$, $p = 0.000$, me masë të fuqisë shpjeguese më të lartë se efektet e rastit, $R\text{-sq: within } R^2 = 40.3\%$, $\text{between } R^2 = 43.2\%$ dhe $\text{overall } R^2 = 19.2\%$, duke e bërë modelin e Efekteve Fikse më të rëndësishëm për tu përdorur.

Pra pas testimit, fuqia shpjeguese është $R^2 = 41.6\%$ ¹⁵⁵ regresioni 4 tabela 19 (regresioni 1 deri 4, tabela 19, fuqia shpjeguese sillet nga 39.8% deri 41.6%, statistikisht janë të fuqishëm. Rezultatet treguan se 41.6 % e shkallës së rritjes së GDP për frymë mund të shpjegohen nga vlerat e variablave të pavarura, ndërkohë që 58.4 % e nivelit të rritjes së GDP për frymë shpjegohet nga faktorë të tjerë që nuk janë matur në studim.

Ndërsa konstantja prej 37.33% e parashehë si të rëndësishëm modelin.

¹⁵⁴ Të dhënat e cekura mund të gjinden të shpjeguara në tabelat e Efekteve Fikse (në Aneks shtese A), që janë të krahasueshme me paraqitjen respektive të: (model summary - krahasueshme me korelacionin e thjeshtë $R = -0.975$ dhe R katrore $R^2 = 41.6\%$, rezultatet krahasueshme me Anova për $F(7,179) = 0.000$ paraqet signifikanen.

¹⁵⁵ Të gjitha statistikatat sugjerojnë: $R\text{-squares}$ nëse variron nga 0.39-0.41 sugjeron një fuqi shpjeguese të lartë për modelin tonë, duke shpjeguar mbi 40 % të variacionit të variablës së varur varet nga variacioni i variablave të pavarura në model.

Plotësimi i ekuacionit të rritjes me koeficientet nga tabela 19:

Në rastin tonë tabela 19, koeficientet jashtë kllapave nuk janë të gjithë pozitivë në ekuacionin regresiv në vijim:

$$\text{Log_}\Delta\text{GDP}_{\text{gpc}_{it}} = 37.33 - 1.496\log_ \text{GDP}_{\text{fill}}^{156}_{it} + 0.0246\text{IHD}_{it} - 0.0213\text{HC}_{it} + 0.00407\text{IHD}_{it} - \text{HC}_{it} + 0.0896\text{GCFC}_{it} - 0.00290\text{IHD_GCFC}_{it} + 0.0145\text{REM}_{it} - 0.0399\text{Shp.P.K.F.Q}_{it} + e_{it}$$

Në vazhdim rezultatet ekonometrike për secilen variabël:

1. GDPfillestare është negativë-variabla GDP_fillestare është negative nga p-vlerat e variablave shpjeguese është e qartë se edhe statistikisht është e rëndësishme në nivelin 1% (pra p-vlera <0.01) tabela 19. Nryshimi relativë i vlerave të koeficientit të variablës GDP_fillestare nga regresioni 1 me vlerë -1,510 në regresion 4 vlera në -1.496 është e vogël, prandaj rezultatet janë bindëse dhe dëshmohet se efekti konvergjent ka ndodhur.

Rezultati ynë tregon se vendet në zhvillim kanë tendencë të rriten më shpejt se vendet e zhvilluara, mbështetur nga një efekt catching-up¹⁵⁷ nga 17 vende vendet në zhvillim.

¹⁵⁶ GDP fillestare, variabël tradicionale në ekuacionin e rritjes Alfaro, (2004), Barro dhe Sal-i-Martin, (1997); Boreinsztein, et al (1998). Ne përdorem këtë variabël duke pasë si baze e vitin paraprak (2003), procesi i konvergjences rezultoj me një koeficient negativë në regresionin e rritjes së GDPgpc. Autorë të shumtë (Barro, 2001); Barro dhe Lee (1994); Mankiw, Romer, Weil (1992), Carkovic dhe Levine (2005), kanë përdoren çdo 5 vite duke marrë parasyshë levizjet ciklike të ekonomisë, megjithatë shumica e studimeve japin efektin e konvergjences (kryesisht përfshihen vende në zhvillim), ndërsa Cristina Jude, merrë në konsideratë levizjet ciklike të ekonomisë çdo 4 vite për gjetjen e konvergjencës së kushtezuar (Y_0), gjetjet e saj nuk japin efektin e konvergjences së kushtezuar meqenëse ka një koeficient pozitiv (mostra e vendeve anëtare e BE-se është shkaku i gjetjeve pozitive të efektit të konvergjences Y_0) periudha 1998-2010.

¹⁵⁷ Efekti catching-up është gjetur më lehtë në studimet empirike për vendet në zhvillim edhe në studimin e Borensztein, et al., (1998), Ford et al. (2008).

2. Investimet e Huaja Direkte (IHD), duke përdorur modelin e efekteve fikse dhe efekteve të rastit, ne adresuan çështjet e heterogjenitetit që ndikojnë në koeficientë edhe si rezultat. Kur hyjnë në ekuacion në mënyrë individuale variablat, Investimet Huaja Direkte dhe kapitalit njerezorë, nuk janë statistikisht të rëndësishëm, megjithatë, kur ne përdorim termin “ndërveprim”¹⁵⁸ ata bëhen statistikisht të rëndësishëm dhe pozitivë. Do të thotë se kapitali njerezorë është i rëndësishëm dhe tërheqës për IHD dhe anasjelltas. Transferi teknologjisë¹⁵⁹ përmes IHD ka zvogëluar hendekun e krijuar në disa vende në zhvillim (Europa perëndimore) të cilat ndikuan në rezultatet tona.

Në vazhdim masim efektin i IHD në rritjen ekonomike i shfaqur në regresionet 1 dhe 4, tabela 19, koeficientët janë pozitivë dhe statistikisht të parëndësishëm (koeficientet 0.006 - 0.024 %). Pra gjetjet tona treguan se efekti i IHD në rritje nuk është gjetur, theksohet se IHD nuk plotëson investimet e brendshme, prandaj duhet të inkurajohen IHD-të që potenciali i tyre të rritet dhe të investohet në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë ku kapitali i brendshëm nuk mund të hyjë dhe ku mungon ekspertiza. Në anën tjetër edhe investimet e brendshme duhet stimuluar me rritjen e kursimeve, lehtësira fiskale në mënyre që të arrihet një komplementaritet pozitivë me kapitalin e huaj e jo negativë siq janë rezultatet tona.

Kjo shpjegohet edhe nga natyra e IHD-ve, periudha 2004-2014 ende karakterizohet nga privatizimi në dëm të investimeve Greenfield, ngjashëm si në studimet e Mecinger

¹⁵⁸ IHD* HC është një term ndërveprimi, është përdorur me qëllim të kapjes së efektit të një fuqie punëtore të arsimuar e cila ka aftësi absorbuese të fluksit të mjeteve valutore në formë të teknologjisë, njohurive, etj.

¹⁵⁹ Në lliteraturen e fundit theksohet roli potencial i IHD në rritjen ekonomike përmes transferit të teknologjisë Grossman dhe Helpman (1991, kapitujt 11 dhe 12), megjithatë vendi pritës duhet të disponoj një nivel të pragut të njohurive mbi atë minimal të kërkuar, Borensztein et. al. (1998:125).

(2003)¹⁶⁰. Në periudhë e studimit ulen ndjeshëm IHD nga kriza globale, europiane dhe një pjesë e vendeve në mostër karakterizohen me borgje dhe importe të larta.

A janë rezultatet tona për IHD në përputhje me studime tjera ?

Rezultati ynë është në përputhje me disa nga studime tjera me të dhëna panel, të cilat nuk gjejnë një efekt të rëndësishëm të IHD-ve në rritjen ekonomike në vendet në zhvillim (Alfaro, 2003; Alfaro et al., 2004; Carkovic dhe Levine, 2005; Herzer et al., 2008).

Borensztein, et al. (1998:1), raporton se *“IHD është mjet i rëndësishëm për transferimin e teknologjisë, duke kontribuar relativisht më shumë në rritje se në investime të brendshme. Megjithatë, produktiviteti më i lartë i IHD-ve është kur vendi pritës siguron një prag minimal të kapitalit njerezorë.”*

Ai gjenë efekte pozitive të IHD në 46 vende sepse kishin prag të mjaftueshëm të kapitalit human nga gjithsej 69, ndërsa 13 vende efekti pozitiv i IHD nuk ishte arritur në rritje sepse nuk e kishin pragu e mjaftueshëm të shkollimit, (Borensztein et al (1998).

Edhe Mileva (2008), argumenton pse koeficientet e IHD ishin të ulët në studimin e saj në krahasim me studime tjera, citon, Ali H. Elboiashe (2011:199)¹⁶¹ duke theksuar se shkakë mund të jenë seri kohore të shkurtëra ose luhatshmëri e lartë e normave të IHD në disa ekonomitë në tranzicion. Ndërsa në rastin tonë qëndron kjo e fundit, pra normat të ulëta të IHD dhe reformat e shumta strukturore në disa vende në tranzicion dhe në zhvillim si dhe paqëndrueshmëria ekonomike në disa vende të zhvilluara që ndodhi pas vitit 2003, bëri që

¹⁶⁰ Mecinger (2003), përdore testin e shkaktësive me dimension kohor të gjatë, ndërsa në studimin tonë duhet interpretuar me kujdes testin e shkaktësive për shkak të dimensionit kohorë të reduktuar (T=11).

¹⁶¹ Nëse rezultatet tona i krahasojmë me studime tjera nuk janë shumë të ndryshme nga ato të Mody dhe Murshid (2005) që raportuan koeficientet për IHD prej 0.72, 0.61, Mileva (2008) raportoi 0.46. Ndërsa studimi ynë raporton koeficientë prej (0.24). Studimet e Borensztein et al. (1998:125) raportuan koeficiente për IHD 2.82; Bosworth dhe Collins (1999) raportuan 2.34; Agosin dhe Mayer (2000) raportuan 5.56.

regresioni i mostrës të raportoj rrezultat të parëndësishëm të IHD në rritje. Kjo tregonse vendet në zhvillim edhe pse kanë rritje ekonomike më të madhe se vendet e zhvilluara, janë dobësia relativee institucioneve, ritmi i ngadalshëm i privatizimit dhe mos-anëtarësimit në BE ndër shkaqet e ritmeve të ulta të IHD-ve, sidomos në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndërsa është pritur një efektë pozitiv i IHD në rritje duke pasë parasyshë se disa nga vendet në zhvillim, viteteve të fundit janë bërë destinacion i rëndësishëm i IHD-ve.

3. Kapitali Human (HC), si masë e zhvillimit të kapitalit njerëzor, koeficientët në regresionin 1 dhe 2, janë statistikishtë të parëndësishëm ndërsa regresioni 3 raporton koeficientë negativë prej - 0.0198 (tabela 19). Edhe në regresionin 4 bëhet vlersimi i fuqishëm i gabimeve standarde “Robust standard ” i variablave duke pasë parasyshë dallimet në mesë vendeve në panel. Paneli i elasticitetit të shkallës së rritjes së GDP për frymë në regresionin 4, duke pasë parasyshë dallimet në mesë vendeve në panel zbulon një shenjë dukshëm negative me koeficientë -0.0213 (-0.2%) për kapitalin human.

Se në çfarë niveli është aftësia absorbuese e kapitalit njerëzore këtë mund ta vertetojmë me gjetjen e “pragut”, rezultatet sugjerojnë se një prag minimal duhet të arrihet, dhe ky pragë është rreth 14.3% e popullsisë kanë nga një diplomë të shkollimit të mesëm të lartë, megjithatë 90% e nxënësve në vendet në zhvillim janë të orientuar në shkollimin në shkenca sociale dhe 10 % në shkollimin profesional. Duhet ndërruar strukturen e shkollimit dhe rritur investimet e firmave në trajnim dhe zhvillim të aftësive të punonjësve sidomos në 17 vende në zhvillim në mostrë prej 24 vendeve.

Nga sa shihet vendet e EQ¹⁶² dhe ETL-se,¹⁶³ kanë një nivel të kapitalit njerëzorë me të lartë (14.3%) se në shumicën e studimeve vendet në zhvillim (10-16%), ku është siguruar pragu minimal i kërkuar nga Borensztein et al (1998), Alfaro et al (2004), etj¹⁶⁴. Megjithatë aftësitë dhe njohuritë e tyre janë të pamjaftueshme për të rritur produktivitetin në firma vendore, prandaj kërkohet më shumë investime¹⁶⁵ në kapitalin human nga firmat vendore në mënyrë që të kapin më lehtë përhapjen e njohurive dhe të teknologjisë së huaj.

A janë rezultatet tona për kapitalin human (HC) në përputhje me studime tjera ?

Kjo tregon se kapitali njerëzor teknikë, nuk mund të rrisë rritjen ekonomike në 24 vende europiane në studimin tonë. Pra po të merrte kapitali i ditur njerëzor (regjistrimi terciar ose R&D) do të ishte me efikas se kapitali njerëzor teknik në vendet e zhvilluara në moster, duke shpjeguar arsyen pse njerëzit dhe qeveritë kushtojnë më shumë vëmendje arsimit të lartë (akademik) se arsimit të mesëm (teknik). Edhe pse niveli i arsimit të mesëm ka siguruar një prag mbi minimalen e kërkuar për të absorbuar teknologjinë edhe njohuritë e kompanive të huaja megjithatë, orientimi i nxënësve në shkollimin joadekuat bënë që firmat e huaja dhe ato vendore të hargjojnë kosto shtesë në aftësimin profesional të tyre

¹⁶²Vendet e zhvilluara në moster (Gjermania, Zvicra, Holanda, Suedia, Norvegjia, Italia) kanë nivel të lartë në variablat R& D dhe zhvillimi financiarë është i theksuar dhe përfitimet më të mëdha i kanë nga R&D meqenëse disponojnë me teknologji të avancuar e cila kërkon edhe njohuri të avancuara, dhe nuk është faktorë i rëndësishëm kapitali human i matur me nivelin e mesëm të lartë të shkollimit si në rastin e vendeve në zhvillim apo në tranzicion.

¹⁶³Kanë një mesatare më të lartë të regjistrimit bruto të shkollimit të mesëm të lartë, si % e popullsisë së vendit edhe pse tendencat e regjistrimit në këtë nivel në vitet e fundit kanë shënuar rënjë krahasuar me 2004.

¹⁶⁴Gjetjet tona janë në kundërshtim me shumë nga studimet të kryera, dhe shpjegimi qëndron në karakteristikat e vendit, disa studjues përdorin vetëm vendet në zhvillim, disa të tjerë përdorin vende të përziera si në rastin tonë (dhe rezultatet janë të njëjta).

¹⁶⁵Një mundësi nga ana e qeverive të këtyre vendeve të investojnë më shumë në shkollimin dhe trajnimin e tyre profesional.

prandaj edhe rezultatet në regresionin 1 deri 4 (tabela 19) kanë dhënë koeficient ose negativ ose pozitiv pa rëndësi statistikore.

Rezultate të ngjashme janë raportuar nga Knight et al. (1993), Razin dhe Collin (1997), dhe Savvides (1995). Ndërsa (Levine dhe Renelt (1992), gjejnë në studimet e tyre rezultat negativë dhe të parëndësishëm të koeficientit të shkollimit duke theksuar se ky rezultat mund të jetë për shkak të problemit të matjes. Sipas Romer (1989), dhe De Gregorio (1992), rezultatin e parëndësishëm statistikorë të variablës së shkollimit e konsiderojnë si rezultat i kolinearitetit në mesë IHD dhe shkollimit. Edhe Romer (1989) dhe De Gregorio (1992) nuk kanë gjetur ndikim të rëndësishëm të kapitalit njerëzor në rritjen ekonomike.¹⁶⁶

4. Investimet e brendshme (INV.BR),¹⁶⁷ në vazhdim (tabela 19, rezultati i ekuacionit të rritjes tregon se investimet e brendshme¹⁶⁸ kanë ndikim të fortë pozitivë (niveli i rëndësisë 1%), pra rritja 1 përqind e investimeve të brendshme nxitë rritjen ekonomike prej 9% (koeficienti 0.0896 ose 8.9 %). Ne kemi gjetur pra se investimet e brendshme janë një burim i rëndësishëm dhe i konsiderueshem i rritjes ekonomike në vendet europiane.

¹⁶⁶Barro (1991) nga ana tjetër, ka raportuar një koeficient pozitiv dhe të rëndësishëm për regjistrimin në shkollë niveli i mesëm. Gjithashtu, Barro (1994) me vonë raportoi një koeficient pozitiv për shkollim të mesëm mashkullor, ndërsa për atë femrorë raporton lidhje negative me rritjen ekonomike.

¹⁶⁷ Investimet e brendshme përfaqesohen nga diferenca e GCFC dhe IHD-ve. Ne presim një kontribut pozitivë të INV.BR., meqenese ndryshe nga autorë të tjerë ne kemi përfshire kapitalin fizik dhe vlerën totale të trajnimit dhe kualifikimit të popullsisë, njësoj për të gjitha vendet. U vertetua se kapitali human në seksionin kryq të vendeve nuk ishte i rëndësishëm, kjo tregon se kapitali i brendshëm nuk është i varur nga kapitali human (i njëjti rezultat është gjetur nga Campos dhe Cinoshita (2002) kur në mostër kishte vetëm vendet në tranzicion.

¹⁶⁸ Investimet e brendshme (fluksi i kapitalit dhe flukset e teknologjise), është vertetuar se së bashku me IHD është variabël endogjene, dhe ndikohet nga mjedisi ekonomik. Këtë e ka shpjeguar edhe Durlauf et al. (2005), thekson se efekti marginal i rritjes së investimeve të brendshme është i lidhur me efektin e mjedisit të secilit vend.

Gjetjet pozitive në Investime të brendshme, na konfirmojnë se transferi i teknologjise në shumicën e vendeve në moster bëhen përveq përmes IHD ndihmuar edhe nga importi (tregtisë). Përfitimet e Investimeve vendase nga IHD në këtë rastë janë përmes eksternaliteteve indirekte që do të shihen në variablat në vazhdim.

Nëse nisemi nga modeli egzogjen, rolin e IHD e shohin si akumulim të kapitalit (IHD si rrjedhë hyrëse që i shtohet kapitalit vendas), në rastin tonë nuk qëndron, IHD-të shihen në këndvështrim të modelit endogjen të rritjes, sepse gjetjet tregojnë se IHD e kanë ndryshuar strukturën e investimeve të brendshme përmes rritjes së cilësisë së tyre edhe pse efekti i tyre ka rrjedhën dalëse (jashtë vendit) kur ndërvepron me IHD.

5. Termi ndërveprim në mes IHD dhe investimeve të brendshme

IHD në ndërveprim me Investimet e brendshme në tabelën 19, jep përgjigjeje në pyetjen:

Sa kanë kontribuar të dy llojet e investimeve në rritje ekonomike ?

Përgjigjeja është, kanë dhënë efektë negativë¹⁶⁹ dhe të rëndësishëm në nivelin 10%, pra rritja prej 10% e variablave në bashkëveprim ulë rritjen ekonomike për-0.002%. Në aspektin teorik nga ndërveprimi në mes dy variablave (akumulimi i kapitalit dhe ndryshimi i strukture së kapitalit nga IHD) pritet efekti pozitivë në rritjen ekonomike. Ndërsa ndodhë e kundërta efekti në rritje është negativë për shkakë se IHD nuk kontribojnë direkt

¹⁶⁹ Gallagher dhe Zarsky (2007) klasifikojë kanalet për grumbullim brenda (Crawdin-in) të IHDve për dallim nga rezultati ynë grumbullim jashtë (crawdin-out). Crawdin-in është si rezultat i ofrimit të mallrave dhe shërbimeve nga ana e firmave të huaja dhe përdorimi i inpute me efikasitetit, ndikon në rritjen e industrisë vendase. Grumbullim “brenda” mund të ndodhë për shkak të përhapjes së njohurive nga firmat shumëkombëshe të firmave vendase që përfitojnë nga casje në teknologji të reja dhe njohurit. Së fundi, efektet shumëzues mund të vërehet kur IHD hyn në vendin pritës. Një shembull i efekteve të tilla mund të jetë që investitorët e huaj të rritin numrin e të punësuarve në vendin pritës në këtë mënyrë rrisin shpenzimet lokale për mallra dhe shërbime të prodhuara në vend, e cila është e favorshme për investitorët vendas.

në rritjen e investimeve të përgjithshme, pra në afatshkurtër së bashku dy llojet e investimeve nuk kontribojnë në rritjen ekonomike, kjo do të ndodhë vetëm në fatëgjatë (që në rastin tonë variabla IHD nuk është matur në afat të gjatë).

Kompanite vendore në rastin tonë janë detyruar për një kohë të tkurren apo edhe të largohen nga tregu. Megjithatë kjo nuk do të ndodhë në një afatë më të gjatë sepse më vonë efekti është pozitiv nga rritja e cilësisë së investimeve në përgjithësi. Sipas rezultateve shihet se strategjia e IHD ishte hyrja e tyre në formën e bashkimit dhe blerjeve (M & A)¹⁷⁰ se atyre greenfield, sepse do të kishin kontribuar më shumë me akumulimin e kapitalit fizik pavarësishtë presionit fillestarë konkurrues.

Pra kontributi i IHD shihet më shumë përmes eksternaliteteve teknologjike (efekteve indirekte), krijimin e lidhjeve tregtare me prodhuesit vendorë përmes nënkontraktimeve, transferit të njohurive në firmat vendore, ekspertizes, etj. Kjo shihet nga efekti pozitiv i investimeve vendase në rritjen ekonomike kur janë vënë në regresion vetëm, përfitimi nga IHD pra shihet si indirekt.

¹⁷⁰ IHD në formën e bashkimit dhe blerjeve (M&A) nuk kontribon në mënyrë të konsiderueshme në akumulimin e kapitalit, sepse M&A janë transaksione financiare pas ndryshimit të pronësisë, për dallim nga IHD Greenfield që çdo gjë është nga fillimi. Nga bashkimi dhe blerjet mund të përfitojnë më shumë vendet që kanë një treg financiar të zhvilluar sepse nga transaksionet krijohen burime monetare dhe në tregun financiar pas rishpërndarjes për të financuar projektet të reja të investimeve dhe përfitimi nga kjo është më i madhë nga këto vende. Në vendet në moster mund të kishin përfituar vendet e zhvilluara dhe vendet që janë anëtare të BE-së sidomos Hungaria dhe Polonia që kanë marrë më shumë IHD në krahasim me vendet e EJT-së.

*A janë rezultatet tona për IHD*INV.BR në përputhje me studime tjera ?*

Ndërsa ne ishim të interesuar të dijmë se Investimet e Brendshme a bashkëpunojnë me IHD,¹⁷¹ që të ndodhë efekti grumbullim brenda (crowding in) dhe sa kontribuojnë të dyja në rritje, rezultatet tona e thonë të kundërtën.

Hipoteza jonë parasheh se hyrjet e IHD-ve do të çojnë në sasi të re¹⁷² ose më të lartë të investimeve të brendshme, dhe të dyja se bashku do të qojnë në rritjen ekonomike, derisa në mungesë të IHD kjo nuk do të ishte e mundur (grumbullim brenda i investimeve të brendshme “Crowding in”, ndodhë kur investimet e huaja gjenerojnë përhapje pozitive në ekonominë vendase).

Në thelbë gjetjet negative në këtë punim konsiderohet kur IHD duke bashkëvepruar me Investime të brendshme ka ushtruar një ndikim negativë në rritjen ekonomike. Kjo gjithashtu tregon se IHD jo vetëm se nuk kanë hyrë ashtu siq pritej por që kanë edhe një marrëdhënjë të fuqishme negative me kapitalin në vendin pritës. Ndërkohë rezultatet e analizave tregojnë se ka efektë të jashtëm grumbullues¹⁷³ „crowding – out”,¹⁷⁴ që ndodhë

¹⁷¹Ne ishim të shqetësuar se firmat e huaja që operojnë në vend do të ketë më shumë pushtet bisedimeve se firmat vendase (Dunning, 1981).Përtej këtyre shqetësimeve, ka edhe një debat nëse grumbullohen IHD ose Investimet e Brendshme, rezultatet janë se IHD janë grumbulluese të investimeve të brendshme duke krijuar efektin negativ crowdin-out në mostrën e studimit tonë. Një arsye e fortë është se periudha 2004-2014 konsiderohet se janë përfshirë IHD me shumë në privatizimin e ndërmarjeve të ekonomive pritëse.

¹⁷² Romer (1993) në një studim përmes modelit të rritjes endogjene, ka pranuar se futja e mallrave të reja ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomise. Kështu IHD supozohet të kontribuojë në formimin e kapitalit të vendit pritës nëpërmjet futjes së mallrave dhe teknologjive të reja.

¹⁷³ Edhe Cristina Jude (2014), gjithashtu në analizën e saj empirike në Evropën Qendrore dhe Lindore konfirmon efektin grumbullim-out të investimeve të brendshme në IHD, në një afat të shkurtër.Efekti negativ është në rënie me kalimin e kohës, meqenese filialat e huaja kanë filluar të zhvillojnë lidhjet tregtare me furnizuesit lokalë, por nuk janë kthyer ende fuqishëm në një grumbullim-brenda “crowding-in”.Rezultatet tona sugjerojnë se investimet greenfield janë të vetmit që ndjeshëmrrisin stokun e kapitalit prandaj duhet stimuluar këtë lloj investimi të huaj. Hungaria, Polonia dhe Estonia kanë përfituar më shumë nga ky grumbullim-brenda.

¹⁷⁴ Efekti crowding out- Efekti kryesor negativ i crowding out është fuqia monopol mbi tregun vendas nga kompanitë investuese.

kur IHD shtrembëron aktivitetin e firmave të mbrendshme dhe bashkëpunëtorëve tjerë të huaj nga aktiviteti i investimeve duke i larguar ata nga bizneset (Bende-Nabende dhe Slater, 2003). Qeveritë e vendeve dhe sidomos qeveria e Kosovës duhet të ofroj masa stimuluese fiskale dhe dhënjën me tokës falas investitoreve që ofrojnë investime Greenfield, ndërsa firmave vendore qasje më të lehtë në financa. Efekti grumbullim jashtë në vende të CEE është gjetur edhe nga Jude C. (2015), edhe ky studim forcon më shumë bindjen se CEE dhe sidomos EEL dominojnë investimet Brownfield në krahasim të Greenfield. Matja e këtij efekti në afat shkurtër tregon se ky efektë nuk do të zgjasë për shumë kohë, prandaj nevojiten edhe veprimet e qeverisë.

Rrjedhë natyrshëm pyetja: *A duhet intervenuar shteti në rastë të paraqitjes së efektit grumbullim jashtë për një kohë më të gjatë ?*

Meqenëse, veprimi i tregut të lirë ju jep hapësirë IHD të bëhen konkurrente dhe nga kjo përfitojnë konsumatorët me blerjen e produkteve me cilësore dhe më të lira, është vetëm njëra anë e medaljes, në anën tjetër efekti grumbullim jashtë shkakton lëvizje negative në tregun e punës dhe në tregun e biznesit duke lënë jashtë tregut firmat vendore që nuk mund të bëjnë ballë konkurrencës. Gjithashtu do të diversifikojnë fitimet e tyre në vende tjera ku normat e kthimit të investimeve janë më të larta. Prandaj duhet kombinuar masat stimuluese nga shteti me tregun e lirë për të rikthyer fuqishëm efektin crowding –in në vendet pritëse, përmes rritjes së kërkesës për mallra dhe shërbime, aktivitete tjera të ndërmjetme në mes firmave të huaja dhe atyre vendore.

Si rezultat i efektit crowding – out, gjetjet tona në ekuacionin e rritjes raportuar efektin IHD në rritje statistikisht të parëndësishme edhe pse pozitivë. Përveq efektit grumbullim jashtë në performancën e IHD në rritje, kanë ndikuar edhe prurjet më të ulta të IHD sidomos pas vitit 2010.

Në rastin e një efekti grumbullimi-jashtë “crowding – out”, sugjeron për autoritetet se mund të përdorin leva fiskale për të stimuluar riinvestimin e burimeve të kapitalit të pa angazhuar nga ndërprerja e aktivitetit, Cristina Jude (2014:25).

Ndërsa Borenzstein, et al.(1998:125) efektin “crowdin –out” e argumenton se ndodhë kur përhapja pozitive nuk ndodhë për shkak se investimeve e huaja rrisin koston e pranimi të teknologjive të reja, e cila me pastaj nuk rritë normën e rritjes.¹⁷⁵ Pra si konkluzion themi se firmat lokale duhet të investojnë më shumë në kërkim –zhvillim dhe shkollimin e personelit të mesëm për të qenë konkurente me firmat e huaja. Kështu që IHD mund të gjenerojë kërkesën për inpute të specializuara, duke rritur produktivitetin marginal të investimeve të përgjithshme në këto inpute.

Në studim de Mello (1999) ka analizuar të dhënat nga 1970-1990 për 32 vende ndërsa Apergis Katrakilidis dhe Tabakis(2006) kanë analizuar 30 vende gjatë periudhës 1992-2002. Të dy studimet gjeten rrezultate të përziera.

Ata theksuan në ekonomitë me teknologji më të avancuar IHD zëvendësohen nga kapitali vendas (crowding –in), ndërsa në ekonomi me teknologji më pak të avancuar kapitali vendas plotëson IHD (crowdin-out).

¹⁷⁵Shih: ekuacionin e rritjes në rastin tonë ku ndodhë e kundërta, INVE.BRE. nëndërveprim me IHD kanë dhënë efektë negativ në rritje, ndërsa në kemi pritur një efektë pozitiv në rritje nëse variablat i vëmë në ndërveprim me njëra tjetren (siq ndodhi të ekuacioni i rritjes ekonomike kur bashkeveprimi i IHD me kapitalin human sjelli efekte pozitive në rritjen ekonomike në 24 vende europiane).

6.Termi IHD në bashkëveprim me kapitalin human (IHD*HC), në tabelen 19, efekti indirekte vërtetohet nëse e shikojme efektin pozitivë të dy variablave tjera në ndërveprim IHD dhe Kapitali human (IHD*HC), IHD janë atraktive për kapitalin human në vend, specializimi dhe trajnimi i kapitalit human nga IHD dhe me pastaj levizja e kapitalit human nga firmat e huaja në firma vendore ka sjelle efektin pozitiv të investimeve privatë (brendshme) në rritjen ekonomike. Ky zëvendësim ka dëmtuar kontributin e IHD¹⁷⁶ në rritje ekonomike në gjetjet tona. Nëse theksojmë se gjatë periudhës së studimit ka pasë një rënjë të madhe të fluksit hyrës të IHD në këto vende, vërtetohet efekti direkt i parëndësishëm i IHD në rritjen ekonomike.

Termi i ndërveprimit IHD*HC, është pozitive dhe statistikishtë i rëndësishëm në nivelin 10%. Rritja e variablave ndërvepruese prej 10% ka shaktuar rritje ekonomike për 0.003% (regresionin 3, tabelës 19), ndërsa në regresion 4 tabela e njëjtë, rritja e variablave bashkëvepruese prej 10% ka ndikuar në rritjen ekonomike në vlerë relative prej 0.004%. Meqenese koeficientet nuk kane ndryshime të mëdha nga regresioni 3 dhe 4 edhe pas vlersimit të fuqishëm të gabimeve standarde (për shkak të dallimeve që egzistojnë në mes vendeve në moster) do të thotë se rezultatet tona janë shumë të sakta.

Kjo tregon se kapitali njerëzor teknike kur bashkëvepronë me IHD mund të rrisë rritjen ekonomike në shumicën e vendeve europiane. Si rezultat, ne pranojmë hipotezën se

¹⁷⁶Njësoj ka analizuar efektin e IHD në rritje Carkovic dhe Levine (2000), në 72 vende në periudhën 1960-1995, duke përdorur katrorët e vegjël, vërtetohet se IHD nuk kanë ndikim pozitiv në rritje. Edhe, Wamboyne (2012) analizoj ndikimin e IHD në rritje në 40 vende në zhvillim të dhënat për vitet 1975-2010, dhe gjetjet nuk treguan ndikimin pozitiv të IHD në rritje.

ndikimi i IHD-ve në rritjen ekonomike në vendin pritës është i kushtëzuar nga niveli kapitalit njerëzor.

*A janë rezultatet tona për IHD*HC në përputhje me studime tjera ?*

Ky rezultat është në përputhje me Borensztein et. al. (1998) dhe Li dhe Liu (2005), por është në kundërshtim me gjetjet nga Carkovic dhe Levine (2005), Herzer et al. (2008) për vendet në zhvillim. Janë përdorur versione të modeleve të ndryshme për besueshmërinë e ndërveprimit të variablave IHD *HC.

Me këtë vlersim është marrë edhe, Nair-Reichert dhe Weinhold (2001:137-72), duke përdorur një panel të dhënave për 24 vende në zhvillim në periudhë kohore 1971-1995, në një model dinamik. Rezultatet në lidhje me IHD dhe termit ndërveprim me HC ishin të përziera në varësi së cfarë teknike vlersimi përdornin.

Kjo na qonë në një përfundim se në vendet e Evropës Qendrore Lindore dhe Juglindore, IHD-të janë të varura nga kapitali human (pra janë të kushtëzuara nga kapaciteti absorbues i vendit) i cili është duke kontribuar indirekte në përshpejtimin e progresit teknologjik duke kapur përhapjen indirekte. Prandaj investimet më të mëdha në kapitalin human do të përmirësoj aftësitë dhe njohuritë e tij,¹⁷⁷ që të mund të kontriboj edhe direkte, dhe jo vetëm indirekte përmes përhapjes të tij nga Investimet e Huaja Direkte. Ndërsa gjetjet tona janë në kundërshtim me studimin e kryer për vende të EQL nga Cristina JUDE (2012:151)¹⁷⁸ ku gjenë një efektë direkt pozitiv të kapitalit human në rritje (vendet në

¹⁷⁷Niveli i mesëm i arsimit më shumë është i drejtuar në shkenca sociale se në arsimin profesional. Mungesa e kordinimit në mesë sektorit privat dhe sektorit publik të arsimit, mungesa e fondeve dhe një platforme për një arsin profesional sidomos në vendet e Europës Perendimore në mesin e tyre edhe Kosova, ka bërë që kontributi direkte i kapitalit human në rritjen ekonomike të mos shihet në studimin tonë.

¹⁷⁸Cristina JUDE (2012:151), në mostren prej 10 vendeve që ishin me karakteristika të njëjta poashtu edhe anëtare të BE-së, vende të ndryshme nga mostra jonë, kanë dhënë rezultate pozitive për ndikimin direkte të

mostër janë anëtare të BE-së dhe shumica prej tyre të ndryshme nga vendet në mostren tonë). Rezultati ynë efekti direkte negativ i kapitalit human në rritje mund të shpjegohet nga shpenzimet të ulta për arsim dhe njëkohësisht edhe struktura e tyre jo e përshtatshme në shumicën e vendeve në moster (vendet në zhvillim të Europës lindore dhe perëndimore me karakteristika të ndryshme).

7. Remitancat si përqindje e GDP-së (REM), statistikisht nuk parashohin rezultat të rëndësishëm në asnjë nivel koeficienti (0.014) dhe në të katër regresionet, edhe pas vlersimit të fuqishëm të gabimeve standarde. Kjo do të thotë se remitancat (tabela 19), në këto vende nuk konsiderohen burim i qëndrueshëm i rritjes ekonomike. Ndërsa në hipotezë remitancat janë konsideruar përcaktues i rëndësishëm i rritjes, rezultatet nuk e vertetojnë. Pra nuk gjejmë dëshmi për mbështetjen e remitancave në rritje ekonomike.

Kjo përshatet me argumentin se remitancat mund të kenë efektë pozitiv në rritjen ekonomike në afatë të shkurtër ndërsa pas një periudhe kohore ato mund të bien. Pra rezultati nuk është në kundërshtim me besimin më të përhapur se dërgesat hyrëse të emigrantëve nuk duken të jenë forca kryesore që qëndron mbrapa rritjes ekonomike në vendet europiane sepse ndikimi i tyre sasior është i papërfillshëm në shumicën e vendeve (në disa vendeve të Europës perëndimore remitancat janë 3 herë më të larta se IHD).

HC në IHD dhe rritje ekonomike, pa u ndikuar njera variabël në tjetren. Autorja konfirmojn gjetjet e Neuhaus (2005) dhe Campos dhe Cinoshita (2002) në CEEC, ndërsa gjetjet e saj janë në kundërshtim me studimin tonë dhe të Boreinsztein, et al (1998), ku variablat ndërvepruese dhanë rezultat pozitivë. Një specifikim të Boreinsztein et al (1998), IHD direkt ka efekt pozitiv në rritje në 46 vende që kanë plotësuar pragun e aftësisë thithese prej mostres prej 69 vendeve, edhe ndërveprimi i dy variabla ka dhënë rezultat pozitivë, ndërsa në rastin tonë IHD direkt nuk dhanë rezultate pozitive në rritje, pra ne gjetëm veten në një drejtim lidhjen pozitive të rritjes ekonomike me IHD kur matja është bërë në afat të gjatë kohor (përdorëm log-un në të dy anët e ekuacionit të IHD e varur): log_IHD si variabël e varur dhe log_GDPgpc e pavarur, dhe poashtu kur përdorëm testim Granger të lidhjes shkajkore (Granger causality) në mes dy variablave si të varura x dhe y, në të dy rastet kapim vetëm efektin një drejtimësh pozitiv të rritjes ekonomike në IHD.

Megjithatë, për shkak të periudhës të shkurtër kohore (11 vite) për të cilën të dhënat janë të disponueshme gjetjet tona duhet të konsiderohen jopërfundimtare. Rezultatet mund të ndryshojnë ndërsa bëhen të disponueshme më shumë të dhëna.

Edhe pse shumica e vendet europiane në mostër konsiderohen ndër vende që kanë tërhequr më së shumti remitanca në Europë gjatë dy dekadave,¹⁷⁹ tendencat e fundit (ulja e emigracionit dhe kriza ekonomike në vende ku ka më shumë emigrant siq janë Greqia dhe Italia), theksojnë se ato po bien dhe nuk konsiderohen faktorë i përshtatshëm për rritjen ekonomike afatgjate.

8. Madhësia e qeverisë (SHP.P.K.F.Q) përfaqësuar nga shpenzimet e përgjithshme të konsumit final të qeverisë, koeficienti i madhësisë së qeverisë paraqitet me shenjë negative -0.039 dhe statistikisht të parëndësishëm edhe pas vlersimit të fuqishëm të gabimeve standarde (tabela 19).

Një qeveri me shpenzime të larta në raport me GDP në vendet europiane, ka qar në uljen e rritjes ekonomike, njësoj si në studimet e autoreve, Grier dhe Tullock (1989), Barro dhe Lee (1994), nga Elboiashi, Husein Ali (2011:195, chap.IV), megjithatë rritja e tyre nuk është e lartë për të ndikuar shumë në uljen e rritjes ekonomike sepse ka shenjë negative por të parëndësishme.

¹⁷⁹ Në periudha kohore në disa vende, p.sh. Shqipëria, Kosova, etj., shuma e remitancave ishte disa herë më e madhe se eIHD-ve dhe ndihmës së huaj).

5.1.3 Zgjidhja e Hipotezës se dytë IHD e varur

Për të marrë rezultatet përfundimtare¹⁸⁰ për IHD e varur kryejme testet enevojshme:

1. Testi Hausman (tabela h në shtojca A)

Për të vendosur në mes të modelit efektet fikse dhe modelin efektet e rastit ne kemi përdorur një test Hausman. Çështja qëndron, nëse efektet unike (u!) të rastit janë të lidhura me variablat e pavarura (regresor) në regresionin tonë.

- ✓ H zero = thotë, u! efektet e rastit nuk janë të lidhuara me regresor, dhe se modeli RE është i preferuar.
- ✓ Hipoteza alternative = thotë, u! është i lidhur me regresorët në modelin e efekteve fikse dhe është teknike me e avancuar e vlersimit.

Hipoteza e mëposhtme duhet të testohet: $H_0: a = 0$ dhe $H_1: a \neq 0$.

Rezultati i testit Hausman është shfaqur në tabelën 20 (në shtojcë tabela c) dhe është bindëse që hipoteza alternative hidhet poshtë në nivelin e rëndësisë 1%.

Testin Hausman,¹⁸¹ ka identifikuar cili është vlerësuesi më i saktë.

Tabela 20 tregon se testi Hausman (1978) konfirmon zgjedhjen e përdorimit RE në vend që të FE, sepse p-vlera e saj është më e madhe se 0.05. Prob 0.156 > 0.05 sugjeron se duhet përdorur metoda e Efekteve të Rasti, prandaj ne përdorim metoden e Efekteve të Rastit, siq parasheh edhe Clark dhe Linzer, (2012:2).

¹⁸⁰ Rezultatete e tabelave: f, g, h, janë në Shtojca A . Përpunimi elektronik nga autori në nga Stata 12.

¹⁸¹ Për më shumë detaje si përdoret testi Hausman , reference <http://www.stata.com/manuals13/rhausman.pdf>;

Table 20. Vlersimi i testit Hausman tabela h, Shtojca A, në modelin panel

	Coefficient (b) Fixed	Coefficient (B) Random	(b-B) Diference	Sqrt (diag (V_b- V_B)) S.E
Log_ΔGDPGPC~ë	.2676096	.2798688	-.0122592	.032659
HC	-.1070223	-.0203723	-.08665	.0364594
GCFC~f	.0430892	.0545818	-.0114926	.0081922
REM~m	-.0078233	.0363206	-.0441439	.0269042
SHP.P.K.F.Q~ë	.0257276	.0448618	-.0191343	.0403195

Kalkuluar nga autori. Shënim¹⁸²: b = në përputhje me Ho dhe Ha; marrë nga xtreg

B = kundërshtim me Ha, efikase në Ho; marrë nga xtreg

Test: Ho: Dallimi në koeficientët jo sistematike

$$\text{CHI2 (5)} = (b-B) [(V_b - V_B)^{-1}] (b-B) = 8.00$$

$$\text{Prob} > \text{CHI2} = 0.1560$$

Statistika, Hausman dhe Taylor(1981:1377), ka shpërndarje asimptotike si Hi-katror me k-shkalle të lirisë nën hipotezën zero, metoda efekteve të rastit (RE) është më e saktë. Pas kryerjes së testeve të nevojshme ne kemi ndjekur këtë logjikë të interpretimit:

Sipas statistikave të vertetuara në modelin tona, të gjitha testet - F, janë më të vogla se 0.5% (<0.05). Kjo është një provë (F) për të parë nëse të gjithë koeficientët në model janë të ndryshëm nga zero.

¹⁸² b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg; B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg; Test: Ho: difference in coefficients not systematic; chi2(5) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B) = 8.00; Prob>chi2 = 0.1560

Në të gjitha vlerësimeve tona, ne kemi rezultate në përputhje me F-testet e sugjeruara se koeficientët janë të ndryshëm nga zero dhe janë të rëndësishme për të shpjeguar shkallën e rritjes së Investimeve të Huaja Direkte si variabël e varur.

Statistikat gjithashtu sugjerojnë se R-katrorët variojnë në mes 0,149-0,396 duke sugjeruar fuqi të lartë shpjeguese të dy modeleve tona. Kjo shpjegon se më shumë se 39 për qind e variacionit të variablit të varur varet nga variacioni në ndryshore të pavarura në modelin RE, ndërsa në FE është 14.9 përqind. Ne tani kthehemi te diskutimi i rezultateve veq e veq për secilen metodë të përdorur (FE/RE), në dhënjen e konkluzioneve përfundimtare për secilen hipotezë të ngritur, duke ju përgjigjur pyetjeve kërkimore.

Testi i përcaktimit të RE kundrejt FE

Tabela 21: Zgjedhja RE kundëjt FE (Tabelat, shtojca A), rezultati.

Variablat Koeficientet Gab. stand. p-vlera	FE	RE
$\log_ \Delta \hat{y}_{it}$	- 0.267 (0.092)	0.027*** (0.086)
HC_{it}	- 0.107 (0.042)	- 0.02** (0.022)
$INV.BR_{it}$	0.043*** (0.022)	0.054*** (0.020)
REM_{it}	- 0.01*** (0.031)	0.036*** (0.015)
$SHPKFQ_{it}$	0.025*** (0.048)	0.044*** (0.026)
Konstantja	1.233 (1.233)	- 1.222 (0.836)
R-squares	149	396
Corr.	-975	0

Në kllapa janë gabimet standarde ;[RE : $p > |z|$] dhe [FE: $p > |t|$]

Nivelet e rëndësis: ***1%, **5%, *10%; Kalkuluar nga autori.

Ngjashmërit dhe dallimet në të dy modelet (RE/FE)

Rezultatet të koeficientet mund të konstatohet se ka ngjashmëri dhe dallime në dy modele të regresionit. Duke pranuar se një konstante (koeficienti-intercept) është shumë më e madh në modelin e efekteve fikse (1.233), por nuk është statistikisht e rëndësishme, në krahasim me konstanten RE (-1.222), e cila është statistikisht e rëndësishme edhe pse është negative, një konfirmim se duhet pranuar modeli RE.

Siç u tha në pjesën teorike, në modelin e efekteve fikse është i mundur heterogjeniteti individual i cili ishte kapur nga konstantja në tabelën 19, përmes versimit të fuqishëm të gabimeve standarde. Në metoda të efekteve të rastit nuk është aplikuar vlersimi i gabimeve standarde, dhe dallimet e supozuara që rrjedhin në mes 24 vendeve janë trajtuar si të rastit sepse ashtu edhe të dhënat janë marrë si të rastit, prandaj edhe rezultatet konsiderohen me bindëse në RE.

Sa i përket variablave dallimet e koeficienteve në dy modelet janë të mëdha, vetëm në variablat investimet e brendshme dhe shpenzimet e qeverisë ndryshimi është më i vogël dhe atë, në modelin RE ka koeficient pozitiv dhe të rëndësishëm, ndërsa në modelin FE janë negativë dhe të parëndësishëm përveq remitancave, prandaj vërtetimi i hipotezës së dytë bëhet përmes rezultateve të modelit RE.

Modeli RE tregon një rritje të GDP për frymë pozitive dhe ($p = 0.027$) statistikisht e rëndësishme në nivelin 1 përqind, dhe konstatohet se rritja e IHD varet nga rritja e GDP për frymë, një rritje prej 1 përqind e rritjes së GDP për frymë shkakton rritje të IHD prej 2.7%.

Një tjetër ndryshim është se R-katror është shumë më e lartë në modelin RE (39.6%) krahasuar me FE (14.9 %), do të thotë se 39.65 e rritjes së IHD varet nga variablat shpjeguese të përdorura në model, ndërsa pjesa tjetër nga variabla tjera të panjohura.

5.1.3.1 Rezultatet përfundimtare modeli Efektet e Rastit (RE)

Paraprakishte po theksojnë se variablat e kontrollit janë zgjedhur në mesin e më shumë se 60 variablave të rëndësishme statistikore, si përcaktues të IHD që studjues të ndryshëm kanë përdorur.¹⁸³

Regresioni i ekuacionit të dytë -fluksi hyrës neto i IHD i shprehur në përqindje të GDP-së, e përcaktua si variabël e varur (tabela 22). Fillimisht është parë shkalla e korrelacionit në mes vlerave të ndryshoreve (e varur dhe të pavarura).

Korrelacioni është zero që nuk tregon një lidhshmëri të fort apo të dobët ndërmjet variablave (r ose $\text{corr}(u_i, X) = 0$).

$\text{Prob } 0.156 > 0.05$ sugjeron se duhet përdorur metoda e Efekteve të Rastit.

¹⁸³ Sala-i-Martin(1997) theksoj disa prej tyre, ndërsa ne zgjedhem disa variabla kontrolli që paraprakishtë i ka përdorur edhe Nath (2009), Campos dhe Cinoshita 92002), Neuhaus (2005), dhe në bazë të Boreinsztein (1998), përveq variablave kryesore edhe variabla që bashkëveprojnë njëra me tjetren, megjithatë për dallin prej tyre nuk përdorem variabla që masin tregtin e jashtme importi dhe eksport ose luftën, korrupsionin efikasitetin e qeverisë etj, pasi që janë trajtuar disa prej tyre me të dhëna parësore përmes pyetsorëve të strukturuar që vertetojnë hipotezën e tretë.

Ekuacioni i regresionit (në rastin tonë modeli logaritmik), e tregoi statistikishtë të rëndësishme Wald $\chi^2(5, 203) = 36.49$, dhe $p = 0.000$, me masë të fuqisë shpjeguese R-sq: within $R^2 = 12.1^{184} \%$; R-sq Between: 39.6%; R-sq Overall: 20.1% (regresioni 1deri 3, fuqia shpjeguese sillet nga 12.1% deri 39.6%, tabela 22).

Rezultatet treguan se 39.6 % e shkallës së rritjes së hyrjeve neto të IHD mund të shpjegohen nga vlerat e variablave të pavarura, ndërkohë që 60.4 % e nivelit tyre shpjegohet nga faktorë të tjerë që nuk janë studjuar.

Në rastin tonë tabela 22, koeficientet jashtë kllapave interpretohen.

Zgjedhja e Efekteve të Rastit (RE) kundrejt Efekteve Fikse (FE)

Në tabelen 22, është përdorur metoda e Efekte të Rastit janë paraqitur rezultatet e regresionit ku përfshihen koeficientët e vlerësuar, gabimet standarde, vlerat R^2 , numrin e vrojtimeve, dhe F-statistikat me p-vlera përkatëse.

Ekuacioni i IHD, rezultatet e regresionit 3 (tabela 22), me modelin e Efekteve të Rastit:

$$\text{Log_IHD/GDP} = -1.122 + 0.28\text{GDP}_{\text{gpc_log}} - 0.010\text{HC} - 0.024\text{HC_1lag} + 0.021\text{HC_1 lag} + 0.055 + 0.034 + 0.052 + u_{it}^{185}$$

¹⁸⁴ Të gjitha statistikat sugjerojnë: R-squares nëse variron nga 0.39-0.41 sugjeron një fuqi shpjeguese të lartë për modelin tonë duke shpjeguar mbi 40 % të variacionit të variablave të pavarura në model.

¹⁸⁵ $u_i = \alpha_i + \varepsilon_{it}$, me α_i fillojnë variablat e rastit (being random variables - i.i.d. random-effects) dhe $\text{Cov}(\mathbf{x}_{it}, \alpha_i) = 0$ (vector $\mathbf{x}_{it}$ korespondon me variablat e pavarura që kanë hyrë në vlersimin tonë).

Tabela 22. *IHDe varur, rritja ekonomike e pav.(Rezultatati përmes metoda Efektet e Rastit).*

Regression number Independent Variable	Coeficient (Standars error)	(1) Random 1	(2) RE 2	(3) RE 3
log_GDPgrowthcapita		0.280*** (0.0860)	0.281*** (0.0860)	0.286*** (0.0867)
HC		-0.0204 (0.0221)	-0.00936 (0.0310)	-0.0104 (0.0314)
lag1_HC			-0.0103 (0.0283)	-0.0240 (0.0341)
lag2_HC				0.0212 (0.0284)
INV/GDP		0.0546*** (0.0207)	0.0542*** (0.0209)	0.0553*** (0.0210)
Remitancat/GDP		0.0363** (0.0157)	0.0366** (0.0160)	0.0343** (0.0164)
Shpen.Pergj.Kons.Fin.Qeve./GDP		0.0449* (0.0267)	0.0514* (0.0274)	0.0520* (0.0282)
Constant		-0.881 (0.836)	-0.998 (0.865)	-1.122 (0.887)
R-Squares (within, Bettwen, Overall)		121	396	215
Observations		203	202	201
Number of countryid		24	24	24
No. of countries below the threshold (start, end) = (24) 2004-2014		HC threshold ≈ 14.3%		

Shënim: Variabël e varur është IHD, ndërsa e pavarur është shkalla e rritjes së GDP për frymë. Vlersimi është me GLS.(Gabimet standarde janë në kllapa). *** p<0.01, ** p<0.05, * p<0.1 ; (1%, 5% , 10%).
Burimi:Të dhënat nga WDI, Kalkuluar nga autori.

Aktualisht shkalla e rritjes së GDP për frymë në këto vende luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e rritjes së IHD. Performanca e përgjithshme, modeli është i kënaqshëm, mund të shihet në statistikat e modelit të dhënë më poshtë:

Qëllimi i kësaj hipoteze është supozimi i përcaktuesve të IHD në disa vende europiane. Përcaktuesit e IHD në studimin tonë janë gjetur të jenë rritja e GDP për frymë, Investimet e brendshme, remitancat dhe shpenzimet qeveritare:

1.Rritja e GDP për frymë (GDPgpc), është përcaktues i IHD në një nivel rëndësie prej 1* që do të thotë se me rritjen prej 1 % të rritjes ekonomike kemi rritje të IHD prej 2,8 përqind (tabela 22), pra është siguruar marrëdhënja pozitive në njërin drejtim. Kjo është vertetuar edhe përmes test parmwise të shakësia Granger, (Granger, C.W. J, 1969:424-335) të cilin e kemi përdorur (në vijim tabela 24).

2.Investimet e Brendshme (INV G/DP),¹⁸⁶ konsiderohen faktorë i rëndësishëm në rritjen e IHD në nivel rëndësie prej 1*, prandaj me një rritje prej 1% të investimeve të brendshme kemi rritje të IHD prej 5.5 përqind (tabela 22). Pra investimet e brendshme kanë efektë pozitivë në IHD. Çfarë është marrëdhënja midis IHD dhe investimeve të brendshme, a janë ato zëvendësuese apo plotësuese ?

Meqenëse njëherë jemi përgjigjur në pyetjen: *Sa kanë kontribuar të dy llojet e investimeve në rritje ekonomike ?*

Tani na mbetet të marrim përgjigjeje edhe nga ekuacioni për IHD e varur:

Në rastin tonë IHD është zëvendësuese e investimeve të brendshme me efektë negativë (crowdin-out), IHD vijnë më shumë përmes bashkimit dhe blerjeve se atyre greenfield, duke u bërë konkurrencë investimeve të brendshme, pra janë krijuar monopole nga IHD në vendet pritëse (kjo u vertetu edhe në ekuacionin e rritjes kur bashkëvepruan IHD me investime të brendshme si rrjedhojë u përqua efekti negativ në rritjen ekonomike). Do të thotë se IHD fitimet e tyre mund ti kenë riatdhesuar apo dërguar (diversifikuar) në ndonjë vend tjetër për të investuar.

¹⁸⁶ Nëse ka një rritje 1% në IHD rezultat i një rritje prej 1% në Bruto Kapitalit Fiks, kjo do të thotë se IHD mbeten të pandryshuar dhe njihet se ndikimi i investimeve të brendshme është neutral.

3. Remitancat (REM), janë shfaqur të jenë përcaktues i IHD në një nivel prej 5%, prandaj me rritjen 5 % të remitancave kemi rritje ekonomike prej 3.4 % të IHD-ve (tabela 22).

4. Shpenzimet qeveritare (SHP.P.K.F.Q), janë gjetur të jenë përcaktues i rëndësishëm i IHD në një nivel rëndësie prej 10%, me rritjen prej vetem 10% të tyre kemi rritje të IHD prej 5.2 përqind (tabela 22). Duke shtuar edhe variablen e shpenzimeve të qeverisë si pozitive, do të thotë se pjesa e konsumit ka stimuluar rritjen e shpenzimet qeveritare, dhe kjo pjesë stimulative e shpenzimeve të qeverisë ka efektë pozitivë në IHD, ngjashëm me gjetjet e Bassanini, Scarpetta, dhe Hemmings (2001) cituar nga Jude (2012). Ndërsa në hipotezë parë, ku rritja ishte e varur nga transfertat e qeverisë (të cilat nuk janë përjashtuar nga konsumi) patën efektë negativë në rritjen.¹⁸⁷

5. Kapitali human (niveli i shkollimit i mesëm i lartë), është konsideruar përcaktues i rëndësishëm i rritjes por, vetëm kur është vënë në bashkëveprim me IHD. Ndërsa si i vetëm kapitali human nuk është konsideruar i rëndësishëm në asnjërin ekuacion (ekuacioni i rritjes dhe ekuacioni i IHD).

Në ekuacionin e IHD e varur, kapitali human është logaritmuar me një afatë kthimi prapa 1 dhe 2 vjeçarë (prej lag_1 dhe lag_2 vite) përsëri kemi një rezultat negativë dhe statistikisht të parëndësishëm të kapitali human në rritjen e IHD-ve.¹⁸⁸

¹⁸⁷ Ndërsa nisur nga pikëpamjet e autorëve, Aiyagari dhe Christiano (1992); Ramey dhe Shapiro (1998), rritja e shpenzimeve të qeverisë inkurajojnë Investimet e brendshme, dhe nxitë rritjen e tyre por nëse nuk janë të vlersuara mirë mund të sjellin efekte të kundërt në shtimin e kapitalit të huaj në vend.

¹⁸⁸ Ndërsa në ekuacionin e rritjes kur kapitali human bashkëvepron me IHD mund të sjellë rritjen ekonomike por si i vetëm nuk ishte atraktive për rritjen ekonomike.

Do të thotë se IHD në vendet pritëse janë të kushtëzuara nga kushtet e vendit pritës, nga shkalla e aftësis thithëse kapitalit human - kapacitetit absorbues të nivelit të mesëm të shkollimit. Kjo shpjegohet edhe te IHD se me uljen prej 1% të nivelit të shkollimit është shaktuar ulje e IHD prej 0.1 përqind. (tabela 19). Do të thotë, politikat qeveritare duhet stimuluar dhe orientuar kapitalin human teknik në shkollimin profesional në shumicën e vendeve në moster dhe ky stimulim mund të mos jetë aq i madhë me vetë faktin se, shkalla e aftësive ka arritur pragun minimal¹⁸⁹ të pranueshem dhe nevojitet vetem një shtysë drejt rritjes cilësore të saj.

Rezultatet e tilla plotësojnë pragu minimal të kërkuar si total (14.3%) por ky pragë në analitikë plotësohet vetem nga 7 vende të zhvilluara në moster, ndërsa cilësia e arsimit në 17 vende në zhvillim (10-12%) dëmton në një farë mase rezultatet tona përfundimtare. Rezultatet negative me vetem me 1%, rrjedhin si rezultat pra i përfshirjes së vende të zhvilluara¹⁹⁰ të cilat kanë një pragë të shkollimit sekondare mbi minimalin të kërkuar (14.3%).¹⁹¹ Në rastin tonë niveli i arsimit nuk është edhe aq homogjen (1/3 e vendeve janë të zhvilluara) këtu kemi parasyshë vende me nivele të ndryshme të zhvillimit.

Në studime të shumta ku janë përfshirë në mostër vende heterogjene si në rastin tonë kanë dhënë rezultate deri diku të njëjta, pra janë ndikuar nga heterogjeniteti dhe supozime të tjera, megjithatë rezultatet tona janë mjaftë bindëse.

¹⁸⁹ Nga 24 vendet në moster vetem vendet e zhvilluara kanë një pragë të kapaciteteve absorbuese të shkollimit të mesëm mbi 14.3% ndërsa 17 vendet tjera nuk e tejkalojnë pragu 10-12%. Prandaj edhe efekti i kapitalit human i nivelit të mesëm nuk dha rezultatet e pritura edhe pse kemi një mesatare të shkollimit mbi pragu minimal të kërkuar. Efekti pozitiv do të arrihet kur vendet tjera në moster të kenë nivelin e shkollimit mbi pragu e kërkuar prej 14%.

¹⁹⁰ Nehaus (2006), theksoj se është shumë e rëndësishme që vendet në moster të kenë një nivel arsimit më homogjene për të dhënë rezultate më të sakta.

¹⁹¹ Modeli RE nuk merr parasyshë ndryshimet individuale, prandaj mund të jete ndikuar nga supozimet siq janë përfshirja në moster e vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim.

5.1.4 Efekti i njëanshëm IHD dhe rritje ekonomike

Për të gjetur lidhjen në mes IHD-ve dhe normës së rritjes së GDP për frymë përdorim testin Wald (1943:11-58), testim Hausman (1978)¹⁹² dhe testim parwise të Granger (1988) të lidhjes shkajkore. Nga testet raportohet se në ekuacionin variabël e varur rritja ekonomike i përshatet më shumë modeli i Efekteve Fikse, ndërsa në ekuacionit variabël varur janë IHD i përshatet më shumë modeli Efekteve të Rastit.

Në tabela 23, janë koeficientet e vlersuar përmes testit Wald zero për të parë efektin e dy variablave sipas ekuacionit të mësipërm dhe testin Hausman për dy variablat si më poshte.

Tabela 23. Vlersimi i testit Hausman (1978) për FE dhe RE

Test cross-section Fix effects				
Test Summary		Chi-Sq. Statistic	Chi-Sq. d.f.	Prob.
Cross-section Fixes		31.30	4	0.0000
Test cross-section random effects				
Test Summary		Chi-Sq. Statistic	Chi-Sq. d.f.	Prob.
Cross-section random		8.00	5	0.156

Shënim: Testi Hausman-kalkuluar me STATA, vs. 12 (nga autori).

Në ekuacionin e IHD-ve, testi Wald refuzon hipotezen zero, por nuk ka nivel rëndësie.

¹⁹² J. A. Hausman(1978). Specification Tests in Econometrics.pp. 1251-1271.
<http://econweb.tamu.edu/keli/Hausman%201978.pdf>

Tabela24: Testi parwise i shkakësis Granger (Granger. 1988).

Koeficientet e vlersuar - Variabla të Varuara (x-y)	
$\Delta GDP_{Ggpc}(lag)$	IHD(lag)
$\Delta GDP_{Ggpc} (0.0867)$	0.286***
IHD (0.0405)	0.0246
Granger Causality parwise Test Wald Causality Test	
Null Hypothesis: GDP causes FDI ; FDI does not cause GDPGCP	

Shënim: Në kllapa është devijimi standard *** Significant në nivelin 1% .

Kalkuluar nga autori.

Nga ana tjetër procedura Toda dhe Yamamoto (1995) gjithashtu përdor një Wald modifikuar (WALD) testi i cili mund të zbatohet pavarësisht nga urdhëri për variabla të integruara.

Testi tregon se IHD ka lidhje pozitive të parëndësishme me rritjen e GDP për frymë. Ndërsa në anën tjetër provat tregojnë së norma e rritjes së GDP për frymë, ka lidhje të fortë pozitive me IHD (nivelin i rëndësisë 1%). Një rritje në 1 për qind në rritjen e PBB për frymë, do të rritë nivelin e IHD prej rreth 9 përqind (0.0867). Ekziston një marrëdhënie pozitive midis GDP për frymë dhe IHD-ve. Prandaj vijmë në përfundim se lidhja në mes dy variablave është njëanshme, rritja ekonomike ka efektë pozitiv në fluksin hyrës të IHDve në vende europiane, ndërsa IHD ka efekte statistikisht të parëndësishëm në rritjen ekonomike, megjithatë është pozitive.

Tabela 24: Vertetimi i Hipotezave-rezultatet

Variable e varuar Log_GDPgpc	FE	Rënd esish me	She nja	Variable e varur Log_IHD	RE	Rënde sia	S h e n j a
Shkurtes				Shkurtes			
Variablat e pavarura				Variablat e pavarura			
LogGDPfillest are	Y_0	PO***	-	LlogGDPgpc	GDPgpc	PO***	+
IHD/GDP	IHD	JO	+	KapitaliHuman/P op	HC	Paren.	-
Kapitali Human/ Pop	HC	JO	-	Lag1_Kapit.Hum a/P	HC_1	Paren.	-
IHD_HC	IHD*HC	PO*	+	Lag2_Kap.Hum./ Pop	HC_2	Paren.	+
Inv.Bren/GDP	GCFC	PO***	+	Inv.Bre/GDP	GCFC	PO***	+
IHD*Inv.Bren d.	IHD_GCF C	PO*	-	Remitancat/GDP	REM	PO**	+
Remitancat/G DP	REM	Paren.	+	SHP.Pergj.Qev./G DP	SHPKFQ	PO*	+
SHP.P.Qeve./ GDP	SHP.P.Q	Paren.	-	*** p<0.01, **p<0.05 *p<0.1			
*** p<0.01 ** p <0.05*		*p<0.1					

Përmbledhje erezultateve ekonometrike

Në këtë punim si hapë i parë janë testuar variabla të pavarura që ndikojnë në rritjen apo uljen e rritjes së GDP për frymë (variabël e varur). Përdorimi i metodologjisë së regresionit të shumëfishtë modeli i katrorëve të vegjel (LS) dhe përdorimi i teknikën (FE) identifikoi lidhjen në mes tyre. Hapi i dytë i metodologjisë është testimi empirik i variablave të pavarura që janë të lidhura me fluksin hyres të IHD (variabël e varur), duke e përdorur modelin e pergjithësuar të katrorëve më të vegjël (GLS) dhe teknikën (RE). Ndërsa hapi i trete, testimi i dy variablave të varura rritja ekonomike dhe IHD përmes testeve Wald dhe parmwise te shkakësis Granger (Granger Causality).

5.2 Analizë Përshkruese Pyetsorëve

Qëllimi i anketave është gjetja e pengesave që ulin performancën e institucioneve duke krijuar klimë të dobët të investimeve në Kosovë në njërin anë dhe anën tjetër çfarë mundësishë ofron Kosova për investitorë të huaj, duke krijuar ide më të qartë se çfarë ndryshimesh duhet të bëjë qeveria gjatë hartimit të politikave që tërheqin IHD.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat e analizuara përmes metodës përshkruese me mjete të thjeshta statistikore në grafikë, duke nxjerrë konkluzione për pyetjet në vazhdim:

5.2.1 Pengesat që hasën investitorët e huaj në Kosovë


Sa i përket Anketës së parë: Pengesat që hasen investitorët e huaj në Kosovë

Pjesa e parë e pyetësit nisë me praqitjen e origjinës së biznesit prej nga vjen dhe përfundon me zgjidhjen e veprimeve më të rëndësishme që Qeveria e Kosovës duhet të marrë për të përmirësuar mjedisin e biznesit.

Sa i përket pyetjes së parë: Cila është origjina e biznesit ?

Përgjigjeja nga të anketuarit është se janë prezentë Kompani të Huaja nga këto vende: Gjermania 17%, Zvicra 12%, Britania e Madhe 8%, Turqia, 13%, Holanda 5%, Shqipëria 25%, Maqedonia 7%, Sllovenia 2%, Franca 9% dhe Serbia 2%.

Pyetja e dytë: Cila është vendndodhja e biznesit ?




Grafiku 34: Vendndodhja e biznesit.

-Vendndodhja e biznesit, për selinë e biznesit se ku veprojnë nuk janë përgjigjur 150 kompani ose 49 % nga 306 kompani të anketuara. Ndërsa pjesa më e madhe e tyre veprojnë në Prishtinë, 91 kompani ose 29.7 përqind, ndërsa 66 kompani ose 21.3 përqind veprojnë në qytetet tjera të Kosovës.

Pyetja e radhës : Si janë të shpërndara bizneset sipas llojit të veprimtarisë?

Nëse shohim se çfarë aktiviteti ato zhvillojnë shihet se shumica prej 106 kompanive ose 22.5 përqind e tyre kryejnë më shumë se një veprimtari ekonomike, duke përfshirë në emërtimin “të tjerë”. Në Anketë janë përgjigjur 304 kompani (98%), nga totali prej 306 respondentëve, dhe 44 kompani ose 14.4 përqind e tyre janë në tregti, ndërtimi i rrugëve 34 kompani (11%), në veprimtari kulturore, art, sondazhe tregu janë 31 kompani ose 10.1 përqind. Kompanitë e Telekomunikacionit janë 18 ose 5.9 përqind, energji dhe gaz natyror janë 12 ose 3.9 përqind, Industria e ushqimit janë 7 ose 2.29 përqind.



Grafiku 35: Shpërndarja sipas llojit të biznesit.

Po ashtu kemi sektorin bankar 6 kompani ose 1.96 përqind, ndërsa në industrinë e tekstilit, transportit rrugor dhe hekurudhor, turizëm-hoteleri, sport, shëndetësi, aktivitetet inxhinierike, agjensione publiciteti dhe transport ajror janë të përfaqësuara 22 kompani ose 7.2 përqind.

Cili është viti i themelimit të biznesit ?

Është vlerësuar se në vitin 2000 janë regjistruar 5 përqind ë bizneseve, në vitin 2001 deri 2003 çdo vit janë regjistruar nga 2% e kompanive, nga 2004 (6%), 2005 (7%), 2006 (9%) dhe 2007 (8%), pra jo më shumë se 9 përqind. Viti 2008 edhe përkundër krizës europiane është rritur numri i kompanive të regjistruara në 12 përqind. Ndërsa në vitin 2009 dhe 2010 (15 % dhe 16%), sipas anketës konsiderohen si vite që më se shumti janë regjistruar kompani të reja në Kosovë.




Figura 3: Vitet e themelimit të biznesit.

Trendi është ulur në vitet në vazhdim 2012 me 7 përqind, 2013 me 2 përqind dhe 2014 me 1 përqind. Ky trend negativë i hyrjes së kompanive të huaja në Kosovë është mjaft shqetësues, statistikisht rrjedhëse të ASK (2014), e vërtetojnë këtë.

Cili është numri i të punësuarve sipas viteve ?

Kompanitë e huaja në vitin e parë të themelimit kanë punësuar shumicën e punëtorëve apo 30.63 përqind e të punësuarve në total (minimumi zero dhe maksimumi prej 2000 punëtorë), duke mos u përgjigjur vetëm 11 anketues. Në vitin 2013 kjo mesatare rritet në 42.86 përqind, ose 12.23 përqind, të punësuar më shumë ndërsa nuk përgjigjen 19 e të anketuarve (respondentëve). Në vitin 2014 kanë refuzuar të përgjigjen 54 kompani ose 17.6 përqind e tyre, mesatarja e punësimit është 45.3 përqind ose 2.44 përqind më e lartë se një vit më parë por kjo përqindje është më e ulët se nga ardhja e parë e kompanive në

Kosovë. Vijnë në përfundim se kompanitë e huaja nuk kontribuojnë mjaftueshëm në punësim, ndërsa niveli e pagave është 40% përqind më e lartë se në kompanitë vendore.

Tablela 26: *Numri i të punësuarve sipas viteve.*

		Punësuar-viti I	Punësuar 2013	Punësuar 2014
N	Valid	296	288	253
	Nuk përgjigjen	11	19	54
	MA	30.63	42.86	45.30
	Minimum	0	0	0
	Maximum	2000	2276	2500

Kryesisht janë sektori bankar, hotelieri, miniera, industri përpunuese, prodhimë dhe tregti që kanë të punësuar nga 50 deri 2500 punëtorë në vit. Ndërsa është konstatuar një ulje e stafit të punësuarve në sektorin banakier nga 1700 sa ishin në 1300 punëtorë ose 31 përqind më pak në muajin tetor 2014. Ka biznese që nuk kanë pasur punëtorë dhe numri i tyre është i konsiderueshëm.




Figura 4: Vitete e të bërit biznes në Kosovë.

Kjo nënkupton se disa kompani të huaja në Kosovë sjellin teknologji por nuk zhvillojnë aktivitet biznesi, shuhen pas një ose dy viteve (nga 306 kompani të anketuara 35 përqind e tyre e kanë shuar veprimtarinë e tyre pas një ose 2 viteve).

Cilat janë vitete të bërit biznes në Kosovë ?

Bizneset e huaja që veprojnë në Kosovë sipas anketimit, 48 përqind e tyre kanë ushtruar veprimtari deri në 5 vite, kurse 6 -10 vite kanë vepruar 33 përqind e kompanive. Janë 9 përqind e Kompanive që punojnë në Kosovë nga 11-15 vite. Ndërsa nuk janë përgjigjur 10 përqind e Kompanive. Kompanitë e huaja që kanë vepruar në Kosovë nuk kanë qëndruar gjatë, me përjashtim të sektorit bankar dhe sigurimeve që kanë krijuar monopol të tyre.

Cili është viti i shuarjes së biznesit të huaj në Kosovë ?

Nga 306 kompanitë anketura janë përgjigjur 43 kompani aktive në Kosovë por nuk tregojnë se në cilin vitë janë themeluar. Nuk janë përgjigjur 177, por theksojnë se kanë marrëveshje kontraktuale me nënkontraktorë biznese kosovare (sektori i ndërtimit), në sjelljen e makinerive të rënda, me sektorin e telekomunikacionit në sjelljen e teknologjisë dhe ekspertizës prej viti 2000 deri 2014. Kryesisht janë kompanitë në ndërtim, banka, hulumtim tregu, tregti dhe turizëm. Nga 306 Kompani 76 biznese ose 25 përqind e tyre janë shuar nga viti 2000 deri 2012, ku vetëm në vitin 2014 janë shuar 18 prej tyre ose rreth 6 përqind në total.

Si renditet klima etë bërit biznes në Kosovë ?

Klimen e biznesit e konsiderojnë të arsyeshme 35 përqind e investorëve të huaj, ndërsa si të mirë 35 përqind e të anketuarve. Ky vlerësim është i mirë kur kemi parasysh pengesat dhe vështirësitë që i kanë renditur investorët.

Ndërsa janë përgjigjur 98 përqind e respondentëve dhe vetëm 2 përqind nuk janë përgjigjur. E renditin ambientin e biznesit si të varfër 6 përqind e tyre, ndërsa 22 përqind si jo të arsyeshëm, kjo duhet të nxitë politikëbërësit dhe institucionet që të promovojnë investimet, të bëjnë reforma në drejtim të përmirësimit të ambientit të biznesit.




Figura 5: Renditja e ambientit të biznesit.

Në pyetjen e përgjithshme : *Cfarë ju tërhoqi për të investuar në Kosovë ?* janë renditur një sërë pyetjesh që morën përgjigje mjaft të përafërta.




Figura 6: Mundësi të mira për investime.

A ka mundësi të mira për investime ?

Janë marrë përgjigjeje inkurajuese nga 46 përqind investitorëve të huaj, e konsiderojnë Kosovën si vend që ofron mundësi të mira për të investuar. Kanë refuzuar të përgjigjen 22 përqind të investitorëve, ndërsa e konsiderojnë pak të rëndësishëm 32 përqind e tyre. Vlerësimi se Kosova ka çka të ofrojë, tregon se rreth gjysma investitorëve ka një planë afatgjatë të qëndrimit në Kosovë.

Ndërsa mospërgjigja prej 22 përqind e tyre, tregon se nëse ndërmerrë qeveria stimuj shtesë (pushime tatimore për 6 muajt e parë, stimuj financiar ose dhënie në shfrytëzim falas të objekteve ose tokës për së paku një vit, lirimi nga TVSH për makinerinë e rëndë në miniera, bujqësi dhe ndërtimtari, etj.), këta investitorë nuk do të largohen nga Kosova.

A renditet Kosova si vend qendror në rajon ?





Figura 7: Kosova vend qendror në rajon.

Nga përgjigjejet, konsiderohet si e tillë me 44 përqind, ndërsa nëse i shtojmë edhe 28 përqind që kanë refuzuar të përgjigjen atëherë është mjaftueshme të dimë arsyen pse investorët po hedhin sytë diku tjetër për të investuar. Ndërsa e konsiderojnë si të rëndësishëm 28 përqind të tyre. Opinioni i tyre është se duhet orientuar në aktivitete që promovojnë imazhin e Kosovës sepse mungon informimi i saktë dhe i shpejtë e të huajve për burimet natyrore dhe njerëzore që ka Kosova.

A ka Kosovë rinj të arsimuar, popullsi dinamike dhe janë njohës të gjuhëve të huaja ?

Sipas tyre, Kosova në arenën ndërkombëtare njihet si vend me popullsi dinamike, mesatarisht të arsimuar dhe më e re në Europë. Këtë faktorë e konsiderojnë mjaft tërheqës 140 Kompani ose rreth 46 përqind e investorëve, kurse 99 Kompani ose 32.35 përqind e konsiderojnë pak të rëndësishëm. Nga 306 të anketuar nuk janë përgjigjur 68 kompani ose 22.2 përqind.



Grafiku 36. Të rinj të arsimuar, popullsi dinamike dhe njohja e gjuhëve.

Pyetja në vazhdim: *A është forca e punës në Kosovë kualifikuar mirë me kosto të ulët dhe konkurruese?*





Figura 8: Forca e punës e kualifikuar mirë, me kosto të ulët dhe konkurruese.

Sipas përgjigjeve Kosova është konkurruese për forcën e punës së kualifikuar dhe me kosto të ulët. Kosova qëndron më mirë se të gjitha vendet fqinje në këtë aspekt, përveç Shqipërisë. E konfirmojnë 51 përqind të tyre se Kosova ofron forcë të lirë pune dhe një nivel të arsimit mjaftueshëm për të përdorur teknologjinë e punës. Pak të rëndësishëm e konsiderojnë 30 përqind e të anketuarve, ndërsa kanë hezituat të përgjigjen 19 përqind të tyre.

A ka Kosova Telekomunikacion modern ?



Grafiku 37: Telekomunikacioni modern në Kosovë.

Opinion i përgjithshëm është se Kosova ka përparuar fuqishëm në drejtim teinfrastrukturës në telekomunikacion sidomos pas vitit 2007. Nga përgjigjete investitorëve është marrë një opinion jo i mirë nga 151 kompani ose 49.3 përqind e tyre,e konsiderojne këtë faktorë pakë të rëndësishëm.Ndërsa 75 Kompani ose 24.5 përqind e konsiderojnë faktorë të rëndësishëm, kurse nuk janë përgjigjur 81 Kompani ose 26.5 përqind.

Pyetja: A është legjislacioni modern në Kosove dhe i ngjashëm me BE-në ?

Legjislacioninmodern dhe kompatibil me BEe konsiderojne një siguri më e madhe e kapitalit të investuar në Kosovë. Janë marrë përgjigje nga 77.1 përqind ë investitorëve, prej tyre e konsiderojnë si të rëndësishëm 94 Kompani ose 39.4 përqind ndërsa 143 Kompani ë rendisin si pak të rëndësishëm ose 30.9 përqind. Nuk janë përgjigjur 70 Kompani ose 22.9 përqind.




Figura 9: Legjislacioni modern dhe i ngjashëm me BE-në.

Aëstëi përgjegjëshëm sistemi bankarë në Kosovë?




Figura 10: Sistem bankarë i përgjegjëshëm.

Është një opinion që nuk shkon në favor të Kosovës edhe pse sistemi bankar është likuid dhe mjaft profitabil për pjesën e investitorëve që kanë investuar, investitorët sektorëve të tjerë e konsiderojnë pak të rëndësishëm sistemin bankar, janë 47 përqind të tyre ndërsa nuk janë përgjigjur 28 përqind e tyre. Vetëm 25 përqind investitorëve e konsiderojnë të rëndësishëm sistemin bankar.

A ka qasjetë lirë Kosova në tregun e BE-së ?

Konsiderohetë rëndësishëm 26 përqind e përgjigjejeve. Ndërsa si pak të rëndësishëm e vlersojnë 49 përqind e kompanive të huaja. Nuk janë përgjigjur 25 përqind etë anketuarve. Meqenëse pjesa më e madhe e investitorëve vijnë nga vendet e BE-së, është një përgjigje se investitorët nuk përballen me pengesa tregtare gjatë investimit në Kosovë, prandaj nuk i japin shumë rëndësi këtij faktori.




Figura 11: Qasje të lirë në tregun e BE-së.

A ka qasje të lirë Kosova në tregun e CEFTA-s ?

Vendimi iinvestitorëve për të investuar në Kosovë sipas sondazhit të bërë rezultojn të jetë ë ndikuar në 30 përqind të tyre si rezultat i tarifave preferenciale të ofruara. Në 41 përqind të investitorëve nuk është i rëndësishëm qasja në tregun e CEFTA-s. Ndërsa nuk janë përgjigjur 29 përqind të tyre.




Figura 12: Qasje të lirë në tregun e CEFTA-s.

Aësthtë tërheqëse Dogana për të investuar në Kosovë ?




Figura 13: Dogana.

Investitorët e konsiderojnë Doganën tërheqëse, stimulimet tarifore dhe lirimet janë faktorë që ndikon në hyrjen më lehtë në tregun kosovarë. Opinioni i investitorëve është irëndsishëm për doganë (28 %), pak i rëndësishëm (39%). Kjo lenë përshtypje sëdëshirojnë ndryshime në dogana. Nuk janë përgjegjës 33 përqind, do të thotë se tarifatat doganore nuk e ulin fitimin e 33 % të anketuarve.

Akonsideroni se në Kosovë ka stimuj të taksave?




Figura 14: Stimujt e taksave.

Stimujt e taksave konsiderohen nga investitorët e huaj të pamjaftueshëm edhe përkundër faktit se Kosova ka shkallë tatimore më të ulta në rajon. Shkallë tatimore në të Ardhura në Korporata prej 10 përqind është konkurrense në rajon, të Ardhura Individuale me shkallë progresive 4, 8 dhe 10 përqind, me shkallë standard të TVSH-së prej 16 përqind. Mirëpo nuk ka mjaftueshëm stimuj të tarifave doganore dhe pushime tatimore për biznese të reja dhe biznese të suksesshme.

Në anketë nuk janë përgjigjur 26 përqind E Kompanive, kurse pak të rëndësishme i konsiderojnë stimujt e taksave 35 përqind e Kompanive. Të kënaqur me stimuj të takave janë 39 përqind e respondentëve të cilët e konsiderojnë Kosovën të pëlqyeshme për të investuar, por ndryshimet ligjore të shpeshta dhe të vazhdueshëm i konsiderojnë pengesë për të planifikuar kapitalin e investuar dhe përfitimet e tyre. Priten reforma të reja fiskale nga korriku 2015 me shkallë standarde 18% dhe shkallë të reduktuar 8% për disa artikuj elementare dhe barëra.

A ka nxitje për investime në Kosovë?

Kompanitë e huaja i konsiderojnë të pamjaftueshme nxitjet për investime, nga 306 Kompani, 25 përqind e tyre nuk përgjigjen. Kurse 43 përqind e tyre e konsiderojnë pak të rëndësishme sepse nxitësit me tepër janë verbal se sa material apo ligjor.




Figura 15: Nxitje e investimeve.

A është tërheqëse Valuta Euro në Kosovë?




Figura 16: Valuta: Euro .

Sipas përgjigjeve përdorimi i valutës Euro në Kosovë ka krijuar stabilitet të çmimeve dhe ka eliminuar rrezikun e kursit të këmbimit, uljen e kostos së transaksionit që ndikon në planifikimin e financave të investitorëve dhe promovimin e tregtisë dhe investimeve.

Sipas anketës 40 përqind e kompanive ndjehen më të sigurta kur përdorin Euron. Kompanitë që refuzojnë të përgjigjen që janë 30 përqind e tyre. Ndërsa 30 përqind e tyre, valutën Euro e konsiderojnë pak të rëndësishme.

A mbështeten bizneset moderne nga institucionet Kosovare ?

Investitorët e huaj, 40 përqind e tyre e konsiderojnë mbështetjen nga institucionet të ulët. Ndërsa gjatë kësaj periudhe 15 vjeçare së paku një here kanë gjetur mbështetje 27 përqind e kompanive, ndërsa kanë hezituar të përgjigjen 33 përqind e tyre.




Figura 17: Bizneset moderne mbështeten nga institucionet.

A ka kufizime tregtare në Kosovë ?





Figura18: Pengesat që hasën Investitorët e Huaj –Kufizimet Tregtare.

Kosova a ka hapur dyert kompanive të huaja në të gjithë sektorët edhe ata më strategjik si janë energjitika, miniera, transporti ajror, telekomunikacioni, etj. Ndërsa 26 përqind e kompanive përgjigjen se kanë pengesa gjatë bërjes tregti në Kosovë, por edhe gjatë kalimit të kufirit jashtë Kosove. Poashtu theksojnë pengesa në angazhimin punëtorëve kosovarë në kompanitë mëmë dhe nevoja e trajnimit të tyre jashtë Kosoves. Pengesat e tilla i konsiderojnë pasojë mosintegritit të Kosovës në BE dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare. Po ashtu theksojnë pengesat kufitare me Serbinë, Maqedoninë dhe ndonjëherë edhe me Malin e Zi. Ndërsa bashkëpunimin me shtetin Shqiptarë konsiderojnë të suksesshëm.

A ka korrupsion dhe nepotizmi në Kosovë ?

Nga opinion i kompanive të huaja është mësuar se kjo është një pengesë serioze e shoqërisë kosovare. Nga 306 kompani të anketuara 198 prej tyre ose 65 përqind e tyre kanë hasur në njerëz të korruptuar gjatë kontaktit me institucione qeveritare dhe komunale (zyrtarë shtetërorë). Si më të korruptuar e konsiderojnë, doganën, gjyqësinë, inspektoriatet në ministrinë tregtisë, industrisë, prokurimit, tatimeve dhe me pakë policinë e Kosovës.



Grafik 38: Pengesat që hasen Investitorët e Huaj – Korrupsioni dhe nepotizmi.

Së paku një herë, secila kompani ka hasur në pengesë korrupsioni gjatë procedurave biznesore në raport me shtetin. Po ashtu nuk hezitojnë të deklarojnë (kërkojnë konfidencialitet), se nuk kanë dëshirë të paguajnë tatime, duke e konsideruar shpesh arsye të mbylljes së kompanive brenda 1-2 viteve dhe hapje të kompanive të reja. Kompanitë që nuk e konsiderojnë pengesë të madhe korrupsionin dhe nepotizmit janë 74 kompani ose 24 përqind e tyre. Nuk janë përgjigjur në anketë 34 kompani ose 11 përqind e tyre. Këtë e shohin si mungesë e vullnetit për të raportuar këto dukuri të shoqërisë, edhe pse mekanizmat për luftimin e këtyre dukurive negative egzistojnë.

A ka procedra burokratike në institucionet kosovare ?

Procedurat burokratike ikonsiderojnë pengesë të madhe duke e raportuar si të tillë 198 kompani ose 64.7 përqind e tyre. Si pak të vështirëe konsiderojnë 73 kompani ose 23.8 përqind, nuk janë përgjigjur 36 kompani ose 11.7 përqind e tyre.





Figura19: Pengesat që hasin Investitorët e Huaj– Procedrat burokratike.

A ka vështiresi në Infrastrukturë dhe mjedis fizik në Kosove ?

I konsiderojnë si pengesë nga 96 kompani ose 31.4 përqind e kompanive, ndërsa pak e vështirë nga 155 kompani ose 51 përqind e tyre. Nuk janë përgjigjur 56 kompani ose 17.6 përqind. Si infrastrukturë i konsiderojnë rrugët, telekomunikimin, furnizimin me energji dhe ujë. Më së shumti theksojnë se kanë pengesa në infrastrukturë rrugore dhe furnizim me energji dhe ujë, ndërsa nuk kanë fare vështirësi në telekomunikim.



Grafik 39: Pengesat që hasen Investitorët e Huaj-Infrastruktura dhe mjedisi fizikë.

A konsiderohen si të rëndësishme reformat qeveritare në Kosovë ?





Figura20: Reformat e administrates qeveritare.

I konsiderojnë 33 përqind e kompanive reformat qeveritare te nevojshme. Ndërsa 37 përqind e kompanive i shohin si pak të rëndësishme këto reforma, sipas tyre në këtë fazë tranzicioni që po kalon Kosova janë të pa efektshme, sepse mentaliteti politik është i njëjtë me vende të rajonit dhe mundësitë zhvillimore janë të vogla.

Janë 28 përqind e kompanive që nuk janë përgjigjur sepse opinion i tyre nuk është se do të nxisë reformat qeveritare.

A konsiderohen të panevojshme procedurat e vështira për dhënien e lejeve të ndërtimit ?



*Grafik 40:*Heqjen e procedurave të panevojshme të dhënies së lejeve për ndërtim.

Konsiderohet si një masë e rëndësishme për shpejtimin dhe përmirësimin e ambientit të bërit biznes në sektorin e ndërtimit.

Si të rëndësishme e konsiderojnë dhënien e lejes për ndërtim 159 kompani ose 52 përqind, si pak të rëndësishme e konsiderojnë 98 kompani ose 32 përqind, ndërsa 50 kompani ose 16 përqind e kompanive nuk janë përgjigjur.

A janë te nevojshme reformat ne thjeshtimin e rregullave dhe procedurave tatimore ?





Figura 21: Reforma në thjeshtimin e rregullave dhe procedurave tatimore edhe më tutje.

Kerkoheqë deklarimet për TVSH të bëhen çdo tremuaj. Kërkoheq heqja e arkave fiskale. Deklarimi elektronik i të gjitha tatimeve të jetë prioritet, specializimi i vendeve të punës nga ana e inspektorëve për vetëm një fushë të tatimit, mos familjarizimi në mes të inspektorëve dhe bizneseve do të bëhej me rrotacion vjetor në kuadër të regjionit dhe tremujor në kuadër të republikës.

Proceduaret ndëshkimore me kontrole të aplikohen jo më shumë se 20 përqind e tatimit bazë. Kërkojnë reforma 157 kompani ose 51.3 përqind, nuk kërkojnë reforma 106 kompani ose 34.6 përqind sepse i konsiderojnë pak të rëndësishme. Nuk janë përgjigjur 44 kompani ose 14.1 përqind.

A konsiderohet e rëndësishme futja e masave të rrepta për ndalimin e korrupsionit në Kosovë ?

Nga anketa është vlerësuar (156 kompani ose 51 %), se futja e masave të rrepta për të parandaluar korrupsionin është e domosdoshme dhe duhet shpejtuar.




Grafik 41: Futja e një mase të rreptë për të parandaluar korrupsionin.

I konsiderojnë pak të rëndësishme këto masa, 105 kompani ose 34.3 përqind e tyre sepse zbatimi i ligjit është i dobët, kurse nuk janë përgjigjur 46 kompani ose 14.7 përqind.

A janë të rëndësishme reformat në arsim ?

Nuk janë përgjigjur 23 % e respondentëve ose 70 kompani, ndërsa 115 kompani ose 37 përqind e tyre e konsiderojnë shumë të rëndësishme reformën në sistemin arsimor (arsimin profesional), për të plotësuar kërkesat e kompanive të huaja me punëtorë të kualifikuar.



Grafik42: Reforma në sistemin e arsimit.

Ndërsa pak të rendësishëm e konsiderojnë 122 kompani ose 40 përqind e tyre.

Çfarë veprime tjera duhet të ndërmarre qeveria për të përmirësuar ambientin e biznesit ?




Figura 22: Veprimet tjera të qeverisë që do të kontribonin në përmirësimin e biznesit.

Veprimet tjera të qeverisë, konsiderohen si të nevojshëm për përmirësimin e mjedisit të biznesit, duke u nisur nga stimulimet në bujqësi 30 përqind, mungesa e zbatimit të ligjit në nivel lokal 37 përqind, mbrojtja e të drejtave të autorit 40 përqind, ligji momental doganor si të mirë e konsiderojnë 45 përqind, ligjet momentale fiskale si të favorshme i konsiderojnë 47 përqind, jo profesionalizmi si rezultat i punësimit nga politika ditore 49 përqind, heqje e procedurave të ndërlikuara nga Administrata Tatimore e Kosovës 50 përqind, ekonomia informale në Dogana 37 përqind, ekonomia informale në tatime që

mbledhen brenda Kosovës 43 përqind, ekonomia informale në pagesën e pensioneve 35 përqind, mungesa e zbatimit të ligjit në raste kontestesh tregtare 48 përqind, mos zbatimi i drejtë i ligjit 48 përqind, vendosja e domosdoshme e TVSH së shkallëzuar përveq TVSH bazë kërkojnë 27 përqind. Nga përgjigjet shihet se është e nevojshme të bëhen reforma në të gjitha ministritë e shtetit, sepse ka një uniformitet të veprimit të institucioneve në Kosovë. Edhe pse vlersimet e anketuesve janë më pak se 50 përqind për ndryshime nuk do të thotë se pjesa tjetër është e kënaqur sepse kanë hezituuar të përgjigjen. Prandaj janë të nevojshme ndryshimet.

A është herë e parë që është investuar në Kosovë ?

Janë përgjigjur 37 përqind e kompanive se është herë e parë që investojnë në Kosovë, ndërsa 60 përqind e tyre theksojnë se veprojnë në Kosovë një kohë të gjatë. Janë vetëm 3 përqind e kompanive që nuk janë përgjigjur.




Figura 23: Herë e parë që është investuar në Kosovë.

Si jeni informuar për Kosovën ?




Figura 24: Si jeni informuar për Kosovën.

Informimi për Kosovën, është bërë shumicën e herave nga miqtë 19 përqind, televizioni 19 përqind, kolegët 17 përqind, familja 15 përqind, gazeta 9 përqind, internet 7 përqind dhe nga dikush tjetër 1 përqind.

5.2.2 Mundësitë dhe planet e Investitorëve të Huaj për të investuar në

Pjesa e dytë (Shtojca B) e pyetësorit paraqet mundësitë që ka Kosova për investitorë të Huaj aktual dhe atyre potencial dhe planifikimet e tyre për investime të ardhmen.

Si mendojnë investitorët potencial : A planifikojnë në të ardhmen të investojnë në Kosovë?

Planet në të ardhmen për të investuar në Kosovë, janë në favor të rritjes së investimeve në Kosovë (nga investitorët tashmë egzistues). Nga ky këndvështrim pritet një rritje e IHD në vitin 2015, prandaj duhet që të stimulohen Investitorët rinj me iniciativë të reja nga ato që tashmë egzistojnë për ti inkurajuar ata. Moskrijimi me kohë e inicentivave konkrete, humb

mundësi për ardhje të investitorëve të rinj dhe gjasat që edhe ata që tashmë janë në Kosovë të drejtohen nga vendet fqinje. Janë deklaruar se do të investojnë në Kosovë 60 përqind e investitorëve. Ndërsa përgjigjejete 40 përqind të investitorëve se nuk do të investojnë në Kosovë por diku tjetër është shqetësuese për institucionet qeveritare të cilat duhet të krijojnë kushte më të favorshme në vend.




Figura 25: Planet në të ardhmen për të investuar në Kosovë.

Si mendojnë investitorët potencial: Sa tërheqëse është situata e investimeve në Kosovë ?

Gjithesëj 120 kompani e konsiderojnë të arsyeshme duke u bazuar në pasuri natyrore, fuqi punëtore të lirë dhe adaptuese me kerkesat eteknologjis së re, ndërsa aspektin institucional nuk e konsiderojnë funksional dhe të mirë.

Si pak tërheqëse e konsiderojne 126 Kompani ose 41 përqind ë tyre, shumë tërheqëse ë konsiderojnë 26 kompani ose 8.5 përqind, jo e arsyeshme e cilësojnë situaten e investimeve në Kosovë 11 Kompani ose 3.6 përqind ndërsa jo tërheqëse e konsiderojnë 12 kompani ose 3.9 përqind e investitorëve.




Figura 26: Sa tërheqës është situata e investimeve në Kosovë.

Si pak tërheqëse e konsiderojne 126 Kompani ose 41 përqind ë tyre, shumë tërheqëse ë konsiderojnë 26 kompani ose 8.5 përqind, jo e arsyeshme e cilësojnë situatën e investimeve në Kosovë 11 Kompani ose 3.6 përqind ndërsa jo tërheqëse e konsiderojnë 12 kompani ose 3.9 përqind e investitorëve. Nuk janë përgjigjur veten 12 Kompani ose 3.9 përqind nga 306 Kompani gjithsej.

Si mendojnë investitorët potencial : Sa është vlera e përafërt e planifikuar për të investuar në Kosovë?

Shuma më e madhe investimit do të jetë 1- 2.5 miliard Euro (nga 3 ose 0.9 përqind ëkompanive të Huaja). Shumen prej 1 milionë deri ne 63 milionë do të investojnë 55 kompani ose 17.9 përrqind e tyre, ndërsa nga 10 mijë deri 900 mijë Euro janë 50 kompani ose 16.3 përqind ekompanive.

Si mendojnë investitorët potencial : Si është cilësina e informacionit në lidhje me mjedisin e biznesit në Kosovë ?

Nga gjithsej 306 respondent sa janë anketuar, e konsiderojnë cilësinë e informacionit pjesërisht të kënaqshme 58 përqind e kompanive, kryesisht të kënaqshme 15 përqind e kompanive, dhe plotësisht të kënaqshme 1 përqind e tyre. Ky vlerësim pozitivë prej 74 përqind është mjaftë inkurajues se është duke punuar në drejtim të informimit të drejtë dhe shpejtë investitorëve të huaj për mjedisin e biznesit Kosovare.

Nuk janë të kënaqur 26 përqind të investitorëve (23% të pakënaqur dhe 3% plotësisht të pakënaqur), duke theksuar se nuk ka transparencë në kontakt me institucione dhe kompani vendore.




Figura 27: Cilësinë e informacionit në lidhje me Mjedisin e biznesit në Kosovë ?

Si mendojnë investitorët potencial : Cila është Zona e tyre më me interes për të investuar ?

Konsiderohet se synimet janë të drejtuara nga sektori i ndërtimi të rrugëve 48 përqind, Bujqësia 9 përqind, Turizmi 7 përqind, transporti hekurudhor 7 përqind, industria e tekstilit


Cila është zona juja më me interes për të investuar?

Sektori	Pondere
Bujqesia	48%
Minierat	9%
Industria e ushqimit	7%
Industria e tekstit	7%
Transporti rrugor	5%
Industria e ndërtimit	4%
Industria e shërbimeve	4%
Industria e energjisë	3%
Industria e turizmit	2%
Industria e informacionit	2%
Industria e shërbimeve të tjerë	2%
Industria e shërbimeve të tjerë	1%
Industria e shërbimeve të tjerë	1%
Industria e shërbimeve të tjerë	1%
Industria e shërbimeve të tjerë	0%
Industria e shërbimeve të tjerë	0%

Si mendojnë për Kosovën Investitorët potencial: A promovon mjaftueshëm Kosovën APIK?

274

marrë përmes kanaleve të tjera (internet, television, Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe kolegëve, rrjeteve sociale, miqëve).




Grafik 43: Agjencia për Promovimin e Investimeve (APIK).

Anketimi i 280 Kompanive se cili burim informacioni për Kosovën ka qenë më i arritshëm për ta, janë përgjigjur se kanë percjellur konferenca, seminare dhe publikime jashtë Kosove të organizuara nga MTI, APIK dhe ECIK në Austri, Gjermani dhe Zvicër përmes mjeteve të informimit, por ato ishin të rralla, prandaj duhet shtuar aktivitete të tilla në agjenden qeveritare jashtë Kosovës. Vetëm 20 Kompani ose 6.5 përqind e tyre theksojnë si të pa dobishëm informacionin e APIK brenda Kosovës, ndërsa 6 Kompani ose 2 përqind e tyre e vlerësojnë si burimin kryesor të informacionit që marrin investitorët e huaj që në kontaktin e parë me Kosovën.

Si mendojnë investitorët potencial: A do të vijnë të investojnë në Kosovë?

Përgjigjen 56 përqind e tyre se do të investojnë në Kosovë. Kanë dhënë përgjigjeje negative 32 përqind e Kompanive. Ndërsa nuk janë përgjigjur 12 përqind e kompanive.



Grafik 44: A do të investonit përsëri në Kosovë?

Si mendojnë për Kosoven investitorët potencial: Cila është madhësia e planifikuar për të investuar në Kosovë ?

Nuk janë përgjigjur sa do të investojnë 17 kompani ose 5.6 përqind e tyre, janë përgjigjur 253 kompani ose 82 përqind se do të investojnë nga 1-10 milionë Euro dhe po të njëjtën shumë do ta investojnë edhe në 3 vitet në vazhdim. Prej 306 kompanive janë përgjigjur 23 kompani të huaja (7 përqind) kanë investuar nga 10 deri 50 milionë Euro dhe do të investojnë në vitin në vijim vetëm 40 përqind të fitimit të tyre ndërsa 60 përqind të fitimit do ta riatdheshojnë.

Nga 14 Kompanitë e huaja (5 përqind e Kompanive), më të mëdha theksuan se kanë investuar në Kosovë mbi 50 milionë Euro ndërsa do të investojnë në vitin në vijim vetëm 30 përqind të kapitalit të tyre. Këto Kompani kanë theksuar se riinvestojnë 70 përqind të fitimit të tyre në Kosovë dhe vetëm 30 përqind në vendim të origjinës për 3 vitet në vijim. Nuk janë përgjigjur 6 përqind e kompanive të Huaj se sa kanë investuar dhe sa do të investojnë në vitin 2015 të tutje.




Figura 29: Madhësia e investimit që Investitorët Huaj do ta bëjnë vitin 2015.

Si mendojnë investitorët potencial: Cila është arsyeja që hezitojnë të investojnë në Kosovë?

Arsyet që Investitorët e Huaj hezitojnë të investojnë në Kosovë, renditen si vijon: knfrastruktura dhe mjedisi fizik 54 kompani ose 10 përqind etyre.




Figura 30: Arsyet që Investitorët e Huaj hezitojnë të investojnë në Kosovë.

Si pengesë konsiderojnë mjedisin politik 125 kompani ose 22 përqind ë tyre, procedurat burokratike 207 kompani ose 37 përqind e tyre, korrupsionin dhe nepotizmin 127 kompani

ose 23 përqind dhe kufizimet e tregtisë 46 kompani ose 8 përqind e tyre, thjeshtëzimi i procedurave të leje ndërtimore 131 kompani ose 22 përqind dhe masat e rrepta për ndalimin e korrupsionit 141 kompani ose 24 përqind.

Cilët janë stimuj e veqante të qeverisë për të tërhequr investimet?

Reformat administrative qeveritare i konsiderojnë të rëndësishme 15 përqind e kompanive, reformat e administrimit të tatimit 28 përqind, reformat e sistemit arsimor 11 përqind e kompanive, thjeshtëzimi i procedurave të leje ndërtimit 22 përqind dhe masat e rrepta për ndalimin e korrupsionit 24 përqind të tyre.




Figura 31: Simujt e veçantë që duhet të bëjë qeveria.

KAPITULLI VI: Përfundimi dhe Rekomandimet

6.1 Përfundimet për analizen Ekonometrike dhe analizen e Pyetsorëve

Në këtë kapitull në radhë të parë janë prezantuar konkluzionet të cilat janë paraqitur në formën e një vështrimi të përgjithshëm të studimit, dhe konkluzionet specifike mbi bazë të rezultateve të studimit. Në fillim paraqiten implikimet teorike, më pastaj rekomandimet praktike dhe rekomandimet për hulumtime të mëtejshme. Në këtë punim përdoret teoria e fundit endogjene e rritjes (Barro, 1991, Anghion dhe Howitt (1992), Barro dhe Sala-i-Martin (1995), Boreinsztein, et al. (1989).

Duke parë rritjen e madhe të fluksit të IHD në vitet e 90-ta, kërkimet e studjuesve morën një zhvillim të madhë, por që ende nuk ka një mendim të inifikuar se IHD ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike. Arsya është se shpesh u sfidua nga analizat empirike të autorëve të ndryshëm, Carkovic dhe Levine (2002:3-23), dështoj të gjejë marrëdhënje pozitive, de Mello (1989) gjenë një lidhje të dobët, Zhang (2001:175-185), thekson se kjo varet nga kushtet e vendit pritës, Johnson (2005:14-28 dhe 2006) thekson se në vende në zhvillim kjo ndodhë nga shkak i përhapjessë teknologjisë, Alfaro(2003:9-14) përmend se IHD në sektorin primarë ndikojnë negativisht, megjithatë jo të gjithë sektorët e ekonomisë përfitojnë nga IHD, në prodhim janë më pozitive, ndërsa në sektorin e shërbimeve lidhja është e pa qartë.

Chowdhury dhe Mavrotas (2005:5-8), gjejnë lidhjen pozitive në dy drejtime, IHD dhe rritje. Ndërsa Li dhe Lue (2005:393-407) gjejnë ndikimin pozitiv të IHD dhe kapitalit njerëzorë në rritjen ekonomike. Edhe Wu dhe Hsu (2008:3-8) sikurse Boreinsztein, et

al.(1998:121) theksojnë se vendet me një nivel më të mirë të PBB dhe kapitalit njerëzore do të kenë më shumë IHD.

Pas një analize të thelluar të literaturës empirike, jemi përcaktuar për qasjen teorike endogjene (meritat e kapitalit human, të implikuara edhe përmes IHD në rritje), zgjedhja e modelit endogjen të rritjes së Boreinsztein, et al. (1998:115-135), duke e konsiderua të përshtatshëm për analizen e rritjes.

Përfundime për analizen ekonometrike - Së pari, janë testuar variablate pavarura që ndikojnë në shkallën e rritjes së GDP për frymë -variabël e varur. Përdorimi i metodologjisë së regresionit të shumëfishtë, modeli i katrorëve të vegjël (LS) dhe metoda e efekteve fikse (FE) identifikon lidhjen në mesë tyre.

Hapi i dytë i metodologjise është, empirikishtë i testuam variablat e pavarura që janë të lidhura me fluksin hyrës të IHD-variabël e varur, duke përdorur modeline përgjithësuar të katrorëve më të vegjël (GLS) dhe metoden e efekteve të rastit (RE), identifikohet efekti i variablave shpjeguese në Investimet e Huaja Direkte.

Pra qëllimi është për të matur efektin e përcaktuesve të rritjes ekonomike në njërin anë dhe në anën tjetër matjen e efektit të përcaktuesve të IHD-ve në 24 vende europiane në mesin e tyre edhe Kosova. Bazuar në literaturën aktuale të rritjes ekonomike dhe të IHD-ve, përcaktuesit e rritjes ekonomike në studimin tonë janë gjetur të jetë GDP fillestare, investimet e brendshme dhe IHD në ndërveprim me kapitalin human.

Ndërsa si përcaktues të IHDve janë, rritja e GDP për frymë, investimet e brendshme, remitancat dhe shpenzimet qeveritare.

Rezultatet analitike janë dhënë në tabelën (19), për rritjen ekonomike si e varur metoda e Efekteve Fikse, ndërsa në Tabelën (22), me metodën RE janë dhënë rezultatet analitike për IHD si e varur.

Fillimisht paraqesim rezultatet për vertetimin e hipotezës së parë: shkalla e rritjes së GDP për frymë- e varur, duke ju referuar tabelës 19, është parë shkalla e korrelacionit në mes vlerave të ndryshoreve (e varur dhe të pavarura).

Korrelacioni është negativ por që tregon një lidhshmëri të fort ndërmjet variablave (r ose $\text{corr}(u_i, X_b) = -0.975$). Ekuacioni i regresionit (në rastin tonë modeli logaritmik) tregoi vlerë të rëndësishme statistikore $F(7,179) = 17.30$, $p = 0.000$, me masë të fuqisë shpjeguese më të lartë se efektet e rastit, R-sq: within $R^2 = 40.3\%$, between $R^2 = 43.2\%$ dhe overall $R^2 = 19.2\%$, duke e bërë modelin e efekteve fikse të rëndësishëm për tu përdorur.

Pra pas testimit, fuqia shpjeguese është $R^2 = 41.6^{193} \%$ regresioni 4 tabela 19 (regresioni 1 deri 4, fuqia shpjeguese sillet nga 39.8% deri 41.6%, statistikisht janë të fuqishëm, tabela 19). Rezultatet treguan se 41.6 % e shkallës së rritjes së GDP për frymë mund të shpjegohen nga vlerat e variablave të pavarura, ndërkohë që 58.4 % e nivelit të rritjes së GDP për frymë shpjegohet nga faktorë të tjerë. Ndërsa konstantja prej 37.33% e parashehë modelin si të rëndësishëm.

Në rastin tonë tabela 19, në ekuacionin regresiv nuk janë të gjithë koeficientët pozitivë.

Në regresion 1 të tabelës 19, korelacioni në mesë GDP fillestare dhe rritjes ekonomike është negativë dhe statistikisht i rëndësishëm në nivelin 1 përqind. Në pajtim me pritjet,

¹⁹³ Të gjitha statistikatat në të dhëna panel sugjerojnë: R-squares nëse varion nga 0.39-0.41 sugjeron një fuqi shpjeguese të lartë për modelin tonë duke shpjeguar mbi 40 % të variacionit të variablës së varur, varet nga variacioni i variablave të pavarura në model.

koeficienti i PBB-së reale fillestare paraqet një sinjal negativ, duke treguar se hipoteza e konvergjences është vërtetuar.

Një shpjegim i mundshëm për një rezultat të tillë është niveli ulët i zhvillimit të shumicës së vendeve në analizë. Efekti catching-up është gjetur më lehtë në studimet empirike për vendet në zhvillim, në vend se në mesin e atyre të zhvilluara (psh. Borensztein et al., 1998). Rezultati është në përputhje me literaturën e rritjes, vendet në zhvillim shkojnë drejt niveleve të ekonomive më të përparuara.

Regresioni (1 deri 4) në tabelën 19 tregon se korrelacioni mes rritjes dhe IHD-ve është positive por statistikisht i parëndësishëm. Pra rezultati konfirmon disa nga gjetjet teorike të përcaktuara në kapitullin e dytë, koeficienti i IHD nuk është statistikisht i rëndësishëm. Kjo sigurisht që bie në kundërshtim me studimet e mëparshme, të cilat treguan një lidhje të fortë dhe pozitive ndërmjet rritjes dhe investimeve të huaja, De Gregorio (1992); Crowdhory dhe Mavrotas (2005:5).

Tabela (19) për IHD përmban vlerësimet “ndikim spontan” që do të thotë se IHD nuk janë vlersuar për një afat më të gjatë kohore.¹⁹⁴ Në regresionet 1 deri 4, gati të gjithë koeficientet e IHD-ve janë pozitivë, por statistikisht të parëndësishëm me koeficiente 0.0246. Ky rezultat nuk duhet të jetë i habitshëm sepse të gjitha vendet në moster kishin marrë sasi të parëndësishme të investimeve të huaja direkte gjatë viteve 2004 dhe 2014. Në fakt vendet e zhvilluara kanë përjetuar vështirësi në kushtet e një krize globale dhe në veqanti të asaj europiane, ndërsa vendet në zhvillim e kanë të vështirë marrjen e kredive prej kamatave të larta dhe gjithashtu shumica e hyrjeve të IHD është bërë përmes bashkimit dhe blerjeve (gjatë periudhës së privatizimit).

¹⁹⁴ Një gjë e tillë do të bëhet kur përdorim metoden Efektet e Rastit në ekuacionin e IHD-ve (tabela 22).

Variabli që përfaqëson kapitalin njerëzor (HC), është i lidhur negativisht me rritjen, duke kundërshtuar gjetjet teorike (pra ka efektë negativë dhe statistikisht të pa rëndësishëm).

Në regresionet 3 dhe 4, janë shtuar variablat ndërvepruese të cilat kanë një efektë pozitivë, pra ndryshimi nga ndërveprimi ($FDI * HC$) është pozitivë, dhe statistikisht i rëndësishëm në nivelin 10 përqind. Pra një rritje 10% e IHD dhe kapitalit human ndikon në rritjen ekonomike për 0.04% (tabela 19).

Matësi i nivelit të pragut të njohurive të kapitalit njerëzor (shkollimi sekondarë) është ende negative dhe statistikisht i pa rëndësishëm në të gjitha versionet e regresioneve të rritjes.

Përsëri ky rezultat nënkupton se të gjitha vendet në mostër janë duke përjetuar shkallë më të ulët të regjistrimit në shkollimin e mesëm gjatë periudhës së studimit.

Në studimet e mëparshme (Barro, 1991) gjeti një efekt pozitiv dhe të rëndësishëm të normës së regjistrimit në shkollimin e mesëm, si një ekujalent për kapitalin njerëzor.

Në regresionet, 1, 2, 3 dhe 4 në tabelën (19), shtojme variabla të rëndësishme të tilla si, investimet brendshme, IHD në bashkveprim me investime e brendshme ($IHD * IN.V.BR$), remitancat dhe shpenzimet e përgjithshme qeveritare.

Investimet e brendshme janë lidhur pozitivisht me rritjen ekonomike, dhe statistikisht janë të rëndësishme në nivelin 1%. Kjo do të thotë se një rritje prej 1 përqind e investimeve të brendshme shkakton rritje ekonomike prej 8.9 % . Pra baza ekonomike e këtyre vendeve mbështetet në Investime të brendshme.

Ndërsa kur bashkëveprojnë investimet e brendshme me IHD rezultati është i paparashikuar, i rëndësishëm në nivelin 10 përqind dhe me koeficient negativë (-0.00290 ose - 2.9%). Pra paraqitet efekti grumbullues jashtë “crowdin-out”, nivelet e fitimeve riatdhesohen. Pra IHD

kanë efekte grumbullues jashtë prej 10% duke shkaktuar ulje të rritjes ekonomike prej 2.9%, pra IHD janë zëvendësuese të investimeve të brendshme dhe jo plotësuese të tyre.

Kur masim efektin e variablave, remitancat dhe shpenzimet qeveritare në rritjen ekonomike, rezultatet nuk janë të dukshme. Kemi një efekte pozitive por statistikisht të parëndësishëm nga remitancat në rritje, do të thotë se pritjet për një rritje ekonomike në afatë më të gjatë nuk do të realizohen.

Ndërsa shpenzimet qeveritare kanë një koeficiente negativë dhe statistikisht të parëndësishëm në rritje, që do të thotë edhe përkundër aktivitetit të qeverisë rritja nuk është pozitive. Prandaj reduktimi në madhësinë e qeverisë mund të nxisë rritjen ekonomike, duke rritur aktivitetin ekonomik nga efekti grumbullues i qeverisë.

Rezultatet përfundimtarë për Hipotezën e dytë (tabela 22), ndikimi i rritjes ekonomike dhe përcaktuesve të tjerë në rritjen e Investimeve të huaja direkte - e varur

Fillimisht është parë shkalla e korrelacionit në mes vlerave të ndryshoreve (e varur dhe të pavarura). Korrelacioni është zero që nuk tregon një lidhshmëri të fort apo të dobët ndërmjet variablave (r ose $\text{corr}(u_i, X) = 0$).

Ekuacioni i regresionit (në rastin tonë modeli logaritmik), e tregoi statistikisht të rëndësishme Wald $\chi^2(5, 203) = 36.49$, dhe $p = 0.000$, me masë të fuqisë shpjeguese R-sq: within (brenda) $R^2 = 12.0\%$, R-sq Between (mes): 39.6%, R-sq Overall (përgjithshëm): 21.5% regresioni 4 tabela 22 (regresioni 1 deri 3, fuqia shpjeguese sillet nga 12.0% deri 39.6%).

Rezultatet treguan se 39.6 % e shkallës së rritjes së hyrjeve neto të IHD mund të shpjegohen nga vlerat e variablave të pavarura, ndërkohë që 60.4 % e nivelit tyre shpjegohet nga faktorë të tjerë të pa studjuar.

Përmes modelit të ktrorëve të vegjël të përgjithësuar (GLS), metodes se Efekteve të Rastit (RE), në ekuacionin e IHD si funksion i variablave shpjeguese, në tabelen 22, gjejmë efektin pozitivë dhe statistikishtë të rëndësishëm të rritjes së GDP për frymë në rritjen e IHD-ve.

Do të thotë se GDP për frymë është përcaktues i rëndësishëm i IHD-ve.

Edhe pse marrëdhënia në mes IHD-ve dhe normes së rritjes së GDP për frymë matur me modelin FE, dha rezultat statistikishtë të parëndësishëm, kur ne masim marrëdhënjen në mes normës së rritjes së GDP për frymë dhe IHD me modelin Efektet e Rastit, gjejmë një efektë pozitiv të koeficienteve të rritjes për frymë dhe statistikishtë të rëndësishëm në nivelin 1 përqind. Kjo do të thotë se rritja 1% e GDPsë për frymë shkakton rritje të IHD prej 2,8 përqind, pra IHD-të janë të varura nga rritja ekonomike.

Regresioni 1 deri 3 i tabelës 22, paraqet investimet e brendshme të rëndësishme për IHD në nivelin 1 përqind dhe me një koeficient pozitiv, pra një rritje prej vetem 1 përqind e investimeve të brendshme shkakton rritje të IHD prej 5,5 përqind. Kjo do të thotë se firmat e huaja janë konkurente me firmat vendore duke qenë zevendësuese të tyre. Firmat e brendshme kontribuojnë në investimet e huaja me fuqi punëtore dhe përmes kanaleve të ndërmjetme të furnizimit. Në afatë të shkurtë investimet e brendshme nuk kanë përfituar mjaftueshëm nga IHD, ndërsa në afat më të gjatë ato mund të përfitojnë nga përhapja e teknologjise dhe njohurive të firmave të huaja, dhe të bëhen konkurente me to.

Ndihet nevoja e përmirësimit të cilësisë së punës në firmat e brendshme, që të përfitojnë më shpejtë nga konkurentet e tyre (përhapja teknologjike dhe e njohurive të huaja).

Edhe remitancat krijojnë efekte pozitive në terheqjen e IHD, sepse të gjithë koeficientet në regresionet 1 deri 3 janë pozitiv në nivel rëndësie 5 përqind, që do të thotë se një rritje prej 5 përqind e remitancave do të rritë IHD për 3.4 përqind.

Edhe madhësia e qeverisë në regresionin 1 deri 3 në tabelen 22, ka koeficiente pozitive prej 0.052 përqind dhe nivel rëndësie prej 1 përqind, që do të thotë se një rritje prej 1 përqind e shpenzimeve qeveritare ndikon në rritjen e IHD prej 5.2 përqind. Efekti i shpenzimeve qeveritare (SHP.Q) kundërshton efektin grumbullim-jashtë parashikuar nga neoklasik në modelin e rritjes. Ky është një tregues se qeveritë në këto vende përpjekën të luajnë një rol kryesor në procesin e zhvillimit. Në të vërtetë, një pjesë e shpenzimeve qeveritare në këto vende është përdorur për të ndërtuar infrastrukture dhe institucionet për të tërhequr investimet e huaja. Megjithatë, edhe pse kanë tërhequr IHD shpenzimet qeveritare nuk janë faktori kryesor i rritjes në këto vende.

Si rezultat i paqëndrueshmërisë globale vendimet e kompanive të huaja të vazhdojnë të investojnë në këto vende shpesh ka ndryshuar, shihet nga statistikat me të ulta të flukseve hyrëse në vitet 2004-2014 (kapitulli III), në krahasim me vitet para studimit.

Si përmbledhje mund të themi se, analiza empirike e këtij studimi konstaton se shkalla e rritjes së GDP për frymë (rritja ekonomike) vazhdimisht dëshmon të jetë një shpjegues i rëndësishëm i hyrjeve të IHD në vendet europiane në mostër në nivelin e rëndësisë 1%.

Ndërsa IHD nuk janë në nivelin e rëndësisë së pritshme, edhe pse nuk janë negative janë statistikisht të parëndësishme. Variabla investimet e brendshme, shpenzimet qeveritare

dhe remitancat gjithashtu dëshmojnë se janë faktorë i rëndësishëm dhe pozitivë i hyrjeve të IHD në nivelin 1%, 10% dhe 5%.

Niveli i shkollimit sekondarë (kapitali human) në afat të shkurtë dhe afatgjatë (HC, lag_1HC, lag_2HC,), është i pa rëndësishëm, sidomos pas vlersimit të dallimeve në mes vendeve pataqitet rezultati negativë. Kjo shihet edhe nga koeficientët negative dhe p-vlerat pa asnjë nivel rëndësie. Kjo është në përputhje me gjetjet tona edhe në tabelen 19, se vendet në moster (vendet në zhvillim) kanë nevojë të ndryshojnë politikat e invetsimeve në arsim duke rritur ato, të ndryshojnë strukturën e arsimit në favor të arsimit profesional. Ndërsa shihet trendi ulës i regjistrimit në nivelin e mesëm të shkollimit, një përfshirje e madhe e tyre në shkollimin në shkenca sociale, një pragë mesatarë prej 14 % perqind për 24 vende, ndërsa veq e veq ky nivel nuk e tejkalon 10% për shumicën e vendeve në zhvillim (sidomos vendet e europes perendimore). Të gjitha këto karakteristika kanë kontribuar në dhënjen e një rezultatit pozitiv (negativ pas vlersimit me robust standard) dhe statistikishtë të parëndësishëm në të gjitha regresionet e të dhënave panel.

Kapitali human vetem në ndërveprim me IHD mund të sjellë efektin pozitivë në rritjen ekonomike. Do të thotë se IHD dhe kapitali human janë të rëndësishëm për njëri tjetrin, sepse IHD përmirëson kapitalin human ndërsa kapitali human më me lehtësi kapë efektin e përhapjes (indirekte) së teknologjise dhe njohurive që sjellin kompanite e huaja.

Edhe pse gjejmë një efekte direkt të IHD të parëndësishëm në rritje, ndërsa efekti indirektë është i rëndësishëm, mund të themi se IHD shihet si pako e përbërë nga aksionet e kapitalit dhe teknologjisë, si shtesë e njohurive përmesë trajnimit të punëtorëve, blerjes së

aftësive dhe shpërndarjes së tyre, futjes së praktikave të reja menaxheriale dhe organizative që së bashku përmirësojnë cilësinë e investimeve të përgjithshme dhe krijojnë rrethana për një rritje afatgjatë në vendet pritëse.

Përfundimet për analizen e pyetsorëve - Qëllimi i këtij studimi është të ndihmojë politikëbërësit në Kosovë në tërheqjen e kapitalit të jashtëm përmes politikave dhe proceseve vendimarrëse që përshtaten me objektivat e investitorëve. Institucionet kanë rëndësi në ekonomi dhe janë përfshirë në analizë.

Pjesa e të dhënave parësore, hedhë dritë mbi supozimet se investitorete huaj përveq se janë të motivuar nga perspektiva ekonomike për të investuar, janë të lidhur ngushtë edhe nga perspektiva institucionale, dhe në rast suksesi imitojnë partneret e tyre të sukseshem. Sinjalet pozitive që marrin nga partneret e tyre për klimen e investimeve, sigurinë e investimeve, sundimin e ligjit, stimujt fiskal, niveli i ulët i korrupsionit dhe infrastrukturë adekuate orientojnë vendimet e investitoreve në cilat vende të investojnë më sigurtë. Nëse shikohet Kosova në këtë perspektivë atëherë mundë të themi se investitorë nga Kosova nuk përfaqësojnë sinjale pozitive tek partnerët e tyre.

Hapja më e madhe ekonomisë ndaj tregtisë dhe investimeve, zbatimi i ligjit dhe rendit, fushë jo e lirë për korrupsion, një sistem tatimor i thjeshtë dhe i balancuar, ndërmjetës të fortë financiarë dhe një infrastrukturë urbane dhe rurale e shëndoshë do të kontribuonin pozitivisht që të vijnë sa më shumë IHD në Kosovë.

Investitoret shkojnë aty ku ata ndihen më të mirëpritur ose ku mund të kenë sukses në përpjekjet e tyre, gjë që në Kosove kjo nuk ndodhë gjithëherë.

Pjesa e pyetsorëve, hedhë dritë mbi shqetësimet e investitoreve të huaj dhe mundësitë që ofrojnë institucionet e Kosovës për një klimë të mirë të investimeve, identifikon shkaktarët dhe pasojat e tyre. Për të realizuar këtë është zhvilluar një anketë me një moster mjaftueshëm e përfaqësuar për kompanitë e huaja në Kosovë. Nga vlersimet e anketës delë se, shqetësimet kryesore nga investorët ekzistues janë: forcimin i proceseve demokratike, mbrojtjen e investorëve, neglizhenca e zyrtarë komunalë dhe në nivel ministror, mostransparenca e procedurave të tenderimit, mosinformimi i mjaftueshëm nga agjensioni për promovimin e investimeve APIK dhe MTI, procedurat burokratike, korrupsioni dhe nepotizmi.

Gjithashtu, mjedis politik i paqëndrueshëm, koha e shkurtër e kontratave të qerasë së objekteve, punëve kontraktuese, mos dhënja e tokës falas për një periudhë kohe, ndëshkime të larta nga ATK, ndryshimet e shpeshta ligjore, stimuj jo të mjaftueshëm, zbatimi i dobët i kontratave të punës. Infrastruktura dhe mjedisi fizik i dobët, parqet industriale jofunksionale, mjedisi politik jo i qëndrueshëm, zbatimi i dobët i ligjit, kontestet pronësore, etj.

Pengesat që secili investitorë i huaj potencial i ka parasyshë janë: vështirësitë në fillim të biznesit duke kërkuar pushime tatimore për vitin e parë, marrja me e lehtë e lejeve dhe licencave në nivel qendror, mbrojtja e investorëve, tregtia përtej kufijve dhe zbatimin i kontratave.

Të pyetur se cila është zona më me interes për të investuar, përgjigjja ishte: Prishtina rreth 30% ose 91 kompani nga gjithsej 306 të anketuar. Veprimtaria që dominon është tregtia 14.45 ose 44 kompani, ndërtimi i rrugëve 11.2% ose 34 kompani 6%, telekomunikacioni

5.8%, shërbime konsulence, hulumtimtregu, art dhe kulturë 10 % e tyre ose 31 kompani, nuk janë përgjigjur 34% e kompanive.

E konsiderojnë të rëndësishëm më shumë sektorin publik se privat, ndërsa konkurrencen si të pandershme edhe pse kompanitë e huaja me kapitalin e tyre dominojnë në tregun kosovarë (që kryesisht veprojnë biznese të vogla dhe të mesme).

Instrumentet e pamjaftueshme të zbatimit të politikës së qeverisë, bëjnë investitorët e huaj ta lëshojnë Kosovën. Investitorët e huaja janë të mendimit se janë të ndikuar negativisht nga autoritetet qendrore dhe lokale sa i përket zbatimit të ligjit dhe luftimit të korrupsionit si një ndër arsytet pse nuk qëndrojnë gjatë në Kosovë. Kompanitë e huaja mesatarisht qëndrojnë deri 5 vite përveq bankaveqë janë afer 16 vite dhe konkurente, konsiderohet se shumica janë regjistruar në vitin 2000, 2005 dhe 2010, 2012. Kompanitë e huaja kanë shuar veprimtarinë tyre rreth 25% gjatë viteve 2000-2012 ndërsa vetëm në vitin 2014 janë shuar 6% e tyre, një sinjal pse IHD ranë rreth 50% në vitin 2014.

Nga statistikat zyrtare të hyrave buxhetore dhe borgjeve të pa inkasuara nga kompani të huaja në Kosovë, jo gjithmonë ju japin të drejtë investitorëve huaj. Arsyet e pengesave të cekuara më lartë janë të qëndrueshme dhe vertetojnë opinionin e investitoreve, por qëndrimi i tyre i shkurtë në Kosovë lidhet edhe me evazionin e tyre të madhë fiskal, shumica prej të cileve nuk i është përgjigjur ligjit për pagesë të borgjit.

Ndërsa e konsiderojnë mjedisin e biznesit në Kosovë si të mirë dhe të arsyeshëm 70 % e tyre, është një opinion mjaft pozitiv dhe verteton se Kosova është ende tërheqese për investitorë të huaj.

Punësimi në kompani të huaja nuk është i lartë, janë rreth 20% e kompanive që nuk kanë asnjë të punësuar. Ka rënje të punësimit sidomos në sektorin bankar 31 % nga viti

2012 në 2014. Në pyetjen se çfarë i tërhoqi për të investuar, janë përgjigjur 46% se më e rëndësishmja konsiderohen të rinjtë të arsimuar dhe dinamikë, ndërsa rreth 51 përqind etyre e konsiderojnë fuqinë punëtore të lirë dhe mjaftueshëm të arsimuar për të plotësuar kërkesat e kompanive për forcë pune. Janë përgjigjur 39 % e investorëve se janë të rëndësishëm stimujt e taksave, ndërsa nxitjen për të investuar i konsiderojnë 43% si të parëndësishme, ndërsa mbështetjen institucionale e konsiderojnë të pamjaftueshme 40% e tyre. Si vështirësi i konsiderojnë korrupsionin dhe nepotizmin, procedurat burokratike 65 %, ndërsa infrastrukturën e dobët e konsiderojnë 31.4 %.

Si veprime të nevojshme të qeverisë i konsiderojnë: mungesa e zbatimit të ligjit 7%, ekonomia informale 7%, profesionalizmi 8 %, stimujt në bujqësi 8%, tarifatat dhe ligjet doganore 8%, kontestet e pazgjidhura tregtare 7 % etj. Ndërsa reformat administrative i konsiderojnë të dobishme 37%, heqjen e procedurave 52%, mundësi për të investuar kanë dhënë vetëm 41 % e investorëve ndërsa 59% e tyre nuk do të investojnë përsëri në Kosovë. Kjo është një prognozë jo e mirë për investimet në Kosovë.

Zonat me interes për të investuar i konsiderojnë transportin rrugor dhe ndërtimi i rrugëve 48 %, miniera 7% , bujqësisë 9%, industrisë së ushqimit 3%, tekstilit 5 % etj. Madhësia e investimit që mund të bëjnë është deri në 10 milionë euro 82% e kompanive, deri në 50 milionë euro 7 %, mbi 50 milionë euro 5% dhe nuk janë përgjigjur 6%.

Duke u nisur nga të gjeturat dhe evidentimi i dukurive negative që shkaktojnë ikjen e kompanive të huaja që aktualisht janë në Kosovë dhe uljen e motivit për të investuar, rekomandohet që politikat për investime të huaja të rishikohen duke i zbatuar me përpikëri: institucione të pakorruptuara, reformat strukturore në ekonomi, stimujt fiskal dhe sundimi i ligjit janë parakushte për të tërhequr investitorë të huaj në Kosovë.

Ndërsa në anën tjetër mundësitë që ofron Kosova për IHD duke filluar nga burime natyrore, sektorë strategjik publik dhe privat, popullsia e re, kosto e ulët e punës, etj.

Kjo tezë nuk ka për qëllim të siguroj një qëndrim të përgjithshëm për teoritë e rritjes së IHDve dhe teorinë institucionale në nivel ndërkombëtarë, dhe nuk tregon se gjetjet e tij të mos ndryshojnë nga studime të natyres së tillë në të ardhmen. Qëllimi ynë është që së pari, të kontribuoj në formimin e një burimi të fortë analize të rritjes ekonomike dhe IHD në një platformë më të gjërë se vetëm për Kosovë më ndryshe se në tregtinë ndërkombëtare, veqanërisht një analizë të mirëfillt institucioneve në Kosovë në kontestin e IHDve, sepse ato duhet të jenë në qendër të vëmendjes, ose të merren në konsideratë në studime të ardhme në shkencat ekonomike në Kosovë.

Gjetjet dhe të gjitha perpjekjet tona nuk i konsideroj të pazëvendësueshme, ato mund të jenë subjekt i shqyrtimit shkencor, eksplorimit, kritikës për një përmirësim në të ardhmen.

6.2 Rekomandimet e Studimit

Qëllimi i kësaj teze është të hetojë a kanë bërë zgjedhje të mirë investitorët e huaj kur kanë investuar në 24 vende europiane dhe veqanërisht në Kosovë, cili ka qenë përfitimi i tyre më i madhë. Hulumtimet e mëparshme dhe korniza teorike ka sugjeruar përcaktues të ndryshëm të rëndësishëm. Qasja e këtij studimi është e atillë që marrë në konsideratë dy kënvështime duke ndërtuar dy ekuacione, secili variablën e varur të ndryshme dhe që historikisht secila ka mbështetje empirike. Variabla në nivel vendi - makro (rritja e GDP për frymë, GDPfillestare, shpenzimet qeveritare, remitancat) dhe në nivel firme (IHD, INV,

HC). Literatura e ndryshme për rritjen ekonomike dhe IHD formoj bazen e këtij studimi duke zgjeruar punën e Boreinsztein (1998), me përfshirjen e variabla shtesë në analizë.

Shumica e literaturës kanë theksuar se kapitali vendas dhe i huaj ishin statistikishtë të rëndësishëm në rritjen ekonomike në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore. Në total të gjitha variablat janë të rëndësishme qoftë pozitive apo negative, dhe nuk ka variablë fare të parëndësishme. Fuqia e kësaj analize ishte madhësia e të dhënave në nivel vendi, një grup prej 24 vendeve të përfshira gjatë një periudhe kohore prej 11 viteve. Kjo mundësoj të kapen ndryshimet e mëdha në mesë vendeve dhe me kalimin e kohës, me shumë se shumica e studimeve të ngjashme gjatë kësaj kohe sidomos për Kosovë.

Rezultatet tona konfirmojnë se duke kombinuar efektin pozitiv të IHDve dhe statistikishtë të parëndësishëm me përhapje pozitive ($IHD*HC$), ne jemi në gjendje për të konfirmuar një ndikim të përgjithshëm pozitiv të IHD në rritjen ekonomike në EQ dhe EJT përfshirë edhe Kosoven. Në rastin tonë nuk themi absolutishtë, se variablat e zgjedhura janë më të rëndësishme për këto vende, por shtojmë në radhën e literaturës edhe një rast tjetër i analizuar në mënyrë empirike për studime të ardhshme.

Rasti i 24 vendeve europiane është i rëndësishëm për tu marrë parasyshë dhe rezultatet përgjithësishtë janë të qarta, dhe nuk janë vetëm studjuesit që përfitojnë nga ky studim. Janë edhe korporatat e vendeve europiane që përfitojnë, dhe politikat qeveritare sidomos të vendeve në zhvillim të ndryshojnë politikat e tyre për shpenzimet qeveritare që kanë destinacion arsimin e mesëm të lartë që konsiderohet kushtë për terheqjen e IHD-ve në EQ dhe EJT. Gjithashtu vertetohet se baza e rritjes ekonomike nuk do të jenë remitancat

por janë Investimet e brendshme për të cilat duhet krijuar ambientë i shëndoshë biznesi dhe një politikë e menqur për të krijuar bashkëpunim në mes bizneseve vendore dhe IHDve, jo si deri më tani ku shumica e IHD janë grumbulluar në sektorë të caktuar dhe vende të caktuara duke qenë konkurrentë në raportë me Investimet e brendshme (në shumicën e vendeve mund të jetë arsyeja e privatizimit masiv gjatë periudhes së studimit). Se cilat janë variablat më të sukseshme, kompanitë mund të vendosin se cili vend është më i rëndësishëm, si p.sh., në vendet në tranzicion është shumë i rëndësishëm dhe tërheqës për IHD, kapitali human në nivelin e mesëm të shkollimit ndërsa në vendet e zhvilluara IHD nuk tërheqen nga kjo variabël. Kjo dëshmon pse nuk kanë ndikuar në rezultatet e studimit shtate vendet e zhvilluara kur dihet se kanë një shkollim të mesëm të zhvilluar.

Si përmbledhje e vertetimit të hipotezës së parë themi se, nga rezultatet e specifikuara më lartë përmes katroreve të vegjel (Least Squares) dhe Efekteve Fikse (FE) mund të nxjerrim si përfundim se efekti i konvergjencës është arritur, edhe investimet private ndihmojnë rritjen ekonomike, ndërsa IHD dhe shkollimi veqmas nuk janë të rëndësishëm për rritjen. Vetem termi ndërveprim mes dy variablave është i rëndësishëm. Nga vlerësimi i modelit shihet se shumica e variablave (IHD, HC, SHPKFQ, REM) nuk kanë dhënë shenjat e pritura, nuk janë statistikisht të rëndësishme (H1), në H2 janë të gjitha të rëndësishme.

Pra qëllim kryesor i kësaj teze ishte hetimi empirik i implikimeve dhe marrëdhënieve në mes rritjes ekonomike dhe IHD, kontributit plotësues të kapitalit human, investimeve të brendshme dhe faktorëve tjerë (remitancave dhe shpenzimeve të qeverisë) në rritjen

ekonomike. Rezultatet sugjerojnë se faktorët e kapacitetit absorbues¹⁹⁵ të vendit pritës janë vendimtarë për përcaktimin e rritjes ekonomike dhe të IHD-ve. Studimi sugjeron se një politikë mbështetëse nëpërmirësimin e IHD-ve, investimeve të brendshme dhe një cilësi më të lartë të kapitalit human (niveli i mesëm i shkollimit), një ulje e shpenzimeve qeveritare apo drejtim i tyre në projekte me kthime pozitive do të tejkaloj hendekun e teknologjisë në shumicën e vendeve në zhvillim në Europë (17 vende në zhvillim) dhe inkurajon aftësinë rritëse të ekonomisë. Ndërsa nuk duhet të shihen remitancat si një përcaktues i rëndësishëm i rritjes në një afat të gjatë edhe pse vlera e tyre tani është domethënëse.

Implikimet

Gjetjet mbi rëndësinë e cilësisë dhe stabilitetit institucional, rendit dhe ligjit dhe llogaridhënies demokratike në tërheqjen e IHD janë fusha të veçanta të cilat politikëbërësit duhet të përqëndrojnë përpjekjet e tyre në përmirësimin sa më të shpejtë. Këta faktorë janë më në krye të shqetësimeve të investitorëve ndërkombëtarë që janë në Kosovë.

-Hulumtimi ka dhënë një pamje të plotë të përcaktuesve të IHD-ve dhe rritjes ekonomike në rajonin e Europës. Është konfirmuar rëndësia e disa përcaktuesve tradicionale që do të ndikojnë në marrjen e vendimeve për të investuar në rajon dhe Kosovë.

¹⁹⁵Borensztein et al. (1998), Xu (2000), Alfaro et al (2004), Li dhe Liu (2005) dhe Kinoshita dhe Lu (2006), konfirmuan nga gjetjet e tyre që IHD mund të kontribuojnë pozitivisht në rritjen ekonomike, por madhësia dhe efekti i tyre varet nga kushtet e vendit pritës.

